

Dr. Abdulmuhsin Abdullah El Xharullah El Harafi

Rrugëtimi
PËR NË SHTËPINË
E FALËNDERIMIT

RRUGËTIMI PËR NË SHTËPINË E FALËNDERIMIT

Dr. Abdulmuhsin Abdullah El Xharullah El Harafij

Prishtinë, 1438h/2017

Titulli:

Rrugëtimi për në shtëpinë e falënderimit

Autor:

Dr. Abdulmuhsin Abdullah El Xharullah El Harafi

E përkthyen nga arabishtja:

Miftar Ajdini & Mulaim Shehu

Redaktor:

Mr. Amir B. Ahmeti

Lektor:

Dr. Hysen Matoshi

Boton: Shtëpia Botuese “Gjurma-botime” (gjurma-botime.com), Prishtinë.

©Gjurma, 2017. Të drejtat ekskluzive për botim dhe shpërndarje në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni i ka Shtëpia Botuese “Gjurma-botime” - Prishtinë. e-mail: info@gjurma-botime.com

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Ndalohet botimi i plotë apo i pjesshëm i këtij libri në çfarëdo forme, përveç në raste të citimit të shkurtër në botime kritike apo recensione.

Shtypi:

Graf-Ing – Prishtinë

Tirazhi:1000

Gusht, 2017

ISBN 978-9951- 427-50- 0

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

O Abdullah, o fryt i zemrës sime!

Ky libër është pasqyrim e një përvoje, në të cilën jemi zhytur me ndjenja të shumta prindërore, që prindi yt dëshiron ta shkruajë dhe ta ndajë si mësim mbi mësim.

Nëse historia përbëhet nga tregime që shkruhen dhe rrëfohen, atëherë ti, loçka e zemrës sime, nuk do të jesh për mua histori, por do të jesh i gjallë sa të jem unë.

Nëna jote.

Përkushtim

Shpirtit të djalit tim, Abdullahut, që më ka paraprirë në “Shtëpinë e falënderimit”, me vullnetin e Allahut, me nderin dhe me premtimin e Tij të sinqertë.

Dhe shoqërueses së rrugëtimit për në “Shtëpinë e falënderimit”, shoqërueses së shtegut, nënës së Abdullahut!

*Motrave të Abdullahut, të dhembshura për të dhe për prindërit e tij!
Të gjithë anëtarëve të familjes së tij dhe dashamirëve të shqetësuar për rininë e tij!*

Miqve të tij besnikë, që ishin shokë të tij të mrekullueshëm në këtë botë dhe pas kalimit të tij në të përtejmen!

Të gjithë të dashurve, që luteshin për shërimin e tij gjatë ditëve të mjekimit!

Të gjithë të dashurve që luten për mëshirë dhe falje të mëkateve pas kalimit të tij në “Shtëpinë e falënderimit”, me vullnetin e Allahut, me nderin dhe me mëshirën e Tij!

Ua përkushtoj këtë libër.

Autori

Falënderim Dhe Lutje

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

Falënderimi i takon Allahut në çdo rast dhe në çdo çast!

Falënderimi i takon Allahut, Atij që nuk falënderohet me dhunë!

Ai është që dha dhe mori! Andaj i Lartësuar është Ai, nga përcaktimi i të Cilit nuk ka kthim!

Ai dhuroi jetën... përcaktoi ymrin... dhe në të zgjodhi atë që do Ai nga robërit e Tij për fisnikëri me rënien dëshmor!

*Ai përcaktoi jetën e rinisë, që prindërit e tyre të privohen nga mundësia e lutjeve të fëmijëve për ta, pas kalimit të tyre si pasardhës të mirë që (do të) luten për ta. Mirëpo, për këtë, Ai ua kompensoi atyre, me një kompensim më të madh sikurse ju la zëvendësim më të mirë, kur ua premtoi atyre “Shtëpinë e falënderimit”, nëse durojnë, përmbahen, falënderojnë Allahun e Madhërishëm dhe thonë: **“Me të vërtetë, ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi!”***

Allah, dhuroja robit Tënd, Abdullahut, mëshirën Tënde të madhe, mundësoja që të banojë në xhenetet e Tua të gjera dhe përcaktoja shpërblimin e shehidëve, për të cilët ka treguar i dashuri Yt, Pejgamberi s.a.v.s.! O Zoti i botëve, ndriçoja varrin dhe bëje që të jetë një kopsht nga kopshtet e xhenetit!

O Zoti ynë, na përcakto që të jemi nga robërit e Tu të mirë, të durueshëm, të përmbajtur, të falur nga mëkatet dhe të kënaqur.

O Zoti ynë, bekoje atë që ka mbetur nga jeta dhe veprat tona dhe mundësona që të jemi banorë të xheneteve më të larta me prindërit tanë, me të dashurit, me njerëzit e mirë dhe me shehidët, sa shokë të mirë që janë!

O Zoti ynë, mbushi zemrat tona dhe të pasardhësve tanë me dashuri dhe me dëshirë për besnikëri ndaj Teje, që, nëpërmjet saj, të jemi të lumtur në të dyja botët!

¹ Fjala: Istirxha', në vazhdim të librit do të përdoret si shkurtesë në vend të ajetit kuranor: **“Me të vërtetë ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi!”**

Falënderim dhe vlerësim për princin njeri!²

Ai ka lënë një gjurmë në shpirtrat tanë brenda shenjave të rrugëtimit për në “Shtëpinë e falënderimit”.

Shkëlqesia e tij, Sabah El Ahmed El-Xhabir Es-Sabah... Princi njeri... Emiri i shtetit të Kuvajtit.

Ai, si zakonisht, ishte princ i dashur për popullin e tij, kurse unë dhe djali im patëm nderin ta gëzonim një pjesë të asaj dashurie.

Pa ndonjë hezitim dhe me një spontanitet të plotë, ai shfaqti dhembshuri për Abdullahun, që nga fillimi i sëmundjes së tij, duke u interesuar për të, meqë e dinte se ai ishte djalë i vetëm i prindërve dhe motrave të tij, i sapodiplomuar, por Allahu është përcaktues i çështjes së tij!

Shkëlqesia e tij, kur vdiq Abdullahu, Allahu e mëshiroftë, e përcolli për ta varrosur, duke shfaqur vullnet të pjesëmarrjes në ngushëllime. Pasi përfundoi plotësisht varrimin, në ikindinë e së mërkurës, më 1 tetor 2014, ai e ndërpreu pushimin e tij, të enjten, më 2 tetor 2014, dhe mori pjesë si i vetëm, i shoqëruar vetëm nga shoferi i veturës, pa autokolonë zyrtare, pa truproja dhe pa mbrojtje; sepse ai e dinte se zemrat e familjes së tij dhe të popullit të tij dhe shtetasit e Kuvajtit janë për të mbrojtja e vërtetë!

Ai qëndroi në pamjen e ngushëllimit një kohë duke dëgjuar me ngrohësi komplimentet për interesimin e madh, dhe duke iu shprehur mirënjohje për besnikëri të gjithë përgjegjësve, gjatë mjekimit të tij në Kuvajt dhe jashtë tij. Ja përmenda atij - pa ndonjë kompliment - se unë vetëm tash i kuptova përmasat e pikëllimit që ndjeu ai kur e humbi vajzën e tij të çmuar, Selven, të cilën e kaploi e njëjta sëmundje në një pjesë tjetër të trupit, e cila është sëmundje e pashërueshme, që infiltrohet pa dallim në ndonjërin nga organet e trupit! Andaj, si do që të jetë, falënderimi i takon Allahut!

Kur ai e pa se ngushëllimi po ia merrte kohën, vendosi që të shkonte! Por, kur unë vendosa të dilja me shkëlqesinë e tij, për ta shoqëruar deri te vetura, në shenjë mirënjohjeje dhe vlerësimi nga unë, për praninë e tij në të pame, ai u ndal në vend dhe u betua që unë mos të lëvizim nga vendi. Ndaj, Allahu përcaktoi, që të shprehem spontanisht, po ashtu duke u

² Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 17. 1. 2016.

betuar që ta shoqëroja deri tek vetura e tij, si mirënjohje dhe vlerësim ndaj tij! Mirëpo, kur ai nguli këmbë që unë të qëndroja në vendin tim, bëra shaka duke thënë: “Jetë të gjatë... që do të thotë, unë do të agjëroj tri ditë, si shpajmim për mëkatën e betimit, në përcjelljen tënde”. Atëherë ai filloi me intuitën e natyrshme, me buzëqeshjen e çiltër dhe shpirtin fisnik duke thënë: “Vallë, a dëshiron që edhe unë pastaj të agjëroj tri ditë?”

Për këtë të gjithë buzëqeshëm! Atë e përcolli një tjetër, që ishte më i vjetër se unë dhe kishte afërsi familjare, siç i ka hije shkëlqesisë së tij, Allahu e ruajt!

Ne kështu jemi në Kuvajt, në pikëllim dhe në gëzim, ruajmë raportin ndërmjet sunduesit dhe sunduarit! Që kur u njoha me jetën, i kuptova trashëgimtarët dhe tërë individët e familjes mbretërore, që shoqërohen mirë me popullin e tyre, në gëzime dhe në pikëllime, meqë kjo është një gjë e rëndomtë për ta! Këtë mirësi e gëzon shoqëria kuvajtiane në kontakte të vazhdueshme ndërmjet sunduesit dhe të sunduarit!

Ju faleminderit, shkëlqesia juaj, o princ njeri!

Përse ky libër?

Për shtatë arsye:

1. Sepse ai është transferim i një vuajtjeje dhe përforsim i një përvoje, e cila ndoshta mund të jetë e dobishme për ata që kanë nevojë.
2. Sepse ai është një sintezë e pashembullt, për njohuritë e nevojshme lidhur me: ★ sëmundjen ★ mjekimin ★ vdekjen.
3. Sepse në të ka paralajmërim për të shkujdesurin, leksion për injorantin dhe konsolidim për punëtorin, secili në fushën e tij.
4. Sepse ai ka përfshirë ndërmjet aromës së kaluar dhe stilit aktual në fushën dhe tematikën e tij ndërmjet kopertinave të një libri!
5. Sepse ai është një dhuratë për secilin nevojtar në tematikën e tij, sepse në të ka mësim dhe kujtim.
6. Sepse në të ka informata të dobishme, urtësi të fuqishme dhe përfitime të reja!
7. Sepse në të ka të tillë, që kanë përjetuar eksperiencën të ngjashme me përmbajtje të pasur, por ndoshta ata nuk kanë nivel të lartë të shprehjes, apo oratori të mirë për hartimin e eksperiencës së tyre, pa ndonjë hezitim apo falsitet, duke dëshiruar që të tjerët të përfitojnë prej tij!

Përfituesit prej këtij libri

1. Të sprovuarit me sëmundje, familjet dhe përcjellësit e tyre.
2. Mjekuesit e sëmundjes.
3. Të sprovuarit me vdekjen e fëmijëve dhe të dashurve të tyre!
4. Të huajt për mjekim në Kuvajt apo jashtë vendit në përgjithësi, si në SHBA veçmas.
5. Të shëndoshët, që dëshirojnë të pajisen me kulturën e sëmundjes, kulturën e mjekimit dhe kulturën e sprovës, me rastin e vdekjes së fëmijëve dhe të dashurve të tyre!

Andaj, duke falënderuar dhe duke shpërblyer, kërkojmë prej tyre lutje, pa ndonjë detyrim!

Një referencë që e veçon dhe e karakterizon këtë libër

Është e njohur se qëndrimi panegjirik i shkrimtarit për librin e tij është një lëndim për të!

Allahu e di se kurrresi nuk ishte qëllimi për kompliment ndaj këtij libri!

Sikur të mos ishte përcaktimi i Allahut, që çështjet lëvizën në kërkimin e ndihmës për redaktim gjuhësor, pas përpilimit të librit, si përgatitje për dorëzim në shtypshkronjë, nëpërmjet mikut bamirës, Dr. Ahmed Sejjid Ahmed Ali, i cili më së miri shfrytëzoi bamirësinë e familjes dhe shokëve nga Universiteti i El-Ez'herit, ndaj ai meriton mirënjohje për redakturën gjuhësore dhe margjinat, për shqyrtimet shkencore brilante në shtjellimin e disa haditheve të theksuara, si dhe për disa vërejtje gjuhësore, të cilat ndikojnë dhe ndërveprojnë me këtë libër! Kështu, ai më sqaroi – sipas vështrimit të tij fisnik – aspekte të shumta që të dallohet ky libër në kapitujt e tij dhe të karakterizohet në bibliotekën arabe dhe islame!

Unë nuk parapëlqeva që ta filloja këtë libër me rekomandim që nga fillimi me aspekte dalluese dhe karakteristike, të cilat i përmendi ai! Andaj parapëlqeva shtyrjen e tyre në “pashënie”, si një rezymë e rezultateve të librit dhe fryt për lexuesin e nderuar dhe të interesuar, i cili arriti duke e lexuar librin deri në fund, me rrugëtimin tim për në “Shtëpinë e falënderimit”, deri në përfundimin e tij në këtë botë!

Pikënisja e librit

Libri fillon me bindje të plotë - pa pikë dyshimi - me realizimin e premtimit të Allahut të Madhërishëm, të cekur në hadith, transmetimin e të cilit e kemi shtjelluar në këtë libër! Kështu, ai vë në pah se Allahu i Madhërishëm i urdhëron melekët e nderuar, që të ndërtojnë një shtëpi në Xhenet dhe ta quajnë “Shtëpia e falënderimit”, për secilin që ka humbur fëmijën e tij, që ka treguar durim, e ka falënderuar Allahun e Madhërishëm dhe e ka bërë istirxa’, përkatësisht, e ka thënë shprehjen: **“Vërtet ne jemi të Allahut dhe tek ai do të kthehemi”**.

Andaj, ky është një rrugëtim i bekuar, me vullnetin e Allahut, në hapësirën e Kuranit dhe Sunetit, që nëpërmjet tij ta përcjellim përvojën modeste nëpër fazat e sëmundjes dhe vdekjes tek ata që mund të përfitojnë prej saj.

Sa shumë më ka inkurajuar për të ecur në pikënisjen time deri te botimi i këtij libri, ndërveprimi i madh dhe i mrekullueshëm i lexuesve të nderuar dhe përcjellja e tyre e serisë së bukur të artikujve të mi në gazetën “El-Kabes”, me titull “Rrugëtimi im me Abdullahun për në Shtëpinë e falënderimit.

Filozofia e radhitjes së përmbajtjes së librit

Libri nuk është ndarë në artikuj dhe kapituj si ndodh zakonisht te shumica e librave të mi në përputhje me natyrën e temave të tyre, por ky libër – siç do t'i duket lexuesit të nderuar – është shprehje e mendimeve të ndryshme, i ngjashëm me tabelat e orientimit në rrugëtimin e këndshëm me Abdullahun, për në Shtëpinë e falënderimit. Andaj, i kam paraqitur ato pa ndonjë radhitje të sistemuar, siç e kërkon përpilimi i tyre në artikuj dhe kapituj, që fryt i saj të jetë përkujdesja për faktorin e joshjes në prezantimin e përmbajtjeve të atyre treguesve të orientimit, kur të kalohet prej një teme në tjetrën pa ndonjë radhitje logjike të parashikuar.

Sidoqoftë, këto janë përpjekje të ndryshme të cilat i kërkon natyra e artikullit dhe rrethanat e tij.

Ajo që më inkurajoi në këtë orientim është se shumë pjesë nga përmbajtja e librit i kam filluar në formë të artikujve gazetareske, që kanë vazhduar më shumë se një vit të plotë, në paraqitje pothuajse javore. Të gjithë ne e dimë mundësinë e kufizuar të hapësirës për artikullin e publikuar në çfarëdo gazete, veçmas në gazetën *El Kabes*, që ka një etikë gazetareske, e cila ma imponon një kriter të rëndësishëm për respektim, siç e respektojnë të gjithë shkrimtarët kur i shkruajnë artikujt e tyre.

Po ashtu ajo që më inkurajoi në shtytjen e këtij orientimi është mirëpritja e artikujve nga lexuesit, të cilët i kam shkruar për përfitim të përgjithshëm dhe përcjellje të përvojës, në mënyrë që të tjerët të mos fillojnë nga zeroja në disa informacione, sidomos për ata që nuk kanë njohuri si kultura e sëmudjes, kultura e mjekimit dhe kultura e vdekjes.

Sa për dijeni, tashmë e kam theksuar në aneks të librit vazhdimësinë e atyre artikujve sipas kronologjisë së botimit dhe lidhshmërinë ndërmjet tyre dhe përmbajtjes së librit, duke i konsideruar si stacione në shtegun e rrugëtimin, që është titulli, të cilin e kam zgjedhur për emërtimin e përmbajtjeve të këtij libri!

Kjo radhitje, sipas vazhdimësisë së saj, kurrsesi nuk do të thotë se flet për rëndësinë e tematikave dhe përfitimin prej tyre, ngase të gjitha ato janë të dobishme! Kështu, të gjitha ato janë të rëndësishme, andaj nuk kam gjetur ndërmjet tyre dallime që do ta bënin të nevojshëm klasifikimin e tyre në artikuj dhe kapituj.

Po ashtu është e natyrshme që këto shkrime të çlirohen nga disa pranga dhe përkufizime të hulumtimit metodiko - shkencor, që mund të krijojnë vështirësi për disa lexues dhe t'i shpërqendrojnë ata nga qëllimi sublim i këtyre shkrimeve!

Gjuha e librit

E falënderoj Allahun e Plotfuqishëm, i Cili më ndihmoi për të shkruar dhe publikuar 15 libra, si autor dhe një serie artikujsh dhe si kryeredaktor. Të gjitha këto i kam shkruar në një gjuhë lehtë, sipas kontekstit të tematikës së tyre. Kështu, të gjitha këto shkrime u mirëpritën nga lexuesit – falë Allahut – duke iu shmangur ndërlikimit dhe panatyrshmërisë, meqë ishin tema të konceptuara, larg nga analiza e thellë, që është çështje e studiuesve të specializuar në histori dhe në konceptet politike të ngjarjeve!

Andaj, shkas për hartimin e atyre librave ishte nevoja për një konsolidim të asaj që nuk ishte konsoliduar, veçmas në ndonjë lëmë ku nuk kishite përfunduar shërbimi i tij, që është konsolidimi i jetëshkrimeve dhe biografive të bamirësve dhe bamirëseve në Kuvajtin e djeshëm dhe të sotëm në veçanti, kurse e burrave dhe grave eminente të Kuvajtit në përgjithësi. Për këtë arsye, ishte i natyrshëm përdorimi i gjuhës së prezantimit të thjeshtë historik dhe besnik me komente besimore, sociale, apo arsimore, sipas nevojës!

Sa i përket gjuhës së këtij libri, atë e kam shkruar nga thellësia e ndërgegjes, aq sa pothuajse secila faqe e tij lahet me lotët e autorit! Në të i kam gërshetuar shprehjet me bojën e shkrimit. Ato shprehin realitet të një jetese e jo përfytyrimin teorik, apo kornize imagjinare, apo mendimi të përpjekjes!

Shpeshherë e kam përsëritur shprehjen tërheqëse se “ajo që del nga zemra, depërton në zemër, kurse ajo që del nga veshët, nuk depërton në veshë.”

Kështu, ky është ai shpirti, nëpërmjet të cilit e kam shkruar gjuhën e librit! Përndryshe, gjuha arabe – siç është e qartë – është gjuha e këtij libri. Megjithatë, gjuha arabe është mbartëse e aspekteve të ndryshme: ajo mbart fushën e letërsisë, fushën e shkencës, fushën arsimore-shkencore. Ajo mbart qëndrueshmëri dhe mbështetje sipas kujdesit dhe aftësisë së autorit. Ndaj gjuha arabe është manifestuar me imazhet e saj më të mrekullueshme në Kuranin famëlartë, i cili sikur të zbritet mbi ndonjë kodër, atëherë ti do ta shihje atë të strukur e të çarë nga frika ndaj Allahut. Kjo dëshmon madhështinë e gjuhës arabe, që në këtë gjuhë ka zbritur Kurani famëlartë! E si jo, kur nëpërmjet saj Allahu i Plotfuqishëm ka sfiduar oratorët dhe eloquentët arabë që të sjellin madje një ajet të ngjashëm me të, e të mos

flasim për një sure, por ata ishin të pafuqishëm, andaj mbetën si të shtangur!

Duke iu kthyer fillimit... për qëllim është qartësimi i natyrës së gjuhës me të cilën e kam shkruar këtë libër, që del nga thellësia e zemrës, pa ndonjë shtrëngim, për të shprehur mendimin e fshehtë të autorit, që më pas nuk ka nevojë për asnjë fije të konfirmimit të besueshmërisë! Për këtë që po e them, Allahun e kam dëshmitar.

Mendoj se është e meritueshme që në këtë kontekst t'i shpreh mirënjohje të madhe Prof. Hazim Ali Mahirit, i cili ka lënë mbresa të këndshme në një paraqitje serioze të kësaj gjuhe në disa tematika të librit në fjalë!

Një fjalë falënderuese para rrugëtimit³

Duke u nisur nga parimi se veçantia e shkakut nuk është pengesë për përfitim të përgjithshëm, unë i bëra këto ndalesa reflektimi tek tabelat e shtegut të rrugëtimit me djalin tim, Abdullahun, për në Shtëpinë e falënderimit, e cila u është premtuar nga Allahu i Plotfuqishëm, përmes gjuhës së Pejgamberit, s.a.v.s., prindërve të cilët e pranojnë fatkeqësinë e humbjes së djalit apo vajzës së tyre, duke falënderuar Allahun, Zotin e botëve dhe duke e thënë me bindje shprehjen: **“Vërtet ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi”**, siç e transmetojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu në hadith sahih!

Ndoshta, qëndrimi i parë në këtë rrugëtim do të jetë te fjala e sinqertë nga zemra, që ua drejtoj të gjithë atyre, që e deshën Abdullahun dhe së pari u lutën për shërimin e tij, e pastaj për faljen e mëkateve dhe për mëshirë pas vdekjes së tij. Ata shprehën dashuri edhe ndaj prindërve të tij, duke u lutur për ta që të kenë durueshmëri dhe qëndrueshmëri! Kështu, më pas unë i shpreh falënderimet e mia për kuvajtianët në përgjithësi: Emirin, Qeverinë dhe popullin, të cilët shfaqën interesim të madh ndaj të mëshiruarit, me vullnetin e Allahut të Plotfuqishëm dhe e përcollën mjekimin e tij.

Vëllezër dhe motra, ju që u lutët për shërimin e Abdullahut gjatë mjekimit të tij, dhe për falje mëkatesh e mëshirë pas vdekjes së tij, që na ngushëlluat me të gjitha mënyrat, si brenda në Kuvajt, ashtu edhe jashtë tij – Allahu ju shpërbleftë me të mira dhe ju falënderoj për ndjenjat tuaja të sinqerta dhe zemërgjera, që na i mbushët zemrat me hare, mua dhe nënës së tij të dhembshur, motrave dhe familjes tij! Ju dërguat qetësi dhe prehje në zemrat tona, ku u bindëm se Allahu i Madhërishëm, na është përgjigjur, siç na ka premtuar me bujarinë dhe mëshirën e Tij. Andaj, me bindjen tonë, për mundësinë e formave të shumta të përgjigjes, siç është theksuar nga Pejgamberi s.a.v.s.; ose me realizimin e kërkesës në jetën e kësaj bote, ose kursim i shpërblimit të ngjashëm në botën e përtejme, ose shlyerje e veprave të këqija!

Prandaj, e lusim Allahun që Abdullahu ta gëzojë fatin e plotë në siharrin e parë dhe të dytë, ashtu siç ka premtuar Allahu i Madhërishëm dhe ju gëzoj juve, siç kanë dhënë fetva dijetarët, se i vdekuri nga kanceri

³ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 12. 10. 2014.

konsiderohet shehid, me vullnetin e Allahut, në analogji me atë që është cekur në hadithin autentik për përcaktimin e llojeve të shehidëve, e ata janë:

Shehidi në rrugë të Allahut, ai që vdes nga murtaja, ai që vdes nga sëmundjet e barkut, ai që mbytet në ujë, ai që pëson nga zjarri – digjet, ai që vdes në rrënoja.

Numri i madh i llojeve të shehidëve është mëshirë e madhe për umetin e Muhamedit, s.a.v.s., të cilët ndërmjetësojnë për prindërit e tyre dhe të afërmit! E lusim Allahun që Abdullahu që jetë prej tyre, që të na dhurojë Allahu shefaatin e tij! Si jo? Po më duket sikur po e shikoj Shtëpinë e falënderimit, të cilën Allahu na e furnizoi në xhenet – me vullnetin e Allahut – përmes të dashurit tonë - Abdullahut! Po më duket sikur po i shikoj kolltukët, të përgatitur për ne, siç është theksuar në Kuranin famëlartë! Po më duket sikur po i shikoj rrobat shkëlqyese të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe të trashë! Po më duket sikur me fuqinë, mbarësinë dhe mirësinë e Zotit tim, djelmoshat përherë të rinj na shërbejnë neve me gastare, ibrikë dhe me gota të mbushura!

Kështu unë notova në hapësirën e mendimit duke e lëshuar frerin e imagjinatës sime në të gjitha përshkrimet e theksuara në Kuranin famëlartë dhe në Sunet në lidhje me banorët e xhenetit dhe begatitë e tij. Megjithatë, duhet ta kemi në konsideratë se unë, sado që i përshkrova apo i imagjinova, megjithatë aty ka çka syri nuk ka parë, veshi nuk ka dëgjuar dhe mendja e njeriut nuk mund ta imagjinojë!

Ashtu siç e nderoi Allahu atë, na nderoi edhe neve me kalimin e tij në Shtëpinë e falënderimit, me vullnetin e Allahut, në ditën e tretë nga dhjetë ditët e begatshme të muajit dhul-hixhe, kur haxhilerët drejtohen kah Qabeja, unë ju përgëzoj për shenjat e pranimit dhe kënaqësisë për Abdullahun si shehid i Allahut në tokën e tij. I përgëzoj banorët e Kuvajtit dhe të tjerët, qofshin nga numri i madh i atyre që vullnetarisht, pa kërkesën tonë, me ndihmën e Allahut, e kryen detyrën e haxhit për të, apo nga një numër i konsiderueshëm që panë ëndrra të bukura përgëzuese për Abdullahun, në lidhje me gjendjen e tij të mirë tek Allahu i Plotfuqishëm. Të gjitha këto, ngjallin lumturi dhe qetësi shpirtërore për të.

Meqë njerëzit - siç na tregon Pejgamberi s.a.v.s. - janë dëshmitarë të Allahut në tokën e Tij, atëherë unë ju përgëzoj, për numrin e madh të njerëzve që ishin të pranishëm në varreza për ta falë namazin e xhenazes dhe për ta përcjellë funeralin, të cilët vazhduan t'i japin ngushëllime familjes tij deri pas akshamit, që rrallë herë ndodh, me gjithë respektin edhe

për të afërmit e tetë xhenazeve të tjera, që u varrosën pranë tij disa ditë më parë.

Duke bërë me dije se ata që erdhën për këtë, me familjarët e tij nuk i lidh ndonjë interes material, krahas masës së njerëzve që zgjodhën largimin pas namazit dhe varrimit dhe nuk shprehën ngushëllime në varreza për shkak masës së madhe. Ata për këtë shkak e shtynë atë për të nesërmen në divan, sidomos, pasi që ishin të angazhuar me iftar nga agjërimi i ditës së shtatë e shtatë të muajit dhul-hixhe. Po ashtu, nga një numër i madh i haxhilerëve nga Kuvajti, që shkuan në haxh disa ditë para varrimit, Allahu i Plotfuqishëm e furnizoi robin e tij, Abdullahun, me lutjet e tyre gjatë ditëve të haxhit, sidomos në Arafat. Andaj, nuk ka asgjë më të vlefshme në këtë botë, sesa këto dhurata hyjnore! Këto dhurata hyjnore janë të mishëruara në lutjen e ditës së Arafatit, në Arafat, nga një numër i madh i kuvajtianëve dhe dashamirëve të tjerë, andaj falënderimi i takon vetëm Allahut!

Në përfundim, ju siguroj - pa ndonjë ekzagjerim, se fjalimi im është i plagosur - për një vërejtje nga çdo njeri që e ka parë fytyrën e tij të ndritshme para varrimit të tij, se vërtet atij i është shtuar nuri pas vdekjes, falë mirësisë së Allahut!

Allahu ju ruajt juve, për lutjet e mira për të dhe për ne! Dhe ju lutemi që në emrin tonë dhe në emër të birit dhe vëllait tuaj, Abdullahut r.h., të vazhdoni me lutje për të, në kuadër të lutjeve për të dashurit tuaj, që edhe ai, me vullnetin e Allahut, të jetë prej tyre.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Treguesit e shtegut të rrugëtimit

Njoftim me shtëpinë e falënderimit (pallatet, tendat dhe dhomat)⁴

Këtë koncept tashmë e kam marrë nga hadithi i mrekullueshëm pejgamberik, që e qetëson secilin që i ka vdekur fëmija dhe e përgëzon, nëse e falënderon Allahun dhe bën istirxha', ngase atëherë shpërblimi i tij do të jetë nga lloji i veprimit të tij, madje edhe më i madh dhe më i mëshirshëm, se ai do ta ketë një shtëpi në xhenet, me emrin Shtëpia e falënderimit.

Transmeton Ebu Musa El Esh'ariu se si i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikujt i vdes një fëmijë, Allahu i pyet melekët: A ia keni marrë shpirtin fëmijës së robit Tim? Ata përgjigjen: Po. Allahu përsëri i pyet: A ia keni marrë frytin e zemrës së tij? Melekët përgjigjen: Po. Ai u thotë përsëri: Çka tha rob i Im? Ata thonë: Ai të falënderoi dhe tha: Inna lil-lahi ve inna ilejhi raxhiun! (Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi). Atëherë Allahu thotë: Ndërtojani robit Tim një shtëpi në xhenet dhe quajeni Shtëpia e falënderimit.”⁵

Këtu vërejmë se ky hadith se Allahu këtë shtëpi, që ia dhuron atij që duron për vdekjen e fëmijës së tij dhe shpreson, e quajti “Shtëpia e falënderimit”.

Dijetarët, nga emërtimi i shtëpisë me këtë emër kanë konkluduar se për “sëmundjet dhe fatkeqësitë” nuk jepet shpërblim, sepse ato nuk janë vepra të zgjedhura vullnetarisht, por shpërblimi jepet për durim. Këtë pi-

⁴ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 19. 10. 2014.

⁵ Transmeton Tirmidhiu në *Sunen*, hadithi nr. 1021; Imam Ahmedi në *Musned*, hadithi nr. 19725; Ibn Hibbani në *Sahih*, hadithi nr. 2948; El Bejhekiu në *Sunen*, hadithi nr. 7146; El Begaviu në *Sherhus sunneh*, hadithi nr. 1550; El Mundhiri në *Et Tergibu vet Terhibu*, hadithi nr. 3065; Es Sujuti në *El Xhamiul kebir*, hadithi nr. 2808; El Hejthemi në *Mevaridudh dhem'an*, hadithi nr. 726; Teksti është i Tirmidhiut, i cili thotë se hadithi është garib, ndërsa Albani e ka cilësuar si *hasen* dhe e ka theksuar në veprën e tij *Es Silsiletus Sahiha*, 3/398, hadithi r. 1408, dhe e ka komentuar me fjalët: “Hadithi, sipas të gjitha formave, të paktën, është është *hasen*.”

këpamje e mbështesin Ibn Abduselami dhe Ibnuk Kajjimi, të cilët thanë: “Në të vërtetë ai e fiton atë shtëpi me falënderim për Allahun dhe me istirxha’ e jo thjesht me fatkeqësinë e tij, meqë si shpërblim i fatkeqësisë i shlyhen gabimet, megjithatë e kundërta është më e saktë...”

Është e qartë se renditja e çështjes është ndërtimi i shtëpisë për falënderimin së bashku me istirxha’në, sepse, nëse ai vjen vetëm me njërin pa e përfshirë tjetrën, atëherë atij nuk i ndërtohet asgjë, prandaj analogjia për këtë emërtim do të ishte: Quajeni atë Shtëpia e falënderimit dhe istirxha’së. Mirëpo, cilësia më e përafërt që e meriton këtë është falënderimi, ndërsa theksimi i istirxha’së bashkë me të është si plotësim që vjen më pas tij, gjë që dëshmohet me ndarjen e saj në emërtim.⁶

Është e ditur se Allahu i Plotfuqishëm tashmë iu ka premtuar robërve të Tij të mirë se do t’iu dhurojë banesa të këndshme në xhenet si shpërblim prej Tij, dhurata të mjaftueshme, sikurse theksohet në Kuranin famëlartë:

Allahu u ka premtuar besimtarëve dhe besimtareve – kopshte të xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, në të cilat do të banojnë përherë. Dhe (u ka premtuar) pallate të mrekullueshme në xhenetin e Edenit. E, kënaqësia prej Allahut është shpërblim më i madh. Kjo është lumturi e madhe.

Banesat e banorëve të xhenetit, zakonisht përmenden me këto tri shprehje: pallate (apo shtëpi), tenda dhe dhoma.

Sa iu përket pallateve, ato janë përmendur në shumë hadithe të Pejgamberit, s.a.v.s., pavarësisht nga shprehja pallat apo shtëpi, siç është thënia e Pejgamberit s.a.v.s.:

“Kush e lexon “Thuaj, Allahu është Një”⁷) deri në fund dhjetë herë, Allahu do t’ia ndërtojë atij një pallat në xhenet.”⁸ Këtë e thekson Albani në “Es Silsiletus sahiha”, 2/136, nr. 589 dhe pohon se hadithi është *hasen!*

Kurse sa iu përket “tendave” ato janë theksuar në ajetin kuranor: **“Hyritë (e xhenetit) të kufizuara në tenda”**.⁹

Ndërsa fjala “dhomat” është përmendur në shumë vende në Kuranin famëlartë, si shembulli i këtij ajeti:

⁶ El Munavi, *Fejdul kadir sherhul xhami’is sagir* 1/440, Egjipt, *El Mektebetut tixharijetul kubra*, bot. II, 1357 h.

⁷ Surja el-Ihlas, 1.

⁸ Transmeton Ahmedi në *Musned*, hadithi nr. 15610.

⁹ Surja err-Rrahman, 72.

“Ndërkaq, ata që i frikohen Zotit, do të kenë dhoma kat-kat – pranë të cilave rrjedhin lumenjtë...”¹⁰

dhe ajeti tjetër:

“...por vetëm ata që besojnë dhe punojnë vepra të mira. Për ta shpërblimi është i shumëfishtë, për atë që kanë punuar, dhe ata do të jenë të sigurt në dhomat e larta të xhenetit.”¹¹

Kur përmendet fjala “shtëpi” në xhenet, fjala është për “pallatin”, siç tregon Imam En-Neveviu, duke përcjellë nga el-Hattabi dhe të tjerët.¹²

Ndoshta për disa ndërlikohet çështja dhe shprehjet ngatërrohen ndërmjet tyre, respektivisht shprehjet e banesave të banorëve të xhenetit me ato në këtë botë! Kjo çështje kërkon që të theksojmë se çdo gjë që është përmendur për kënaqësinë e Xhenetit, ajo është vetëm për përafrim në mendjen e njerëzve, por në këtë botë nuk ka diçka të ngjashme me to, përveç emrave. Këtë e konfirmon Kurani famëlartë:

“Askush nuk di se çfarë gëzime të fshehta janë për ta – shpërblimi për atë që kanë punuar.”¹³

Po ashtu këtë e pohon edhe hadithi kudsij, të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a.: Ka thënë Pejgamberi, s.a.v.s., se si Allahu i Plotfuqishëm ka thënë: “Kam përgatitur për robërit e Mi të mirë atë që syri nuk e ka parë, veshi nuk e ka dëgjuar dhe mendja e njeriut nuk e ka imagjinuar.”¹⁴

Është transmetuar nga Ibn Abbasi r.a., i cili ka thënë: “Në Xhenet nuk ka diçka që është e ngjashme me atë të kësaj bote, përveç emrave.”¹⁵

Nuk ka dëshmi më të madhe, p.sh. sesa kur mendja jonë, te përmendja e fjalisë së Allahut **“Hyritë (e xhenetit) të kufizuara me tende”**, shkon te forma e tendës me të cilën jemi mësuar në jetën tonë në këtë botë. Transmeton Ebu Bekër b. Abdullah b. Kajs, nga babai i tij se si i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ka thënë:

¹⁰ Surja ez-Zumer, 20.

¹¹ Surja es-Sebe’, 37.

¹² *Sherhun Nevevi ala Muslim*, 15/200.

¹³ Surja es-Sexhde’, 17.

¹⁴ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 3244; Muslimi, hadithi nr. 2824.

¹⁵ Transmeton El Bejhëkiu në *El Ba’thu ven nushuru*, hadithi nr. 332. Albani e ka cilësuar si *sahih*, në veprën e tij *Es Silsiletus Sahiha*, 5/219, hadithi nr. 2188.

“Në Xhenet është një tendë e gjerë nga margaritari; gjerësia e së cilës është 60 milje. Në çdo kënd të saj ka njerëz (familje), të cilët nuk e shohin njëri-tjetrin, ndërsa rreth tyre sillen besimtarët...”¹⁶

Kuvendet e banorëve të Xhenetit në Shtëpinë e falënderimit

Oh, sa bukur!

I madhëruar është Zoti ynë, kur paraprakisht na përgëzoi me përshkrimet e kuvendeve në Xhenet, në Shtëpinë e falënderimit, në pallate, në tenda, në dhoma të Xhenetit etj.

Më lejo, lexues i dashur dhe i nderuar, t’i paraqes në fillim disa ajete kuranore që i përshkruajnë kuvendet e bukura të banorëve të xhenetit!

Kur Pejgamberi, s.a.v.s., na njofton se durimtari që shpreson dhe e falënderon Zotin e tij, pas marrjes së shpirtit të fëmijës së tij, e ka një shtëpi në Xhenet, e cila quhet Shtëpia e falënderimit, ne nuk duhet ta çojmë mendjen te format e zakonshme e shtëpisë, sidomos pasi t’i shohim ajetet e shumta që e përshkruajnë gjendjen e banorëve të Xhenetit dhe banesat e tyre, si shembulli i ajetit:

“Dhe, Ne, do ta shporrim urrejtjen nga zemrat e tyre (që kanë pasur më parë), ata do të rrinë ulur si vëllezër në kanape (kolltukë) – njëri përballë tjetrit.”¹⁷

Pastaj ajeti:

“Për ta është Xheneti i Adnit, nëpër të cilin rrjedhin lumenjtë. Në të, ata do të stolisen me byzylykë ari dhe do të vishen me rroba të gjelbra – nga mëndafshi i hollë dhe i trashë, duke ndenjtur të mbështetur në kanape. Shpërblim i mrekullueshëm është ky! Dhe, sa vendbanim i bukur që është ky!”¹⁸

Pastaj këto dy ajete:

“Atë ditë, me të vërtetë, banorët e Xhenetit janë të angazhuar me kënaqësi, - ata dhe gratë e tyre janë në hije (flade), të mbështetur në kolltukë.”¹⁹

¹⁶ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 4879; Muslimi, hadithi nr. 2838.

¹⁷ Surja el-Hixhr, 47.

¹⁸ Surja el-Kehf, 31.

¹⁹ Surja Jasin, 55-56.

Dhe këto ajete:

“Dhe, për durimin e tyre (në të drejtë), Ai i shpërblen ata me Xhenet dhe (petka) të mëndafshita: - (ata) të mbështetur në kanape, nuk do ta ndiejnë as vapën (e Diellit) dhe as të ftohtit (e dimrit), - dhe do t’u jetë afër tyre hijsa e pemëve, frytet e të cilave do të mund t’i shfrytëzojnë (kapin) lehtë.”²⁰

Ky përshkrim dëshmon ngjashmërinë e kuvendit nga aspekti i natyrës së përgjithshme të ekzistimit të shtretërve përballë njëri-tjetrit. Kjo pozitë ballë për ballë u jep mundësi kuvendarëve – ashtu siç është rasti në kuvendet tona në këtë botë – për bisedë të drejtpërdrejtë dhe shkëmbim të mendimeve në diskutim, në një atmosferë ku iu hiqet urrejtja nga zemrat e tyre, me qëllim që të bëhen vëllezër, meqë ata i kanë lënë prapa tyre kontraktat e kësaj bote dhe brengat e saj, andaj ata kënaqen me frymën e vërtetë vëllazërore!

Më pastaj vjen një ajet tjetër që përshkruan pozitën në kuvendin e tyre, duke qenë në shtretër ballë për ballë, të mbështetur në kolltukë me një rehati dhe dashuri maksimale falë Allahut dhe mirësisë së Tij. Pozita e mbështetjes i pasqyron përmasat e relaksimit të gjatë të cilin e ndiejnë banorët e tij duke gëzuar begatinë e madhe në Xhenetin e përjetshëm.

Pastaj biseda madhështore kalon nga një ajet në tjetrin. Ajeti i parë i përshkruan kuvendet ballë për ballë në kolltukë ndërmjet vëllezërve, kurse ajeti tjetër i përshkruan banorët e Xhenetit:

“Ata dhe gratë e tyre janë në hijsa (fllade), të mbështetur në kolltukë.”²¹

Këtu ajeti nuk e përmend kontekstin “ballë për ballë” në kolltukë, por ai e braktis afërsinë dhe përputhjen, për ta kuptuar dëgjuesi dhe lexuesi i ajetit me shumë edukatë dhe shije të lartë.

Sidoqoftë, ata janë me vëllezërit e tyre dhe familjet e tyre, siç theksohet në ajetin tjetër – të mbështetur në kolltukë dhe aty nuk shohin as diell e as të ftohtë, respektivisht ata nuk përjetojnë ndëshkim as nga vapa as nga acari, por gjatë atyre ndejave, atyre iu afrohen kalaveshët e pemëve të Xhenetit, derisa ata të jenë aty.

Oh, sa përshkrim i mrekullueshëm... dhe sa kuvende të bukura që janë!

²⁰ Surja el-Insan, 12-14.

²¹ Surja Jasin, 56.

O Allah, na i mundëso këto kuvende, ku nuk ka shtetësi të banorëve, nuk ka shtresa sociale apo pozita, por të gjithë në to janë vëllezër, meqë **“Më i ndershmi ndër ju është ai që është më i devotshmi tek Allahu”**.

Thellimi në këto nocione dhe përshkrime ngjall në shpirt dëshirë të flaktë, frymëzon vendosmëri të madhe dhe zgjon shpresën për premtimin e Atij të Cilit i drejtohet çdo krijesë! Vërtet këto janë përshkrime, që para të cilave është e parëndësishme çdo fatkeqësi, përballë tyre zhduket çdo rrezik dhe pa to zvogëlohet çdo begati! Andaj, cili prej nesh nuk i do këto? Cili prej nesh nuk ka dëshirë të zjarhtë to?

“Ky, me të vërtetë, është sukses i madh! Për diçka të tillë, le të angazhohen punëtorët!”²²

Në përfundim, mjafton sqarimi i vlerës, që njeriu ta ketë një shtëpi në Xhenet. Kjo ka qenë shpresë e njëjës nga dy gratë, me të cilat Allahu ua ka sjellë shembullin atyre që besuan, e ajo ishte gruaja e faraonit, e cila iu lut Zotit të Plotfuqishëm, që t’ia ndërtonte asaj një shtëpi në xhenet:

“E, Allahu jep shembull për ata që besojnë – gruan e faraonit, kur ajo tha: “O Zoti im, ndërtoja një banesë te Ti në xhenet, dhe shpëtomë nga faraoni e veprat e tij dhe më shpëto nga populli zullumqar!”²³

O Zoti ynë, ndërtoja një shtëpi çdonjërit që duron dhe shpreson me rastin e humbjes së fëmijës së tij, që është loçka e zemrës tij, me mëshirën Tënde, o më i madhi Mëshirues!

PËR KË ËSHTË SHTËPIA E FALËNDERIMIT NË XHENET - Dr. Omer Abdulkafi (1:07)²⁴

Ju lutemi, duke jua bërë me dije rëndësinë e shkarkimit të aplikacionit **Reader QR**, që janë iniciale të termit **Quick Response**, ku çdo lexues e gjen përgjigjen e shpejtë me hapjen e tij, ta kthejë ekranin e telefonit tërësisht në drejtim të kamerës, pastaj ta drejtojë kah **code QR**, që duket lart në faqe. Ky është brezi i ri i **Code Bar**, që aktualisht po përdoret shumë, për t’i lexuar çmimet e artikujve. Për të hapur lidhjen e materialit të programit, që tregohet në këtë faqe dhe faqet e tjera në vijim të këtij libri. Kështu, realizohet shtimi i materialit i TV-së dhe radios, mbështetur në materialin e shkruar në këtë libër!

²² Surja es-Saffat, 60-61.

²³ Surja et-Tahrim, 11.

²⁴ Gjatë leximit të këtij libri do të hasni në ligjerata audio-vizive të dijetarëve të ndryshëm islamë, të cilave autori iu ka referuar për tematikat përkatëse. (Shënim i redaktorit).

Çfarë është thënë për shpërblimin e atij që e ka humbur fëmijën (fëmijët)

Allahu i Gjithëfuqishëm, i Urtë, i Madhërishëm, që nuk ka zot tjetër përveç Tij, thotë:

“O besimtarë, kërkoni ndihmë duke duruar dhe duke u falur! Me të vërtetë, Allahu është me durimtarët. Dhe mos thoni për ata që vriten në udhë të Allahut se kanë vdekur! Jo! Ata janë të gjallë, por ju nuk i vëreni! Na do t’ju provojmë me ndonjë gjë: me pak frikë, uri, me dëmtim të pasurisë, dëmtim të njerëzve dhe të të lashtave. Ti përgëzoji durimtarët! Të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme, thonë: “Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!” Ata do të shpërblehen me dhunti dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!”²⁵

Sprova për humbje të fëmijës është sprova më e madhe! Ajo është një dhembje që depërton në zemra dhe i shton pikëllimin e vuajtjet! Ndaj, ndarja nga i dashuri konsiderohet nga fatkeqësitë më të mëdha, aq sa gati mund ta humbë mendjen edhe çdo njeri i arsyeshëm që shquhet me intuitë! E pra, si është puna kur ka të bëjë me largimin pa kthim? Kur është fjala për largimin e fëmijëve që janë fryti i zemrës, jeta e shpirtit, kënaqësia e xhanit dhe drita e syve! Andaj, kur duron dhe shpreson, e falënderon Allahun bën istirxha’ me shpirt të besueshëm në përcaktimin e Allahut, atëherë Allahut do t’i dhurojë shpërblim të madh dhe ua premtion prindërve shefaatin e tij në Ditën e ringjalljes!

Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikujt i vdes një fëmijë, Allahu i Madhëruar u thotë melekëve: A ja morët shpirtin e djalit të robit Tim besimtar? Ata thonë: Po. Thotë: A ja morët frytin e zemrës së tij? Ata thonë: Po. Thotë: Dhe, çfarë tha robi Im? Ata thonë: O Zot, ai të falënderoi dhe tha: Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi. Allahu thotë: Ndërtojani robit Tim një shtëpi në Xhenet dhe quajeni: Shtëpia e falënderimit.”²⁶

²⁵ Surja el-Bekare, 153-157.

²⁶ Transmeton Tirmidhiu në *Sunen*, hadithi nr. 1021.

Në Sahih el-Buhari nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Thotë Allahu i Madhërishëm: ‘Për robin Tim, të cilin i merret ajka e tij nga njerëzit e kësaj bote, më pastaj ai tregon bindje dhe shpresë, nuk ka shpërblim tjetër pos Xhenetit!’”²⁷

Falënderimi i takon Allahut, i Cili e përcakton zhdukjen dhe shuarjen për të gjithë robërit e Tij dhe e zbaton urdhrin e Tij ndaj tyre sipas urtësisë dhe qëllimit të Tij. Ai u ka premtuar shpërblim të bukur atyre që bëjnë durim në caktimin e Tij dhe i ka kërcënuar të revoltuarit me ndëshkim të madh në botën e përtejme. Ai i freskon zemrat e njohësve me rregullimin e Tij, andaj gëzimi i shpirtrave të tyre është në dorëzimin ndaj përcaktimit të Allahut të Plotfuqishëm – e falënderojmë Atë për çdo rast dhe çast – dhe vetëm prej Tij kërkojmë ndihmë, sukses dhe udhëzim!

Sihariqet për durimtarët me rastin e humbjes së fëmijës

Sihariqi i parë: Përsëndetjet, mëshira dhe udhëzimi nga Allahu:

Thotë Allahu i Plotfuqishëm:

“Ne do t’ju provojmë me ndonjë gjë: me pak frikë, uri, me dëmtim të pasurisë, dëmtim të njerëzve dhe të të lashtave. Ti përgëzoji durimtarët, të cilët, kur i godet ndonjë e pakëndshme thonë: ‘Ne jemi të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehem!’” Ata do të shpërblehen me dhunti dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!”²⁸

Sihariqi i dytë: Shpëtimi nga zjarri

Durimi për humbjen e fëmijëve është ruajtje nga zjarri dhe nga zemërimi i të Plotfuqishmit.

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a., i cili ka thënë:

“Një grua erdhi me një fëmijë të vogël të saj dhe tha: ‘O i Dërguari i Allahut! Lutju Allahut (për të)! Sepse unë i kam varrosur tre (fëmijë).’ Ai tha: ‘Me të vërtetë, që ti ke dhënë një mbrojtje shumë të fortë ndaj Zjarrit.’ /Do të thotë: Je mbrojtur me një mbrojtje të fortë./”²⁹

²⁷ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 6424.

²⁸ Surja el-Bekare, 155-157.

²⁹ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 2636.

Sihariqi i tretë: Hyrja në Xhenet

Thotë Allahu i Plotfuqishëm:

“E, ata që kanë besuar dhe u shkojnë pas pasardhësit e tyre në besim, do t’ju bashkojmë pasardhësit e tyre dhe nuk do t’ju pakësojmë asgjë nga veprat e tyre – çdo njeri është peng (përgjegjës) për atë që ka punuar.”³⁰

Transmeton Enes bin Malik r.a. se si i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ka thënë:

“Nuk ka asnjë mysliman në mesin e njerëzve, të cilit i vdesin tre fëmijë, para se ta arrijnë moshën e pjekurisë, e që Allahu të mos e fusë në Xhenet për shkak të mëshirës së gjerë ndaj tyre.”³¹

Nga Mahmud bin Lebijd, nga Xhabiri, i cili ka thënë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut të thotë:

“Atij që i vdesin tre fëmijë - dhe ai duron dhe e shpreson shpërblimin, do të hyjë në Xhenet!” Tha ne i thamë: “O i Dërguari i Allahut e për dy? Tha: “Edhe për dy.” Tha Mahmudi: “Unë i thashë Xhabirit: Mendoj se nëse do t’i thoshit “edhe për një”, atëherë ai do të thoshte: “Edhe për një!” Tha: “Pasha Allahun, edhe unë mendoj kështu!”³²

Sihariqi i katërt: Shtëpia e falënderimit.

Allahu i Plotfuqishëm e ka paraparë për atë që duron, me rastin e humbjes së fëmijës një shtëpi të veçantë me emrin e saj në Xhenet, e cila do të ketë shenjë dhe nishan, e ajo është Shtëpia e falënderimit.

Transmetohet nga Ebu Musa el-Esh’ariu se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikujt i vdes një fëmijë, Allahu i Madhëruar u thotë melekëve: A ja morët shpirtin e djalit të robit Tim besimtar? Ata thonë: Po. Thotë: A ja morët frytin e zemrës së tij? Ata thonë: Po. Thotë: Dhe, çfarë tha rob i Im? Ata thonë: O Zot, ai të falënderoi dhe tha: Të Allahut jemi dhe tek Ai do kthehemi. Allahu thotë: Ndërtojani robit Tim një shtëpi në Xhenet dhe quajeni: Shtëpia e falënderimit.”³³

³⁰ Surja et-Tur, 21.

³¹ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 1248.

³² Transmeton Ahmedi, 3/306, hadithi nr. 14336, dhe Buhariu, hadithi nr. 146.

³³ Transmeton Ahmedi 4/415, hadithi nr. 1974; Tirmidhiu 3/341, hadithi nr. 1021 dhe Albani në *Es Silsiletus sahiha*, 3/398.

Mësim dhe ngushëllim nga njoftimet për humbjen e fëmijëve

Vërtet kjo jetë është një shtëpi e brengës, dertit dhe shqetësimit, që s'ka shmangie nga fatkeqësitë, sprovat, hidhërimet dhe intrigat. Andaj, njeriu në të është i rrezikuar nga këto fatkeqësi, të cilat nuk largohen prej tij, veçse me largimin e tij nga kjo botë! Shpirti nuk spastrohet veçse me sprovë, meqë në sprovë njihen burrat, siç ka thënë Imam ibn El Xhevzi: “Kush mendon që të vazhdojë shpëtimi, paqja dhe shëndeti pa ndonjë sprovë, atëherë ai nuk e ka kuptuar ngarkimin e tij as nuk e ka perceptuar dorëzimin! Andaj, çdo njeri, qoftë besimtar, qoftë jobesimtar, patjetër duhet ta përjetojë dhimbjen dhe askush të mos aspirojë se mund të shpëtojë nga sprovë dhe dhimbja! Kështu njeriu në kohën e tij është i paqëndrueshëm duke kaluar nga mirëqenia në sprovë”.

Mirëpo, ai që e kupton realitetin e kësaj ndarjeje, që është e paevitueshme, atëherë ai do të realizojë atë që është më e mira! Do të bindet se paniku dhe tmerrri nuk e kthejnë të kaluarën dhe nuk e sjellin të munguarin, por e zemërojnë Allahun e Madhërishëm dhe i kënaqin armiqtë! Andaj, kush e kupton këtë realitet, ai duhet të ketë durueshmëri dhe merr shembull nga veprimi i paraardhësve të devotshëm, kur merrnin lajme të ngjashme si ky.

Transmetohet nga Thabiti, e ky nga Enesi, i cili ka thënë:

“Kemi hyrë me të Dërguarin e Allahut, s.a.v.s., tek Ebu Sejf El Kajni, Ibrahim (a.s.) kishte një mëndeshë. Pejgamberi, s.a.v.s., e mori Ibrahimin e puthi dhe i mori erë! Më pastaj ne hymë tek ai. E Ibrahim ishte duke dhënë shpirt. Sytë e Pejgamberit (a.s.) u përletën. Në atë rast, Abdurrahman Ibn Avfi i tha: “O Pejgamber i Allahut, po qan?!” Kurse Pejgamberi (a.s.) tha: “O Ibn Auf, kjo është mëshirë.” Pastaj vazhdoi: “Syri loton, zemra pikëllohet, por nuk themi gjë tjetër, vetëm atë me çka është i kënaqur Zoti ynë. Ne jemi të mërëzitur me ndarjen tënde, o Ibrahim.”³⁴

Kalifi i drejtë Omer bin Abdulazizi r.h., kur vdiq biri i tij Abdulmeliku, solli një shembull të mrekullueshëm, që duhet të ndiqet në shëmbëlltyrën e durueshmërisë, në fuqinë e qëndrueshmërisë dhe për mospikëllim, por vetëm për gëzim!

Sufjan Eth-Thevriu tregon se si Omer bin Abdulazizi, djalit të tij Abdulmelikut, duke qenë i sëmurë, i kishte thënë:

– “Si e sheh veten?” “Për vdekje”, përgjigjet ai.

³⁴ Transmeton Buhariu në *Sahih*, hadithi nr. 1303.

- “Të jesh ti në peshojën time, për mua është më e dashur sesa unë të jem në peshojën tënde!”, i thotë.

- “O babai im, të jesh në atë që ti e dëshiron, është më e dashur për mua, sesa unë të jem në atë që dëshiroj”, u përgjigj djali.

Thuhet se pasi vdiq djali i tij, Abdulmeliku, atëherë Omeri tha: “O biri im, ishe në këtë botë, siç thotë Allahu i Madhërishëm: **“Pasuria dhe fëmijët janë stoli të jetës në këtë botë”**, kështu ti ishe stolua më vlefshme, andaj unë sot dëshiroj që ti të jesh **‘nga veprat e mira të vazhdueshme’**, të cilat janë më të mira sesa jeta e kësaj bote, me shpërblim më të mirë dhe me shpresë më të mirë. Pasha Allahun, ajo që më gëzoi shumë është kur unë të luta, ti mu përgjigje mua!

Pasi e varrosi, u ngit Omeri dhe para varrit të tij tha: “Që na çasti kur u përgëzova me ty, ende jam i gëzuar me ty. Kurrë nuk kam qenë më i kënaqur për ty sesa sot!” Pastaj tha: “O Allahu ynë, falja gabimet Abdulmelikut, të birit të Omerit dhe atyre që kërkojnë falje për të!”³⁵

Poeti ka thënë:

*Mos e dhëntë Zoti ndarjen ndërmjet nesh,
se shija e ndarjes është shije e hidhur!*

*Sikur të gjenim në ndarje ndonjë shteg,
do ta shijonim ndarjen, si shije të ndarjes!*

Andaj, o Zot dhuro prehje për të gjithë të sprovuarit! Dhuroju durim atyre që sprovohen me humbjen e të dashurve të tyre dhe na bëj neve nga ata që durojnë në përcaktimin Tënd dhe janë të kënaqur me sprovën!

Transmetohet nga Thabiti, i cili ka thënë: “Kur vdiq Abdullah bin Mutarrafi, babai i tij ‘Mutarrafi’ doli para njerëzve me rroba të mira dhe i kishte parfumos. Njerëzit, për këtë u hidhëruan, andaj i thanë: “Vdiq djali yt, Abdullahu, kurse ti del me këto rroba të parfumosura?!”

Atëherë ai iu përgjigjet: “Vallë, a t’i nënshtrohëm asaj!” (d.m.th. fatkeqësisë për vdekjen e djalit të tij). Zoti im i Lartmadhërueshëm m’i ka premtuar tri veçori, që çdo njëra prej tyre është më e mirë se jeta në këtë botë dhe janë më të dashura për mua sesa kjo botë dhe gjithçka ka në të...

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

³⁵ Shih: *El Muxhalesetu ve xhevahirul ilmi*, Ebu Bekr Ed Dijnuri, 2/250, Daru Ibni Hazm, Bejrut, 1419 h; *El Edhkar Ed Dijnuri*, fq. 152, Darul fikri lit tibaati, Bejrut, 1414 h; *Teslijetu ehlil mesaib*, El Munbexhi, fq. 156, Darul kutubil ilmije, Bejrut, 1426 h. – 2005 m.

“Ata, të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi, thonë: “Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!”³⁶

“Ata do të shpërblehen me dhunti dhe mëshirë nga Zoti i tyre; dhe ata janë në rrugën e drejtë!”³⁷

E para është: **“Ata do të shpërblehen me dhunti”**

E dyta është: **“dhe mëshirë”**

Kurse e treta: **“dhe ata janë në rrugën e drejtë!”^{38 39}**

Është transmetuar nga Ibn Abasi se si atë e informuan për vdekjen e vajzës së tij, duke qenë në udhëtim, ndërsa ai, aty për aty, bëri istirxha’ e pastaj tha: *“Një turp që Allahu e mbuloi, një ndihmë që Allahu e siguroi dhe një shpërblim që Allahu i Plotfuqishëm e dhuroi! Pastaj zbriti i fali dy rekate namaz dhe tha: “Tashmë vepruam ashtu siç na ka urdhëruar Allahu i Madhërishtëm:*

“Kërkoni ndihmë me durim dhe me namaz!”^{40 41}

Urve bin Zubejri ishte njeri i devotshëm dhe i përsipirtshëm, për të cilin transmetohet se ishte sëmurë nga gangrena në këmbë derisa ishte në udhëtim! Atij ia sollën mjekun, i cili ia amputoi gjysmën e këmbës dhe nuk u dëgjua prej tij asnjë ndjenjë nga durimi i tij. Më pas atij i erdhi lajmi për vdekjen e djalit të tij, të cilin e kishte shkelur mushka, edhe për gjithë këtë nuk u dëgjua prej tij ndonjë demoralizim! Pasi që bëri istirxha’ e citoi ajetin kuranor:

“...sepse, jemi lodhur nga ky udhëtim ynë.”⁴² O Zoti im, unë i kisha shtatë djem, Ti ma more një, por m’i le gjashtë! I kisha katër gjymtyrë, ma more një, por mi le tri! Kështu, Ti më sprovove dhe më shërove! Dhe Ti më more, por më shumë më le!⁴³

³⁶ Surja el-Bekare, 156.

³⁷ Surja el-Bekare, 157.

³⁸ Surja el-Bekare, 157.

³⁹ Shih: Ibni Sa’d, *Et Tabekatul kubra*, 7/181, Darul kutubil ilmije, Bejrut, 1410 h. – 1990 m.; *Teslijetu ehlil mesaib*, El Munbexhi, fq. 32.

⁴⁰ Surja el-Bekare, 157.

⁴¹ *Tefsirul Kurtubi*, 1/372, Darul kutubil misrije, Kajro. Aty thuhet se ai e vajtoi villain e tij Kathemin, e thuhet edhe: bijen e tij. Botimi II, 1484 h.

⁴² Surja el-Kehf, 62.

⁴³ Edh Dhehebi, *El Kebair*, fq. 192; Ez Zubejdi, *Ithafus Sadetil muttekin*, 2/381, Muessetut tarihil arabij.

Andaj, dijëni - Allahu ju mëshiroftë - se kush qan, le të qajë për vetë. Transmetohet nga një paraardhës i devotshëm, se si në prag të vdekjes tij, gruaja e tij po qante, kurse ai i thotë: “Çfarë të shtyn që të qash?” Ajo tha: “Për ty!” Ai i tha: “Nëse ti qan, atëherë qaj për veten tënde, sepse unë kam qarë për këtë ditë më shumë se dyzet vjet.”

Kështu shkuarja e këtyre të dashurve, nuk është diç tjetër, veçse një vërejtje për ne, sepse edhe ne do të shkojmë nga kjo botë. Andaj, ata janë pararendës, ne jemi pasues, kurse pas pak edhe ne do të jemi kalimtarë!

Durimi me rastin e sprovës

Durimi është dritë për myslimanin në jetën e tij, kurse niveli më i lartë i tij është pajtimi me kadanë dhe kaderin e Allahut të Plotfuqishëm. Për këtë, pejgamberët dhe të përshpirtshmit sollën shembuj të mrekullueshëm. Në krye të tyre është pejgamberi ynë Muhamedi s.a.v.s. E, po ashtu edhe Ejjubi a.s. Prandaj, besimtari duhet të stoliset me durim dhe pajtim që të arrijë nivele të larta të devotshmërisë!

Domethënia e durimit

Durimi në aspektin gjuhësor është: Parandalim dhe përmbajtje.

Durimi në aspektin fetar islam është: Përmbajtja e vetvetes nga pikëllimi, e gjuhës nga ankimi, e duarve nga flakaresha në fytyrë dhe shqyerja e xhepave.

Thuhet se durimi është: Karakter i përsosur nga karakteret e njeriut, që përmes tij përmbahet nga ndonjë veprim që nuk përmirëson as nuk zbu-kuron! Ai është një forcë nga forcat e shpirtit, me të cilën bëhet mirësia çështjes dhe forcimi i saj.

Kështu, shpirti i ka dy forca: forcën e guximit dhe forcën e frenimit. Andaj, thelbi i durimit është që forca e guximit të përdoret thjesht në atë që sjell dobi, kurse forca e frenimit në përmbajtje është nga ajo që sjell dëm!

Statusi i kënaqësisë dhe pozita e saj te durimi

Pajtimi dhe kënaqësia: Ajo është gëzim, zemërgjerësi në përcaktim dhe braktisje e dëshirës për largimin e dhimbjes edhe nëse ndjen dhimbje. Mirëpo, kënaqësia është ajo që e lehtëson atë që fillon të hyjë në zemër nga

shpirti me bindje të thellë. Kjo do të thotë, nëse njeriun e kaplon ndonjë sprovë, atëherë ai nuk dëshiron që ta largojë atë sprovë, për shkak se e dëshiron shpërblimin e Allahut të Madhërishëm. Nëse atij i kërkohet të zgjedhë ndërmjet kthimit të asaj që ka humbur dhe moskthimit, ai do ta zgjedhë moskthimin. Nëse atij i vdes fëmija, apo e humb pasurinë, apo e humb dëgjimin apo shikimin, atëherë dëshira e tij është tek shpërblimi i Allahut. Dashuria e tij për kadanë dhe kaderin e Allahut të Madhërishëm e bën atë që mos të ketë dëshirë tjetër përveç asaj që është! Kështu që ai pajtohet me përcaktimin e Allahut, e dëshiron shpërblimin e Tij dhe shpirti i qetësohet me kadanë dhe kaderin e Allahut të Madhërishëm!

Shejhul-Islami ka thënë: “Kënaqësia - pajtimi me vendimin e Allahut është shkalla më e lartë e durimit, meqë ajo është *mustehab* - e parapëlqyer! Por, shkallë më e lartë se ajo është falënderimi ndaj Allahut për fatkeqësinë, meqë ai i sheh begatitë e Allahut ndaj tij, të cilat bëhen shkak për shlyerjen e mëkateve, për ngritjen e gradave, për kthimin e tij tek Allahu, për lutje drejtuar Atij, për mbështetje të sigurtë dhe shpresë tek Ai e jo te njerëzit.”⁴⁴

Gjithashtu, Shejhul Islami ka thënë: “Çështja e kënaqësisë nuk është përmendur siç është përmendur çështja e durimit. Vetëm është përmendur mirënjohja për pjesëtarët e saj! Allahu i Plotfuqishëm nuk i ka detyruar njerëzit për kënaqësi-pajtim, por vetëm e ka pëlqyer për ta e ka lavdëruar atë dhe ata që e ushtrojnë, i ka njoftuar se shpërblimi i saj është kënaqësia e Tij ndaj tyre, gjë që është më madhore, më e madhe dhe më e lartë sesa xhenetet dhe çfarë ka në to! Prandaj, kush është i kënaqur ndaj Zotit të tij, këtë e ka si rezultat i kënaqësisë së Allahut të Madhërishëm ndaj tij!”

Frytet e durimit në sprovë

Allahu i Plotfuqishëm, në Librin e tij të shenjtë, i ka përgëzuar durimtarët duke thënë:

“Na do t’ju provojmë me ndonjë gjë: me pak frikë, uri, me dëmtim të pasurisë, dëmtim të njerëzve dhe të të lashtave. Ti përgëzoji durimtarët! Të cilët, kur i godet ndonjë gjë e pakëndshme thonë: “Ne jemi

⁴⁴ *El Furkan bejne evlijairr Rrahman ve evlijaish shejtan*, fq. 135, Mektebetu Daril Bejan, Damask, 1405 h. – 1985.

të Allahut dhe ne vetëm tek Ai kthehemi!” Ata do të shpërblehen me dhunti dhe mëshirë nga Zoti i tyre; ata janë në rrugën e drejtë!”⁴⁵

Pejgamberi, s.a.v.s., duke na udhëzuar dhe mësuar na drejtohet:

“Nuk i është dhënë askujt dhuratë më e madhe dhe më e gjerë sesa durimi.”⁴⁶

Durimtarët janë fitues dhe të shpëtuar

Allahu i Plotfuqishëm, lidhur me besimtarët të cilët do ta fitojnë begatinë e xhenetit në botën e përtejme, thotë:

“Unë, i kam shpërblyer ata sot, për durueshmërinë e tyre, e ata, me të vërtetë, janë të shpëtuar.”⁴⁷

Gjithashtu Allahu i Plotfuqishëm na ka përgëzuar me atë që do t’iu thuhet banorëve të xhenetit në Ditën e Gjykimit:

“(E ju thonë): “Shpëtimi qoftë mbi ju, meqë keni duruar, e sa përfundim i bukur që është ky!”⁴⁸

Ata ibn Ebi Rebah ka thënë se si Ibnu Abasi i kishte thënë: “A dëshiron të të tregoj për një grua, e cila është prej banorëve të xhenetit?” “Po”, – i thashë. Ai tha: “Njëherë kjo grua e zezë erdhi te Pejgamberi, s.a.v.s., dhe tha: “Mua më kap epilepsia dhe si shkak i saj edhe zbulohem. Lute Allahun e Lartësuar për mua! Pejgamberi, s.a.v.s., i tha: “Nëse bën durim, do të shpërblehesh me xhenet. Por nëse dëshiron e lus Allahun e Lartësuar që të të shërojë”. Ajo tha: “Do të bëj durim”, pastaj vazhdoi: “Unë zbulohem, prandaj lute Allahun që të mos zbulohem”. Atëherë ai u lut për të.”⁴⁹

Durimtarët shpërblehen pa masë!

Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë.”⁵⁰

⁴⁵ Surja el-Bekare, 155-157.

⁴⁶ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 1469, dhe Muslimi, hadithi nr. 1053.

⁴⁷ Surja el-Muminun, 111.

⁴⁸ Surja err-Rra’d, 24.

⁴⁹ Transmeton Ahmedi, hadithi nr. 3240; Buhariu, hadithi nr. 5652 dhe Muslimi, hadithi nr. 6663.

⁵⁰ Surja ez-Zumer, 10.

Sulejman b. El Kasimi ka thënë: “Çdo veprë i dihet shpërblimi i saj me përjashtim të durimit: “Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë.” Ai tha: Është si uji rrjedhës!

Allahu i Plotfuqishëm ua kompenson durimtarëve me të mira!

Transmetohet nga Mus'ab b. Se'ad, nga babai i tij, Sead b. Ebu Vekas, se ka thënë: “Një herë i thashë të Dërguarit të Allahut, s.a.v.s., se kush janë njerëzit me sprova më të mëdha? Ai më tha: *‘Pejgamberët, pastaj ata të cilët janë poshtë tyre në gradë.’ Kështu sprovohet njeriu në saje të besimit që ka. Nëse besimi i tij është i fortë shtohen dhe sprovat, por nëse besimi i tij është i dobët, atëherë sprovohet në saje të besimit që ka dhe sprovat vazhdojnë ta godasin robin derisa të arrijë njeriu të ecë nëpër tokë e ai të mos ketë kurrfarë gjynahu.*”⁵¹

Durimi është shkak i shlyerjes së mëkateve dhe shtim i veprave të mira

Ka thënë një paraardhës i mirë: “Sikur të mos ishin fatkeqësitë, atëherë në botën tjetër do të shkonim të falimentuar.”

Transmetohet nga Ebu Hurejre r.a. se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

*“Nuk e godet myslimanin asnjë lodhje, asnjë sëmundje, asnjë shqetësim, asnjë trishtim, asnjë vuajtje dhe asnjë mjerim, bile asnjë gjemb që e shpon, për tjetër veçse që Allahu t’i falë me të prej mëkateve të tij.”*⁵²

Nuk ka fatkeqësi, lëngatë, mërzi, pikëllim, dëm, apo brengë që godet myslimanin, qoftë edhe gjembi që e thumbon, e të mos ia shlyejë Allahu, përmes tyre, mëkatet e tij”.

Durimi është shkak për udhëzimin e zemrave

Vërtet durimi është shkak për udhëzimin e zemrave, për largimin e egërsisë, për krijimin e butësisë dhe qetësimin e tyre. Sa shumë njerëz të shkujdesur i janë kthyer Zotit të tyre vetëm atëherë kur i ka goditur ndo-

⁵¹ Transmeton Ahmedi, hadithi nr. 1481; Daremiu, hadithi nr. 2783; Tirmidhiu, hadithi nr. 2398; Albani në Es Silsiletus sahiha, 1/225.

⁵² Transmeton Ahmedi, hadithi nr. 8014; Buhariu, hadithi nr. 5641 dhe Muslimi, hadithi nr. 6660.

një sëmundje. Sa shumë njerëz i janë afruar Zotit të tyre vetëm atëherë kur e kanë humbur të dashurin e tyre! Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“... E ai që i beson Allahut, ia udhëzon (në rrugë të drejtë) zemrën e tij.”⁵³

Ka thënë Alkame: “Ai është njeriu të cilin e godet fatkeqësia, dhe ai duke e ditur se është nga Allahu, pajtohet me të dhe shpëton!”⁵⁴

Kuptimi i ajetit: Atë që e godet ndonjë fatkeqësi dhe ai e di se është përcaktim i Allahut, andaj duron, shpreson dhe plotësisht i dorëzohet caktimit të Allahut, atij Allahu ia udhëzon zemrën, ia kompenson atë që i ka kaluar në këtë botë duke ia udhëzuar dhe qetësuar zemrën, duke ia thelluar bindjen dhe duke ia zëvendësuar atë që ka pasur me më të mirë.

Andaj, o Allah, na bëj neve nga të durueshmit falënderues! Na bëj që të jemi të kënaqur me caktimin Tënd dhe na bëj udhëheqës të udhëzuar në rrugën e drejtë!

Ndërmjet mjerimit dhe fatkeqësisë

Tashmë familja i kaloi ditët e rrugëtimit me Abdullahun për në Shtëpinë e falënderimit. Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“A mendoni ju të hyni në xhenet pa i përjetuar ato (vuajtjet) ashtu si i kanë përjetuar të tjerët para jush? Ata i pati goditur mjerimi dhe sëmundjet dhe aq shumë qenë tronditur, saqë pejgamberi dhe ata që ishin me të thirrën: “Kur më do të arrijë ndihma e Allahut?!” Qe, ndihma e Allahut është afër!”⁵⁵

Andaj, mjerimi është ai që e godet njeriun jo në veten e tij, si kërcëni-mi i sigurisë, dëbimi nga shtëpitë, sëmundja e afërt apo vdekja e tij! Ndërsa fatkeqësi është ajo që e godet njeriun në veten e tij, si sëmundja, ndëshkimi apo vdekja!

⁵³ Surja et-Tegabun, 11.

⁵⁴ *Tefsiru Ibnî Kethir*, 8/161, Darul kutubil ilmije, Bejrut, Bot. I, 1419 h.

⁵⁵ Surja el-Bekare, 214.

Ndalimi i ulërimës dhe vajtimit të tepruar

Falënderimi i takon Allahut, të Urtit në atë që përcakton në çdo kohë, të Butit ndaj robërve të Tij, kur ata i shqetësojnë brengat dhe pikëllimet, i Cili iu premtoi të durueshmëve shpërblime pa fund dhe pa parashikim.

Imam Edh Dhehebiu, në librin e tij *El-Kebair*, nxjerr në pah nga Omer b. El-Hattabi r.a. i cili ka thënë: *“Kur Meleku i vdekjes a.s. ia merr shpirtin besimtarit, qëndron para derës, ndërta anëtarët e familjes lëshojnë britmë: Disa i godasin fytyrat e tyre, disa i shkulin flokët e tyre, kurse disa të tjerë mallkojnë për mjerimin e tyre! Atëherë Meleku i vdekjes a.s. thotë: Pse ky pikëllim dhe prej nga ky tmerr?! Pasha Allahun, nuk ia kam shkurtuar jetën asnjërit prej jush, as nuk ia kam marrë riskun asnjërit prej jush, as nuk i kam bërë asnjë zullum asnjërit prej jush! Kështu, nëse ankesa dhe zemërimi juaj është ndaj meje, atëherë, pasha Allahun, unë jam i urdhëruar për këtë! Nëse është për të vdekurin tuaj, atëherë ai për këtë është i detyruar! Nëse kjo është ndaj Zotit tuaj, atëherë ju jeni mosbesues ndaj Tij. Vërtet unë e kam obligim ndaj jush që të kthehem sërish te ju, derisa të mos mbetet asnjëri prej jush!”*

Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur ta shihnin vendin e tij, ta dëgjonin fjalën e tij, atëherë do ta harronin të vdekurin e tyre dhe do të qanin vetëm për veten e tyre.”⁵⁶

Ka thënë shejh Abdulkadir El Xhejlani, duke e këshilluar birin e tij: *“O djali im, vërtet fatkeqësia nuk ka ardhur te ti që të të shkatërrojë ty, por ajo ka ardhur te ti që ta sprovtojë durimin dhe besimin tënd! O djali im, kaderi është egërsirë, kurse egërsira nuk e ha cofëtinen.”⁵⁷*

Ebu Ed Derda ka thënë: *“Kur Allahu bën ndonjë përcaktim, Ai dëshiron që (njerëzit të) jenë të kënaqur!”⁵⁸*

Imam El Buhariu r.h. në kapitullin ‘Çka urrehet prej vajtimeve për të vdekurin’, thotë ka thënë Omeri: *“Lëri ato të qajnë për Ebu Sulejmanin, nëse nuk ka torturim dhe zhurmë. Torturim është pluhuri mbi kokë, kurse zhurmë është ajo që vret veshin!”⁵⁹*

⁵⁶ Edh Dhehebi, *El Kebair*, fq. 178.

⁵⁷ *Teslijetul Mesaib*, fq. 166.

⁵⁸ Ibnu Muflihmi *El Adab esh sher'ije*, Botues: Alemul kutub, pa vit botimi.

⁵⁹ Sahihul Buhari, 2/80, Daru Ibni Kethir, Bejrut, Botimi III, 1407 h, 1987.

Pastaj Imam El Buhariu, në *Isanadin* e tij, e vazhdon transmetimin e hadithit nga EL-Mugijre b. Shu'be që ka thënë: E kam dëgjuar Pejgamberin, s.a.v.s., duke thënë:

*“Ndëshkohet ai, ndaj të cilit vajtohet, për shkak të vajtimit ndaj tij!”*⁶⁰

Imam El Buhariu r.h. në kapitullin “Fjalja e Pejgamberit, s.a.v.s.: “I vdekuri ndëshkohet për disa vajtime të familjes tij”, thotë se vajtimi është theksuar në traditën e tij, sipas fjalëve të Kuranit:

*“O ju që besoni! Ruajini veten dhe familjet tuaja nga zjarri...”*⁶¹

Kështu ndalimi i vajtimit për të vdekurin bëhet nëse është me ulërimë, me zë të lartë, me kujë dhe me britmë që vjen si rezultat i zemërimit ndaj caktimit të Allahut.⁶²

Po ashtu El Buhariu r.h. në kapitullin “Ajo që ndalohet nga ulërima, vajtimi dhe britma”, ka thënë se nëse është thjesht e qajtur dhe pikëllim, atëherë kjo nuk ndalohet, meqë kjo ka ndodhur edhe te njeriu më i devotshëm, Pejgamberi s.a.v.s.⁶³

Më pas ai transmeton në *Isanadin* e tij, nga Usame ibn Zejdi r.a. se si kishte thënë: *E kishte lajmëruar e bija e Pejgamberit, s.a.v.s., se i biri i saj ishte i sëmurë për vdekje, ndërsa ne ishim aty kur i Pejgamberi, s.a.v.s., i dërgoi selam duke i thënë: “E Allahut është ajo që e merr dhe ajo që e jep dhe se çdo gjë tek Ai e ka kohën e caktuar; andaj duro dhe mbështetu në Zotin.” Por prapë ajo kërkoi që Pejgamberi të shkonte tek ajo. U ngrit Pejgamberi, s.a.v.s., ndërsa me të ishin Sa’ad ibn Ubadeh, Muadh ibn Xhebeli, Ubej ibn Ka’bi, Zejd ibn Thabiti dhe disa sahabë të tjerë. Ia dhanë Pejgamberit, s.a.v.s., fëmijën dhe ai e vuri në prehërin e tij, ndërsa shpirti i fëmijës po bënte përpjekje të dilte, e Pejgamberit, s.a.v.s., iu mbushën sytë lot. Se’adi i tha: O i Dërguar i Allahut, pse po qan? Ai u përgjigj: “Kjo është mëshira e Allahut, që e ka mbjellë në zemrat robërve të Tij, pa dyshim Allahu i mëshiron robërit e Tij që janë të mëshirshëm.”*⁶⁴

El Ajniu ka thënë: Fjalja e tij: *“Pejgamberit, s.a.v.s., iu mbushën sytë lot...”*, është qarje pa ulërimë, që dëshmon se qarja pa ulërimë është e lejueshme, andaj nuk fajësohet për të as ai që qan dhe as i vdekuri!⁶⁵

⁶⁰ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 1291.

⁶¹ Surja et-Tahrim, 6.

⁶² Sahihul Buhari, 2/79.

⁶³ Sahihul Buhari, 1/439.

⁶⁴ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 1284 dhe Muslimi, hadithi nr. 923.

⁶⁵ *Umdetul Karij’*, 8/72, Daru ihjait turathil arabij, Bejrut, pa vit botimi.

Ibn Abdul Birri r.h. ka thënë: Transmeton Ebu Is'hak EsSebij'i nga Amir b. Se'ad El Bexhli nga Ebu Mes'ud El Ensari dhe Thabit b. Zejd dhe Kurdha b. Ke'ab, se si kanë thënë: “Na është lejuar neve qarja për të vdekurit pa ulërimë! Sytë e Pejgamberit, s.a.v.s., iu mbushën me lot me rastin e vdekjes së djalit tij Ibrahimit (a.s.) dhe për këtë u pikëllua Pejgamberi s.a.v.s.”⁶⁶

Enesi ka thënë: “E kam parë atë, respektivisht e kam parë Ibrahimin, që ishte duke dhënë shpirt para Pejgamberit, s.a.v.s., sytë e Pejgamberi iu mbushën me lot dhe tha:

*“Syri loton, zemra pikëllohet, por nuk themi gjë tjetër, vetëm atë me çka është i kënaqur Zoti ynë. Ne jemi të mërzitur me ndarjen tënde, o Ibrahim.”*⁶⁷

En Neveviu ka thënë: Fjala e tij: “*Pejgamberit, s.a.v.s., iu mbushën sytë lot...*”, dëshmon lejimin e qarjes dhe pikëllimit për të sëmurin dhe kjo nuk e kundërshton pajtimin me caktimit, madje ajo është mëshirë, të cilën e ka vendosur Allahu në zemrat robërve të Tij. Mirëpo, të qortuara janë: vajtimi me elegji, ulërima, klithma, kuja e të ngjashme me to nga shprehjet e pavlerë. Për këtë Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë: “*Ne nuk themi gjë tjetër, vetëm atë me çka është i kënaqur Zoti ynë.*”⁶⁸

Pejgamberi, s.a.v.s., qau dhe pasi që u ankua Se'ad b. Ubade e pasi që njerëzit e panë Pejgamberin, s.a.v.s., duke qarë, atëherë edhe ata qanë! Pastaj Pejgamberi, s.a.v.s., tha:

*“A nuk po dëgjoni se Allahu nuk ndëshkon për lotin e syrit dhe as për dhembjen e zemrës? Por Ai ndëshkon ose fal për këtë - dhe bëri me shenjë kah gjuha e tij! Me të vërtetë i vdekuri ndëshkohet për shkak të të qarit (vajtimit) të familjarëve të tij për të.”*⁶⁹

O Zoti ynë, Ty të lutemi, falënderimi të takon vetëm Ty, nuk ka zot dhe rival tjetër përveç Teje, o Dhurues!

O Krijues i qiejve dhe tokës, o i Madhëruar dhe i Nderuar, o i Përherëshëm dhe Mbikëqyrës, kërkojmë prej Teje që t'i falësh mëkatet e të vdekurve tanë dhe të të gjithë myslimanët e vdekur!

⁶⁶ Shih: Ibnu Abdil Birr, *El Istidhkar*, 3/67, Darul kutubil ilmije, Bejrut, 1421 h, 2000.

⁶⁷ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 2315.

⁶⁸ *Sherhun Nevevi ala Muslim*, 15/75, Daru ihjait turathil arabij, Bejrut, 1392 h.

⁶⁹ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 1304.

O Zoti ynë, fali mëkatet e tyre, ki mëshirë ndaj tyre, fali ata dhe nderoji me mirëseardhje, zgjeroje hyrjen e tyre dhe pastroji ata me ujë bore të ftohtë, o më i madhi Mëshirues!

DURIMI NDAJ SPROVAVE DHE FATKEQËSIVE - Shejh Muhamed Muteveli Esh Sh'aravi (6:37)

SI ËSHTË DURIMI PËR NDARJEN APO VDEKJEN E ATIJ QË E DO! - Shejh Meshari El-Harraz (11:13)

Rreth respektit ndaj të vdekurit⁷⁰

Çështja e parë që shfaqet në mendje, me rastin e bisedës për respektin ndaj të vdekurit është citati i hadithit: *“Respekti ndaj të vdekurit është varrimi i tij.”* Kështu që shumë njerëz mendojnë se përshpejtimi i varrimit të të vdekurit është mënyra e vetme e respektimit të tij për të cilën kemi tekste fetare!

Në realitet, Islami i kushton rëndësi të madhe respektit ndaj të vdekurit edhe materialisht edhe moralisht. Megjithatë, nuk bën të ndahet respekti material nga ai moral, sepse në respekti material ndaj të vdekurit është po ashtu edhe respekt moral. Kështu që, respektimi i trupit të tij, njëherësh është edhe respektim i shpirtit të tij, madje ky është respekt ndaj njeriut përgjithësisht!

Kështu, nga veçantitë e respektit të Islamit për njeriun është nxitja për respektim të parimeve të caktuara gjatë larjes, mbështjelljes me qefin, gjatë xhenazes dhe varrimit, me rastin e vizitës së varrit të tij – të gjitha këto i bashkon respekti dhe nderimi ndaj të vdekurit. Po ashtu këtë çështje e gjejmë te ndalimi i talljes me trupin e tij, apo ndalimi nga përmendja e tij për të keq pas vdekjes. Përkundrazi, nxitet theksimi i të mirave të tij dhe bërja lutje për falje dhe mëshirë për të!

Është numër i madh i ajeteve kuranore dhe i haditheve të Pejgamberit, s.a.v.s., që e trajtojnë këtë tematikë. I tillë është ky ajet:

“Ne, me të vërtetë, i kemi nderuar bijtë e Ademit: u kemi bërë të mundshme të udhëtojnë në tokë dhe në det, duke i furnizuar me gjella të shijshme dhe u kemi dhënë përparësi të madhe ndaj shumicës nga ata që i kemi krijuar.”⁷¹

Ky ajet shprehet përgjithësisht, pra duke përfshirë të gjallët dhe të vdekurit, siç e komentoj tradita pejgamberike nëpërmjet haditheve të shumta, që konfirmojnë se respekti ndaj pasardhësve të Ademit i përfshin po ashtu edhe të vdekurit! Gjithashtu, respekti ndaj të vdekurit është sikur respekti ndaj të gjallit në nivel të barabartë. Në këtë kontekst janë edhe hadithet vijuese të Pejgamberit s.a.v.s.:

⁷⁰ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 12. 7. 2015.

⁷¹ Surja el-Isra, 70.

“Përmendni mirësitë e të vdekurve tuaj dhe mos i theksoni të metat e tyre!”⁷²

“Le t’i lajnë të vdekurit tuaj të besueshmit.”⁷³

“Thyerja e ashtit të njeriut të vdekur është sikurse thyerja e ashtit të njeriut të gjallë.”⁷⁴

“Nëse ndonjëri prej jush e mbështjell me qefin vëllanë e tij të vdekur, le ta mbështjellë në mënyrën më të mirë!”⁷⁵

Prej këtyre haditheve është edhe ndalimi i Pejgamberit s.a.v.s.:

“Të mos patinohen varrezat, të mos shkruhet mbi to dhe të mos shkelen!”⁷⁶

Transmetohet nga Pejgamberi, s.a.v.s., të ketë thënë:

“Ulja e dikujt prej jush mbi gacën e zjarrit dhe ajo t’i djegë rrobën dhe të arrijë në lëkurën e tij, është më e mirë për të se sa të ulet mbi varr.”⁷⁷

Në një hadith Ibni Omeri r.a. ka thënë:

“Nëse vdes dikush prej jush, mos e mbani, por nxitoni me të për në varrin e tij.”⁷⁸

Po ashtu, Pejgamberi, s.a.v.s., ka porositur për të vdekurin, duke thënë:

“Varroseni të vdekurit tuaj në mesin e njerëzve të mirë, sepse i vdekuri vuan shpirtërisht pranë fqinjit të keq, ashtu siç vuan i gjalli pranë fqinjit të keq!”⁷⁹

Ka edhe shumë hadithe të tjera, të cilat sqarojnë se deri ku ka arritur vlerësimi i fesë sonë të vërtetë ndaj njeriut të gjallë dhe të vdekur!

Falënderim i takon Allahut për begatinë e Islamit.

⁷² Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 4900 dhe Titmidhiu, hadithi nr. 1019.

⁷³ Transmeton Ibni Maxhe, hadithi nr. 1461. Albani në veprën e tij *Silsiletul ehadidhid daijfe*, 9/386, thotë se hadithi është *mevdu’*.

⁷⁴ Transmeton Ibni Maxhe, nga hadithi i Ajshes, hadithi nr. 1616.

⁷⁵ Transmeton Muslimi nga hadithi i Xhabirit, hadithi nr. 943, Ebu Davudi, hadithi nr. 3148 dhe En Nesaiu, hadithi nr. 1895.

⁷⁶ Transmeton Tirmidhiu, hadithi nr. 1052.

⁷⁷ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 971.

⁷⁸ Transmeton Taberaniu në *El Kebir*, hadithi nr. 13613.

⁷⁹ Ebu Neijm, *El Hulje*, 6/354.

E kush mund të jetë më i vërtetë se Allahu në thënie⁸⁰

Do të ndalemi këtu te dallimi ndërmjet dy shprehjeve “thënie” dhe “fjalë”, të cilat janë theksuar në dy ajete të ndryshme në suren en-Nisa.

Ajeti i parë është:

“Allahu është një, i vetëm, - i pashoq. Ai me të vërtetë, do t’ju tujtojë në Ditën e Kiametit. Për këtë nuk ka dyshim fare! E kush mund të jetë më i vërtetë se Allahu në thënie?”⁸¹

Kurse ajeti i dytë është:

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, Ne do t’i shpiem në kopshte të xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë, ku do të qëndrojnë vazhdimisht e përgjithmonë. Ky është premtimi i vërtetë i Allahut. E kush është më i vërtetë se Allahu në fjalë?!”⁸²

Së pari, vërejmë se në këto dy ajete theksohet çështja e bisedës për Ditën e Gjykimit që nuk ka dyshim dhe se premtimi i Allahut për futjen e atyre që besojnë dhe bëjnë vepra të mira në xhenete, ku rrjedhin lumenj është premtim i vërtetë që po ashtu nuk ka dyshim në të.

Së dyti, vërejmë se këto dy ajete në fund janë theksuar në trajtën e pyetjes retorike dhe të sfidës njëkohësisht! Megjithatë, ka qenë e mundshme të theksohen vetëm në trajtën informative, sikur të thoshte i Lartmadhërishti: “Nuk ka asnjë më të saktë në thënie a fjalë!” Mirëpo, Allahu i Plotfuqishëm deshi që njeriu të mendojë dhe reflektojë: “Vallë, a ka ndonjë më të saktë sesa Allahu i Madhërishtëm?” Natyrisht, përgjigjja është me mohim kategorik! Atëherë, pse disa njerëz dyshojnë – nëse nuk janë shumica e tyre - në ringjallje dhe llogaridhënie!

Ndërkaq, sa i përket vërejtjes së tretë, që ka të bëjë me atë se Allahu tashmë i zgjodhi dy fjalë të ndryshme në shqiptim, kurse të njëjta në kuptim! Një nga komentuesit e Kuranit këtë ndryshim e ka interpretuar si

⁸⁰ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 15. 11. 2015.

⁸¹ Surja en-Nisa, 87.

⁸² Surja en-Nisa, 122.

motiv gjuhësor, i cili është shfaqur në ajetin e dytë me shprehjen “fjalë”, që të merr trajtën e paskajores, të për t’u përshtatur me shprehjet paprapake “premtim i saktë” që u ngjet në lehtësi. Ndaj, sukuni i bashkëtingëllores së mesme dhe numri i bashkëtingëlloreve të tyre është sikur dy paskajoret e mëparshme. Kjo duket, sikur është qëllimi i përsëritjes së paskajores me shprehjen e saj, ku u rëndua përsëritja për afrim, që është zakon i arabëve në këtë çështje, andaj është niveluar për ta përputhur kuptimin, në mënyrë që tri paskajoret të jenë me një ecuri dhe trajtë të lehtë duke arritur përputhshmëri dhe përshtatshmëri.

Meqë kjo nuk është prezantuar në ajetin e parë që duhej, atëherë vërtet fjala e Allahut të Madhërishëm: ***Ai me të vërtetë, do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit...***⁸³ është njoftim rreth ringjalljes pas vdekjes dhe tubimit të njerëzve për llogaridhënien dhe shpërblimin e tyre për të mirë a për të keq! Kështu, ky është një njoftim dhe lajm, ngjashëm me atë që theksohet në fjalën e Allahut të Madhërishëm, lidhur me mohuesit e ringjalljes:

“A doni t’ju tregojmë njeriun i cili ju lajmëron se kur të shkapërdherdheni plotësisht (në varreza)...”⁸⁴

Kështu njoftimi këtu ka të bëjë me atë lajmin e saktë nga Allahu i Madhërishëm: ***“Ai me të vërtetë, do t’ju tubojë në Ditën e Kiametit...”*** Kështu janë sqaruar këto dy ajete në përputhshmëri dhe përshtatshmëri, megjithatë Allahu e di më së miri!⁸⁵

Larg të metave është Allahu i Madhërishëm!

KUPTIMI I SINQERITETIT ME ALLAHUN - Shejh Salih El Megamisi (2:55)

⁸³ Surja en-Nisa, 87.

⁸⁴ Surja es-Sebe’, 7.

⁸⁵ *Melakut te’vilil kati’ bi dhevil ilhadi vet ta’tili fi tevzhijhil muteshabihil lafdhi min ajit tenziji*, Ahmed bin Ibrahim bin Ez Zubejr Eth Thekafi El Garnati, Ebu Xhafer, 1/108, Darul kutubil ilmije, Bejrut – London.

Shqiptimi i shehadetit para personit që është në prag të vdekjes⁸⁶

Kjo temë – për fat të keq – nuk është e pranishme në mendjen e shumë njerëzve, me gjithë rëndësinë e saj të madhe, sepse, me lejen e Allahut, mund ta realizojë synimin në përcaktimin e fatit të atij që është në prag të vdekjes pasi që jep shpirt!

Andaj, lexues të nderuar, mos u çuditni as mos u mahnitni, sepse Muadh b. Xhebeli thoshte se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush vdes dhe fjala e tij e fundit është La ilahe il-lallah, hyn në xhenet.”⁸⁷

Transmeton Ebu Se’id El Hudri se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë: *“Përkujtojuani të vdekurve tuaj (në agoninë e vdekjes) dëshminë La ilahe il-lallah.”⁸⁸* Ka thënë El Hafid Ibn Haxher r.h.: *“Qëllimi me shprehjen: “La ilahe il-lallah” në këtë hadith dhe në hadithe tjera janë dy shehadetet (dy dëshmitë).”*

Dy shehadetet janë: *“La ilahe il-lallah”* (Nuk ka zot tjetër përveç Allahut) dhe *“Muhammedun resulullah”* (Muhamedi është i dërguari i Allahut), qoftë kështu apo me dëshminë: *“Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i dërguar i Tij.”*

Ndërkaq, sa i përket mënyrës së këndimit, ajo është që të kërkosh butësisht nga ai që është në prag të vdekjes, që të thotë: *“Nuk ka zot përveç Allahut”*, por këtë mos ia thuaj shumë herë. Mjafton përmendja një apo dy herë, në mënyrë që të jetë e pranishme në mendjen e tij dhe të jetë fjala e tij e fundit me vullnetin e Allahut.

Allahu na dhuroftë neve dhe juve përfundim të mirë dhe vdekje me fjalën e shehadetit!

⁸⁶ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 22. 11. 2015.

⁸⁷ Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 3116, Hakimi, hadithi nr. 1229. Albani e konsideron *sahih*.

⁸⁸ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 916.

Filozofia e sëmundjes sipas Islamit⁸⁹

Nën hijen e kënaqësisë absolute me përcaktimin e Allahut, që është i Urtë dhe i Gjithëdijshëm, nuk na takon neve, madje as të pëshpëritim në vet-vete: Pse Allahu veproi me ne kështu, e nuk veproi ashtu?! Vërtet ky është kapërcim i limitit tonë njerëzor, tejkallim në të drejtën e të Plotfuqishmit dhe injorancë në madhësinë e Tij, sepse ne nuk mund ta përfshijmë dijen e Tij me diçka, përveçse aq sa Ai ka dëshiruar. Thotë Allahu i Plotfuqishëm:

“Ai di çdo gjë që ka ndodh përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen. Por, njerëzit, nuk dinë asgjë nga dijenia e Tij, përveç asaj që Ai ka dashur t’ua tregojë...”⁹⁰

Kur ne i parashtrojmë vetes pyetje lidhur me urtësinë hyjnore për kaplimin e njerëzve me sëmundje, ne fillimisht pohojmë se Krijuesi i këtij kozmosi është Mëshirues i Urtë! Andaj, nëse nuk është kështu, atëherë në parim nuk do ta pyesnim veten për shkakun ekzistimit të dhimbjes, apo sherrit në këtë gjithësi, meqë nëse kjo është normë, atëherë nuk do ta kuptonim dhe nuk do t’i kushtonim vëmendje asaj! Por ajo është një përjashtim dhe shfaqje, që i prek të gjithë njerëzit në ndonjë kohë në jetën e tyre në këtë botë, për shumë urtësi, për të cilat kanë folur shkencëtarët dhe të urtit nëpër kohëra!

Nga këto urtësi që i studioan dijetarët, konfirmohet se sëmundja edhe nëse është e keqe nga një aspekt, megjithatë ajo është e mirë në shumë aspekte të tjera! Sepse Allahu i Madhërishëm, siç thotë Imam Ibn Kajjim El Xhevzije r.h.: “Nuk krijon thjesht të keqe nga të gjitha aspektet, por çdo gjë që Ai ka krijuar, e ka bërë për një përfitim dhe urtësi, madje edhe nëse në ndonjë pjesë të saj ka një të keqe relative. Kurse, sa i përket të keqes absolute të tërësishme nga çdo aspekt, vërtet Allahu i Plotfuqishëm është i pastër prej saj dhe nuk i përket Atij.”⁹¹

Nga urtësia e kaplimit të sëmundjes tek robi është që t’i nënshtrohet Zotit të tij, të pendohet, t’i kthehet Atij, ta njohë nivelin e shkujdesjes

⁸⁹ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 2. 11. 2014.

⁹⁰ Surja el-Bekare, 255.

⁹¹ *Shifaul alijl fi mesailil kadai vel kaderi vel hikmeti vet ta’lijl*, fq. 169.

dhe padrejtesisë ndaj vetvetes! Ai nuk ka të drejtë të tregohet superior ndaj askujt, apo të mendojë se në veten e tij ka fuqi të pamposhtur, por ta dijë se ai është vetëm një rob i dobët si një “virus”, që nuk shihet me syrin e thjeshtë, të cilin e mban disa vite. Mjafton ta përmendim shkakun e shkuarjes tij në brendinë e tokës, pasi që ecte mbi të me mendjemadhësi dhe krekosje!

Çështja e sëmundjes, nëse ajo nuk i jep fund jetës së njeriut, atëherë ajo e bën atë të shëndoshë e të fuqishëm! Meqë ai tashmë i ka njohur begatitë e panumërta të Zotit tij, andaj e kontrollon veten, tregohet modest së pari para Allahut, e pastaj edhe para njerëzve, bën vepra të mira, kujdeset sa ka mundësi për shëndetin e vet dhe shëndetin e të tjerëve. Po ashtu, ai ka dhembshuri për të sëmurët e veçmas për të varfrit prej tyre. Atyre u jep lëmoshë nga pasuria dhe mirëqenia e tij, meqë goditja, e cila nuk e thyen shpinën e njeriut, e forcon atë!

Sëmundja – siç është theksuar në shumë hadithe të vërteta – e pastron njeriun nga mëkatet dhe gabimet, andaj është traditë t’i thuhet të sëmurit atë që ia ka thënë Pejgamberi, s.a.v.s., një beduini kur e vizitoi: *“E kaluar qoftë, me pastrim in sha’ Allah.”*⁹²

Kështu shumica e sëmundjeve që na godasin, madje edhe fatkeqësitë, janë pasojë e veprave tona, siç e konfirmon Allahu i Madhërishëm: *“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, kjo është për shkak se e keni fituar vetë, e Ai edhe fal shumë.”*⁹³

Allahu i Madhërishëm i ka përgëzuar robërit e Tij nëpërmjet Pejgamberit të Tij, s.a.v.s., që sprovohen me një lloj nga llojet e sëmundjes, ku thotë:

*“Nuk e godet myslimanin asnjë lodhje, asnjë sëmundje, asnjë shqetësim, asnjë trishtim, asnjë vuajtje, dhe asnjë mjerim bile asnjë gjemb që e shpon, për tjetër veçse që Allahu t’i falë me të prej mëkateve të tij.”*⁹⁴

Në një hadith tjetër thotë:

*“Nuk ka mysliman, të cilin e godet lëndimi i sëmundjes, e të ngjashme me të, e të mos ia shlyejë Allahu përmes saj të këqijat e tij, ashtu siç bien fletët e pemës.”*⁹⁵

⁹² Pjesë nga hadithi të cilin e transmeton Imam El Buhariu në Sahih, Libri i virtyteve, Kapitulli Shenjat e pejgamberisë, hadithi nr. 3616. (...)

⁹³ Surja el-Bekare, 255.

⁹⁴ Muttefekun alejhi, e transmeton Buhariu, hadithi nr. 5641 dhe Muslimi, hadithi nr. 2572, teksti është i Buhariut.

Pastaj hadithi:

“Shembulli i besimtarit kur ta godasin temperatura dhe ethet është sikurse shembulli i një hekuri, i cili hyn në zjarr, me ç’rast largohet ndryshku i tij, ndërsa mbetet pjesa tjetër e mirë e tij.”⁹⁶

Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

“Nuk ndodh ta godasë njeriun ndonjë fatkeqësi, më shumë apo më pak sa ajo, e të mos jetë shkak i mëkatit, ndërsa ato që Allahu jua fal janë të shumta.”⁹⁷

Dhe hadithi i Pejgamberi s.a.v.s.:

“Vërtet Allahu e sprovon robin e Tij me sëmundje, në mënyrë që t’ia shlyejë atij çdo mëkat.”⁹⁸

O Allah, sa Fisnik që je o Zoti ynë, madje edhe përmes gjembit, bren-gës, apo shqetësimit i gëzon robërit e Tu me shlyerjen e mëkateve të tyre!

Andaj, Allahu ka më shumë dëshirë për mëshirë ndaj robit të Tij sesa robi ndaj vetvetes! Vërtet i Plotfuqishmi është më i mëshirshëm ndaj nje-riut sesa nëna e tij.

Transmetohet nga Ibni Omeri se ka thënë:

Ishim me Pejgamberin, s.a.v.s., në një fushatë ushtarake, kaluam pranë disa njerëzve, të cilët i pyeti: “Kush jeni ju?” Thanë: “Ne jemi myslimanë”, ndërsa një grua e hodhi tanorin, që pranë saj ishte fëmija i saj, atëherë u ngrit prushi i tanorit, e preku pak me të! Më pas erdhi te Pejgamberi, s.a.v.s., duke i thënë: “A je ti i dërguari i Allahut?” Tha: “Po!” Tha ajo: “Për kokën e prindërve të mi, a nuk është Allahu (më) Mëshiruesi i mëshiruesve?” Tha: “Po!” Tha ajo: “A nuk është Allahu më i mëshirshëm ndaj robërve të Tij sesa nëna ndaj fëmijës së saj?” Tha: “Po!” Tha ajo: “Nëna nuk e hedh fëmijën e saj në zjarr!” Atëherë Pej-gamberi, s.a.v.s., uli kokën duke qarë! Më pas e ngriti kokën duke iu drejtuar asaj: “Vërtet Allahu nuk i ndëshkon robërit e Tij, përveç tiranin e pabindur, i cili rebelohet ndaj Allahut dhe refuzon të thotë: Nuk ka zot tjetër përveç Allahut!”⁹⁹

⁹⁵ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 5648 dhe Muslimi, hadithi nr. 2571.

⁹⁶ Transmeton Hakimi në *El Mustedrek*, hadithi nr. 246 dhe Bejhekiu në *Es Sunen el kubra*, hadithi nr. 6544.

⁹⁷ Transmeton Tirmidhiu në *Sunen*, hadithi nr. 3252.

⁹⁸ Transmeton Taberaniu në *EL Kebir*, hadithi nr. 1548, Hakimi në *El Mustedrek*, hadithi nr. 1286 dhe Bejhekiu, hadithi nr. 9397.

⁹⁹ Transmeton Ibni Maxhe, hadithi nr. 4297.

Është nga mëshira e të Lartmadhërishmit që, kur na godet sëmundja t'i lutemi Atij, t'i drejtohem me lutje për falje, ndoshta do të na shërojë neve apo atë që e duam! Kjo urtësi nuk na vjen vetëm përmes sëmundjes, apo të këqijave (fatkeqësive), por na vjen edhe përmes të mirave (mirëqenies). Le të reflektojmë në fjalën e Allahut të Madhërishëm:

“Ne, i kemi vënë në sprovë ata me gjëra të mira dhe të këqija për (pendim) t’u kthyer.”¹⁰⁰

Po ashtu, fjala e Allahut të Madhërishëm:

“Ne ju vëmë në sprovë juve – me të keqe dhe me të mirë...”¹⁰¹

Kështu shohim se Allahu i Plotfuqishëm i sprovon robërit e Tij, me luks dhe me skamje, me dëshirë dhe me frikë, me mirëqenie dhe me sprovë.¹⁰²

Është nga urtësia e të Lartmadhërishmit që goditja e disave me sëmundje të jetë mësim dhe leksion për neve dhe për të tjerët, në mënyrë që ta kuptojnë vlerën e shëndetit kur kanë mirëqenie! Po ashtu, ta kuptojnë se kjo mirëqenie nuk është e përhershme, por është e përkohshme! Sikur ajo të ishte e përhershme, atëherë ne do të ishim në nivel mbinjerëzor, ku nuk do të na përfshinte mangësia as paaftësia, por ne jemi me origjinë njerëzore, që kemi mangësi dhe zhdukje.

Këto janë disa sinjale të atypëratyshme lidhur me urtësinë e sëmundjes, të cilat nuk i kuptojnë dhe nuk përfitojnë prej tyre përveç atyre që durojnë dhe falënderojnë si dhe e perceptojnë mëshirën e të Lartmadhërishmit. Andaj, atë që e godet sprova mos të kërkojë prej Tij tjetër veçse durim të bukur pa iu ankuar njerëzve, pa pikëllim, pa zemërim për caktimin e tij qysh në ezel. Dhe atëherë mund të përgëzohet se njerëzit më të sprovuar janë pejgamberët e pastaj personalitetet e shquara!

Transmetohet nga Ebu Se’id El-Hudri se si kishte hyrë te Pejgamberi, s.a.v.s., i cili ishte i rënduar me ethe, mbi të kishte një kadifë, e vuri dorën mbi të dhe ndjeu temperaturë sipër kadifes, atëherë Ebu Se’idi tha: “Sa temperaturë të madhe që ke, o i Dërguari i Allahut!” Tha: “Ne kështu kemi sprova të mëdha, andaj na dyfishohet shpërblimi.” Tha: “O i Dërguari i Allahut, cilët njerëz janë më të sprovuarit?” Tha: “Pejgamberët, pastaj njerëzit e mirë! Ndonjëri prej tyre sprovohet me varfëri, nuk kishte gjë tjetër përveç pelerinës që e

¹⁰⁰ Surja el-A’raf, 168.

¹⁰¹ Surja el-Enbija, 35.

¹⁰² Shih: Tefsiri i Ibni Kethirit, 3/498.

paloste dhe e vishte, ndonjëri sprovohet me morra derisa e mbysin! Dikush prej tyre ishte më i gëzuar me sprovë sesa ndonjëri prej jush me dhunti.”¹⁰³

Nëse kështu ishte gjendja e peygamberëve dhe e njerëzve të mirë, atëherë si është gjendja e atyre që janë në nivel më të ulët se ata dhe që janë në largësi më të madhe nga Allahu i Plotfuqishëm?

Vërtet ushtrimi i durimit dhe falënderimit mund ta vendosë të sëmurin në shoqërinë e peygamberëve, njerëzve të mirë dhe të ngjashëm me ta, veçmas kur ai insiston duke iu lutur Allahut të Plotfuqishëm që me mirësinë dhe mëshirën e Tij ta bëjë shoqërues me peygamberët dhe njerëzit e mirë në xhenet.

Për këtë arsye, poeti thotë:

*E fiton kënaqësinë robi, që është falënderues në mirëqenien e tij,
pastaj durimi i ndihmon atij kur të jetë në vështirësi.
Kur i Gjithëmëshirshmi është i kënaqur me robin e vet,
fal Allahut, ai është i lumtur në dynja dhe në ahiret.*

¹⁰³ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 510. Albani e konsideron *sahih*.

Filozofia e vdekjes sipas Islamit¹⁰⁴

Vdekja është një realitet i pamohueshëm, në të cilin askush nuk mund të dyshojë, është e vërtetë që s'ka asnjë dyshim në të! Ajo vjen shpeshherë befasisht pa ndonjë paralajmërim të qartë dhe gjithmonë pa asnjë shpejtim as vonim:

“Çdo popull e ka fundin e vet dhe kur t'i vijë koha e fundit, nuk mund të shtyhet as të shpejtohet, kurrsesi.”¹⁰⁵

Ajo është një gotë, prej së cilës do të pijë çdo njeri! Ajo është një pishinë në të cilën çdokush do të notojë, i pasuri dhe i varfri, i dashuri dhe i përbuzuri, i fuqishmi dhe i dobëti:

“Çdo qenie e gjallë do ta shijojë vdekjen. Shpërblimet do t'iu plotësohen vetëm në Ditën e Kiametit dhe kushdo që largohet nga zjarri i xhehenemit dhe hyn në xhenet, ai e ka arritur atë që ka dëshiruar. E jeta e kësaj bote është vetëm kënaqësi mashtruese.”¹⁰⁶

Kështu, i Gjalli, i Përrjetshmi ka përcaktuar zhdukjen për të gjithë mbi sipërfaqen e tokës, madje për të gjithë në këtë gjithësi, që të mbetet vetëm Ai i Plotfuqishmi në jetë absolute, në të cilën nuk ka vdekje, as para, as pas:

“Çdo gjë që është në Tokë është kalimtare (do të shkatërrohet), e mbetet vetëm Zoti yt, i Madhërishmi dhe Bamirësi.”¹⁰⁷

Ky është një realitet, të cilit shumica e njerëzve përipiqen t'i shmangen, nëse jo me veprat e tyre, atëherë e bëjnë me ndjenjat dhe mendimin e tyre, por kjo është e pamundur:

“Thuaj: “Vdekja, të cilës po i ikni ju, do t'ju arrijë. Pastaj, ju do të ktheheni tek Ai, që i di gjërat e dukshme e të padukshme dhe Ai do t'ju informojë juve për atë që keni punuar.”¹⁰⁸

¹⁰⁴ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 9. 11. 2014.

¹⁰⁵ Surja el-A'raf, 34.

¹⁰⁶ Surja Alu Imran, 185.

¹⁰⁷ Surja err-Rrahman, 26-27.

¹⁰⁸ Surja el-Xhumu'a, 8.

Pastaj, po për ku do të jetë kjo ikje? Vdekja e ndjek njeriun - kur vjen exheli i tij - në çdo vend:

“Kudo që të gjendeni ju, do t’ju arrijë vdekja, madje qofshi edhe në kështjellat më të forta.”¹⁰⁹

Kështu që nuk ka shpresë që të dërguarit e Allahut (melekët e vdekjes) ta kundërshtojnë urdhrin e Zotit tyre për t’ua marrë shpirtat e krijesave:

“Ai sundon mbi robërit e vet dhe ju dërgon rojtarë; kur njërit nga ju i vjen vdekja, të dërguarit tanë (melekët) e bëjnë të vdekur (ia marrin shpirtin), duke mos bërë kurrfarë lëshimi (pa përjashtim).”¹¹⁰

Kështu asnjë nuk mendon se ndonjëri nga anëtarët e familjes, shokët apo miqtë mund ta shpëtojë nga vdekja, apo t’ia kthejnë sërish shpirtin, por ata qëndrojnë para tij të paaftë në shpëtimin e tij:

E, përse kur t’ju vijë shpirti në fytyrë, - dhe kur ju atëherë e shikoni atë, - e ne jemi më afër atij se ju, por ju nuk shihni, - e sikur të ishit ju të fuqishëm (e nuk do të sundonte tjetërkush) - atëherë do t’ia kthenit (shpirtin atij), nëse e thoni të vërtetën?”¹¹¹

Sa fëmijë i ka rrëmbyer vdekja nga babai i tyre, sa etër nga fëmijët e tij, sa vëllezër nga vëllezërit e tyre, sa shokë nga shokët e tyre, sa të dashur nga të dashurit e tyre, sa të afërm nga të afërmit e tyre dhe asnjëri prej tyre nuk mundi ta zbrapste vdekjen apo ta kthente te miku apo i dashuri.

Vallë, si mund ta shpëtojnë atë nga vdekja, kur ata në fakt nuk mund ta shpëtojnë veten e tyre prej saj, kur iu vjen exheli:

“Atyre që nuk luftuan e u thanë vëllezërve të vet: “Sikur të na dëgjoni neve nuk do të mbyteshit”, thuaju: “Prapësojeni vdekjen nga vetja, nëse e flisni të vërtetën!”¹¹²

Nuk ka dyshim se vdekja është fatkeqësi për familjen, për të dashurit dhe për shokët e tij, siç e konfirmon ajeti kuranor: ***“...dhe ju gjen fatkeqësia e vdekjes”***¹¹³, megjithëse ajo mund të jetë rehati për njeriun nga vuajtja e jetës, nga dhimbjet e sëmundjes, apo nga plaga që e ka goditur.

¹⁰⁹ Surja en-Nisa, 78.

¹¹⁰ Surja el-En’am, 61.

¹¹¹ Surja el-Vakia, 83-87.

¹¹² Surja Alu Imran, 168.

¹¹³ Surja el-Maide, 106.

Vdekja vërtet dhe sinqerisht është mëshirë për atë banesa e të cilit është xheneti! Ajo është rehatia e tij e parë e plotë nga shtrëngesat dhe vështirësitë e jetës. Për këtë arsye, kur Pejgamberi, s.a.v.s., i ndjeu dhimbjet e vdekjes, që nuk i kishte ndierë më parë, Fatimja, i tha: *“Vuajtje, o babi im.”* Ndërsa Pejgamberi, s.a.v.s., u përgjigj: *“Pas së sotmes nuk ka më vuajtje për babanë tënd! Babai yt është në prag të vdekjes, së cilës nuk ka mundur t’i shmanget askush, mbërritje “takim a pranim” në Ditën e Gjykimit.”*¹¹⁴

Po ashtu, ndonjëherë është mëshirë për të gjallët rreth tij, nëse i vdekuri ka qenë i sëmurë me sëmundje të dhembshme dhe të pashpresë për shërim, apo ka qenë njeri dëmtues, prej të cilët frikësoheshin njerëzit, meqë ata nuk kishin mundësi t’i shmangeshin torturës së tij. Kështu, mbytja e djaloshit ishte rehati për prindërit e tij të mirë, përndryshe ai do t’i mundonte me tortura dhe kufër, sikurqë është theksuar në suren el-Kehf, ku Kurani famëlartë tregon për njeriun e mirë, të cilin e ndiqte Musai për të marrë dituri prej tij. Mirëpo, ai i bëri disa veprime të çuditshme, për dikë që nuk i kupton qëllimet, ku njëra prej tyre ishte mbytja e djaloshit!

“Dhe, shkuan (ata), e kur e takuan një djalosh, dhe e mbyti atë tha (Musai): “Pse e mbyte njeriun e pafajshëm që nuk ka mbytur askënd! Me të vërtetë, bëre një punë të shëmtuar!”¹¹⁵

Pas kësaj ia shpjegoi Musait a.s. se çfarë kishte pas atij veprimi me ajetin:

“E sa i përket djaloshit, prindërit e tij ishin besimtarë, andaj ne u frikuan që ai (djali i tyre) mos t’i kthente ata në të keqe dhe mohim, - e ne dëshirojmë që Zoti i tyre, në vend të atij (djalit), t’ua japë një më të mirë, më të pastër (prej mëkateve) dhe më të mëshirshëm (ndaj prindërve).”¹¹⁶

Andaj, vdekja e tij ishte mëshirë për prindërit, madje edhe për vetë djaloshin, sepse ajo e pengoi nga mosrespektimi i prindërve, kur arriti moshën e pubertetit!

Nga kjo që u ekspozua, shihet urtësia e vërtetë pse Allahu i Plotfuqishëm i ka krijuar vdekjen dhe jetën, e ajo është sprovë e njeriut, shpërbëlimi i tij me xhenet apo me xhehenem, në përputhje me ajetin kuranor:

¹¹⁴ Transmeton Ibni Maxhe, Libri i xhenazeve, Kapitulli i vdekjes dhe varrimit tij, hadithi nr. 1627. Albani e konsideron *sahih*.

¹¹⁵ Surja el-Kehf, 74.

¹¹⁶ Surja el-Kehf, 80-81.

***“Ai i cili ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t’ju provuar se kush prej jush vepron më mirë; – Ai është i Plotfuqishëm dhe Falës.”*¹¹⁷**

Ajo është sprovë, e cila nuk ka për qëllim kërcënim dhe frikësim, aq sa është këshillë dhe mësim, që njeriu ta kuptojë realitetin e ekzistencës së tij dhe që vetë ta përcaktojë fatin e tij në jetën reale, përkatësisht, në botën e përtejme:

***“Jeta e kësaj bote nuk është gjë tjetër përveçse argëtim dhe lojë. E, me të vërtetë, jeta e botës tjetër është jetë. Sikur ta dinin ata këtë!”*¹¹⁸**

Kështu nëse njeriu e kupton filozofinë e vdekjes, sipas Islamit, atëherë ai do ta kuptojë edhe vlerën e vërtetë të kësaj bote dhe do ta kthejë fytyrën e tij kah ana e ahiretit, pastaj do të punojë për të me zell dhe sinqeritet, ashtu që kur t’i vjen exheli të jetë plotësisht i gatshëm për të hyrë në xhenet! Allahu na bëftë neve, juve dhe të vdekurit tanë prej banorëve të xhenetit pa dhënë llogari dhe pa ndëshkim paraprak.

Po ashtu, perceptimi i filozofisë së vdekjes, do të bëjë që njeriu ta vështrojë vdekjen me një vështrim të matur dhe të qetë! Andaj, ai nuk do ta teprojë në pikëllimin e vdekjes së ndonjërit, nuk do ta godasë fytyrën me shuplaka, nuk do ta teprojë në vaj dhe kujë, por to ta shohësh të durueshëm, mirënjohës, të kënaqur, të bindur me parimet islame, duke shpresuar në shpërblim dhe të qetë, pavarësisht nga raporti i tij me të vdekurin!

Është transmetuar nga Umu Seleme se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

*“Kur një robi i bie një fatkeqësi dhe thotë atë që ka urdhëruar Allahu: “Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehem! O Zot! Më shpërble për fatkeqësinë dhe pasoje me diçka më të mirë!” Pa dyshim që Zoti do ta shpërblejë me diçka më të mirë.” Kur vdiq Ebu Seleme thashë: “Cili mysliman është më i mirë sesa Ebu Seleme? Shtëpia e tij është e para që është shpërngulur te Pejgamberi s.a.v.s. Pasi që unë e thashë këtë, Allahu ma kompensoi atë me Pejgamberin s.a.v.s.”*¹¹⁹

Ky është fryt i perceptimit real të vdekjes dhe shpërblim për atë që e pranon atë në përputhje me vëllimin e saj. Ajo është një fatkeqësi e begative, por të gjithë njerëzit herët a vonë do ta përjetojnë atë!

¹¹⁷ Surja el-Mulk, 2.

¹¹⁸ Surja el-Ankebut, 64.

¹¹⁹ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 918.

KËNDIMI I SHEHADETI PËR ATË QË ËSHTË NË PRAG TË VDEKJES - Shejh Muhamed Ismail El Mukaddem (3:57)

SËMUNDJA ËSHTË PASTRIM OSE NËNÇMIM DHE PARIMET E VIZITËS SË PACIENTIT - Dr. Omer Abdulkafi (8:37)

KUR TË SËMURET ROBI, ALLAHU IA DËRGON DY MELEKË - Shejh Muhamed Ratib En Nabulsi (14:32)

Filozofia e lutjeve dhe rukjeve sipas Islamit¹²⁰

*“Lutja është adhurim.”*¹²¹ Ajo mbart në përmbajtjen e saj shumë kuptime dhe dëshmi të besimit, të cilat e konfirmojnë adhurimin e njeriut ndaj Zotit të tij, e mbështesin tek Ai. Ai beson se Zoti është i vetmi që ka fuqi për t’iu përgjigjur kërkesës tij dhe për ta shëruar të sëmurin. Sepse dispozita e Tij, kur dëshiron të bëjë diçka, është vetëm të thotë “Bëhu!” – dhe ajo bëhet.

Duke marrë parasysh rëndësinë e lutjes si dëshmi e njëshmërisë dhe dorëzim ndaj Allahut të Madhërisëm, atëherë ai i cili e neglizhon atë dhe nuk tregon nevojë për të, në besimin e tij ka një çrregullim, ndaj duhet ta analizojë vetveten dhe t’i kthehet fjalës së Allahut:

“Jo, jo (megjithatë), me të vërtetë, njeriu e ka kaluar kufirin (në të keqe), për shkak se e ndien veten të pavarur (se nuk i nevojitet askush).”¹²²

E ndien veten të pavarur, nga kush?!

Vallë, a nuk ka nevojë për Atë, i Cili i dha, i dhuroi, ia mbuloi të metat dhe e lartësoi?! Ky është shkatërrim i padiskutueshëm dhe mendjemadhësi, e cila e çon në xhehenem, e shenjë e kësaj është braktisja e lutjes, që konfirmohet me ajetin kuranor:

“Zoti juaj, ka thënë: “Më thirrni Mua (më adhuroni), Unë do t’ju përgjigjem (do t’ju shpërblej)! Me të vërtetë, ata që nga mendjemadhësia nuk duan të Më adhurojnë – do të hyjnë të poshtëruar në xhehenem.”¹²³

Fakti se lutja është adhurim – siç është theksuar në hadithin e lartpërmendur – nuk është thjesht një çështje marginale për të cilën nuk ka nevojë, por është çështje që e përcakton realitetin e besimit të njeriut ndaj Zotit të tij dhe përmasat e bindjes në Të! Kështu ky realitet është bazë,

¹²⁰ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 17. 11. 2014.

¹²¹ Transmeton Tirmidhiu në *Sunen*, hadithi nr. 3372, dhe thotë se hadithi është *hasen*.

¹²² Surja el-Alak, 6-7.

¹²³ Surja Gafir, 60.

mbi të cilën mbështetet çdo hadith në lidhje me lutjen. Të qenët e tij shenjë e njëshmërisë, d.m.th. që njeriu të besojë se nuk ka strehim as mbrojtje përveç tek Ai, të Cilit i drejtohen të gjithë! Andaj insiston në lutje dhe tërë vëmendjen e përqendron në Të, pastaj e shkëlqen nga zemra çdo lidhje me krijesat dhe krejt çështjen ia dorëzon Krijuesit të Plotfuqishëm. Ai i zgjedh kohët më të përshtatshme për lutje, siç e zgjedh edhe vendin më të afërm që Ai e do – e ajo është sexhdeja kah Kibla! Ai kujdeset që t'i nënshtrohet vetëm Atij dhe, sa të ketë mundësi, të mos jetë i padëgjueshëm ndaj Tij. Ai i frikësohet Allahut në raport me vetveten, me familjen dhe me njerëzit e tjerë. Ai ushqehet me hallall dhe lutet për të mirë e kursesi për të keq! Ai nuk i ndërpret lidhjet me të afërmit dhe nuk nxiton për përgjigje të lutjes dhe gjëra tjera prej parimeve të lutjes.

Për përgjigjen e lutjes kushtëzohet – si parim i përgjithshëm – që lutësi të jetë besimtar ndaj Allahut, t'iu përgjigjet urdhrave të Tij, duke u shmangur nga ato që Ai i ka ndaluar, siç konfirmon fjala e Allahut të Plotfuqishëm:

“Kur besimtarët e Mi të pyesin për Mua, (thujt): Unë jam afër, iu përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai të më lutet Mua. Prandaj le ta plotësojnë thirrjen Time (për agjërime e detyra të tjera) dhe le të më besojnë Mua (mos të shmangen nga besimi), për të qenë në rrugën e drejtë.”¹²⁴

Këtu përjashtohet lutja e të imponuarit dhe lutja e të shtypurit, sepse ata edhe nëse janë jobesimtarë ndaj Allahut, në parim, Allahu i Plotfuqishëm do t'iu përgjigjet lutjeve të tyre, qofshin myslimanë, qofshin jobesimtarë, sepse Ai është Zot i botëve!

Reflekto, lexues i nderuar, për këto fjala të Allahut të Plotfuqishëm:

“Ai jua mundëson të udhëtoni nëpër tokë dhe det. E, kur ju të gjendeni në barkë (anije) dhe ajo lundron me ju me erën e përshtatshme, e ata i gëzohen kësaj, arrijnë një stuhinë dhe ata do t'i sulmojnë valët nga të gjitha anët e mendojnë ata që do të shkatërrohen, (atëherë) i luten Allahut sinqerisht, duke i premtuar besimin: “Nëse na shpëton nga kjo, na, me të vërtetë, do të jemi falënderues”. E kur Allahu i shpëtoi ata; ata përnjëherë, pa kurrfarë të drejte, bënë çrregullime në Tokë. O njerëz! Me të vërtetë, padrejtësia që bëni për t'u kënaqur në

¹²⁴ Surja el-Bekare, 186.

jetën e kësaj bote, vetëm juve ju dëmton. Ju do të ktheheni te Ne dhe Ne pastaj do t'ju njoftojmë për atë që keni punuar.¹²⁵

Kur robi kujdeset për njëshmërinë e Zotit të tij, vetëm Atij i frikësohet, vetëm Atij i mbështet dhe përgjithësisht ka devotshmëri ndaj Tij, atëherë ai duhet të jetë i bindur se lutja e tij është pranuar, sepse ky është premtimi i Allahut:

“Allahu, me të vërtetë, ka blerë nga besimtarët e vet trupin dhe pasurinën e tyre, për t’ua dhuruar xhenetin atyre. Ata luftojnë në rrugën e Allahut, vrasin dhe vriten. (Ky është) premtimi i tij i vërtetë në Tevrat, Inxhil dhe Kuran. E kush është më i plotë (më konsekuent) se Allahu në premtim? Andaj, gëzojuni kësaj shitjeje të juaj, që e keni kontraktuar me Të, dhe kjo është fitore e madhe.”¹²⁶

Megjithatë, përgjigjja e lutjes nuk kushtëzon që t’ia dhurojë njeriut pikërisht atë kërkesë të tij, apo atë shmangie veçmas nga ajo që ruhet prej tij! Vërtet Bujari nuk dhuron sipas njohurisë së lutësit dhe dëshirave të tij, por Ai dhuron sipas ditorisë dhe njohurisë së Tij për çdo send! Kështu njeriu ndodh që të lutet për të keq pa e ditur, duke menduar se po lutet për të mirë! Ai mund të urrejë diçka e ajo të jetë e dobishme për të dhe mund të dojë diçka, e ajo të jetë e dëmshme për të, kurse i Gjithëdituri dhe i Gjithinformuari, më së miri e di atë që është më e mirë për njeriun! Prandaj, është ligjësuar namazi i “istihares”, thelbi i së cilit është dorëzimi i çështjes tek Allahu, me bindje të plotë se Ai do të zgjedhë atë që është e mirë për të, madje edhe nëse ai nuk e percepton urtësinë e tij në atë moment.

Kjo çështje bëhet e qartë nga duaja e istihares, e cila në tërësi konsiston në dorëzimin e çështjes tek Allahu dhe në mbështetje tek Ai.

Është theksuar nga Xhabir bin Abdullahu r.a. se ka thënë: “Pejgamberi, s.a.v.s., na mësonte të bëjmë Istiharen për të gjitha çështjet/punët tona, ashtu siç na mësonte suret e Kuranit. Ai na thoshte: *‘Nëse ndonjëri prej jush mendon të bëjë diçka, le t’i falë dy rekate namaz (jo prej namazit farz), pastaj le të thotë:*

“O Zot, me diturinë Tënde kërkoj hairin! Kërkoj ndihmë prej fuqisë Sate, kërkoj prej të mirave të Tua të shumta, sepse Ti je i Gjithëfuqishëm, e unë jam i dobët, Ti di çdo gjë e unë nuk di, Ti je Ai që i di të fshehtat. O Zot,

¹²⁵ Surja Junus, 22-23.

¹²⁶ Surja et-Tevbe, 111.

nëse kjo punë e imja është hair për fenë dhe jetën time, për kohën e tashme dhe të ardhmen, bëje të mundshme që të realizohet, lehtësoje dhe bekoje! E nëse kjo punë është e dëmshme për fenë dhe jetën time, për të tashmen dhe të ardhmen dhe për në ahiret, largoje prej meje dhe largomë mua nga ajo, përcaktoma hairin kudo qoftë, pastaj më bëj të kënaqur me të (emëron këtu dëshirën, hallin etj).”¹²⁷

Kështu, lutja kërkon përpjekje serioze të menjëhershme, duke marrë në konsideratë rrethanat, pa përtaci dhe pa mbështetje në atë që është e ndaluar sipas Islamit, i cili konsiderohet hedhje e vetvetes në shkatërrim dhe kundërvënie urdhrut të Allahut të Plotfuqishëm: **“Dhe mos e sillni veten tuaj në shkatërrim...”**¹²⁸

Gjithashtu, ai në këtë mënyrë e kundërshton programin e Pejgamberit, s.a.v.s., i cili i merrte në konsideratë rrethanat, sipas mundësive që kishte bashkë me kërkimin e ndihmës nga Allahut përmes dhikrit dhe lutjes. Këtë ai e ka shprehur në mënyrë të përmbledhur në këshillën ndaj një shoku të tij: *“Lidhe atë, e pastaj mbështetu.”*¹²⁹

Në këtë kontekst vjen rukja sipas parimit Islam, me të cilën njerëzit shërbehen, meqë ajo hyn në kuadër të shkaqeve, e jo si alternativë absolute e saj! Andaj, kush mendon, për shembull, se i sëmuri do të shërohet vetëm me rukje, atëherë ai është injorant i ligjeve hyjnore, të cilat urdhërojnë pasimin e shkaqeve, madje edhe në momente mrekullie! Për shembull, Allahu i Madhërishtëm ka mundur ta furnizojë zonjën Merjemen me një furnizim të madh pa e urdhëruar “që ta shkundë trupin e hurmës”, gjithashtu ka qenë e mundur ta përkrahë të dërguarin e Tij, Muhamedin, s.a. v.s., pa hyrë fare në të gjitha ato beteja, apo pa e pësuar asnjë lëndim nga politeistët!

Më në fund, vërtet ndikimi i lutjes dhe rukjes nuk kushtëzon që me të Allahu t'i dhurojë njeriut atë që do, por mjafton që të ruhet. Madje, ndonjëherë Allahu ia kompenson atij me shpërblim në shumë çështje të tjera, qoftë në këtë botë, qoftë në botën e përtejme, me kusht që të mos e humbë shpresën në mëshirën e Allahut: **“Me të vërtetë, shpresën në mëshirën e Perëndisë nuk e humbin, përpos popullit mohues.”**¹³⁰ Gjithashtu nuk duhet nxituar për përgjigje, siç është theksuar në shumë hadithe, e ky është njëri

¹²⁷ Transmeton Buhariu në *Sahih*, hadithi nr. 6382.

¹²⁸ Surja el-Bekare, 195.

¹²⁹ Transmeton Tirmidhiu në *Sunen*, hadithi nr. 2517. Albani e konsideron *hasen*, në veprën *Tahrihu mushkilet il fakri*, 1/23

¹³⁰ Surja Jusuf, 87.

prej tyre: “Secilit nga ju i pranohet duaja nëse nuk ngutet; atëherë kur thotë: u luta, u luta, u luta dhe nuk m’u pranua duaja.”¹³¹

Ndodh që babai, për shembull, e jep maksimumin e tij për shërimin e birit të sëmurë dhe insiston në lutje drejtuar Zotit të tij – sinqerisht dhe pendueshëm – që ta ruajë, megjithatë i vdes i biri. Vallë, a të zemërohet babai apo të jetë bindur se Allahu për të ka zgjedhur më të mirën? Ndoshta Zoti ka zgjedhur djalin e tij si shehid dhe e ka shpëtuar nga dhimbjet e padurueshme, që të hyjë në xhenetin Adn, e që pastaj ta pasojnë atë 70 anëtarë të familjes tij! Atëherë, cila nga këto dy çështje është më e mirë?

Pastaj, kur babai i lutet Zotit të tij në këtë gjendje, është në pozitën e nevojtarit, lutjes së të cilit nuk i përgjigjet kush përveç Allahut të Madhërishtëm, siç është theksuar Kuranin famëlartë: “**Apo është (më i mirë) Ai, i cili i vjen në ndihmë nevojtarit të ngushtë kur i lutet Atij...**”¹³² Do të thotë, se lutjes së tij mund t’i përgjigjet në çdo rrethanë, por në formën që e cakton Allahu në interesin e robit, i cili kërkon ndihmë nga Zoti i tij, e ajo në këtë rast është vdekja e paevitueshme.

Kjo është shkurtimisht filozofia e lutjes sipas Islamit, të cilën myslimani duhet ta perceptojë atë në mënyrë të plotë, sepse lutja është shenjë e besimit! Andaj, ai që nuk i lutet Allahut, nuk mund të jetë besimtar ndaj Tij, ndaj madhësisë së Tij, ndaj mbikëqyrjes së Tij mbi krijesat e Tij dhe as kur të vendosë për ndonjë gjë, vetëm thotë për të “Bëhu!” – dhe ajo bëhet.

¹³¹ Muttefekun alejhi. Transmeton Buhariu, hadithi nr. 634 dhe Muslimi, hadithi nr. 2735.

¹³² Surja en-Neml, 62.

Lutjet dhe rukjet

Këto rukje fetare i kam lexuar në shishe me ujë, dedikuar që Abdullahu të pinte dhe të lahej me të. Dhe ai sipas mundësisë ka pirë prej saj dhe është larë, por sëmundja nuk i dha afat që ta përfundojë atë! Sidoqoftë, falënderimi i takon Allahut në çdo rast dhe në çdo çast:

“Çdo lavdërim i përket Allahut, Zotit të Gjithësisë - Mëshirues dhe Përdëllimtar i Madh. - Sunduesit të Ditës së Gjykimit. - Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë! - Udhëzona në rrugë të drejtë. - Në rrugën e atyre që u ke dhuruar mirësi. E jo në (rrugën) e atyre që e kanë shkaktuar pezmin (Tënd), as në rrugën e atyre që janë të humbur!”¹³³

“Elif, Lam, Mim. - Ky libër, është i padyshimtë, udhëzues për të gjithë ata që i druajnë dënimit të Allahut. - të cilët u besojnë gjërave të padukshme (në bazë të argumenteve mendore) dhe bëjnë namaz dhe japin nga ajo që Jua kemi dhënë; - të cilët besojnë që të ka zbritur Ty (Kurani) dhe atyre para Teje (pejgamberëve të tjerë) dhe që pa dyshim i besojnë jetës tjetër. - Ata janë, me të vërtetë, në rrugën e Zotit dhe vetëm ata janë të shpëtuar.”¹³⁴

“E Zoti juaj – është Një! S’ka zot tjetër përveç Tij, Ai është Mëshirues dhe Përdëllimtar! - Me të vërtetë në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në ndryshim të natës dhe të ditës; në anijet që lundrojnë nëpër det për t’iu sjellë dobi njerëzve; në ujërat që zbret Allahu prej qiellit, e me të cilat i ngjall tokat e vdekura (tokat e thata) – nëpër të cilat ka shpërndarë gjithfarë lloj shtazësh; në ndryshimin e erërave e reve të nënshtruara lëvizjeve në mes qiellit e Tokës – (në të gjitha këto), ka dokumente për të gjithë ata që mendojnë. - Ka njerëz që në vend të Allahut marrin disa gjëra të tjera për zot dhe i duan ato si Allahun; ndërsa ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun. Sikur ta dinin paganët në atë çast kur do ta shohin dënimin – se me të vërtetë e tërë

¹³³ Surja el-Fatiha, 1-7.

¹³⁴ Surja el-Bekare, 1-5.

fuqia i përket Allahut dhe se dënimi i Allahut është fort i ashpër (atëherë, ata nuk do të vepronin ashtu).’’¹³⁵

“Allahu është – s’ka tjetër zot përveç Tij, (i cili) jeton përgjithmonë dhe zotëron (mbi të gjitha krijesat)! Atë nuk e kaplon as kotja as gjumi! Të Atij janë të gjitha ato që gjenden në qiej dhe në Tokë. Kush mund të angazhohet për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë në të ardhmen. Por, njerëzit, nuk dinë asgjë nga dijenia e Tij, përveç asaj që Ai ka dashur t’ua tregojë. Froni (Madhëria) e Tij përfshin qiejt dhe Tokën dhe Atij nuk i vjen rëndë t’i ruajë ato. Ai është shumë i Lartë, i Madhëruar! – S’ka shtrëngim në fe se me të vërtetë është dalluar e drejta nga e shtrembëta! Ai që i mohon putat (të këqijat) dhe beson në Allahun – ai ka siguruar lidhjen më të fortë, e cila nuk këputet kurrë. – Se Allahu i dëgjon të gjitha dhe di çdo gjë. – Allahu është mik dhe ndihmëtar, i atyre që besojnë dhe Ai i nxjerr ata nga errësira në dritë, ndërsa ata që nuk besojnë – për mik kanë djallin, i cili i nxjerr ata nga drita e i shpie në errësirë. Këta janë banorët e xhehenemit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë.’’¹³⁶

“Elif, Lam, Mim. – Allahu është (një), s’ka zot tjetër përveç Tij, (i Cili) jeton përgjithmonë dhe zotëron (mbi të gjitha krijesat). – Ai ta ka shpallur Librin ty, të vërtetën e saktë duke vërtetuar ato të mëparshmet. Ai i ka zbritur Tevratin dhe Ungjillin. – më parë udhërrëfyes për njerëzit dhe ka zbritur Furkanin, që dallon të vërtetën nga e pavërteta. Ata që nuk i besojnë ajetet e Allahut, i pret dënimi i ashpër, se Allahu është dënues i Plotfuqishëm. – Pa dyshim, Allahut nuk i mbetet asgjë sekrete, as në Tokë, as në qiell!’’¹³⁷

“Me të vërtetë, Zoti juaj është Allahu, që i ka krijuar qiejt dhe tokën për gjashtë ditë (periudha të caktuara kohe), e pastaj e mbisundoi gjithësinë. Ai me errësirën e natës e mbulon ditën, e cila e ndjek atë; e Dielli, Hëna dhe yjet i përulën urdhrit të Tij. Vetëm ai krijon dhe sundon. I Lartësuar është Allahu, Zoti i gjithësisë! – Lutjuni Zotit tuaj me përulje dhe ngadalë! Ai, me të vërtetë, nuk i do ata që e kalojnë kufirin. – Dhe mos bëni çrregullime në tokë, kur në të është

¹³⁵ Surja el-Bekare, 163-165.

¹³⁶ Surja el-Bekare, 255-257.

¹³⁷ Surja Alu Imran, 1-5.

*vënë rregulli, e Atij lutjuni duke iu frikuar dhe shpresuar; se, me të vërtetë, mëshira e Allahut është afër bamirësve.*¹³⁸

*“E, Ne, ia shpallëm Musait: “Hedhe shkopin!” E, ai (shkopi) filloi t’i gëlltisë të gjitha ato që i trilluan ata. – Dhe, kështu, doli në shesh e vërteta dhe dështoi ajo që vepruan ata. – Këtu, ata u mundën dhe u kthyen të poshtëruar.”*¹³⁹

*“Pasi erdhën magjistarët, Musai u tha: “Hidhni ç’keni për të hedhur!” – E, kur i hodhën ata, Musai tha: “Atë që e keni sjellë ju është magji. Me të vërtetë, Allahu do ta shkatërrojë atë. Allahu, me siguri, nuk do ta forcojë punën e ngatërrestarëve. – Allahu, me premtimin e Tij e forcon të Vërtetën, e madje edhe sikur ta urrejnë mëkatarët!”*¹⁴⁰

*“Ata thanë: “O Musa, ose gjuaj ti, ose të bëhemi ne hedhësit e parë?” – (Musai) tha: “Jo, hidhni ju!” E, atëherë, (pasi që i hodhën ata) litarët dhe shkopinjtë e tyre, – prej magjive të tyre – iu dukën atij, se me të vërtetë, po rrëshqasin, – andaj Musai – ndjeu në vete frikë. – Ne i thamë: “Mos u frikëso, se me të vërtetë, ti je fitues! – Dhe hidhe atë që e ke në dorën e djathtë! Do t’i gëlltisë ato që i kanë punuar ata. Atë që e kanë punuar ata, është vetëm një mashtrim i magjistarëve. E, magjistari, nuk do të ketë sukses, kudo që të gjendet.”*¹⁴¹

*“Mos vallë, keni menduar ju, që Ne ju kemi krijuar juve kot dhe që nuk do të ktheheni te Ne?” – I lartësuar është Allahu, sundimtari i Vërtetë! S’ka zot tjetër përpos Tij, Zotit të Arshit (Kozmosit) madhështor! – Ai që pos Allahut, adhuron zot tjetër, duke mos pasur kurrfarë dokumenti për këtë, me siguri – llogaria është vetëm te Zoti tij. Me të vërtetë, nuk ka shpëtim për mohuesit. – Dhe, thuaj (o Muhamed!): “O Zoti im, fal dhe mëshiro, e Ti je më i miri mëshirues!”*¹⁴²

“Pasha ata (meleqet) që janë të radhitur – dhe ata që i pengojnë (njerëzit prej mëkateve) – dhe ata që e lexojnë Kuranin, – në të vërtetë, Zoti juaj është Një, – Zot i qiejve dhe i Tokës dhe çka gjendet mes tyre dhe Zot i lindjes (i verës dhe dimrit)! – Me të vërtetë, Ne e kemi stolisur

¹³⁸ Surja el-A’raf, 54-56.

¹³⁹ Surja el-A’raf, 117-119.

¹⁴⁰ Surja Junus, 80-82.

¹⁴¹ Surja Taha, 65-69.

¹⁴² Surja el-Mu’minun, 115-118.

qiellin e kësaj bote me shkëlqimin e yjeve, - dhe e mbrojmë nga çdo djall kryeneç, - që mos t'i përgjojë meleqet e lartësuar; ata (djajtë) sulmohen nga të gjitha anët, - për t'i dëbuar ata: për ta ka vuajtje të përhershme, - e ai që grabit diçka, atë e ndjek dritë verbuese. - Pyeti ata (o Muhamed): A është më i vështirë krijimi i tyre apo të gjitha gjërat e tjera që i kemi krijuar? - Ata i kemi krijuar nga bota (balta) ngjitëse. - Ti çuditesh (nga mohimi i atyre) e ata përqeshin, - e kur t'iu drejtohen këshilla, ata nuk i pranojnë, - dhe kur e shohin një argument, ata e nxisin njëri-tjetrin për përqeshje - dhe thonë: "Kjo s'është gjë tjetër veçse një magji e vërtetë!"¹⁴³

"Do t'ju qëllojmë juve (për shpërblim dhe llogari), o ju, dy barrët e Tokës (njerëzit dhe xhinët)?! - e, cilat dhunti të Zotit tuaj po i përgënjeshtroni?! - O grupe të xhinëve dhe njerëzve, nëse mund të dilni prej kufijve të qiejve dhe të Tokës, dilni, por do të mund të dilni vetëm me fuqi të madhe (e këtë nuk e keni, andaj nuk mund të ikni)! - e cilat dhunti të Zotit tuaj po i përgënjeshtroni?!¹⁴⁴

"Sikur këtë Kuran t'ia shpallim ndonjë mali, ti do ta shihje atë të përulur dhe të copëtuar nga frika e Allahut. Kësi shembujsh ua përkujtojmë njerëzve që të mendojnë. - Ai është Allahu, që s'ka zot tjetër përveç Tij. Ai i di gjërat e dukshme dhe të padukshme, Ai është mëshirues dhe përdëllimtar! - Ai është Allahu, që s'ka zot tjetër përveç Tij, Sundues, i Amshueshëm, Ai është i pastër nga të metat, Paqedashës, ai që jep siguri, Ai që mbikëqyr të gjitha, i Plotfuqishëm, Imponues, Madhështor. Qoftë falënderuar Allahu, Ai është shumë lart nga ato që ia përshkruajnë Atij! - Ai është Allahu, Krijues, Ai që prej asgjëje krijon, Ai që çdo gjëje ia jep formën, Ai posedon emrat më të bukur, Atë e falënderojnë të gjithë (çka ekziston) në qiej dhe në Tokë, Ai është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm."¹⁴⁵

"Ai, i cili, i ka krijuar shtatë qiej njërin mbi tjetrin, - ti nuk vëren në krijesat e Mëshiruesit kurrfarë disharmonie dhe shiko edhe një herë a mos po sheh ndonjë plasaritje, - pastaj shiko përsëri shumë herë, shikimi do të kthehet i lodhur dhe i molisur."¹⁴⁶

¹⁴³ Surja es-Saffat, 1-15.

¹⁴⁴ Surja err-Rrahman, 31-34.

¹⁴⁵ Surja el-Hashr, 21-24.

¹⁴⁶ Surja el-Mulk, 3-4.

“Pothuajse, me të vërtetë, jobesimtarët duan të të rrëzojnë me shikim kur dëgjojnë Kuranin, duke thënë: “Ai, në të vërtetë, është i marrë!” – E, ai (Kurani), është këshillë për tërë botën!”¹⁴⁷

“Thuaj (o Muhamed!): “Mua më është shpallur se disa prej xhinëve (krijesa të padukshme), kanë dëgjuar dhe kanë thënë: “Me të vërtetë, kemi dëgjuar (një) Kuran të mrekullueshëm, – i cili udhëzon në rrugën e drejtë – e ne kemi besuar në të dhe kurrsesi më nuk do t’i bëjmë shok askënd Zotit tonë.”¹⁴⁸

“Thuaju: “O ju mohues! – unë nuk do ta adhuroj atë që po e adhuroni ju, – e as ju nuk do ta adhuroni Atë që po e adhuroj unë; – unë nuk kam adhuruar atë që e keni adhuruar ju, – por edhe ju nuk e keni adhuruar Atë që po e adhuroj unë. – Ju keni besimin tuaj, e unë kam besimin tim!”¹⁴⁹

“Thuaj: “I lutem dhe mbështetem te Zoti i agimit – që të më mbrojë nga sherri i të gjitha krijesave – dhe prej sherrit të natës kur kaplon terri, – dhe prej sherrit të fallxhorëve që fryjnë në nyja (bëjnë magji), – dhe nga sherri i ziliqarit kur e shfaq zilinë!”¹⁵⁰

Thuaj: “I lutem dhe i mbështetem Zotit të njerëzve, – Sundimtarit të njerëzve, – Zotit të njerëzve, – nga sherri i djallit, bezdisës, – i cili fshehurazi hedh dyshime në shpirtat e njerëzve – prej xhinëve dhe prej njerëzve!”¹⁵¹

O Allah, o Zoti i njerëzve, largoje vështirësinë dhe shëro, sepse nuk ka shërim tjetër, përveç shërimit Tënd, shërim që nuk lë asnjë sëmundje. (shtatë herë)

I lutem Allahut të Madhëruar, Zotit të Arshit të madh, që të të shërojë. (shtatë herë)

Kërkoj mbrojtje me fjalët e plota të Allahut nga hidhërimi i Tij dhe ndëshkimi i Tij, që të më mbrojë nga e keqja e njerëzve, nga cytjet e djajve dhe që ata të mos më afrohen! (tri herë)

Me emrin e Allahut Shërues! O Allah, shëroje robin Tënd dhe vërtetoje të dërguarin Tënd!

¹⁴⁷ Surja el-Kalem, 51-52.

¹⁴⁸ Surja el-Xhin, 1-2.

¹⁴⁹ Surja el-Kafirun, 1-6.

¹⁵⁰ Surja el-Felek, 1-5.

¹⁵¹ Surja en-Nas, 1-6.

Format e përgjigjes së lutjes

Isha në periudhat më të vështira të sëmundjes së të dashurit Abdullah r.h. dhe nganjëherë më vinte në mendje kjo pyetje: Vallë, pse ne nuk trokasim në këtë derë, përveçse në momentet e dobësisë dhe thyerjes, atëherë kur ndiejmë brenga dhe plogështi? Atëherë kur na ngushtohet bota, edhe përkundër gjerësisë së saj, dhe na rëndohen shpirtrat tanë, edhe përkundër bartjes së tyre! Vallë, a nuk është Ai, Zoti i adhuruar, Fisniku i synuar, që është afër robërve të Tij, Mëshirues dhe Përdëllimtar i madh ndaj krijesave të Tij? Po, gjithsesi! Ai është përkrah nesh me fjalën e tij **“Unë jam afër”**, siç theksohet në ajetin kuranor:

“Kur besimtarët e Mi të pyesin ty për Mua (thuaje): Unë jam afër, iu përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai të më lutet Mua. Prandaj, le ta plotësojnë thirrjen Time (për agjërim e detyra të tjera) dhe le të më besojnë Mua (të mos shmangen nga besimi), për të qenë në rrugën e drejtë.”¹⁵²

Ky ajet dëshmon se lutja është një nga adhurimet më madhore. Kurani famëlartë ka përfshirë 14 pyetje, që të gjitha fillojnë me: **“të pyesin ty”** dhe pastaj përgjigja vjen: **“thuaje”** apo **“andaj thuaj”**, përveç në një vend, ku fillon me fjali kushtore: **“E kur robërit e Mi të pyesin ty për Mua”**, ka ardhur përgjigja kushtore pa foljen: **“thuaje”**, por ka thënë: **“Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai të më lutet Mua”**, duke tërhequr vërejtje për afërsinë e madhe të robit të Zotit të Tij në momentin e lutjes! Andaj, kjo është më retorike sesa të jetë përgjigje për shkakun e zbritjes – nëse mund të thuhet – kur e pyeten Pejgamberin s.a.v.s.: **“A është Zoti ynë afër që t’i lutemi me zë pëshpëritës, apo Ai është larg që t’i lutemi me zë të lartë?”**

Atëherë, fjalia e Tij **“kur ai të më lutet Mua”**, që në të është një simbol se kusht i përgjigjes së lutjes është që lutësi duhet të jetë i pranishëm me zemër kur i lutet Zotit të Tij, i sinqertë në lutje ndaj Tij dhe të jetë i bindur se vetëm Allahu i Madhërishëm i përgjigjet nevojtarit kur i lutet Atij dhe ia largon të keqen!

Nga udhëzimet e këtij parimi dhe domethënies së tij është se Allahu i përgjigjet lutësit kur i lutet Atij; kjo nuk to të thotë që Ai t’i përgjigjet

¹⁵² Surja el-Bekare, 186.

kërkesës së tij, sepse i Madhërishmi ndonjëherë e vonon përgjigjen e kërkesës, në mënyrë që lutësi me përlulësi t'i shtojë lutjet drejtuar Allahut, të insistojë në lutje, kështu e forcon besimin e tij, i shtohet shpërblimi, ose ia ruan atë për në Ditën e Gjykimit; apo Ai e mbron nga e keqja, që është përfitim ma i madh për lutësin! Sa begati e mrekullueshme, të cilën nuk di ta vlerësojë kush përveç atij që e ka përjetuar! Mirëpo, ai që i vështron shumë myslimanë injorantë sesi janë qasur kërkimit të ndërmjetësimit përmes evliave dhe njerëzve të mirë, ose kanë bindje se lutja nuk pranohet, përveçse përmes filan evliasë apo filan zotërisë, do të zbulojë përmasat e ndërlikimit dhe paqartësisë që kanë ndodhur në lidhje me këtë çështje.

Ibn El-Kajjimi r.h. thotë: “Dijetarët kanë rënë dakord se sukcesi yt është që Allahu të mos të lërë ty pas dore, ndërsa mossuksesi yt është që të të lërë ndërmjet teje dhe vetes tënde.”¹⁵³ Nëse është krejt mirë, atëherë thelbi është sukcesi, i cili është në kompetencën e Allahut e jo në kompetencën e robit dhe çelësi i tij është lutja, nevoja, strehimi i sinqertë, dëshira dhe frika vetëm prej Tij. Kështu, kur Ai ia dhuron robit të Tij këtë çelës, dëshiron që robi ta përdorë për të hapur, por kur ia humb çelësin, atëherë porta e mirësisë mbetet pa shteg. Emiri i besimtarëve, Omer b. El Hattabi, ka thënë: “Me të vërtetë unë nuk e mbaj brengën e përgjigjes, por unë e mbaj brengën e lutjes! Kur frymëzohem me lutje, vërtet përgjigja është me të.”

Sa i mrekullueshëm është një rob, i cili e shfaq varfërinë dhe adhurimin e tij me lutje drejtuar Zotit të tij, me pendim para Krijuesit dhe Furnizuesit të tij, në dorën e të Cilit është i tërë kontrolli! Sa i lumtur është ai kur i shfrytëzon kohët e përgjigjes për t'iu lutur Zotit të tij, duke kërkuar nga mirësia e pafund të mirat e të dy botëve! E lusim Allahun e Madhërishëm që të na dhurojë mbrojtje të qëndrueshme dhe strehim pranë Tij, lutje të përkryer ndaj Tij, fuqi për t'u mbështetur tek Ai, që Ai të mos e hedh poshtë lutjen tonë, të mos na kthejë të zhgënjyer për shkak të mëkateve dhe të lëshimeve tona! Allahu i Madhërishëm na afroftë pranë Tij përtej pritjeve tona. Kjo bëhet e qartë përmes ajetit kuranor: “*Ne (me dijeninë Tonë) jemi më afër se damari i tij i qafës.*”¹⁵⁴

¹⁵³ *Midraxhus Salikin*, 1/415.

¹⁵⁴ Surja Kaf, 16.

Kushtet e pranimit të lutjes

1. Ai, i cili bën lutje, duhet të angazhohet për pastrimin e zemrës dhe shpirtit të tij, t'i kthehet Zotit të tij dhe ta ndjekë si shembull jetën e udhëheqësve të njerëzimit, të pejgamberëve dhe të dërguarve.
2. Lutësi duhet të angazhohet për pastrimin e pasurisë së tij nga çdo grabitje dhe padrejtësi dhe që ushqimi i tij të mos jetë nga harami! Është transmetuar nga Pejgamberi, s.a.v.s., se ka thënë: *“Kush dëshiron që t'i pranohet lutja, le ta pastrojë ushqimin dhe fitimin e tij!”*, do të thotë që njeriu të largohet nga ushqim haram, sepse ushqimi haram është pengesë mes tij dhe pranimit të lutjes së tij, siç është konfirmuar nga hadithin e vërtetë nga Pejgamberi, s.a.v.s., se ka thënë: *“Vërtet Allahu është i mirë, andaj ai nuk pranon veçse të mirën! Dhe vërtet Allahu i ka urdhëruar besimtarët me atë që i ka urdhëruar të dërguarit.”* Pastaj, Pejgamberi, s.a.v.s., e ka përmendur rastin e udhëtarit flokë pakrehur e të pluhurosur, i cili ngriti duart lart e tha: *“O Zot, o Zot!”*, por ushqimi i tij është prej haramit, veshja e tij është prej haramit dhe është furnizuar me haram. Dhe Pejgamberi, s.a.v.s., tha: *“E si t'i përgjigjet Zoti këtij?”*
3. Nuk ka dallim lutja nga xihadi i vazhdueshëm kundër të gjitha ngjyrave të korrupsionit, sepse Allahu nuk i përgjigjet atij që e braktis urdhrin për vepra të mira dhe ndalimin nga të këqijat. Transmetohet nga Pejgamberi, s.a.v.s., se ka thënë: *“Ose do të urdhëroni për të mirë dhe do të ndaloni nga e keqja, ose përndryshe Allahu do të dërgojë mbi juve dënim, pastaj do t'i luteni Atij dhe nuk do t'ju përgjigjet.”*

Format e përgjigjes së lutjes

Nëse plotësohen këto kushte dhe Allahu i Plotfuqishëm nuk i është përgjigjur lutjes, atëherë Ai ose ia largon të keqen, e cila është më e madhe, ose do t'ia kompensojë atij në Ditën e Gjykimit dhe do t'i dhurojë shpërblim edhe më të madh. Pengesa e përgjigjes është bërë për një urtësi, pra që t'i japë shpërblim dy herë: një herë për lutjen e tij dhe një herë për fatkeqësinë e tij për mospërgjigje, kështu që Allahu ia kompenzon me diçka më të madhe dhe më të plotë!

Njeriu të mos e presë lutjen me pa durim, sepse kjo është nga shkaqet e pengesës së pranimi të saj, siç është theksuar në hadithin e Pejgamberit s.a.v.s.:

“Secilit nga ju i pranohet duaja nëse nuk ngutet”. I thanë: “O i Dërguar, e si ngutet?” Tha: “Atëherë kur thotë: U luta, u luta, u luta dhe nuk m’u pranua duaja.”

Andaj, njeriu nuk duhet që ta pres me padurim përgjigjen, sepse kështu ai do të lodhet nga lutja. Madje, edhe nëse lutja nuk është diç tjetër veçse adhurim ndaj Allahut të Madhërishëm, megjithatë ia vlen që njeriu të ketë vëmendje ndaj saj! E këtillë ishte bindja e Abdullahut derisa dha shpirt i kënaqur me caktimin e Zotit të tij.

Përmbledhje e përgjithshme e rukjeve nga dijetarët më të njohur

Kështu më ka arritur mesazhi mua gjatë mjekimit të Allahut! Andaj po e vendosi tekstualisht para lexuesit të nderuar me qëllim që të përfitojë prej tij. E lus Allahun e Madhërisëm që ta shpërblejë atë që i tuboi ato dhe ua lehtësoi myslimanëve, të cilët kanë nevojë për to. Po ashtu, e lus Allahun që t'i shpërblejë dijetarët e nderuar, të cilët e përgatitën materialin dhe e incizuan në një formë shumë të lehtë dhe të thjeshtë. Unë i provova disa prej tyre dhe pashë se ishin të shkëlqyeshme nga aspekti i tubimit të lutjeve të vërteta nga Kurani famëlartë dhe nga hadithet e vërteta, në një kornizë të bukur, me zë emocional dhe lexime të bukura, që konsideroj se janë nga zemrat e sinqerta, dhe do të jenë burim i përgjigjes - me vullnetin, me mirësinë dhe me mëshirën e Allahut.

Udhëzime

Vendose dëgjuesen në kokë, relaksohu dhe dëgjoje një herë apo dy herë (rukjen legjitime) dhe me vullnetin e Allahut do të ndryshojë gjendja për të mirë...

“Një zë modest dhe i rehatshëm”

[3mp.h_allrqe/h_allrqe/items/5/org.archive.us.600908ia//:http](http://3mp.h_allrqe/h_allrqe/items/5/org.archive.us.600908ia//)

Koha e kësaj pjese është 39:59 minuta.

Mos lejo që të të kalojë kjo vepër e mirë.

Rukja legjitime me zë dhe lexime të ndryshme 3mp// O Zoti ynë bëje këtë një lëmoshë të vazhdueshme për mua, për prindërit e mi, për pasardhësit e mi dhe për të gjithë ata që e shpërndajnë.

Rukja legjitime me zërin e Mahir El Me'ajkali (1:10:59)

[gto-99E27881/ht.v//:http](http://gto-99E27881/ht.v//)

Rukja legjitime me zërin e Ahmed El Axhmi (1:02:30)

[jNh-99E27881/ht.v//:http](http://jNh-99E27881/ht.v//)

Rukja legjitime me zërin e Se'ad El Gamidi (1:02:30)

[erR-99E27881/ht.v//:http](http://erR-99E27881/ht.v//)

Rukja legjitime me zërin e Meshari El Afasi (1:13:38)

Lex-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Ebu El Alije El Xhurani (1:05:18)

E.x-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Muhamed El Muhajsi (1:24:48)

woj-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Nasir El Katami (1:16:50)

pzn-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Halid El Xhelil (34:07)

Djg-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Faris Ubbad (1:01:51)

4bk-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Jaser Ed Dusri (1:00:30)

qVq-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Ahmed El Bellejhid (32:28)

1Q3-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Halid El Kahtani (1:11:40)

knS-99E27881/ht.v//:http

Rukja legjitime me zërin e Nebijl El Avadi

JL5-99E27881/ht.v//:http

Atyre që i kanë këto incizime, ju urojmë bereqet dhe përfitim!

Allahu ju shpërbleftë me të mira!

Vlen të theksohet se këtu janë përfshirë shumë lutje, lutjet për të mëshiruarin Abdullah, me vullnetin e Allahun, përmes WhatsApp-it, në çdo fazë të sëmundjes së tij dhe në fazën e vdekjes, që i bënin lutje atij për shërim dhe mëshirë, kurse neve për durim dhe ngushëllim! Nuk ka mundësi këtu t'i citojmë të gjitha për shkak të numrit të madh, falë Allahut, dhe të përsëritjes së disa përmbajtjeve të tyre.

Sidoqoftë, me rëndësi është që lutja të jetë e sinqertë, edhe nëse është e shkurtër dhe e thjeshtë, meqë nuk është e domosdoshme që lutja të jetë e gjatë dhe e ngarkuar me shumë rima!

Kërkojmë prej Allahut përgjigje të lutjeve tona, siç kërkojmë prej Tij pranimin, shpërblimin dhe mëshirën!

Mesazhi i nënës së Abdullahut, drejtuar dashamirëve të saj dhe dashamirëve të Abdullahut, ku kërkon prej tyre lutje për të

Falënderim i takon vetëm Allahut!

Dashamirë të mi dhe dashamirë të Abdullahut, zemërmirë, zemërbar-dhë dhe zemërdëlitë, unë, nëna e tij, me sa jam në dijeni gjatë 24 viteve të kaluara, ai nuk është hidhëruar ndaj asnjërit dhe nuk e ka larguar as-kënd nga zemra e tij! Zoti im i dhuroftë mirësinë e Tij dhe me diç edhe më të mirë, in sha Allah!

Kërkoj prej jush lutje dhe vendosmëri për Abdullahun.

Kjo është lutja dhe prej Teje kërkojmë përgjigje, o Zot i botëve!

O i Gjallë përgjithmonë, o Mbikëqyrës, o i Madhërishtëm, o i Gjithë-fuqishëm, o i Madh, o i Lartësuar, o i Plotfuqishëm, o Krijues i qiejve dhe Tokës, ky është “djali im Abdullahu”, robi Yt nga robërit e Tu të dobët nevojtarë të Ti, e goditi fatkeqësia, dhe ai duroi, edhe ne duruam, Ty të falënderuam, Ty të besuam përcaktimin Tënd ndaj tij! O Zoti ynë, vërtet ai është nën vullnetin dhe mëshirën Tënde! O Zoti ynë, o Ti që e shërove Ejjubin nga sprova, ia ktheve Musain nënës së tij, e shpëtove Junusin në barkun e balenës, e bëre zjarrin e ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin, shëroje Abdullahun nga ajo që i ka ndodhur! O Zoti ynë, ata e besuan si ‘kader dhe e miratuan atë’. O Zoti ynë, Ty të përkasin përcaktimet, fuqia dhe madhështia, andaj ki dhembshuri ndaj tij dhe largoja dhimbjen. O Allah, largoja sëmundjen e tumorit plotësisht, të mos i kthehet dhe të mos i mbetet më asnjë gjurmë.

O Zoti ynë, o Ti që largon brengën dhe mërzinë, që iu përgjigjesh nevojtarëve, ma largo mua brengën dhe mërzinë dhe përgjigju lutjes sime! Ki mëshirë ndaj dobësisë dhe paaftësisë sime dhe më dhuro gëzim me shërimin e Abdullahut, prej nga unë nuk e mendoj, “që ndoshta Allahu më pas bën diçka tjetër.”

O Zoti ynë, prej Teje kërkojmë dhembshurinë Tënde, bujarinë Tënde, mëshirën Tënde dhe dhuntinë Tënde, që ta shërosh Abdullahun, robin Tënd nevojtar për Ty, meqë ai është i dobët dhe bir i robëreshës Tënde të dobët, nevojtar për Ty! Vërtet, Ti je i Plotfuqishëm për çdo gjë!

Ti je bindja jonë dhe shpresa jonë dhe Ty ta dorëzojmë çështjen tonë, andaj ki dhembshuri ndaj tij dhe ndaj nesh dhe lehtësoja mjekimin e tij si dhe largoja sëmundjen dhe le të përfitojë nga ilaçet.

O Zoti ynë, të lutemi me emrin Tënd më të madhërishtëm, me emrin Tënd më bujar dhe me lutjen e Junusit a.s.: **“S’ka zot tjetër përveç Teje! Ti je i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar (ndaj vetes)! -** që t’ia shpejtosh shërimin e tij. O Zoti ynë, shpejtoje shërimin e tij, O Zoti ynë, shpejtoje shërimin e tij. O Ti që ke urdhëruar ndërmjet ‘kafit’ dhe ‘nunit’, o ndryshues i çështjeve dhe drejtues i tyre, drejtoje çështjen e tij në mënyrën më të mirë, mundësoja atij që të jetë me robërit Tu të mirë, bëje prej durimtarëve dhe bëje që ajo që e ka goditur të jetë ngritje e fuqi për të dhe dhuroji atij shpëtim të bukur dhe shëndet, pas të cilit nuk ka sëmundje.

O Zot, ai është robi yt nevojtar, kurse Ti je Dhuruesi Bujar, dhuroji atij shëndet dhe shërim nga çdo sëmundje, o Ti që dëgjon, je afër dhe i përgjigjesh lutje sonë, o Zot!

O Zoti ynë, dhuroji atij qëndresë, qetësi, siguri dhe kënaqësi me dhembshurinë Tëndë! O Zoti ynë, ki dhembshuri dhe dashuri ndaj tij! O Zot ynë, le të jetë në dispozicion të tij ushtria dhe fuqia Jote! O Zoti ynë, dobësinë e tij shndërroje në forcë me fuqinë dhe forcën Tëndë. O Zoti ynë, largoja fatkeqësinë, shëroje dhe falja mëkatet e tij.

O Zoti ynë, jepi kurajë atij, bëje të disponuar, dhuroja gëzimin e shërimin dhe shpëtimin; Ti je i Gjithëfuqishëm dhe Mbikëqyrës i tërë kësaj. O Zoti ynë, që e ke emrin më të madhërishtëm!

Unë të lutem Ty, vetëm Ty të takon falënderimi, nuk ka zot tjetër përveç Teje, Ti je i Dhembshur dhe Dhurues, Krijues i qiejve dhe tokës, Ti je i madhëruar dhe i nderuar! O i Gjallë i përgjithmonshëm dhe o Mbikëqyrës, vërtet robi yt nevojtar, i biri i robëreshës Tëndë nevojtare dhe të mjerë, kërkon mbrojtjen Tëndë. Kërkoj prej Teje, o Allah, të na qetësosh neve, ta shërosh birin tonë dhe ta gëzosh zemrën e tij dhe zemrat tona.

O Zoti im, veten time Ty ta kam dorëzuar dhe krejt çështjen time dhe ajo që më shqetëson, Ti kujdesu për mua. Ti je Ai që më mjafton mua! Më mjafton vetëm Ti si Kërkues llogarie! O Zoti im, plotësoje kërkesën time dhe përgjigju lutjes sime! O Zoti im, ndihmomë për atë që më ka lodhur! O Zoti im, ndihmomë me diçka më të mirë sesa që unë e mendoj! Largomë nga ajo që unë frikësohem dhe ruhem, Ti ke thënë në Librin Tënd fisnik: **“A nuk është Allahu që i mjafton robit të vet?”**

O Zoti ynë, që iu përgjigje Nuhut kur ai të është drejtuar Ty!

O Ti, që ia largove fatkeqësinë Ejubin në sprovën e tij. O Ti që e dëgjove Jakubin në ankesën e tij, dhe e ktheve Jusufin dhe vëllanë e tij. Me mëshirën Tënde iu ktheje drita e syve të tij!

Shëroje Abdullahun dhe realizoja qëllimin e dëshiruar, ji me të në fshehtësinë dhe lutjen e tij pëshpëritëse! Largoja brengën dhe mërzinë e tij dhe nga çdo shtrëngesë - jepi shtegdalje!

O Zoti im, Ty po ta lë amanet Abdullahun, Ty që nuk i humb amanetet! O Zoti im, Ty po ta lë amanet mendjen e tij, zemrën e tij, eshtrat e tij, veshin e tij, syrin e tij, gjuhën e tij, gjymtyrët e tij, të gjitha organet e tij, kujtesën e tij, fuqinë e tij fizike dhe shpirtërore.

Ruaje atë nga ajo që është para tij, prapa tij, nga e djathta e tij, nga e majta e tij dhe sipër tij, e nga poshtë, kërkoj ndihmë me madhërinë Tënde që ta mbrosh të mos rrëshqas.

O Zoti im, bëj që melekët e qiellit ta ruajnë dhe ta mbrojnë atë! Bëj që sukcesi të shfaqet nga duart e mjekëve, mjekuesve dhe nga medikamentet, lehtësoja dhimbjen dhe ruaje nga rreziku! Kërkojmë prej Teje që t'ia mundësosh shërimin nga tumori dhe t'ia heqësh çdo qelizë të tij me fuqinë dhe forcën Tënde! Ta përkëdhelësh atë me dhembshurinë Tënde shëruese, që të mos rikthehet sëmundja dhe të mos lërë asnjë gjurmë! Ti je Mbikëqyrës i saj dhe je i Plotfuqishëm mbi gjithçka!

O Zoti ynë, na i trego mrekullitë e fuqisë Tënde, që e gëzojnë zemrën tonë dhe i mahnitin mjekët me fuqinë dhe forcën Tënde!

O Zoti im, gëzoje mendjen time me shërimin e Abdullahut dhe më kënaq me mirësinë e tij dhe të pasardhësve të tij. Vërtet Ti je i Plotfuqishëm për çdo çështje! Ti ke thënë në librin Tënd famëlartë: **“E çka mendoni ju për Zotin e gjithësisë?”**¹⁵⁵ O Zoti ynë, Ti je bindja jonë dhe shpresa jonë, ne nuk mendojmë diç tjetër, përveç mirë prej Teje, andaj na dhuro dhe mos na privo! Përgjigju lutjes sonë dhe mos na kthe të zhgënjyer, Ti je Mbikëqyrës dhe i Plotfuqishëm ndaj saj, o i Lartësuar mbi gjithçka!

O Zoti ynë, që je i dhembshur ndaj nesh,

O Bamirës i madh dhe Mëshirëmadh,

O Ti që je Dhurues i pakufishëm,

O Zoti ynë, siç i gëzove prindërit e tij me lindjen e tij të shëndetshme,

¹⁵⁵ Surja es-Saffat, 87.

plotësojua atyre lumturinë e tyre, me të dhe me pasardhësit e tij!

Nuk ka shpërblyes tjetër, përveç asaj që Ti dhuron,

Mirësia Jote është e domosdoshme!

Mëshira dhe të mirat Tua na përfshijnë neve, o Ti që je me attribute të gjera dhe sublime dhe me emrat e mëdhenj e të bukur!

O Zoti ynë, ndriçoji ato zemra që i shqetëson brenga,

dhe ndriçoji ata shpirtra që i djeg mërzia,

dhe zbrite shërimin Tënd, që të mos mbetet më asnjë sëmundje!

Shërimi i të sëmurëve nëpërmjet sadakave (lëmoshave)¹⁵⁶

Sadakaja, sipas asaj që dëshmojnë ajetet kuranore dhe tradita e të Dërguarit, s.a.v.s., konsiderohet prej mënyrave më të rëndësishme të afrimit tek Allahu i Madhërishëm! Pikërisht për këtë, përfitimi prej saj shtrihet dhe përfshin hapjen e shumë kapitujve të mirësisë për sadakëdhënësin dhe ndihmën e tij për plotësimin e nevojave! Kështu ajo është shkak për të hyrë në xhenet, siç është theksuar në hadithin sahih, të cilin e transmetojnë Buhariu dhe Muslimi:

“Ai që i ushqen dy bashkëshortë në rrugën e Allahut, do të thirret nga cila do derë e xhenetit, o rob i Allahut, kjo është mirësia, ai që ka qenë prej njerëzve të namazit, do të thirret nga dera e namazit, ai që ka qenë prej njerëzve të xhihadit, do të thirret nga dera e xhihadit, ai që ka qenë prej agjëruësve, do të thirret nga dera Rajjan, dhe ai që ka qenë prej njerëzve të sadakasë (lëmoshës), do të thirret nga dera e sadakasë.”

Ky kapitull është ndër ata që shlyejnë veprat e këqija, duke e konfirmuar fjalën e Pejgamberit s.a.v.s.:

“Sprovimin e burrit në familjen e tij, pasurinë e tij, fëmijët e tij dhe në fqinjnin e tij, të gjitha këto i shlyejnë namazi, agjërimi dhe sadakaja.”¹⁵⁷

Ajo është shkak për shuajtjen e zemërimit të Zotit, duke iu referuar hadithit të Pejgamberit s.a.v.s.:

“Sadaka e shuan hidhërimin e Zotit ndaj robit dhe të vdekurin nga e mbron nga e keqja!”¹⁵⁸

Ajo është mbrojtje nga ndëshkimi i zjarrit dhe nga vuajtja në varre, siç na ka lajmëruar Pejgamberi, s.a.v.s., në fjalën e tij drejtuar nënës së besimtarëve, Ajshes r.a.

“Oj Ajshe, shpaguhu nga zjarri, qoftë edhe me gjysmë hurme, sepse ajo ia largon të uriturit urinë dhe e bën si të ngopur.”¹⁵⁹

¹⁵⁶ Një pjesë e këtij materiali është botuar në revistën *El Kabes*, më 30. 11. 2014.

¹⁵⁷ Transmeton Tirmidhiu, *Sunen*, Kapitulli i zekatit.

¹⁵⁸ Transmeton Tirmidhiu, hadithi nr. 664.

Ajo është pastrim i shpirtit, gëzim për të varfrit, të sëmurë dhe të mjerët. Shih fjalën e Allahut të Plotfuqishëm lidhur me zjarrin:

“E do të jetë larg nga ai (zjarri), ai që është i devotshëm, - ai që ndan nga pasuria e tij, duke e pastruar veten (nga të këqijat), - e nuk e jep atë - për t’ia kthyer ndokush, - por vetëm që të fitojë kënaqësinë e Zotit të tij të Lartmadhërishëm - dhe ai, me siguri, do të jetë i kënaqur!”¹⁶⁰

Po ashtu sadakaja është largim i sprovës, bereqet në pasuri, kurse sadakëdhënësi e ka shpërblimin e luftëtarëve në rrugën e Allahut, si dhe një mori përfitimesh e frytësh të tjera të cilat i dëshmojnë shumë ajete kurranore dhe hadithe të Pejgamberit s.a.v.s.

Ndoshta referencë e kësaj është se sadakaja mbart shumë kuptime sublime dhe dëshmi të nivelit të lartë për mbrojtjen e sadakëdhënësit nga lakmia, për bujarinë e tij, për mbështetjen e tij në Allahun, për mëshirën e tij ndaj njerëzve, shpezëve dhe kafshëve, duke e konfirmuar hadithin të cilin e transmeton Enes b. Maliku, se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

*“Çdo mysliman që mbjell apo lëron diçka dhe prej saj ushqehen shpendët, njerëzit, apo kafshët, për çdo gjë atij do t’i quhet sadakë.”*¹⁶¹

Po ashtu mëshira e sadakëdhënësit, siç e ka lejuar xhumhuri i dijetarëve, i përfshin edhe jomuslimanët, duke u mbështetur në fjalën e Allahut:

“Allahu nuk jua ndalon të shprehni mirësinë dhe të jini të drejtë ndaj atyre, të cilët nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë (suaj) dhe që nuk ju dëbojnë juve prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë, Allahu i do të drejtët.”¹⁶²

Dhe në ajetin tjetër:

“Dhe i ushqejnë të varfrit, bonjakët dhe të zënë robër (në luftë)...”¹⁶³

Po ashtu, edhe në fjalën e Pejgamberit s.a.v.s.: *“Për çdo gjë të gjallë ka shpërblim”*.¹⁶⁴ Veçmas kjo mund të jetë për fitim e zemrave të tyre dhe thirrje praktike për hyrje në Islam. Po ashtu, dhënia e sadakasë, pa

¹⁵⁹ Transmeton Ahmedi në *Musned*, hadithi nr. 24501.

¹⁶⁰ Surja el-Lejl, 17-21.

¹⁶¹ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 2320 dhe Muslimi, hadithi nr. 1553.

¹⁶² Surja el-Mumtehine, 8.

¹⁶³ Surja el-Insan, 8.

¹⁶⁴ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 2363 dhe Muslimi, hadithi nr. 2244.

dyshim, është nga veprat e mira për të cilat nxisin ajetet kuranore. Edhe dhënia e ushqimit është një ndër sadakatë më të rëndësishme në përgjithësi. Prandaj, ajeti i dytë e konfirmon hadithin për të, duke e konsideruar urinë si nevojë më të rëndësishme e njeriut përgjithësisht, krahas sigurisë, konform asaj që pohon Kurani:

“(Allahu e zhduku ushtrinë e elefantëve) për t’i qetësuar Kurejshët, - t’i qetësojë ata në udhëtimin që bëjnë dimër e verë, - le të adhurojnë pra Zotin e kësaj shtëpie (Qabesë), i cili i ushqen (ngop) ata nga uria dhe i siguron nga frika.”¹⁶⁵

Ndoshta sadakëdhënësi është më i nevojshëm për pasuri sesa sadakëmarrësi! Kështu i dyti, përfiton nga sadakaja vetëm në këtë botë, në shumicën e rasteve, ndërsa i pari, nëse tregon sinqeritet ndaj Zotit të tij dhe pasuria e tij është hallall, atëherë ai patjetër me sadakanë e tij patjetër përfiton shpërblim edhe në këtë botë dhe në botën tjetër. Së këndejmi, ai veçmas e kërkon ndihmën e saj në rast shtrëngese, si goditja e tij apo e dikujt nga familja e tij me ndonjë sëmundje! Aq më tepër, kur kemi një hadith të vërtetë, i cili iu drejtohet myslimanëve, që me sadakë të kërkojnë shërimin e pacientëve të tyre. Hadithi është ky: “Shërojini të sëmurët tuaj me sadaka!”¹⁶⁶ Dhe një hadith tjetër i vërtetë konfirmon se: “Kryerësit e barmirësisë mbrohen nga e keqja!”¹⁶⁷

Kështu, te myslimani i bindur nga efekti i sadakave në largimin e spro-vës, zhvillohet një motiv i fuqishëm për dhënien e ndihmave me format e saj materiale dhe konkrete ndaj nevojtarëve dhe të varfërve, çfarëdo qoftë përkatësia e tyre fetare, racore dhe gjeografike.

Së këndejmi, unë nuk gjej ndonjë hezitim – falë Allahut – që t’iu dhurojë sadaka të pastrehëve dhe nevojtarëve në rrugë pranë spitalit, ku mje-kohej Abdullahu r.h., në qytete të mëdha në SHBA, me nijet të dhurimit të shpërblimit për të. Këtu i shohim dallimet e mëdha në sistemin kapitalist, i cili i bashkon milionerin dhe miliarderin me atë që është pa strehë në të njëjtën rrugë, madje në të njëjtin trotuar, ku i pastrehuari fle jashtë banesës, ndërsa i pasuri brenda saj!

¹⁶⁵ Surja el-Kurejsh, 1-4.

¹⁶⁶ Transmeton Taberaniu në *El Kebir*, hadithi nr. 10196. Albani e konsideron *hasen. Sahihul Xhami*, hadithi nr. 3358.

¹⁶⁷ Pjesë nga hadithi, transmeton Taberaniu në *El Kebir*, hadithi nr. 8014, dhe të tjerë. Albani e konsideron *sahih*.

Madje, priren për të mirë dhe përpjekjen për vepra të mira e interpreton hadithi i Pejgamberit s.a.v.s.: *“Për çdo gjë të gjallë ka shpërblim”*, që është shtytës i mjaftueshëm për kujdesin në tubimin e copave dhe thërrmijave të bukës, pastaj dërgimi i tyre në vendet ku jetojnë shpezët shtëpiake për ushqimin dhe ngopjen e tyre me ushqim.

Kështu, sadakatë dhe mirësitë e tyre zhvillojnë një impuls pozitiv që e tejkalon ushqimin e njerëzve tek ushqimi i zogjve dhe i kafshëve. Si të mos jetë kështu, kur Pejgamberi i Islamit, s.a.v.s., na njofton për një rast kur:

“Një grua është futur në zjarr për një mace të cilën e kishte lidhur as nuk i jepte për të ngrënë dhe as e linte të lirë të hante prej kandrrave të tokës.”¹⁶⁸

Ndërsa nga ana tjetër:

“Një grua imorale pa një qen duke nxjerrë gjuhën jashtë në një ditë të nxehtë, duke u rrotulluar rreth një pusi dhe gati sa s’po ngordhte nga etja. Ajo mori mbështjellësen e këmbës, e lidhi me shaminë e saj dhe i nxori ujë nga pusi pastaj i dha për të pirë dhe Allahu e fali atë për këtë gjë.”¹⁶⁹

O, sa fe madhështore është Islami! O sa Bujar dhe i Mëshirshëm është Zoti ndaj krijesave të Tij, ndaj të gjitha krijesave, ndaj njerëzve dhe të tjerëve!

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve!

¹⁶⁸ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 3482 dhe Muslimi, hadithi nr. 904.

¹⁶⁹ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 3321.

Tani më fal mua i dashuri Abdullah, madje edhe deri në një kohë tjetër!¹⁷⁰

O Allah... O dhuratë e Allahut... A më sheh, o Abdullah, pas dashurisë si me për ty, që nuk kam nevojë me të për ndonjë detaj, andaj kërkoj leje prej teje kësisoj?

Sa herë, o Abdullah, e kam lexuar këtë ajet kuranor, por nuk e kam perceptuar mirë, vetëm atëherë kur e kuptova qëndrimin tim ndaj teje! O Abdullah, Zoti im, Zoti yt dhe Zoti i botëve, ka thënë:

“Kur i afërmi nuk pyet asgjë për të afërmin, - e, njëri-tjetrin do ta shohin. Atëherë, fajtori, dëshiron të paguajë dënimin e asaj Dite me djemtë e vet, - me gruan e vet dhe vëllanë e vet, - dhe me farefisën e tij të ngushtë, - si dhe me të gjithë ata që gjenden në faqe të Tokës - vetëm për të shpëtuar.”¹⁷¹

Kështu, nuk pyet i afërmi për të afërmin... që e kishte harruar! Përkundër kësaj, ajeti fillon me theksimin e fëmijët para gruas dhe vëllezërve, madje edhe para të gjithë të afërmve... Cilët të afërm: Ata të cilët i sjellin siguri dhe e sigurojnë kur e strehojnë. Madje, nuk mund ta shpëtojnë të gjithë ata në Ahiret!

Të kërkoj ndjesë ty, meqë atëbotë do ta harroj nënën time dhe babanë tim, nënën tënde dhe motrat tua, sepse ata do të jenë të preokupuar, andaj dëgjoje, fjalën e Allahut:

“E, kur të arrijë zëri i madh shurdhues, - në Ditën kur njeriu ikën nga vëllai i tij - dhe nga nëna e babai i tij - dhe nga bashkëshortja e fëmijët e tij; - atë Ditë, çdonjëri është i preokupuar me gjendjen e vetvetes.”¹⁷²

O Allah... Sa i vështirë është ai qëndrim dhe sa i çuditshëm është ai përshkrim!... Ai qëndrim i cili do të të bëjë të më harrosh mua, nënën tënde të dashur dhe motrat e tua të dhembshura për ty.

¹⁷⁰ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 1. 11. 2014.

¹⁷¹ Surja el-Mearixh, 10-14.

¹⁷² Surja Abese, 33-37.

Mirëpo, mua më ngushëllon se ky qëndrim – edhe nëse zgjat – është parashikim i Allahut ndryshe nga parashikimi ynë, edhe nëse vështirësohet vuajtja, megjithatë ajo do të përfundojë në Ditën e Gjykimit pas tubimit të njerëzve! Më pas krejt shpresa është se do të takohemi sërish, ashtu siç na ka premtuar Zoti ynë i Madhërisëm në Shtëpinë e falënderimit.

Është edhe një sihariq tjetër që më inkurajon të qetësohem për takim me ty pas atij qëndrimi të vuajtjes, një premtim madhështor i Allahut të Madhërisëm me Xhenet, shtëpi e ndritur, të cilën e përgatitur Allahu i Madhërisëm për robërit e Tij besimtarë. Aty ka lumturi, të cilën mendja e njeriut nuk mund ta imagjinojë, as ta arrijë imagjinata e ndonjërit! Kështu kush hyn në të do të lumturohet me lumturi të përjetshme dhe do të fitojë me një fitore të madhe!

Pjesë e kësaj lumturie është ajo që Allahu i Plotfuqishëm ua siguroi robërve të Tij besimtarë se do ta bëjë bashkimin e një familjeje: Prindërit dhe fëmijët pas hyrjes së tyre tok në xhenet me mëshirën e Allahut të Madhërisëm dhe me shefaatin e Pejgamberit s.a.v.s. Ja ky është premtimi i të Lartmadhërisëmit:

“E, ata që kanë besuar dhe u shkojnë pas pasardhësit e tyre në besim, do t’i bashkojmë pasardhësit e tyre dhe nuk do t’iu pakësojmë asgjë nga veprat e tyre...”¹⁷³

Ibn ‘Abbasi, në komentimin e këtij ajeti, thotë: “Vërtet Allahu do t’i ngrejë pasardhësit e besimtarit në shkallën e tij, edhe nëse ata janë me vepër në nivel më të ulët se ai, për t’i afruar ata me të! Pastaj ai e lexoi ajetin e mësipërm.”¹⁷⁴

Ndërsa Taberiu është zgjeruar në komentimin e tij për këtë premtim të saktë: ***“Xheneti i Adnit, në të cilin do të hyjnë ata, dhe prindërit e tyre, dhe gratë e tyre, dhe pasardhësit e tyre...”***¹⁷⁵ Dhe ajeti tjetër: ***“(U thuhet): hyni në xhenet të gëzuar, ju dhe bashkëshortet tuaja.”***¹⁷⁶

El Hafidh Ibni Kethiri ka thënë: “Do të thotë, bashkohen ata aty me dashamirët e tyre, si: prindërit, familjarët dhe fëmijët me njeriun e mirë besimtar për të hyrë në xhenet: që të kënaqen me ta! Madje, aty i ngrihet

¹⁷³ Surja et-Tur, 21.

¹⁷⁴ Transmeton Ibn Ebi Hatimi në *Tefsir*, 10/3316, nr. 18683 dhe Ibn Ebi Ed Dunja në *El Ijal*, nr 357. Albani e konsideron *sahih*, në *Es Silsileus sahiha*, ne. 2490.

¹⁷⁵ Surja err-Rra’d, 23.

¹⁷⁶ Surja ez-Zuhruf, 70.

shkalla e atij që është më poshtë deri tek ai që është më lart, pa ndonjë mangësi për atë që është më lart, si mirënjohje dhe mirësi nga Allahu.¹⁷⁷

Këtë e ka konfirmuar Komiteti i Përhershëm për Fetva, në fetvanë e tij nr. 2/409, me rastin e përgjigjes ndaj pyetjes së drejtuar atij në këtë aspekt, andaj mund të shikohen referencat e saj adekuate.

Unë kërkoj falje në fillim për ty, o Abdullah, meqë më në fund unë tërësisht kam një shpresë që do të takohemi tok! Si jo, kur unë përherë e përsëris mendimin e mirë, madje bindjen time tek Allahu i Madhërishtëm dhe te premtimi i Tij i realizueshëm! Betohem në Allahun e Madhërishtëm, kjo është që më bën të përmllohem për ty dhe takimin tonë në Shtëpinë e falënderimit, me vullnetin e Allahut, me mirësinë dhe mëshirën e Tij.

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshim mbi ju!

Babai yt që të do,

Abdulmuhsin El Xharullah El Harafi

¹⁷⁷ *Tefsiruk Kuramil Adhim*, 4/451.

Çfarë duhet të bëjë ai që e shoqëron pacientin apo e viziton?

Vërtet nga përfitimet e sëmundjes, përgjithësisht, është pastrimi i zemrës nga sëmundjet! Shëndeti herë-herë të çon në më të keqen, në mendjemadhësi dhe vetëpëlqim, atëherë kur njeriu gëzon ndonjë aktivitet, fuqi dhe qetësi mendore! Por, nëse atë e kaplon sëmundja dhe i shkakton dhembje, atëherë ai dëshpërohet, i zbutet zemra, pastrohet nga veset dhe cilësitë e shëmtuara!

Dijetari Ibn El Kajjim r.h. ka thënë: “Sikur të mos ishin provat e kësaj bote dhe fatkeqësitë, atëherë robin do ta kaplonin sëmundjet e mendjemadhësisë, egos, arrogancës dhe vrazhdësia e zemrës, që janë shkak i vdekjes së tij herët a vonë! Falë mëshirës së të Gjithëmëshirshmit, njeriu, herë pas here, arrin të kontrollohet me disa lloje të ilaçeve, të cilat do të jenë mbrojtje për të nga këto sëmundje.”¹⁷⁸

Me të vërtetë, sëmundja është një gjendje njerëzore, në të cilën barazohen të gjithë, myslimani dhe jomuslimani! Pacienti ka nevojë për vizitorë, që t’ia lehtësojnë dhimbjen, ta ndihmojnë dhe qetësojnë! Pikërisht për këtë Pejgamberi, s.a.v.s., në porositë drejtuar shokëve të tij, nuk bënte dallim ndërmjet pacientit mysliman dhe atij jomusliman! Andaj, ka shumë hadithe dhe urdhra ku është theksuar shprehja “vizitoheni të sëmurin”, duke mos përcaktuar fenë, as kombësinë e tij. Kush e shikon veprimtarinë e tij, do të shohë se se Pejgamberi, s.a.v.s., i vizitonte myslimanin dhe jomuslimanin. Kështu, kur ishte sëmurë xhaxhai tij, Ebu Talibi, që nuk ishte mysliman, Muhamedi, s.a.v.s., ishte në vizitë tek ai, madje i tha në prag të vdekjes së tij:

“Thuaj: Nuk ka zot përveç Allahut, do të ndërmjetësoj për ty në Ditën e Gjykimit”. Tha: “O bir i vëllait tim, sikur të mos më turpëronte fisi Kurrejsh, atëherë do të të bëja të gëzuar ty.”

Pas kësaj zbriti ajeti kuranor:

¹⁷⁸ *Zadul Me’ad*, 4/ 179, *Muesseseturr Brisale*, Bejrut, botimi 27, viti 1415 h, 1994.

“Ti (o Muhamed), me të vërtetë, nuk mund ta udhëzosh (në formë imponuese) në rrugën e drejtë, atë që dëshiron ti, – por Allahu e udhëzoi (në të gjitha normat). Ai, i di më së miri ata që janë të udhëzuar.”^{179 180}

Pejgamberi, s.a.v.s., e vizitoi një kalama hebre me rastin e sëmundjes nga e cila vdiq. Enes b. Maliku na tregon si është zhvilluar biseda duke thënë:

*“Ishte një djalosh hebre që i shërbente Pejgamberit s.a.v.s. Kur ai sëmuret, Pejgamberi, s.a.v.s., shkon tek ai për ta vizituar. U ul tek koka e tij dhe i tha: “Pranoje Islamin!” Fëmija e shikoi babanë e tij që ishte aty, i cili i tha: “Bindju Ebul Kasimit s.a.v.s.!” Kështu, ai e pranoi Islamin. Pastaj, duke dalë Pejgamberi, s.a.v.s., tha: “Falënderimi i takon Allahut, i Cili e shpëtoi atë nga zjarri.”*¹⁸¹

Vërtet vizita e pacienti është e dëshirueshme sipas Islamit, ajo është një ndër detyrat e myslimanit ndaj vëllait të tij mysliman! Transmetojnë Tirmidhiu dhe Ibni Maxhe se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

*“Kush e viziton (për t’i dhënë durim) një të sëmurë, ose e viziton një vëlla të tij vetëm për hir të Allahut (pra pa kurrfarë interesi), atij i vjen një thirrës duke i thënë: Je i bekuar dhe të është bekuar ecja e i ke përgatitur vetes një vend në xhenet.”*¹⁸²

Ndërsa Muslimi në *Sahih* transmeton se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

*“Detyrat e myslimanit ndaj myslimanit janë gjashtë... në mesin e tyre e ka përmendur edhe: “Kur të sëmuret, ta vizitojë.”*¹⁸³

Nga kultura e vizitës janë:

- Zgjedhja e kohës së përshtatshme për vizitë,
- T’ia lehtësojë qëndrimin,
- Ta ulë shikimin,
- Të pyesë pak,
- Të tregojë interesim për të,
- Të përfundojë me lutje për të.

¹⁷⁹ Surja el-Kasas, 56.

¹⁸⁰ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 25.

¹⁸¹ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 1356.

¹⁸² Transmeton Tirmidhiu, hadithi 2008 dhe Ibni Maxhe, hadithi nr. 1443.

¹⁸³ Transmeton Muslimi, hadithi 2162.

Prej lutjeve për të sëmurin, të cilat theksohen në hadithet e Pejgamberit, s.a.v.s., është edhe transmetimi i Ibni Abasit se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush shkon për ta vizituar një të sëmurë, të cilit nuk i ka ardhur exheli e thotë tek ai shtatë herë: “E lus Allahun e Madh, Zotin e Arshit të Madh që të të shërojë”, do ta shërojë Allahu nga ajo sëmundje.”

Duhet që t’i japë atij shpresë, siç është cituar nga Pejgamberi, s.a.v.s., fjala e tij për të sëmurin: *“E kaluar qoftë¹⁸⁴, pastrim in sha Allah.”¹⁸⁵* Ta qetësojë me fjalë të mira duke i folur atij për durim, sepse në të ka shpërblim të madh, si dhe duhet ta paralajmërojë nga mospërmbajtja, sepse ajo shkakton mëkat.

Vërtet përcjellja e pacientit është ndër veprat më të mira, sepse ajo është mirësi, kryerje e çështjeve dhe nevojave të tij.

Kur ishte sëmurë Rukaja, vajza e Pejgamberit, s.a.v.s., atëherë Muhamedi, s.a.v.s., e kishte urdhëruar burrin e saj, Othman b. Affanin r.a. që të qëndronte tek ajo dhe të kujdesej për shëndetin e saj. Kështu, meqë Othmani qëndroi për shkak të sëmundjes së saj, atëherë ai mungoi në Betejën e Bedrit! Për këtë, Pejgamberi, s.a.v.s., i tha atij: *“Vërtet ti do ta kesh shpërblimin sikur personi që ka marrë pjesë dhe ka luftuar.”¹⁸⁶*

Ky është një vështrim i rëndësishëm për ne, që ia vlen ta përmendim: Se përcjellësi i pacientit patjetër duhet të karakterizohet me durueshmëri, sepse e rëndon veten me vështirësi në pagjumësi, me përcjellje dhe mirësjellje ndaj të sëmurit! Kështu, duhet të jetë i mëshirshëm ndaj tij, ta shikojë interesin e tij, andaj e ka shpërblimin dhe sevapin e mirësisë ndaj tij.

Shpërblimi i përcjellësit të pacientit

Vërtet ndër veprat më të mira tek Allahu i Madhërishëm, më të dashura, më të larta dhe më fisnike është mirësia ndaj të dobët dhe të sëmurit, si dhe përmbushja e çështjeve dhe e nevojave të tij.

Përcjellësi i pacientit patjetër duhet të karakterizohet me durim, pasi që e rëndon veten me vështirësi në pagjumësi, me përcjellje dhe mirësjellje ndaj të sëmurit! Allahu i Madhërishëm thotë:

¹⁸⁴ Transmeton Ahmedi në *Musned*, hadithi nr. 2138 dhe Ebu Davudi, hadithi nr. 3106. Albani thotë se është *sahih*.

¹⁸⁵ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 3616, 5656.

¹⁸⁶ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 3130.

“Vetëm ata që janë të durueshëm do të shpërblehen pa masë.”¹⁸⁷

Andaj, ai patjetër duhet të jetë i mëshirshëm, meqë Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Të mëshirshmit i mëshiron i Gjithëmëshirshmi, mëshironi ata që janë në tokë, ju mëshiron Ai që është mbi qiell.”¹⁸⁸

Kështu përcjellësi i pacientit nuk duhet ta harrojë fjalën e mirë, për të cilën pacienti ka nevojë, siç ka nevojë për ilaç, andaj ai nuk duhet të flasë përveç fjalëve të mira!

Në të kaluarën vakëfi islamik është kujdesur për gjendjen psikologjike të pacientit. Prandaj, myslimanët formuan vakëfe për shoqërimin pacientëve, duke iu bërë shoqëri për t'ua ngritur moralin, siç kemi shpjeguar në një kapitull tjetër të këtij libri.

Preferimi i mosqëndrimit gjatë te pacienti

Vizita e pacientit është sunet i Pejgamberit, s.a.v.s., që i bashkon zemrat, ia lehtëson dhimbjet dhe vuajtjet e pacientit. Ajo kontribuon në harmoninë shpirtërore, vepron në formimin e urave të miqësisë dhe të dashurisë, në përhapjen e dukurive të simpatisë dhe të ngushëllimit, si dhe në përforcimin e lidhjeve të anëtarëve të shoqërisë.

Por në kohën tonë shohim veprime negative, me të cilat nuk jemi mësuar! Kështu, disa njerëz janë të rëndë në vizitë pa e ndier këtë, duke qëndruar gjatë tek i sëmurit. Kjo është në kundërshtim me parimet Islame të vizitës së të sëmurit, madje edhe të vizitës në përgjithësi. Nga Ebu Dherri r.a. transmetohet: Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

“Vizito më rrallë, do të shtohet dashuria.”¹⁸⁹

Dikush nga të sëmurët është “mugibb” që vizitohet ditë pas dite! Vallë, çfarë do të thotë “mugibb”? Thuhet se kjo është nga “gabbe el ibilu” dhe ka kuptimin, kur deveja pi ujë çdo të dytën ditë! Andaj shprehja “mugibben...” do të thotë: Vizito çdo të dytën ditë! Disa dëshirojnë që të qëndrosh gjatë dhe t'i vizitosh çdo ditë! Kurse disa të tjerë mërzi të, lodhen dhe ndikohen nga vizitat e shumta dhe qëndrimet e gjata!

¹⁸⁷ Surja ez-Zumer, 10.

¹⁸⁸ Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 4941 dhe Tirmidhiu, hadithi nr. 1924. Sahihun e Ebi Davudit, Albani e konsideron si *sahih*.

¹⁸⁹ Transmeton El Bejhëkiu në *Shuabul iman*, hadithi nr. 8007. Albani e konsideron si *sahih* në *Sahihul Xhami*, hadithi nr. 3568.

Vizita e pacientit konsiderohet një nga faktorët e shërimit të tij, ku përmes saj e freskon shpirtërisht pacientin dhe në të ka argëtim dhe ngushëllim për të! Kështu pacienti gjatë vizitës e kupton pozitën e tij te njerëzit, si rezultat i vëmendjes së tyre ndaj tij, që e çon në optimizëm, në ngritje morale, në rezistencë ndaj sëmundjes dhe mosdorëzimit ndaj saj.

Shkenca bashkëkohore i kushton kujdes të madh çështjes së qetësisë psikologjike të pacientit, ku mjekët e konsiderojnë stabilitetin psikologjik ndaj pacientit fazë të parë e shërimit, andaj nuk ka dobi mjekimi me humbje të shpresës dhe dëshpërim sado që të arrijë fuqia e tij.

Kështu, përveç përfshirjes së saj në përfitimet e vizituesit, ajo ia përkujton edhe begatitë e Allahut ndaj tij, kur ai e sheh sprovën e sëmundjes, andaj e kupton begatinë e shëndetit, e përkujton dhe e falënderon Allahun dhe më pas kërkon falje nëse ka qenë keqbërës.

Prandaj, është sunet i Pejgamberit, s.a.v.s., që vizituesi të bisedojë me pacientin për atë që e dëfren, që ia lehtëson sëmundjen, e këshillon për durim, i flet me fjalë të mira, ia përkujton se sëmundja i shlyen mëkatet nëse duron i sëmuri pa zemërim!

SHËRONI TË SËMURËT TUAJ ME SADAKA - Shejh Muhamed El Avedi (2:50)

VLERA E VIZITËS SË TË SËMURIT - Shejh Muhamed Hasan (2:15)

DURIMI PËR FAMILJEN E TË SËMURIT - Shejh Salih El Megamsi (3:44)

Çka më mësoi rrugëtimi për në shtëpinë e falënderimit¹⁹⁰

Rrugëtimi me Allahun për në Shtëpinë e falënderimit, më mësoi:

*Shpresa është një shok i mrekullueshëm, që ndoshta mungon,
por ajo kurrë nuk të tradhton.*

*Sa njerëz të mrekullueshëm janë ata që shpresën përherë e mbështesin tek Allahu..
që ta jetojnë sinqeritetin dhe besnikërinë me dashurinë dhe sigurinë e Tij,
dhe ai do t'i fitojnë të gjitha të mirat.*

Më pëshpëriti (rrugëtimi) në veshin tim duke më thënë:

*“Kur ti të mendosh
se pas vështirësisë vjen lumturia,
pas lotëve të tu vjen buzëqeshja...
e ke kryer një çështje madhore që quhet
mendimi i mirë për Allahun.”*

Po ashtu, ma përkujtoi fjalën e Shejh Muhamed Salih El Uthejmin r.h.:
“Kush pret shpëtim do të shpërblehet për atë pritje, sepse pritja e shpëtimit është mendim i mirë për Allahun, dhe mendimi i mirë për Allahut është vepër e mirë për të cilën shpërblehet njeriu.”

Sikundër që më ndriçoi me një ajet, që shpesh e lexojmë duke mos e prekur njërin nga kuptimet e tij themelore:

Thotë Allahu i Madhërishëm, kur erdhi sihariqtari:

“...Ia vuri këmishën në fytyrën e tij (Jakubit), e atij iu kthye të parët.”¹⁹¹

Ibni Kethiri në komentimin e fjalës së Es Sudiut thekson: “Vërtet ai e ka sjellë, sepse ai ka ardhur – që është për qëllim Jehudha b. Jakub – me

¹⁹⁰ Përzgjedhje nga mesazhet e pranuar përmes WhatsApp-it gjatë periudhës së sëmundjes së të dashurit Abdullah dhe pas vdekjes së tij, Allahu e mëshiroftë!

¹⁹¹ Surja Jusuf, 96.

këmishën e përlyer me gjak të rrejtshëm! Ai deshi që ta lajë atë me këtë, andaj e solli këmishën ia vuri në fytyrë babet të tij dhe iu kthye të parët!

Kështu që mund të shohësh diçka që është shkak i pikëllimit tënd, por shumë shpejt do të shohësh të njëjtën gjë që është shkak i lumturisë tënde, e kjo nuk është e vështirë për Allahun!

Kur ti thërret: O Zot!

Atëherë të përgëztoj se nuk do të zhgënjehesh;

ose do të përgjigjet në lutje,

ose prej teje do të largohet sprova,

ose do të shkruhet shpërblimi në fshehtësi.”¹⁹²

Andaj, le të ndriçojë mëngjesi dhe mbrëmja jonë duke e falënderuar se ne kemi Një Zot, që nëse mbyllen portat e tjera, porta e Tij nuk mbyllet.. nëse ndërpriten shkaqet, atëherë vjen ndihma e Tij dhe nëse zemrat bëhen të vrazhda, atëherë zbret mëshira e Tij!

Rrugëtimi më është drejtuar me këto fjalë:

Ji i sjellshëm në pikëllimin tënd, ji falënderues në lotët e tu dhe ji elegant në dhimbjen tënde!

Pikëllimi sikur edhe gëzimi janë dhuratë e Zotit të robërve, që do të qëndrojnë pak, e më pas do të kthehet te Zoti i tyre duke mbartur detajet e durueshmërisë tënde.

Po ashtu ai m’i përkujtoi fjalët që lidhen me zemrën, kur m’u drejtua mua duke thënë:

Çfarë mendon, nëse ti ke takim në një vend, ku janë gjithë të mirat që i do ti dhe zemra jote.

Vallë, a do të dëmtojë ty nëse vetëm ngjyra e portës, që të çon në atë vend, nuk të pëlqen?

Po ashtu, edhe përcaktimet e Allahut, që shpirtrat tanë i urrejnë, nuk janë diç tjetër veçse porta që na shpijnë në vepra të mira, të cilat ne i shpresojmë, i duam dhe i dëshirojmë..

Ndonjëherë e shikojmë portën dhe qëndrojmë me pesimizëm nga pamja e saj, por ne harrojmë se vetëm do të kalojmë përmes saj, ndërsa bukuria e brendshme është përtej imagjinatës sonë!

Kështu, kush e njeh Allahun me atributin e Tij “Mëshirëplotë”, i Cili e drejton robin për të mirë, nëpërmjet shtegut që ai e urren, atëherë ai do ta

¹⁹² Këtë e konfirmon hadithi i njohur Pejgamberit s.a.v.s.

shikojë të urryerën me shikim të shndritshëm, sepse ai prapa saj sheh të mira të gjithëmbarshme dhe dhurata të mëdha! Andaj, caktimet e Allahut kurrsesi nuk ndalen nga mëshira e Tij, por ato kanë nevojë për të tillë që sheh me zemër e jo (vetëm) me sy!

Përcaktimet e Allahut janë të fshehura me mëshira, por ju jeni një popull që nxitoni!

Po ashtu ai (rrugëtimi) më bëri që t'i drejtohem me fjalë të mira Prof. dr. Omer El Mukbelit, kur i tuboi parimet e bashkëpunimit me vështirësitë, duke e përmendur atë të cilin e godasin ato! Andaj ja sqarimi i tyre:

Parimi i parë: “Ti nuk je vetëm”.

Parimi i dytë: “Allahu nuk përcakton diçka veçse për një urtësi”.

Parimi i tretë: “Allahu është Ai që sjell dobinë dhe largon dëmin, andaj mbaji raportet me Të”.

Parimi i katërt: “Ajo që të ka ndodhur, nuk ka mundur të të anashkalojë, ndërsa ajo që të ka anashkaluar nuk ka mundur të të ndodhë”.

Parimi i pestë: “Njihe realitetin e kësaj bote, atëherë do të çlodhesh”.

Parimi i gjashtë: “Ki mendim të mirë për Zotin tënd”.

Parimi i shtatë: “Zgjedhja e Allahut për ty është më e mirë sesa zgjedhja jote për veten tënde”.

Parimi i tetë: “Sa më shumë që të intensifikohet sprovat, aq më shumë afrohet shpëtimi”.

Parimi i nëntë: “Mos mendo në mënyrën e shpëtimit, meqë kur Allahu do diçka, Ai i përgatit shkaqet në formën, që nuk mund të imagjinohet me mendje”.

Parimi i dhjetë: “Ti duhet t'i lutesh Atij që i ka kompetencat e shpëtimit”.

Ibn El Kajjimi r.h. ka thënë: “Ti mos mendo se vetja jote është ajo që të ka drejtuar në vepra të mira, por dije se ti je një rob që të do Allahu, andaj të ka frymëzuar për vepra të mira! Pra, mos e tepro në këtë dashuri e të të harrojë Ai”.

Gjithashtu ai (rrugëtimi) më mësoi një dobi madhore nëpërmjet Ibn Tejmijes r.h., kur e pyetën: “Cili është ilaçi të cilin e kontrollon sëmundja, cila është mendjemprehtësia të cilën e sundon çrregullimi, cila është vepra që e mposht përtacia, cila është rruga e suksesit, cila është shtegdalja që e vlerëson hutimi? Qëllimin e orientimit drejt Allahut e pengon pasioni, se nëse dëshiron të veprojë, nuk e nënshtron dështimi?”

Ai është përgjigjur si vijon:

- “Ilaçi i tij është strehimi tek Allah i Madhërishëm, vazhdimi i bindjes ndaj Allahut, lutja, mësimi i lutjeve të transmetuara, praktikimi i lutjes aty ku do të ketë përgjigje, p.sh. në fund të natës, gjatë ezanit dhe ikametit, në sexhde dhe pas përfundimit të namazeve!
- Kësaj ia bashkëngjit istigfarin, sepse ai që i bën istigfar Allahut, pastaj pendohet tek Ai, Allahu do ta bëjë të kënaqur me një kënaqësi të mrekullueshme deri një afat të caktuar.
- Le të marrë ndonjë pjesë të dhikrit gjatë ditës dhe natës!
- Le të bëjë durim në ato pengesa që i shfaqen, meqë ai nuk do të qëndrojë gjatë e Allahu do ta përkrahë me mëshirën e Tij dhe do t’ia rrënjosë besimin në zemrën e tij.
- Le të ketë kujdes në plotësimin e namazeve farze, si në aspektin brendshëm ashtu edhe atë të jashtëm, sepse namazi është shtylla e fesë!
- Le të jetë praktika apo shprehia e tij: “Nuk ka forcë dhe as fuqi veçse me Allahun e Madhërishëm”, sepse ai me këtë i bart peshat, shtrëngesat e llahtaritë dhe kështu do të arrijë nivel të lartë!
- Të mos mërzitet nga lutja dhe kërkesa, sepse lutja do t’i përgjigjet njeriut, nëse ai nuk nxiton e të thotë: Jam lutur, por nuk më është përgjigjur!
- Le ta dijë se triumfi vjen me durim, shpëtimi vjen me vuajtje, lehtësimi vjen pas vështirësisë! Askush nuk ka arritur ndryshe një përfundim të mirë, përveçse me durim!

Andaj, falënderimi i takon vetëm Allahut, Zotit të botëve!”¹⁹³

Po ashtu ma përkujtoi fjalën e Shejh Muhamed Mutevel-li Esh Sh’aravit r.h.:

Çuditem me katër individë që i injorojnë katër çështje madhore:

- Çuditem me atë që është sprovuar me një ‘brenge’ si e injoron shprehjen: “**S’ka zot tjetër përveç Teje! Ti je i lavdëruar! Me të vërtetë, unë kam gabuar (ndaj vetes)!**” Kur Allahu pas kësaj thotë: “**Na iu gjegjëm atij dhe e shpëtuam nga brengosja.**” (el-Enbija, 87-88).
- Çuditem me atë që është sprovuar me ‘mjerim’ si e injoron shprehjen: “**Mua, më ka goditur mjerimi, e Ti je më i mëshirshmi prej**

¹⁹³ *Mexhmu’ul Fetava*, 10/136-137.

mëshiruesve!” Kur Allahu thotë pas kësaj: *“E, iu gjegjëm Ne atij dhe ia larguam mjerimin që kishte ai.”* (el-Enbija, 83-84).

- Çuditem me atë që është sprovuar me ‘frikë’ si e injoron shprehjen: *“Mua më mjafton Allahu dhe Ai është mbrojtës i mrekullueshëm!”* Kur Allahu thotë pas kësaj: *“Ata u kthyen (nga Bedri) me dhuntitë dhe begatitë e Allahut, nuk i gjeti asgjë e keqe...”* (Alu Imran, 173-174).
- Çuditem me atë që është sprovuar me ‘mashtrimet e njerëzve’ si injoron shprehjen: *“E, unë – rastin tim ia lë Allahut, me të vërtetë, Allahu i sheh robërit e Vet.”* Kur Allahu thotë pas kësaj: *“Dhe, Allahu e ruajti atë prej të këqijve dhe trillimeve të tyre..”* (Gafir, 44-45).

Po ashtu nuk hezitova të përkujtoj se:

Lutja është thelb dhe themel i adhurimit, së cilës myslimani i kthehet në momentet e shtrëngesës! Megjithatë, është mirë që t’i kthehet edhe në momentet e mirëqenies! Andaj duhet të insistosh përherë në lutje, sepse Allahu do të përgjigjet ty! Mos e braktis lutjen, nëse nuk gjen ndonjë shenjë të përgjigjes në lutje, sipas fjalës së Pejgamberit s.a.v.s.: *“Secilit nga ju i pranohet duaaja nëse nuk ngutet”, - i thanë: -O i Dërguar, e si ngutet?!- Tha: -“Atëherë kur thotë: U luta, u luta, u luta dhe nuk m’u pranua duaaja”.*

Edhe përkundër kësaj, ai ma përkujtoi udhëzimin e Imam Ahmedit r.h. kur e pyetën:

“Sa është distanca ndërmjet nesh dhe ndërmjet Arshit të Mëshiruesit?”

Tha: *“Një lutje e singërtë për vëllanë tënd.”*

Gjithashtu më mësoi të bëj vepra të mira.

Tregimi për një njeri të moshuar, i shtrirë në spital, të cilin e viziton një djalosh çdo ditë, ai qëndron me të më shumë se një orë, i ndihmon të hajë ushqim dhe të lahet, pastaj e merr e shëtit në kopshtin e spitalit, i ndihmon që të shtrihet dhe ikën pasi të qetësohet për të.

Një ditë hyri tek ai infermierja që t’ia jepte ilaçet. Ajo duke e shikuar gjendjen e tij i tha: *“Ma sha Allah! Allahu ta ruajt djalin që po të viziton çdo ditë!”*

Ai shikoi nga ajo, por nuk tha asgjë! I mbylli sytë dhe tha në vete: *“Ah sikur të ishte ndonjëri nga bijtë e mi si ky jetim i lagjes, në të cilën banojm! Një herë pashë duke qarë te dera e xhamisë, pasi që i kishte vdekur babai. Unë e qetësova dhe i bleva ëmbëlsira dhe nuk kam kontaktuar me të që nga ajo kohë... Por kur ai kuptoi se unë dhe gruaja ime kemi mbetur të vetmuar, atëherë ai filloi të na vizitonte çdo ditë, për të parë gjendjen tonë. Kur u dobësua trupi im, ai e mori gruan time në shtëpinë e tij,*

ndërsa mua më solli në spital për mjekim. Kështu, kur e pyeta, pse o djali ynë po ngarkohesh me këtë barrë, me ne?

Ai buzëqeshi dhe tha:

“Ende shija e ëmbëlsirës, o xhaxhai im, është në gojën time me çdo frymëmarrje”.

Mbille një të mirë dhe bëj mirësi, se nuk do të humbet e mira kudo që mbillet!

Vërtet vepra e mirë, edhe nëse kalon një kohë e gjatë, atë nuk do ta korrë tjetërkush, veçse ai që e ka mbjellë!

KËNAQËSIA ME KADANË DHE KADERIN ËSHTË KUSHT PËR LARGIMIN E SPROVËS - Shejh Muhamed Mutevel-li Esh Sha'ravi (00:23)

SI DO TË SILLESH ME ALLAHUN NËSE TË GJEN BELAJA - Shejh Meshari El Haraz (9:02)

Zbulojni botët e tjera te fëmijët tuaj¹⁹⁴

Këtë fjalë po jua adresoj vëllezërve të mi dhe motrave të mia prindër, që t'i zbulojnë botët e tjera në jetën e fëmijëve të tyre, veçmas kur ekzistojnë mjetet e komunikimit elektronik, përmes të cilave fëmijët tanë po jetojnë në bota të tjera jashtë shtëpisë, shumë larg gjeografikisht.

Unë befasohesha shumë kur Abdullahu r.h. e mbyllte derën e dhomës tij, natën si zakonisht, por ai ishte i integruar në bisedë sikur të ishte në mes të ditës. E takova në kulmin e përfshirjes në bisedë me shokët e tij dhe e mendova si bisedë spontane. Pastaj ndenja me shokët e tij, pas vdekjes tij, për t'i vazhduar kontaktet me ta, për ta nuhatur aromën e tij prej tyre, për ta ndjekur udhëzimin e Pejgamberit, s.a.v.s., për lidhje të mira me dashamirët e babait, nënës, bashkëshortit, bashkëshortes pas vdekjes së ndonjërit prej tyre. Ato ishin takime shumë të bukura, të mbushura me emocione të trazuara, përmes të cilave të gjithë ata i konsideroja si fëmijët e mi dhe të gjithë ata mua më konsideronin si prind të tyre.

Deklaroj: Pa dyshim unë kur rrija me ta duke e kujtuar të dashurin në mesin e tyre, ata komentonin aspekte, të cilat unë nuk i kisha ditur në personalitetin e të mëshiruarit. Ata hynin në mënyrë të përbashkët dhe formonin një skuadër prej 10 personash në një si projekt në formë të lojës elektronike, ku kishte planifikim strategjik, mbrojtje dhe sulm, shitje dhe blerje, shpërndarje të thesareve dhe sferave të forcave, pastaj bëhej ndarja e anëtarëve të skuadrës së dhjetëshes, në mbrojtës, sulmues dhe ndihmës. Abdullahu r.h. ishte kryesues i grupit të sulmuesve dhe kishte marrë drejtimin e qitjes. Shokët e tij të skuadrës e kishin shënuar rezultatin që kishin arritur dhe kishin vërejtur se ai kishte marrë pozitën e tretë në mesin e rreth 10 milionë pjesëmarrësve në nivel botëror. Kjo kishte ndodhur në vitin 2012, në programin e quajtur “Bota e hapur – World Open”, siç ma përcollën shokët e tij, si reflektim i karakterizimit të tij në qitje. Ai fare nuk ishte i interesuar për përfitime materiale, të cilat i shfrytëzonin disa, por ai ato i përdorte për ngritjen e performansës, ose e jepte kapitalin e tij vullnetarisht për përmirësimin e performansës së shokëve tjerë të skuadrës, apo të tjerëve. Ai në praktikë e zbatonte parimin: “Dora e lartë (që jep) është më e mirë se dora e poshtme (që merr)!” dhe, në një formë, e shfaq-

¹⁹⁴ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 3.8.2015.

te altruizmin e vetëmohimin e tij, në një botë ku pjesëmarrësit garojnë për fitim dhe grumbullim.

Unë nuk e kam pritur ekzistimin e një bote të vlerave të bukura, të cilën e jetonte dhe e praktikonte Abdullahu në këtë botë elektronike, nga dhoma e tij, apo nga divani, apo nga salloni, vetëm duke e mbajtur me vete një kompjuter laptop, për t'i përshkuar kontinentet me pjesëmarrje të miliona njerëzve në mënyrë paralele, sa që kishte fituar një bazë të njohjes së gjuhës angleze, e cila ishte shkak i rritjes së mesatares në shkollimin e mesëm dhe në provimin pranues për Universitetin e Kuvajtit, në kohën kur po bie gjithnjë e më tepër mesatarja te studentët e shkëlqyeshëm.

Kjo epërsi gjuhësore e nxiste për zbulimin e të rejave të programit, “Bota e hapur”, që t'i kontrollojë personalitet e tij, pastaj njoftojë skuadrën e tij për zhvillimet e pritshme të cilat e përmirësojnë performansën. Ai nuk i kursente këshillat ndaj askujt, përkundrazi i inicionte dhe drejtonte sikur të ishte në botën reale.

Fjalët e mia për Abdullahun janë të plagosura, por po i them pa asnjë paragjykim: Atë që e pohova për botën elektronike dhe të tjerat, përshatet plotësisht me botën aktuale reale për cilësitë dhe praktikat e tij dhe sikur ta bënte Zoti që të hynte në projekte të jetës, do ta shihnim edhe në botën reale atë që e mësova në botën tjetër.

Për këtë arsye, i këshilloj vëllezërit e mi dhe motrat e mia prindër, që të afrohen më tepër me fëmijët e tyre në botët e tyre elektronike për t'i inkurajuar, orientuar dhe udhëzuar.

TERBIJETUL EVLAD FIL ISLAM - Shejh Muhamed Ratib En Nablusi (40:50)

MEHARAT FI TERBIJETIL EBNAË - Shejh Xhasim El Matu' (40:48)

Cilat drama po na i tërheqin fëmijët tanë¹⁹⁵

Kohëve të fundit isha i befasuar me jetën e të dashurit Abdullah r.h. dhe ndjekjen e tij të serisë japoneze me karikatura dhe u impresionova me largimin e tij nga kjo dramë e gjatë dhe e njohur për të cilën Ministria e Informacionit po shpenzon mijëra dinarë dhe nuk po ka sukses për tërheqjen e saj. Shumë prej shokëve si ai, madje secili prej tyre, ka zgjedhur ndonjë seri televizive në ‘laptopin’ e tij, që nga ky largim më lehtë të vijë deri te materiali mediatik në kohën e duhur dhe të përshtatshme.

Pasi vazhduam me disa shokë të tij¹⁹⁶ në një ndejë emocionale, ku evokuam kujtimet për të – Allahu e mëshiroftë – ata më informuan për sfondin e serisë japonezë, të titulluar **“Piece One”**, përkatësisht një pjesë në të cilën përtërihet përmbajtja e saj e mbushur me vlera njerëzore të përshtatshme për çdo qytetërim dhe fe prej të cilës përfitojnë shikuesit. Ajo i nxjerr në pah të mirat dhe nuk fantazon siç bëjnë disa drama kuvajtiane duke nxjerrë në pah të metat, sa që shoqëritë arabe dhe ato të Gjirit e shikojnë shoqërinë kuvajtiane si një shoqëri me intriga, me probleme dhe tradhti bashkëshortore, përplot me skena rrahjesh me shuplaka, me keqardhje, sikur të ishte tipar i shoqërisë kuvajtiane!

¹⁹⁵ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 9. 8. 2015.

¹⁹⁶ Ndoshta është e përshtatshme t’i përmendim emrat e shokëve të tij në dy grupe, sepse ai – Allahu e mëshiroftë – ishte njeri shoqëror, mbante kontakte me disa grupe të shokëve në të njëjtën kohë.

Grupi i parë: Muhamed Shahate, Fahd El Katami, Halid Ed Dusri, Ibrahim El Haxheri, Su’ud El Garir, Sali Es Sen’usi, Mushari El Hijsan, Fehd El Fehd, Abdurrahman El Ufur, Dari Err Rreshid, Saud Err Rrumi, Saud El Muslim, Abdullah El Mehna, Muhamed Es Sen’usi, Abdulaziz El Xheri, Fehd El Xheri, Abdulhadi El Xheri, Ahmed El Xheri, Omer El Ganim, Fehd Es Sejf, Velid Err Rreshid, Mubarek Es Sabah, Burak El Ganim, Tarik El Gajs, Muhamed Es Sultan, Salih Eth Thunejb, Jusuf El Ganam, Muhamed El Ganam, Ibrahim Malullah, Hamid El Heran. Gjithashtu edhe Abdurrahman Esh Shemlan – student në SHBA, i cili ishte me ne përgjatë rrugëtimit tonë për në Shtëpinë e falënderimit.

Grupi i dytë: Fehd Saud Es Sa’d, Abdurrahman Saud Es Sa’d, Sultan Mensur Es Sa’d, Abdulmuhsin Muslim Ez Zamil, Ahmed Abdullah Es Sa’d, Abdullah Bedër El Vezan, Hamed Et Tachus, Abdulaziz Err Rrifai, Fehd El Kadi, Ahmed Err Rremih, Bedër Et Tachus, Ahmed Et Terkit, Abdurrahman Et Tachus dhe Saud Nasir Es Salih.

Kjo seri japoneze, ashtu si edhe seritë e tjera të orientuara me karikatura, janë me imagjinata të gjera, me përmbajtje morale, përplot me vlera të besnikërisë dhe miqësisë së mirëfilltë, me koncept të vërtetë të familjes dhe të shoqërisë besnike, me besim të ndërsjellë dhe me bindjen se ai që kujdeset për ty bëhet pjesë e familjes tënde.

Një nga karakteret e serisë “Nakama” përqendrohet në thesarin e miqësisë dhe orientimin e tij të marrëdhënieve funksionale dhe sociale në formën më të mirë, thjesht njerëzore. Këto gjëra i mbështet edhe feja jonë e vërtetë fillimisht, por, me keqardhje, pastaj i prishin praktikën e gabuara, të cilat e dëshpërojnë atë që e shikon në dallimet tona sociale nga ato të vlerave, përveç rënies politike të orientuara e të balancuara larg nga grindjet dhe problemet.

Nga kjo seri prej vlerave që i kishte mësuar përmendsh Abdullahu r.h. dhe shpesh i përsëriste, është edhe kjo shprehje me përkthim tekstual:

“Kur mendon se vdesin njerëzit?

A vdesin atëherë kur shkrepet zjarri mbi ta? Jo.

A vdesin atëherë kur i ekspozohen sëmundjes së pashërueshme? Jo.

A vdesin atëherë kur pinë pijen e prodhuar nga kërpudhat helmuese? Jo.

Ata vdesin kur të përfundojë kujtimi për ta!”

Unë dëshmoj se ti, o Abdullah, je i gjallë në zemrat tona dhe në ndër-gjegjen tonë. E falënderoj Allahun e Plotfuqishëm që ju ka dhuruar besnikëri prindërve, familjes dhe dashamirëve, kështu që të dashurit e tyre të vdekur mbesin të gjallë në mesin e tyre duke i përmendur për të mirë.

Rëndësia e mjekimit dhe moskundërshtimi i tij me tevekulin (mbështetjen te Zoti)

Dikush mund të befashohet për përzgjedhjen e një teme të kuptueshme si kjo, por është rast i përshtatshëm për zgjerimin e njohurive he njohjen dimensionit tjetër të temës.

Pejgamberi, s.a.v.s., thotë:

“E çuditshme është çështja e besimtarit. Çështja e tij është krejt mirë për të dhe nuk është e tillë për askënd tjetër. Nëse besimtarin e godet gëzimi, ai falënderon (Allahun), e kjo i sjell dobi, kurse nëse e godet e keqja, ai bën durim (sabër), andaj edhe kjo i sjell dobi.”¹⁹⁷

Sëmundja është shkak për faljen e mëkateve, të cilat i ka bërë njeriu me zemër, me vesh, me sy, me gjuhë dhe me organet të tjera. Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, kjo është për shkak se e keni fituar vetë, e Ai edhe fal shumë.”¹⁹⁸

Njeriu mund të ketë pozitë të lartë tek Allahu i Plotfuqishëm, por nuk ka bërë vepra për ta arritur atë pozitë, andaj Allahu e sprovon me sëmundje derisa ta bëjë të denjë për atë pozitë dhe ta arrijë atë me mirësinë e me mëshirën e Allahut.

Rëndësia e mjekimit nga sëmundjet, për shkak të shërimit, buron nga legjitimiteti i saj në besimin islam, sepse Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“O robër të Zotit, mjekohuni, sepse Allahu i Madhërishëm, nuk ka bërë sëmundje pa e caktuar për të edhe ilaçin, përveç pleqërisë.”¹⁹⁹

Në këtë hadith, Pejgamberi, s.a.v.s., e ka legjitimuar mjekimin për umetin e tij, derisa nuk është me haram. Juristët myslimanë kanë mospajtime rreth çështjes së mjekimit, në disa drejtime:

¹⁹⁷ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 2999.

¹⁹⁸ Surja esh-Shura, 30.

¹⁹⁹ Transmeton Ibni Maxhe në *Sunen*, hadithi nr. 3436.

- Xhumhuri i ulemave, e në mesin e tyre hanefijtë dhe malikijtë, thonë se mjekimi është i lejuar (mubah), ndërsa malikijtë shprehen me fjalët: s'ka gjë të keqe në mjekim.

- Ndërkaq, Shafi'ijtë, El Kadiu, Ibni Akili dhe Ibni El Xhevzi nga hanbelinjët thonë është i parapëlqyer (mustehab), duke argumentuar me këtë hadith të Pejgamberit s.a.v.s.:

“Vërtet Allahu e ka zbritur sëmundjen dhe për çdo sëmundje ka ilaç, prandaj mjekohuni dhe mos u mjekoni me haram!”²⁰⁰

Ekzistojnë hadithe në të cilat tekstualisht urdhërohet mjekimi, siç e kanë marrë hixhamin dhe mjekimin e Pejgamberit, s.a.v.s., dëshmi për legjitimitetin e mjekimit. Shafi'ijtë qëndrimin e tyre për parapëlqim mbështesin në faktin se ai nuk ishte kategorik në deklaratë, sepse nëse do të ishte kategorik, atëherë mjekimi do të bëhej i obligueshëm (vaxhib).

Te xhumhuri i hanbelinjve braktisja e tij është më e mirë, për të cilën është deklaruar Ahmed: “Sepse ai është më afër me mbështetjen (tevekul) në Allahun.”

Është pyetur Imam Ebu Abdullah Ahmed bin Hanbel për një njeri që mjekohet, e ai është përgjigjur: “Mjekimi është leje, ndërsa braktisja e tij është më e lartë se ai.”

Imam El Hamevi, në përgjigje ndaj tyre, thotë: “Vërtet tevekuli nuk vjen në kundërshtim me shkakun, sepse tevekuli është mbështetja e zemrës në Allahun e Plotfuqishëm, e kjo nuk është në kundërshtim me shkaqet, pasi që shumica e shkaqeve bëhen me tevekul, ngase shëruesi nëse ka njohuri me mjekësinë, ai e bën atë që kërkon puna, pastaj çështjen ia dorëzon Allahut dhe mbështetet tek Ai për sukses, sepse po të ishte vetëm tevekuli i mjaftueshëm, nuk do të thoshte Allahu i Plotfuqishëm:

“O besimtarë! Bëhuni syçelë...”²⁰¹

Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Lidhe atë së pari, pastaj mbështetu!”²⁰²

Gjithashtu, ka thënë:

“Mbyllni dyert!”²⁰³

²⁰⁰ Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 3874.

²⁰¹ Surja en-Nisa, 71.

²⁰² Transmeton Tirmidhiu, hadithi nr. 2517.

²⁰³ Transmeton Ahmed, hadithi nr. 15057 dhe Ibni Hibani në *Sahih*, hadithi nr. 1271.

Kush mendon se tevekuli është braktisja e shkaqeve, atëherë ai nuk e ka njohur tevekulin, sepse nëse do të ishte siç mendojnë, Pejgamberi, s.a.v.s., nuk do të fshihej në shpellë dhe nëse thotë dikush mbylle derën dhe mbështetu, do të ishte në kundërshtim me arsyen dhe fenë.”

Interpretimi i braktisjes së mjekimit:

Sa i përket atij që argumentohet me ata që e kanë braktisur mjekimin nga myslimanët e parë, siç transmetohet nga Ebu Bekri r.a. dhe të tjerë, atyre iu përgjigjemi me disa çështje:

E para, që të ketë ndodhë mjekimi pastaj është ndalur.

E dyta, se ajo që ka thënë nuk e kundërshton mjekimin, por atë e ka konsideruar si dorëzim ndaj caktimit (kaderit).

E treta, që të jetë zbuluar afërsia e vdekjes (exhelit).

E katërta, që të jetë i preokupuar me përmendjen e përfundimit e tij nga gjendja e tij.

E pesta, që të jetë sëmundja e përkohshme, kurse nga ilaçi i përshkruar të mos supozohet dobi. Mbi këto gjëra e mbështesin gjendjen të gjithë ata që e braktisin mjekimin dhe mbi këto e ka mbështetur fjalën e tij edhe Imam Ahmed bin Hanbeliu, sepse, sipas rrethanave, braktisja e shkaqeve nuk është e dobishme, përkundrazi njeriu duhet të bëjë përpjekje, madje edhe nëse nuk e arrin qëllimin.”²⁰⁴

Mjekimi është i obligueshëm dhe nuk është në kundërshtim me tevekulin

Mjekimi është i obligueshëm nëse me braktisjen e tij njeriut i kanoset vdekja sipas dëshmisë së mjekëve të besueshëm.

Juristët, të cilët e mbajnë këtë qëndrim, argumentojnë me këto citate nga Kurani:

“Dhe mos e sillni veten tuaj në shkatërrim...”²⁰⁵

Si dhe:

“Dhe mos vritni vetveten (dhe njëri-tjetrin)! Allahu, me të vërtetë, është mëshirues për ju.”²⁰⁶

²⁰⁴ *El Ahkamun nebevije fis sina'atit tibije*, fq. 195.

²⁰⁵ Surja el-Bekare, 195.

Ata, gjithashtu, argumentojnë edhe me hadithet që e urdhërojnë mjekimin, siç është hadithi i Usame b. Shurejikut:

“Erdha te Pejgamberi, s.a.v.s., ndërsa shokët e tij si të kishin zogj mbi kokat e tyre. Ju dhashë selam dhe u ula. Aty erdhën arabë nga anë të ndryshme dhe i thanë: ‘O i Dërguari i Allahut, a bën të mjekohemi?’ Tha: ‘Mjekohuni, sepse Allahu i Madhërishëm, nuk ka bërë sëmundje pa vendosur për të edhe ilaçin, përveç pleqërisë.’”²⁰⁷

Se braktisja e mjekimit nuk është kusht i tevekulit dëshmon edhe transmetimi i Omerit r.a. dhe sahabëve të tjerë lidhur me ngjarjen e mortajës. Atyre, pasi që ishin nisur për në Damask dhe ishin ndaluar në Xhabije, u erdhi lajmi se atje ishte përhapur një mortajë shumë e rrezikshme, nga e cila kishin vdekur shumë njerëz, andaj njerëzit u ndanë në dy grupe. Njëri grup thanë: “Nuk shkojmë të hyjmë në epidemi e të hidhemi me duart tona në shkatërrim.” Grupi tjetër thanë: “Jo, por do të hyjmë duke u mbështetur në Allahun dhe nuk do të ikim nga caktimi i Allahut, as nuk do të ikim prej vdekjes, sikur ata për të cilët Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“A nuk i pe ti (o Muhamed!) ata që nga frika e vdekjes – ikën nga qytetet e tyre...”²⁰⁸

Atëherë u kthyen dhe e pyetën Omerin r.a. për mendimin e tij, dhe ai iu përgjigj: “Do të kthehem dhe nuk do të hyjmë në epidemi!” Kundërshtarët e mendimit të tij thanë: “A do të ikim nga caktimi i Allahut?” Omeri tha: “Po, do të ikim nga caktimi i Allahut për në caktimin e Allahut...” Në mëngjes, erdhi Abdurrahmani dhe Omeri e pyeti për këtë çështje. Ai tha: “Po, o Prijës i besimtarëve, unë e kam dëgjuar Pejgamberin, s.a.v.s., duke thënë: “Nëse dëgjoni se në një vend është përhapur murtaja mos hyni në të, nëse ajo përhapet kur ju jeni atje mos dilni prej atij (vendi).”²⁰⁹

HEL JEXHUZU LI SHAHSIN EN JUHSINE ET TEVEKKULE ALALLAHI VE JETRUKEL ILAXHE - Shejh Mustafa El Advi (3:18)

²⁰⁶ Surja en-Nisa, 29.

²⁰⁷ Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 3855.

²⁰⁸ Surja el-Bekare, 243.

²⁰⁹ Transmeton Buhariu në *Sahih*, hadithi nr. 5729 dhe Muslimi në *Sahih*, hadithi nr. 2219, nga Ibni Abasi.

I vdekuri nga kanceri është shehid²¹⁰

Ekziston një sihariq i mrekullueshëm pejgamberik, të cilit nuk i kushtojnë vëmendje shumë myslimanë, megjithëse ai u jep shpresë të pushtuarve nga sëmundja dhe ua heq mërzinë, i qetëson zemrat e të tremburve dhe të frikësuarve për fatin e tyre të botën tjetër, apo për fatin e ndonjërit prej të afërmeve, apo të dashurve të tyre. Gati se nuk gjendet familje e cila nuk përfshihet me atë që thuhet aty. Po cili është ai sihariq?

Ai sihariq rezymohet në pohime të theksuara në disa hadithe autentike të Pejgamberit, s.a.v.s., të cilat na kanë bërë sihariq duke zgjeruar konceptin islam mbi “shehidin – dëshmorin”, në të cilin përfshihen shumë cilësi. Hafidh Ibni Haxheri ka arritur t’i regjistrojë rreth 27 cilësi, të cilat janë përmendur në hadithe të vërtetuara nga Pejgamberi, s.a.v.s., ndërsa Imam Esh Shevkani ka bërë numërimin e kategorive të shehidëve, bashkangjitur me argumente dhe ka gjetur pesëdhjetë kategori.²¹¹

Prej haditheve që e dëshmojnë zgjerimin e konceptit islam të “shehidit” është hadithi i Ebu Hurejres r.a., i regjistruar nga dy Sahihët, ku thuhet: “Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.:

“Shehidët janë pesë llojesh: ai i cili vdes nga murtaja, ai i cili vdes nga sëmundjet e barkut, ai i cili mbytet në ujë, ai i cili vdes nën gërmadhat e ndonjë objekti të rrënuar dhe ai i cili vdes në rrugën e Allahut.”²¹²

Kanë transmetuar Imam Maliku në ‘El Muvetta’, Imam Ahmedi në ‘El Musned’, Ebu Davudi, En Nesaiu dhe Ibni Maxhe në ‘Sunenet’ e tyre hadithin nga Xhabir bin Utejk r.a., se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Janë shtatë kategori të shehidëve, me përjashtim të atyre që vdesin në betejë në rrugën e Allahut: ai që vritet në rrugën e Allahut është shehid, ai që vdes nga murtaja është shehid, ai që mbytet në ujë është shehid, ai që vdes nga sëmundjet e barkut është shehid, ai që pëson nga zjarri – digjet është shehid,

²¹⁰ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 26. 10. 2014.

²¹¹ “*El Fet’hurr rrebani min fetava El Imam Esh Shevkani*”, 10/4947.

²¹² Transmeton Buhariu nga Ebu Hurejre, hadithi nr. 2829.

ai që vdes në rrënoja është shehid dhe gruaja që vdes gjatë lindjes së fëmijës është shehid.”²¹³

Imam Muslimi në Sahihun e tij, nga Ebu Hurejre, ka transmetuar se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë: “Kë e konsideroni ju shehid?” Ata thanë: “O i Dërguari i Allahut, ai që vritet në luftë në rrugën e Allahut është shehid.” I Dërguari i Allahut, s.a.v.s., tha: “Shehidët e umetit tim janë pak.” Ata thanë: “Cilët janë ata, o i Dërguari i Allahut?” Ai u përgjigj: “Ai që vritet në rrugën e Allahut është shehid, - ai që vdes në rrugën e Allahut është shehid, - ai që vdes nga murtaja është shehid, - ai që vdes nga sëmundjet e barkut është shehid dhe ai që mbytet në ujë është shehid.”²¹⁴

Hadithet në këtë kapitull janë të shumta, por të gjitha ato demonstrojnë përmasat e dhuratës së Allahut mbi këtë umet me zgjerimin e konceptit të shehidit, saqë Imami Hafidh Ibn Haxheri ka cituar nga Imam Ali ibn Ebi Talibi, të ketë thënë: “Çdo vdekje në të cilën vdes myslimani ai është shehid, mirëpo, ato (vdekjet) diferencohen sipas gradave.”²¹⁵

Disa shkencëtarë kanë vendosur kritere gjithëpërfshirëse për kategoritë e shehidëve. Ato kritere janë: “Çdokush që vdes nga një sëmundje e dhimbshme dhe e gjatë, ose nga një sëmundje e tmerrshme, ose nga një fatkeqësi e papritur - ai e ka shpërblimin e shehidit. Nga lloji i parë është ai që vdes nga sëmundjet e barkut, nga lloji i dytë është ai që vdes nga murtaja dhe nga lloji i tretë është ai që mbytet në ujë.”²¹⁶

Ndërkaq, sa i përket sëmundjes së kancerit dhe përmasave të konsiderimit të atyre që vdesin prej tij si shehidë, unë jam njohur me shumë fetva, të cilat konfirmojnë se të vdekurit nga kjo sëmundje janë shehidë – me lejen e Allahut – duke qenë se kanceri shkakton dhimbje të mëdha, pastaj i prekuri me këtë sëmundje vuan një kohë të gjatë. Andaj kjo, ose bën pjesë sipas tekstit në sëmundjet e lartcekura, sipas sqarimeve për këto sëmundje, ose sipas interpretimit, sepse kanceri bën pjesë në sëmundjet të cilat shkencëtarët i kanë konsideruar prej sëmundjeve që të vdekurin e çojnë shehid.

²¹³ Transmeton Maliku në ‘*El Muvetta*’, hadithi nr. 996, Ahmedi në ‘*El Musned*’, hadithi nr. 23753, Ebu Davudi në ‘*Es Sunen*’, hadithi nr. 3111 dhe En Nesaiu, në ‘*Es Sunen*’, hadithi nr. 1846.

²¹⁴ Transmeton Ibnu Hibbani në *Sahihun* e tij, hadithi nr. 3186.

²¹⁵ *Fet’hul Bari*’ 6/44.

²¹⁶ “*Fejdul Bari Sherhu Sahihil Buhari*”, El Keshmiri, 2/248, nr. 652, botues: Darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1421 h, 2005.

Nga fetvatë që kam njohur, të cilat e konfirmojnë këtë sihariq, janë edhe këto në vijim:

1. Fetvaja e Shejh Dr. Abdullah bin Muhamed El Mutlak, këshilltar në Oborin Mbretëror, anëtar i Trupit të Shkencëtarëve të Lartë dhe anëtar i Komitetit të Përherëshëm për Kërkime Shkencore në Mbretërinë e Arabisë Saudite, në të cilën, shkëlqesia e tij konsideron se i vdekuri nga kanceri është shehid, duke qartësuar se i sëmuri nga kanceri është sikurse i sëmuri nga mortaja, nga sëmundjet e barkut dhe nga tuberkulozi, sepse këto bëjnë pjesë në sëmundjet e cekura me shkrim. Nga Ebu Hurejre r.a. transmetohet se Pejgamberi, s.a. v.s., ka thënë: *“Kë e konsideroni ju shehid?”* Ata thanë: *“O i Dërguari i Allahut, ai që vritet në luftë në rrugën e Allahut është shehid.”* Tha: *“Shehidët e umetit tim janë pak.”* Ata thanë: *“Cilët janë ata, o i Dërguari i Allahut?”* Ai u përgjigj: *“Ai që vritet në rrugën e Allahut është shehid, ai që vdes në rrugën e Allahut është shehid, ai që vdes nga murtaja është shehid, ai që vdes nga sëmundjet e barkut është shehid.”*²¹⁷
2. Fetvaja e Myftinisë së Përgjithshme të Jordanisë, në të cilën thuhet: *“Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe bekimet qofshin për zotërinë tonë, të Dërguarin e Allahut. Ekzistojnë tekste fetare, të cilat i qartësojnë kategoritë e shehidëve. I tillë është edhe hadithi i Ebu Hurejres r.a., i transmetuar nga Buhariu, se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë: *“Shehidët janë pesë llojesh: ai i cili vdes nga murtaja, ai i cili vdes nga sëmundjet e barkut, ai i cili mbytet në ujë, ai i cili vdes nën gërmadhat e ndonjë objekti të rrënuar dhe ai i cili vdes në rrugën e Allahut.”*²¹⁸ Disa shkencëtarë kanë vendosur kritere për llojet e shehidëve. Ata kanë thënë: *“Çdokush që vdes nga një sëmundje e dhimbshme dhe e gjatë, ose nga një sëmundje e tmerrshme, ose nga një fatkeqësi e papritur - ai e ka shpërblimin e shehidit. Nga lloji i parë është ai që vdes nga sëmundjet e barkut, nga lloji i dytë është ai që vdes nga murtaja dhe nga lloji i tretë është ai që mbytet në ujë.”*²¹⁹ Studiuesi i kategorive të vdekjeve të përmendura në hadithe vëren se aty ka vështirësi, ku atij që i është afuar vdekja është i vetëdijshëm, i ndërgjegjshëm dhe i ndjeshëm ndaj dhimbjeve, kështu ai është dëshmitar i vetvetes në Ditën e takimit me Allahun e Plotfuqishëm. Të gjitha këto ia rrisin shpërblimin, ia shlyejnë mëkatet dhe e vendosin në radhët e shehidëve, ku grada më e lartë është vdekja në rrugën e Allahut. Mirëpo, prej kushteve të fitimit të*

²¹⁷ Transmeton Muslimi nga Ebu Hurejre, hadithi nr. 1915.

²¹⁸ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 2829.

²¹⁹ *“Fejdule Bari Sherhu Sahihil Buhari”*, El Keshmiri, 2/248, nr. 652.

shpërblimit të shehidit janë edhe: durimi ndaj sëmundjes, shpresa e robit në shpërblimin e Allahut, siç është shprehur El Imam Es Subki në fetvatë e tij, kur është pyetur për shehidin, ka thënë: “Ajo është një gjendje fisnike, tek e cila robi arrin përmes shkakut, kushtit dhe rezultatit.” Pastaj prej kushteve i numëron disa çështje, ndër të cilat janë: durimi dhe shpresa, si dhe mungesa e gjërave që pengojnë siç është borxhi, marrja e hakut të huaj ... dhe të tjera.”²²⁰ Kush sëmurët me kancer dhe e përballon me durim, e falënderon Allahun për gjendjen e tij, pastaj vdes për shkak tij, ai e fiton shpërblimin e shehidit, me lejen e Allahut. Kjo është ndër sëmundjet më të njohura vrastare, që në të shumtën e rasteve çon në vdekje, për të cilën deri sot njerëzit nuk kanë gjetur ilaç. Andaj, kush goditet me të, nuk duhet të shqetësohet as t’i ngushtohet gjoksi, por duhet t’i bëjë të gjitha përpjekjet për mjekim, çështjen t’ia dorëzojë Allahut të Plotfuqishëm duke qenë i kënaqur me caktimin e Tij, i bindur se nuk mund ta godasë asgjë përveç asaj që ia ka caktuar Allahu dhe se Allahu ia ka shkruar që ta përzgjedhë me shehidët, nëse bën durim dhe istirxha’. Një lajm i gëzueshëm për të gjithë myslimanët, është ai që ka cituar El Hafidh Ibn Haxheri, në librin “*Fet’hul Bari*”: “Transmeton El Hasan bin Ali El Havlani, në librin e tij “*El Ma’rife*” me sened të mirë, hadithin nga Ali bin Ebi Talib r.a., i cili thotë: “Çdo vdekje në të cilën vdes myslimani ai është shehid, por ato (vdekjet) diferencohen sipas gradave.” Allahu i Plotfuqishëm e di më së miri.

3. Fetvaja e Prof. dr. Ahmed Taha Rejjan, profesor në Uneversitetin ‘Al Az’har’, thotë: “Falënderimi i takon Allahut, paqja dhe bekimet qofshin për atë që u dërgua mëshirë për të gjitha botët. Pastaj: Është vërtetuar në hadithin të cilin e transmetojnë Maliku, En Nesaiu dhe Ebu Davudi, për të cilin En Neveviu thotë se është i saktë me konsensus, ku thuhet: “Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: “*Shehidët janë shtatë kategorish, me përjashtim të atyre që vdesin në betejë në rrugën e Allahut: ai që vdes nga murtaja është shehid, ai që mbytet në ujë është shehid, ai që vdes nga pleuriti është shehid, ai që vdes nga sëmundjet e barkut është shehid, ai që pëson nga zjarri – digjet është shehid, ai që vdes në rrënoja është shehid dhe gruaja që vdes gjatë lindjes së fëmijës është shehid.*”²²¹ El

²²⁰ “*Fetava es Subki*”, 2/339, Botues Darul Mearif, pa vit të botimit.

²²¹ Transmeton Maliku në ‘*El Muvetta*’, hadithi nr. 996, Ahmedi në ‘*El Musned*’, hadithi nr. 23753, Ebu Davudi në ‘*Es Sunen*’, hadithi nr. 3111 dhe En Nesaiu, në ‘*Es Sunen*’, hadithi nr. 1846.

Hafidh Ibn Haxheri i ka përmendur cilësitë e statusit të shehidit të cilat janë vërtetuar me hadithe, derisa ka arritur në 27 cilësi. Ai gjithashtu ka thënë: “Ka edhe cilësi të tjera që janë theksuar në hadithe, por nuk është ndalur tek ato për shkak të dobësisë së tyre.”²²² Prej atyre cilësive të përmendura në hadithet e mira, është edhe i vdekuri nga tuberkulozi. Gjithashtu, siç transmeton Ed Dejmliu, nga hadithi i Enesit r.a. edhe i vdekuri nga ethet është shehid. Transmeton El Hafidh Ibn Ali El Havlani, në librin “*El Ma’rife*”, me sened të mirë, hadithin nga Ali bin Ebi Talibi r.a., që thotë: “Çdo vdekje në të cilën vdes myslimani ai është shehid, por ato (vdekjet) diferencohen sipas gradave.” Arsyeja e përdorimit të termit ‘shehid’ për këto vdekje – siç ka thënë El Imam el Baxhi dhe Ibnu et Tini – është për shkak të dhimbjeve të forta, andaj Allahu i Plotfuqishëm preferoi, që për umetin e Muhamedit, s.a.v.s., ta bëjë atë pastrim të mëkateve të tyre dhe shtim të shpërblimit, derisa t’i përfshijë në radhët e shehidëve. Dijetarët kanë mendime të ndryshme lidhur me interpretimin e disa cilësive të përfshira në hadith. Kështu, në interpretimin e *murtajës* thuhet se ajo është një gjëndër si devesë, që del nën sqetulla. Për *pleuritin* thuhet se është tumor i nxehtë, shfaqet në membranën themelore të brinjëve. Gjithashtu, thuhet është kallje apo djegie. Për *sëmundjet e barkut* thuhet se janë diarre. Ka mendim se mund të jetë edhe magjepsja. Ibn El Ethiri thotë: “Ai që vdes nga sëmundja e barkut është si ai që vdes nga hidropizia (trupazia, edematoza)”. Ndërsa Ebu Bekër El Mirvezi, nga mësuesi i tij Shurejhu, thotë se ajo sëmundje është ‘kolunxha’. Sipas asaj që u tha, mund të konkludohet se kanceri, pasi që shkakton dhimbje të forta dhe se i prekuri me këtë sëmundje vuan një kohë të gjatë, ose sipas tekstit bën pjesë në sëmundjet e mësipërme, pas sqarimeve që u bënë për këto sëmundje, ose sipas interpretimit, sepse i plotëson kushtet e dijetarëve, të cilat këtë sëmundje e radhisin në ato që të vdekurin e çojnë shehid. Mirësia e Allahut është e pakufishme, kurse depot e Tij janë të mbushura plot. Allahu e di më së miri.

4. Fetvaja e Shejh dr. Sefer bin Abdurrahman El Havali, të cilit i ishte shtruar kjo pyetje: “*Ai që vdes nga kanceri, a është shehid?*”, ishte përgjigjur: “Shpresojmë të jetë i tillë, me vullnetin e Allahut, pasi që Pejgamberi, s.a.v.s., duke e ditur se shehid është vetëm ai që vritet në betejë, kishte thënë: ‘*Shehidët e umetit tim janë pak.*’ Pastaj kishte kërkuar nga Allahu që të jenë më shumë dhe ajo i është dhënë.

²²² *Fet’hul Bari’* 6/44.

Imam Es Sujutiu r.h. e ka bërë përmbledhjen e cilësive të shehidit dhe ka arritur të numërojë mbi 24 cilësi. Prej tyre: Murtaja, sëmundjet e barkut, lehona – gruaja që vdes gjatë lindjes së fëmijës... Shpresojmë që edhe kanceri të hyjë – me vullnetin e Allahut – në kuadër të këtyre sëmundjeve, të cilat ne i quajmë me emra të ndryshëm, si kanceri, cirroza e mëlçisë dhe emra të ngjashëm që nuk kanë qenë të njohur më parë.”

5. Fetvaja e Shejh Abdulaziz bin Abdullah bin Baz r.h., në të cilën thuhet: “I sëmuri me kancer apo me sëmundje tjetër ka një të mirë të madhe, shpresohet për të një e mirë e madhe, për faktin se çdo njeri, të cilin e godet një sëmundje apo ndonjë dëmtim, madje edhe një ferrë, të gjitha këto i llogariten si shlyerje për mëkatet e tij.”
6. Fetvaja e Shejh dr. Ahmed El Haxhi El Kurdit, anëtar i Këshillit për Fetva pranë Ministrisë së Vakëfeve dhe Çështjeve Islamike në Kuvajt, ekspert në Enciklopedinë e jurisprudencës dhe profesor prestigjioz i sheriatit, në bazë të një pyetjeje nga një dashamir drejtuar shkëlqesisë së tij, rreth përmasës në të cilën i vdekuri nga kanceri konsiderohet shehid, qoftë edhe nga kanceri në tru (siç është rasti i djalit tim), është me interes. Teksti i pyetjes është si vijon: “Vdiq djali i një dashamiri tim, pasi që ishte i sëmurë nga kanceri në tru; pra, a konsiderohet ky prej shehidëve në botën tjetër? Sidomos, pasi që kam hasur në kundërthënie të fetvave. Disa syresh, e konsiderojnë në shehid vetëm atë që vdes nga kanceri në bark dhe jo në ndonjë vend tjetër të trupit, duke e trajtuar atë në kuadër të sëmundjeve të barkut. Disa të tjerë, shehid e konsiderojnë atë që vdes nga një sëmundje e gjatë dhe me dhimbje të forta, sipas të cilit në këtë koncept hyn çdo i sëmurë nga kanceri dhe sëmundjet tjera të ngjashme... Allahu ju shpërbleftë me të mira dhe ju ruajt nga çdo e keqe.” Shkëlqesia e tij i ktheu këtë përgjigje: “Ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: *‘Shehidët janë pesë llojesh: ai i cili vdes nga murtaja, ai i cili vdes nga sëmundjet e barkut, ai i cili mbytet në ujë, ai i cili vdes nën gërmadhat e ndonjë objekti të rrënuar dhe ai i cili vdes në rrugën e Allahut.’*²²³

Në bazë të kësaj – sipas ixhtihadit tim – mund të bëhet analogji edhe për të vdekurin nga sëmundjet e rënda si kanceri e të tjera, ku unë shpresoj që personi, për të cilin është bërë pyetja, të jetë prej shehidëve në botën tjetër.”

²²³ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 2829 dhe Muslimi, hadithi nr. 1914, nga hadithi i Ebu Hurejres.

Vërtet mëshira e Allahut është e gjerë, kurse depot e Tij janë të mbushura plot, të cilat nuk i pakëson dhurimi i Tij, i cili as mund të numërohet e as të llogaritet. O Allah, djalin tim Abdullahun dhe të gjithë të vdekurit nga kanceri, konsideroju shëhidë tek Ti! Dhe të gjithë ata, pranoji tek Ti me robërit e devotshëm, se me të vërtetë Ti je që dëgjon dhe përgjigjesh!

Ligjshmëria e heqjes së pajisjeve të reanimimit nga pacienti të cilit i ka vdekur truri²²⁴

Ky është një ndër momentet më të vështira të njeriut, kur mjekët e informojnë se pacientit të tij i ka vdekur truri dhe se nga vdekja atë e ndan vetëm heqja e pajisjeve të reanimimit!

Çështja bëhet edhe më e vështirë, kur mjekët prej tij kërkojnë që të zgjedhë ndërmjet asaj se a do të mbetet pacienti në atë situatë që është, me lodhje të trupit dhe zemrës së tij, a të mbetët ashtu në mes jetës dhe vdekjes, apo të hiqen prej tij pajisjet e reanimimit dhe ai sigurisht se do të vdesë!

O Allah, ai është momenti më kritik në jetën e njeriut... Ai është vendimi më i dhimbshëm në të gjitha situatat, negative, ose pozitive. Nëse e refuzon heqjen e pajisjeve, vuan bashkë me vuajtjen e pacientit të tij, madje mund të mendojë se edhe ai vetë ka dorë në zgjatjen e kësaj vuajtjeje, nëse e lë kështu, as të gjallë e as të vdekur. Nëse pajtohet, atëherë e humb ëndrrën e tij që e shpreson, qoftë edhe nëse është e pamundur, që pacienti të rikthehet në jetë.

Njeriu mbetet ndërmjet dy vendimeve, ku më i ëmbli është i hidhur si pelini, sidomos në spitalet tona, të cilat vendimi deri në fund i lihet kujdestarit, për dallim prej spitaleve amerikane, p. sh., të cilat e japin një afat për marrjen e vendimit dhe pastaj vetë ata marrin vendim, të tërhequr nga familja e pacientit të cilit i ka vdekur truri, siç përcaktohet me Ligjin amerikan.

Allahu i Plotfuqishëm, me mirësinë dhe mëshirën e Tij, na ka bërë pjesëtarë të Islamit, të kësaj feje madhështore, e cila ia largon njeriut vështirësinë, nuk e ngarkon përtej mundësive dhe kujdeset për kushtet e tij në çdo rast dhe në çdo çast. Prej kësaj, është se edhe sheriati ndalon torturimin e pacientit që gjendet në prag të vdekjes, duke përdorur ndonjë pajisje apo medikament, atëherë kur i është bërë e qartë mjekut specialist kompetent të besueshëm, se e gjithë kjo është e padobishme dhe se jeta

²²⁴ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 8. 3. 2015.

në trup pashmangshëm po shkon në vdekjen e përgjithshme përfundimtare.²²⁵

Për këtë arsye, janë nxjerrë fetva të shumta nga këshillat e jurisprudencës dhe nga shkencëtarët për lejimin e saj. Ne këtu, për shkak të hapësirës së kufizuar që kemi në dispozicion në këtë artikull, si dhe për t'iu shmanhur përsëritjes, do të mjaftohemi vetëm me një të një prej tyre. Akademia e Fikhut Islamik, pranë Organizatës së Konferencës Islamike, në mbledhjen e mbajtur në Aman, kryeqytetin e Jordanisë, gjatë 3-5 korrik 1986, mori vendimin vijues: “Pacienti, i cili ka të instaluar në trupin e tij pajisjet për reanimim, lejohet heqja e tyre, nëse ndërpriten plotësisht të gjitha funksionet e trurit të tij dhe nëse Komisioni i përbërë nga tre mjekë specialistë ekspertë ka vendosur se mosfunksionimi i atyre funksioneve është i pakthyeshëm, edhe pse zemra dhe frymëmarrja vazhdojnë të punojnë automatikisht, me anën e pajisjeve të instaluar. Mirëpo, ligjërisht nuk gjykohehet për vdekjen e tij, përveçse kur ndalet plotësisht frymëmarrja dhe zemra, pas heqjes së këtyre pajisjeve.”

Ky vendim, ndoshta ka edhe një dimension tjetër në vendet e varfra, sepse aty ka lehtësi të madhe për njerëzit, veçanërisht për familjen e pacientit, e sidomos nëse ata nuk posedojnë mjete për mbajtjen e pajisjeve të reanimimit për një periudhë më të gjatë në trupin e pacientit, atëherë çështja bëhet shumë kritike për ta.

Falënderimi i takon Allahut për begatinë e Islamit! O Allah, të gjithë ata që janë sprovuar me këtë sprovë dhe për familjet e tyre, frymëzoji me durim dhe ngushëllim!

²²⁵ Shejh Xhadulhak Ali Xhadulhak – ish Rektor i Universitetit “Al Az’har”, “*Buhuth ve fetava islamije fi kadaja muasire*” (Studime dhe fetva islame në çështje bashkëkohore), fq. 508, e tutje.

Shumësia e këshillave mjekësore te pacienti dhe familjarët e tij dhe vlefshmëria e tyre²²⁶

Dashamirët janë të shumtë.

Atij, i cili e gëzon dashurinë e tyre tej mase, e shohim se si ata i urojnë gjithë të mirat për pacientin, ku secili prej tyre ia dërgon përvojën e tij personale, ose të përcjellë nëpërmjet tij, ose që është fituar nga mediet shoqërore. Dhe ato janë aq shumë, sa që familjarët e pacientit vihen në mëdyshje se cilat përvoja t'i përdorin?

Ndërsa, për sa i përket rukjes, lutjes dhe dhikrit, ato janë të mundshme, por është e rëndësishme të bëhet dallimi, se cilat prej tyre janë të argumentuara me dëshmi të sakta, duke pasur parasysh që lutjet dhe rukjet të jenë të kufizuara në ato që rrjedhin nga Pejgamberi s.a.v.s. Edhe pse lutja e përgjithshme edhe dhikri i përgjithshëm janë të lejuar dhe ka dobi – me lejen e Allahut – megjithatë, kush e kërkon bekimin e tyre në shërim, atëherë duhet t'i përzgjedhë lutjet me saktësi të argumentuar.

Ndërsa, kur është fjala për recetat dhe barnat popullore, ato iu nënsht-rohen këtyre konsideratave, siç vijon:

1. Janë të mbështetura në përvoja thjesht personale, sipas llojit të sëmundjes dhe përshtatshmërisë së recetave popullore për të.
2. Mund të mos jenë domosdo në proporcion me gjendjen e pacientit, bazik është mjekimi të cilin është duke e bërë pacienti në spitalin ku është i shtrirë, veçanërisht në ata jashtë shtetit, ku nuk kanë arritur mjekimet popullore dhe, për pasojë, nuk mund të bëhet dallimi i tyre, kurse familja e këshillon për marrjen apo mosmarrjen e tyre.
3. Mund të jetë paaftësia e familjes së pacientit për t'i siguruar ato në vendet përëndimore për shkak të mungesës së komponentëve.
4. Nganjëherë mund të përdoren nga njerëzit e dobët, ose nga ata që nëpërmjet kësaj realizojnë përfitime materiale. Dhe sa janë të gatshëm pronarët e emocioneve të shfrenuara për të paguar çdo shumë për shërimin e të dashurve të tyre. Unë nuk po i fajësoj ata nga ana

²²⁶ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 3. 1. 2016.

emocionale, por ata logjikisht duhet ta dallojnë të mirin dhe të keqin.

5. Pacienti dhe familjarët e tij janë shumë të angazhuar rreth vetë mjekimit në njërën anë, kurse në anën tjetër rreth komunikimit me mjekët, me ç'rast, këshillat e shumta në pamundësi për të përfituar prej tyre, ndoshta mund të çojnë në zhgënjimin e pacientit dhe të familjes së tij.
6. Absolutisht nuk ka referenca mjekësore për të gjitha këto receta dhe rrallëherë janë të licencuara nga autoritetet mbikëqyrëse për referenca shëndetësore. Gjithashtu, nuk mund të sigurohet pacienti nga pasojat e përdorimit të barnave paralele, në vend të atyre origjinale, pa konsultim me mjekët!
7. Askush nuk e mohon përfitimin e përgjithshëm nga barnat popullore, por ato nuk duhet të përshkruhen për raste të veçanta, krejtësisht pa dëshmi dhe pa dijeninë e mjekëve.
8. Këshilla për mjekim dhe përdorim të këtyre barnave, mund të jetë një imazh normal për të treguar dhembshuri, dashuri dhe dëshirë për të ndihmuar, por jo domosdo ajo mund të jetë mënyra më e mirë dhe më e saktë. Ndërkaq, duaja e përmban edhe bereqetin edhe përgjigjen në ndonjërin nga format e marrjes së përgjigjes, të cilat i kemi përmendur edhe më parë në këtë seri të bukur, por më detajisht do t'i shpalosim në një artikull më vonë - me vullnetin e Allahut.

Mirë se vjen fqinji ynë, Halid Abdulatif esh Shajië, në Shtëpinë e Falënderimit²²⁷

Mirë se vjen fqinji ynë në Shtëpinë e falënderimit!

Një model i mirë është fqinji ynë i ri në Shtëpinë e falënderimit!

Do të filloj nga njoftimi me të, pastaj do të shpjegoj se pse ai është fqinji ynë atje.

Halid Abdulatif Ali Esh Shajië r.h. është model i personalitetit të mirë në modesti dhe në raport me të vegjlit e me të mëdhenjtë. Lidhja farefisnore tek ai, shkon përtej familjes tij dhe njerëzve të tij, deri te miqtë e babait tij r.h. në të gjitha zonat e brendshme dhe të jashtme të Kuvajtit. Ai i nxit edhe vëllezërit e tij ta bëjnë këtë, duke e interpretuar, me këtë rast, hadithin e Pejgamberit s.a.v.s.:

“Vërtet prej mirësive më të mëdha është që njeriu t’i vizitojë të dashurit e babait tij.”²²⁸

Bujaria e kishte rrethuar nga të dyja anët: bujaria e moralit dhe bujaria e dorëdhënies, krahas cilësive fisnike që kishte trashëguar nga prindërit e tij.

Ai është një model fisnik për një familje të lashtë fisnike, e cila është e pranishme në jetën sociale dhe ekonomike, ka dhënë kontribute për bamirësi në të gjitha fatkeqësitë e njohura në botën myslimane. Këtë e kam theksuar me hollësi në librin tim *“Komiteti popullor për mbledhjen e kontributeve vullnetare – 2007”* (El-Lexhnetush sha’bijjetu lit-teberruati – 2007), gjithashtu edhe në librin *“El Vusul ilel usul – Evrak kuvejtijje fi sijakis sijretil ailijje: Ailetul Xharullah El Harafi”*, ku një pjesë ia kam kushtuar kësaj familjeje dhe njerëzve të saj të nderuar, brenda kontekstit të familjeve të lumtura në Kuvajt.

Ajo është një familje që nuk ka nevojë për prezantim, me lidhje të ndërsjellë dhe me edukatë të mirë të brezave, nuk është dëgjuar për të, as për brezat e saj diç që i turpëron, në kohën e depërtimit të materializmit dhe ndikimit të tij në sjellje.

²²⁷ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 22. 3. 2015.

²²⁸ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 2552.

Ndërkaq, për fqinjin tonë të ri në Shtëpinë e falënderimit kam vendosur që të flas në pjesën e dytë dhe të fundit i këtij artikulli, sepse unë e di se pena ime do të shkruajë me lotët e mi, jo me kapacitetin e saj. Kur u zgjova në mëngjesin e së premtes së kaluar, i krevat tri sunetet karshi të mëshiruarit – me lejen e Allahut – Halid Esh Shajië, të cilit ia fala namazin e xhenazes, e përçolla deri në varr, e pastaj te varri i tij bëra lutje për qëndrueshmëri dhe falje. Më pas, para nisjes për ngushëllime, u ktheva te varri i të dashurit Abdullah, u ktheva nga fytyra e tij fisnike, e përshëndeta me selam, pastaj u ktheva në anën tjetër në drejtim të kiblës dhe bëra lutje për të, pastaj i fola duke mos i përmbajtur lotët, duke i thënë: “Sihariq për fqinjin e ri në Shtëpinë e falënderimit!”, ku ai tashmë kishte humbur djalin e tij “që kishte qenë djalë i vetëm me dy motra”, në një aksident me makinë, kur ishte në lulen e rinisë, në korrik të vitit 1999”.

Andaj, ai duroi, e falënderoi Allahun, shpresoi në shpërblimin e Tij dhe bëri istirxha’, duke thënë: **“Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi.”** Për këtë arsye, ai e meriton premtimin e Allahut të Plotfuqishëm, të përçjellë përmes gjuhës së Pejgamberit, s.a.v.s., besnik dhe i besueshëm, i cili nuk ka folur nga hamendja, që ka dhënë sihariq:

“Secili që e humb fëmijën e tij dhe ai përballon me durim, me shpresë në shpërblim, me falënderim dhe me istirxha’, - melekët e dëgjueshëm do t’ia ndërtojnë atij një shtëpi në xhenet, e cila quhet “Shtëpia e falënderimit”.

I fola Abdullahut të dashur me bindje të plotë sikur po e shoh Shtëpinë e falënderimit, duke pasur mendim të mirë për Zotin tim. Unë dëshmoj dhe mirë më kujtohet kur i ofrova ngushëllime Halid Esh Shajiut r.h. – atëherë për birin e tij – r.h., në lutjen e ngushëllimit ia shtova edhe fjalët “duro dhe shpreso”, dhe ai bashkëpunoi, e falënderoi Allahun dhe bëri istirxha’.

Veçantia e Halid Esh Shajiut është se, ai është nga të ndjerët që njoh unë, i cili bashkohet me mua në fatkeqësinë e humbjes së djalit të tij të vetëm, madje ai, më pas gjithashtu e humbi edhe nipin e tij të vetëm. Allahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij dhe e bëftë banor të xheneteve madhështore.

XHEZAU MEN JASBIRU ALA MEVTI VELEDIHI - Shejh Muhamed El Arifi (2:25)

INNEMEL MU’MINUNE IHVETUN - Shejh Muhamed Ratib En Nablusi (12:00)

Angazhimi civilizues i umetit islamik ndaj të sëmurëve të tij

Vakëfi shëndetësor

Vakëfi, ndoshta është prej koncepteve më të dalluara që ka pasqyruar dhe vazhdon të pasqyrojë altruizmin e madh, i cili kërkon angazhim kulturor dhe material nga brezat e umetit islamik kundrejt brezit tyre dhe brezave pasues, kryesisht pa i njohur. Kjo, kur brezat e umetit islamik bëjnë sakrificë vetëmohuese nga ajo që posedojnë, qoftë edhe nëse vetë janë nevojtarë, për të lënë vakëfe, të cilat do të shërbejnë për qëllime të mira të dobishme, si për brezin e tyre, ashtu edhe për brezat pasues.

Kontributet e vakëfit në fushën e shëndetësisë kanë lënë vepra të mrekullueshme, të cilat i vëren i afërmi dhe i largëti. Janë themeluar spitale – Pimaristane²²⁹, të cilat kanë ofruar shërbime shëndetësore për pacientët; si krevate, shtretër, medikamente dhe barna të nevojshme për të sëmurët e ndryshëm. Nga të ardhurat e vakëfeve, të destinuara për spitale, sigurohet ushqim i shëndetshëm dhe i përshtatshëm për çdo pacient, sipas gjendjes tij shëndetësore, pastaj ndriçimi dhe uji i pijshëm.

Vakëfi islamik dhe roli i tij në kujdesin shëndetësor dhe psikologjik

Vakëfi ka kontribuar për avancimin e shkencës së mjekësisë, për hulumtime në lidhje me diagnozën e sëmundjeve, për zbulimin e shkaqeve të tyre dhe për gjetjen e barnave për mjekimin e pacientëve. Për këto arsye, pranë spitaleve të vakëfit janë ndërtuar si anekse sektorë për mësimdhënie, për mbajtje të ligjëratave për studentët, tryeza të hapura shkencore për takim të profesorit me studentët dhe për diskutim me ta.

²²⁹ “Pimaristan” – fjalë persishte, e përbërë nga dy pjesë: “Pimar”, që do të thotë “i sëmurë” dhe “Stan” që do të thotë “vend”. Me kalimin e kohës kjo fjalë u deformua dhe u bë “Maristan”, dhe pasi që shqiptohej për çdo spital në përgjithësi, më vonë njerëzit filluan ta përdorin vetëm për spitalin e sëmundjeve mentale.

Përkrahja ishte themel për kujdesin shëndetësor të pacientëve nga të gjitha shtresat e shoqërisë. Ajo nuk ishte e kufizuar vetëm për pacientët e shtrirë në Pimaristan, por i përfshinte edhe të sëmurët e varfër në shtëpitë e tyre, të cilët i shëronin dhe, gjithashtu, iu ofronin ilaçe, ushqim e pije. Vakëfet e kanë hequr edhe koston e pagesave të pagave të profesorëve të mjekësisë dhe të studentëve të tyre.

Vakëfet shëndetësore nuk janë kufizuar vetëm në kujdesin e pacientëve për nevojat e tyre për mjekim trupor, por, përtej kësaj, janë kujdesur edhe për mjekim shpirtëror, kështu që u caktuan vakëfe për shoqërimin e të sëmurëve, për futjen e gëzimit në shpirtrat e tyre dhe për ngritjen moralopsikologjike, pasi që këto kanë ndikim të madh në shpejtësinë e shërimit.

Disa u specializuan për ngushëllimin e baballarëve dhe nënave, të cilët i kanë humbur fëmijët, për sigurimin e ilaçit më të mirë për shpirtrat e tyre, për qetësimin e shpirtrave duke ua kujtuar shpërblimin e Allahut për durimin dhe ngushëllimin, si dhe duke i udhëzuar në vepra prej të cilave i vdekuri i tyre ka më shumë dobi, siç është lutja, lëmosha, durimi dhe shpresa.

Vakëfi ka kontribuar edhe në kujdesin social të pacientëve, duke paguar shuma parash për mbajtjen e familjeve të tyre gjatë kohës së mjekimit. Ndërsa, pas shërimit, nga të ardhurat e vakëfit atij i jepen mjete për veshmbathje dhe për alokimet financiare, në mënyrë që mos të detyrohet të punojë gjatë periudhës së rimëkëmbjes, veçanërisht nëse mjekimi i tij ka pasur nevojë për ndërhyrje kirurgjike.

Vakëfi e ka ruajtur nderin e pacientit si të gjallë, ashtu edhe të vdekur, kështu që ai ka ndarë një pjesë nga të ardhurat e vakëfit të kursyera për Pimaristan, si bankë për përgatitjen dhe varrimin e të vdekurve, pavarësisht nëse kanë qenë nga pacientët e Pimaristanit, apo prej atyre që kanë vdekur në shtëpitë e tyre pranë familjarëve.

Me institucionet dhe ndërmarrjet e tij – Pimaristani – ka realizuar një qëllim të madh prej qëllimeve të shariatit, e ai është mbrojtja e shpirtit njerëzor duke i siguruar ushqim, pije, veshmbathje, strehim dhe kujdes mjekësor. Kujdesi shëndetësor është prej domosdoshmërive për ruajtjen e shpirtit njerëzor. Andaj, vakëfi ka ndihmuar në gjetjen dhe kujdesin e gjithë asaj që ka lidhje me ruajtjen e shëndetit të njeriut.

Nuk ka asnjë dyshim se vakëfi ia ka lehtësuar barrën shtetit, duke i hequr shpenzimet për ndërtimin e spitaleve, barnatoreve dhe laboratorëve, gjë që janë zvogëluar shpenzimet shtetërore në sektorin e shëndetësisë, për t'i kryer detyrimet e ngarkuara në mënyrë më të plotë.

Spitali i parë në islam, ndoshta, është themeluar që në kohën e Velid bin Abdulmelikut, i cili ka qenë spital i veçantë për të lebsur dhe aty ka pasur mjekë të cilëve u është siguruar furnizimi. Pastaj, ka vazhduar ndërtimi i spitaleve, të cilat njiheshin me emrin ‘Pimaristane’, ose shtëpitë e të sëmurëve.

Në vijim po e paraqesim një përmbledhje e shkurtër të modeleve të vakëfeve, të cilat i ka dokumentuar historia dhe kanë luajtur rol të madh në kujdesin shëndetësor e psikologjik të pacientëve të dhe familjarëve të tyre.

Pimaristani (spitali) organik në Bagdad

Pimaristani organik në Bagdad, i themeluar në vitin 366 h. – 976 m., ka qenë spitali ku kryhej mjekimi falas për të gjithë. Aty pacienti, në kuadër të mjekimit dhe kujdesit spitalor, merrte rroba sterile të pastra, ushqime të ndryshme dhe ilaçe të nevojshme, kurse pas shërimit të sëmurit i jepeshin edhe shpenzimet e udhëtimit që të ishte në gjendje të kthehej në vendin e tij.²³⁰

Ibn Xhubejri, në “*Rihlen*” e tij, përmend se kur kishte ardhur në Bagdad, e kishte gjetur një lagje, e cila emërtohej si ‘Tregu i Pimaristanit’. Të gjitha objektet dhe ndërtesat e saj ishin vakëf për mjekimin e të sëmurëve dhe ajo lagje dukej si një lagje mjekësore. Kjo lagje ishte kibël për çdo të sëmurë, pasi që aty gjendeshin studentë të mjekësisë, mjekë dhe farmacistë, të cilët e kishin marrë mbi vete detyrën e ofrimit të shërbimeve mjekësore si kompensim për shërbimet dhe furnizimin që merrnin aty nga mjetet e vakëfit.”²³¹

Vakëfi për shoqërimin e pacientëve dhe të huajve

Ky ishte një vakëf prej të cilit financohej një numër i myezinëve, që kishin zë të bukur dhe performansë të mirë. Ata performonin kaside fetare gjithë natën, në mënyrë që secili prej tyre këndonte nga një orë, deri në agim, duke u përpjekur ta lehtësonin pacientin, të cilin nuk kishte kush ta lehtësonte dhe ta shoqëronin të huajin, të cilin nuk kishte kush ta shoqëronte.

²³⁰ *Revai’ul Evkaf*, Ragib Es Serxhani, fq. 95, duke cituar nga *Ujunul Ebna fi Tabekatil Etibba’*, Ibn Ebi Usajbi’a, 1/67.

²³¹ Shih: Ibn Xhubejri: *Rihletu Ibni Xhubejri*, fq. 285.

Vakëfi për inspirimin e pacientit për shërim

Ky është një vakëf, i cili, në kuadër të funksioneve mjekuese në spitale, kishte edhe një funksion, e ai është caktimi i dy infermierëve që do të qëndrojnë afër pacientit, në atë mënyrë që ai i dëgjon por nuk i sheh dhe njëri prej tyre i thotë shokut tij: “Çka tha mjeku për këtë pacient?” I dyti përgjigjet: “Mjeku po thotë: Ai është mirë, ka shpresë për shërim, në sëmundjen e tij nuk ka diçka për shqetësim apo mërzitje. Ndoshta do të ngrihet nga shtrati i sëmundjes pas dy apo tri ditëve.”

Kjo është një formë e inspirimit shpirtëror për pacientin që pothuajse e shëron dhe e fiton mirëqenien.

Pimaristani i Madh i Dritës në Damask

Këtë Pimaristan e themeloi sulltani dhe mbreti i drejtë, Nurudin Esh Shehidi, në vitin 549 h., - 1154 m., nga paratë që i kishte marrë haraç nga një mbret evropian. Ndërtesa e tij ishte një ndër spitalet më të bukura të ndërtuara në të gjithë vendin dhe ishte i kushtëzuar vetëm për të varfrit dhe nevojtarët.

Pimaristani i Madh i Dritës konsiderohet një nga monumentet më të famshme arabe islame ekzistuese, jo vetëm në qytetin e Damaskut, por në mbarë botën islame, pasi që ende ruan shumë elemente arkitekturale, dekorative dhe të shkruara. Ai merret si shembull i gjallë që pasqyron progresin shkencor dhe kulturor të arabëve myslimanë.

Ai gjendet në mes të qytetit të vjetër të Damaskut, në rrugën që e mban emrin e tij, të zonës së djegur, në jugperëndim të Xhamisë Emevite, kah gjysma jugore e tregut “Hamidije”, afërsisht rreth 100 metra. Pimaristani i Madh ka ekzistuar deri në vitin 1317 h. Thuhet se që nga ndërtimi i tij, në të kurrë nuk është fikur zjarri. Fama e tij është përhapur aq shumë, aq sa konsiderohet prej universiteteve të para mjekësore në Lindje.

Pimaristani i Dritës ka qenë një institucion urban dhe stacion humanitar për të gjithë njerëzit. Mjetet e diagnostikimit, parandalimit dhe mjekimit në të, flasin me qartësi për madhësinë e qytetërimit tonë. Për të gjitha këto, ai ishte një monument përkujtimi i gjenialitetit arab dhe islam.

Pimaristani i mirësisë

Këtë Pimaristan e themeloi sulltan Salahuddin El Ejjubi, pasi që e çliroi Kudsën dhe Mesxhidi Aksanë nga nënshtrimi kryqtar dhe u quajt “Pimaristani i mirësisë”, që ta kthente jetën në Kuds. Sulltani i la vakëf edhe disa troje, pastaj e pajisi me ilaçe dhe medikamente. Aty edhe studiohej mjekësia, krahas ushtrimit praktik të saj.

Pimaristani Kalavun – “Spitali el Mensurij”

Spitali i Madh El Mensurij, i njohur si “Pimaristani Kalavun”, ishte pallati i disa emirëve, por mbreti El Mensur Sejfuddin El Kalavun, në vitin 783 h. – 1284 m. e shndërroi në spital, pastaj ia la një vakëf që i sjell të ardhura 1000 dërrhemë në vit, ia bashkëngjiti edhe një xhami, një shkollë dhe një mejtep për fëmijët jetimë. Ky spital merrej si model organizimi dhe rregulli. Hyrja në të dhe përfitimi prej tij ishte i lejuar për të gjithë, femra dhe meshkuj, të lirë dhe robër, sundues dhe të sunduar. Kur pacienti lëshohet prej tij, pas shërimit, i jepën veshmbathje, ndërsa atij që vdes, i përgatitet xhenazja, mbështillet me qefin dhe varroset. Aty ka të punësuar punëtorë dhe shërbëtorë, të cilët iu shërbejnë pacientëve dhe kujdesen për ta. Për çdo pacient kujdesen nga dy persona. Secili pacient e ka një krevat dhe një shtrat të plotë. Ky spital ka bërë punë madhështore. Disa mjekë, të cilët kanë punuar aty, kanë treguar se, për çdo ditë, aty kanë hyrë të sëmurë, janë mjekuar dhe kanë dalë nga katër mijë njerëz. Pacienti pas shërimit, nuk lëshohet prej aty, derisa t’i jepet veshmbathja dhe shpenzimet e udhëtimit, në mënyrë që mos të detyrohet të kërkojë punë menjëherë pas daljes nga spitali.

Ne do të vazhdojmë këtu – ndryshe nga zakoni i përmbledhjeve – që të notojmë mbi hapësirën e këtij vakëfi të çuditshëm shëndetësor, të shohim se çka thuhet në Vakëfnamen e këtij spitali madhështor, siç e ka theksuar autori i *Historisë së Pimaristaneve në Islam*, duke thënë: “Mbikëqyrësi do të shërbehet nga të ardhurat këtij vakëfi për nevojat e pacientëve me parfume për çdo ditë, me enë porcelani të portretizuara me ushqime, me kupa dhe gota qelqi me portrete të pijeve, me kënata uji dhe ibrik nga qeramika, me vazo porcelani, me vaj për djegie, me ujë nga lumi Nil, të portretizuara me ushqime dhe pije. Mbikëqyrësi shumë e këtyre e shpenzon nga të ardhurat e këtij vakëfi, pa bërë shpenzime apo dëmtime, pa shpenzime të mëdha, por edhe pa e tepruar përtej nevojave. Të gjitha këto i bën për aq sa e lyp nevoja për të fituar shpërblim.

Mbikëqyrësi në këtë vakëfi paguan dy njerëz myslimanë të cilësuar me fetari (devotshmëri) dhe besnikëri. Njëri prej tyre është arkëtar që bën shpërndarjen. Ai i shpërndan pijet, ilaçet e lëngëta (për sy), barishtet, pastat, yndyrat dhe supostet. Ai ka autorizim që këto t'i shpenzojë nga administruesit. Ndërsa personi i dytë, që është i besueshëm, për çdo mëngjes dhe mbrëmje i merr gotat me pije të caktuara për pacientët me çrregullim mendor, burra dhe gra, që janë të shtruar në këtë Pimaristan, pastaj ua shpërndan dhe secilit ia jep ta pijë barin përkatës sipas përshkrimit që i është bërë...

Mbikëqyrësi nga të ardhurat e këtij vakëfi bën pagesën e mjekëve të emëruar, si ata që merren për natyrën e sëmundjeve, okulistë e kirurgë, sipas kohës dhe nevojës që kërkon pacienti. Ai është i lirë ta zgjedhë mjetin, nëse aty nuk ka dëmtim apo padrejtësi. Ata në këtë Maristan (çmendinë) i mjekojnë pacientët me çrregullim mendor, burra dhe gra, bashkërisht dhe me ndërrime, që i caktojnë vetë ata me marrëveshje ose me leje të mbikëqyrësit. Ata e pyesin secilin pacient për gjendjen e tij, çka ka të re në sëmundjen e tij shtesa apo mangësi, pastaj secilit pacient ia shënojnë në kartonin e tij terapinë me ushqim, pije dhe medikamente që duhet t'i marrë sipas saj. Ata janë të detyruar të bujnë në Maristan, qoftë bashkë, qoftë me ndërrime. Mjekët okulistë qëndrojnë në këtë Maristan për mjekimin e syve të pacientëve të sëmurë nga oftalmia. Ata e bëjnë mjekimin edhe të gjithë myslimanëve që vijnë në këtë Maristan për mjekimin e syve dhe nuk refuzohet asnjë mysliman me oftalmi që vjen për mjekim për çdo ditë. Mjekët i mjekojnë ata dhe i trajtojnë me dashamirësi. Ata i shoqërojnë pacientët nga oftalmia dhe, nëse ndonjëri prej tyre ka ndonjë plagë (dregëz) apo sëmundje në sy, që okulisti mendon se duhet ta shohë natyralisti, ai e sjell aty dhe e shoqëron pandërprerë dhe e viziton gjatë kohës së përmirësimit dhe shërimit...

Pasi të shërohen dhe të këndellen, pacientëve të trajtuar në këtë Pimaristan të bekuar, mbikëqyrësi nga të ardhurat e vakëfit të përmendur, iu jep veshmbathje të zakonshme, sipas gjendjes së tyre, për të mos shkaktuar ndonjë vështirësi shtesë për pacientët dhe interesat e tyre. Të gjitha këto, mbikëqyrësi i realizon sipas asaj që mendon se është më e përshtatshme dhe më e nevojshme. Mbikëqyrësi në këtë vakëf duhet ta ketë parasysh devotshmërinë ndaj Allahut, fshehtas dhe publikisht, të mos e favorizojë prestigjiozin ndaj të dobëtis, as të fortin ndaj më të dobëtis, as të afërmin ndaj të huajit, por përparësi në shpenzime t'i jepet rritjes të shpërblimit dhe afrimit tek Zoti i zotëve.”

Spitalet, në përgjithësi, dyert e tyre i hapnin për mjekimin e popullatës, falas për të gjithë pa dallim, i pasur apo i varfër, i afërm apo i largët. Ato ndaheshin në dy pjesë: pjesa për meshkuj dhe pjesa për femra. Mjekët aty punonin me ndërrime. Secili mjek e kishte orarin e caktuar dhe katin e caktuar ku i mjekonte pacientët. Secili spital ka numër të caktuar të past-ruesve (meshkuj dhe femra), infermierëve dhe ndihmësve. Të gjithë ata kanë paga të mjaftueshme. Në secilin spital kishte barnatore, e cila quhej ‘depoja e pijeve’, por spitalet kishin edhe institute mjekësore. Çdo spital kishte amfiteatër të madh për ligjërata. Ky ishte sistemi që ka dominuar në spitalet e botës islame për më shumë se dhjetë shekuj, pavarësisht a kanë qenë në Perëndim apo në Lindje, në spitalet e Bagdadit, Kajros, Kudsit, Mekës, Medinës, Magrebit apo Andaluzisë.

Spitali i Merakeshit

Ai është një ndër spitalet më të dalluara të Marokut, të cilin e kishte themeluar El Mensur Ebu Jusufi, pasi ia kishte zgjedhur një pozitë të veçantë me një pamje që ta qetëson shpirtin. Pastaj kishte urdhëruar që hapësirat të mbillen e të bëhen kopshte. Që dritaret e dhomave të pacientëve të kenë pamje në ato pemishte frutore nga të gjitha llojet që i dëshiron shpirti. Aty kishte sjellë ujëra dhe në tokën e spitalit kishte ndërtuar pishina me mermer të bardhë. Për secilin pacient kishte caktuar rroba të ditës dhe të natës. Nuk e kishte kufizuar (të drejtën e mjekimit) vetëm për të pasur, duke i privuar të varfrit, por ai ishte për të gjithë njerëzit, të afërm e të largët, të njohur e të panjohur.

Pyetja jonë: Vallë, si ishte kujdesi mjekësor në Evropë, atëherë kur spitalet tona ishin kaq të specializuara, të sofistikuara dhe njerëzore?! A nuk ishin të humbura në errësirë? A nuk ishin të tilla, që nuk njihnin saktësi as pastërti, e të mos flasim për shkencat mjekësore dhe farmaceutike!?

Gjendja e spitaleve, atëbotë, në Evropë

Orientalisti gjerman Max Meyerhof, e përshkruan gjendjen e spitaleve në Evropë, në kohën kur në Lindjen islame ishte, siç u theksua më lart, me këto fjalë: “Vërtet spitalet arabe dhe sistemet shëndetësore në vendet islame, sot na japin një leksion të ashpër e të hidhur dhe ne nuk mund t’i vlerësojmë drejt, përveç nëse e bëjmë një krahasim të thjeshtë me spitalet evropiane të po asaj kohe.”

Kurse Dr. Mustafa Es Sibai, në librin “*Min revai’ hadaretina*” (*Kryeveprat e qytetërimit tonë*), thotë: “Deri në shekullin XVIII (v. 1710), të sëmurët mjekoheshin në shtëpitë e tyre, ose në shtëpi të posaçme. Para asaj kohe spitalet evropiane ishin si shtëpi bamirësie, si strehimore për të pastrehë, qofshin ata të sëmurë, qofshin të paaftë. Ne kemi qenë para perëndimorëve në rregullimin e spitaleve së paku për 9 shekuj. Spitalet tona kishin një pasion fisnik të pashembullt në histori, të cilin perëndimorët nuk e njohin as sot.”

EL VAKF ES SIHHIJ, ENVAUHU VE ISTITHMARATUHU

Dr. Sulejman bin Xhasir El Xhasir (1:25:42)

KEJFE TUESSISU VAKFEN MUMEJJEZEN?

Dr. Sulejman bin Xhasir El Xhasir (37:21)

Shoku ynë “numërori”,²³² miku fisnik në duart e pacientit dhe të familjarëve të tij

I sëmuri dhe familjarët e tij duhet të trokasin në derën e Allahut të Plotfuqishëm dhe të kërkojnë shërim, posaçërisht në 1/3 e fundit të natës. Secili duhet ta bëjë këtë me nënshttrim dhe përulje para Allahut të Plotfuqishëm, duke mos u mbështetur në forcat e veta, por vetëm në forcën e të Plotfuqishmit, i mërzhitur dhe me prani të zemrës gjatë lutjes, duke u drejtuar kah Kibla, duke filluar me lavdërim e falënderim Allahut, pastaj me salavate për Pejgamberin, s.a.v.s., dhe duke mos nxituar në përgjigje, sepse Allahu i dëgjon lutjet dhe iu përgjigjet.

Ligjshmëria e tespihut me numëror e të ngjashme

“Nuk ka asgjë të keqe nëse myslimani e bën tespihun apo dhikrin me të ashtuquajturat rruaza, guralecë, apo bërthama. Këtu bën pjesë edhe numërimi manual. Pra, ato i zëvendësojnë tespihet apo bërthamat në bërjen dhe numërimin e dhikrit.”²³³

Shejhul Islam Ibni Tejmije thotë: “Numërimi i tespihut me gishtërinj është sunet... ndërsa numërimi me bërthama, guralecë, apo gjëra të ngjashme është i mirë (hasen). Ka pasur edhe sahabë që kanë vepruar kështu. Pejgamberi, s.a.v.s., e kishte parë nënën e besimtarëve h. Ajshen r.a. duke bërë tespih me guralecë dhe e kishte miratuar. Transmetohet se edhe Ebu Hurejre kishte bërë tespih në këtë mënyrë. Ndërsa tespihun me të ashtuquajturat rruaza të sistemuara e të ngjashme, disa njerëz e urrejnë, por nëse me të është qëllimi i mirë, atëherë ai është i mirë dhe nuk është i urryer. Ndërkaq, marrja e tyre pa nevojë, apo paraqitja para njerëzve, si: varja në qafë, apo bërja e tyre si byzylyk në dorë, e të ngjashme, kjo bëhet për syfaqe para njerëzve, ose si supozim pa nevojë i ngjashëm me

²³² Me shprehjen *numëror* këtu është për qëllim një mjet i vogël elektronik, të cilin përdoruesi e përforcon në gishtin e tij. Atë e quajnë me emra të ndryshëm, disa e quajnë “tesbih elektronik”, e disa edhe “tesbih unazë”.

²³³ Fetvaja nr. 18408, Qendra për Fetva pranë Menaxhmentit për Thirrje dhe Udhëzime Fetare, në Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Islame, Katar.

syefaqësinë. Me këtë rast, veprimi i parë është i ndaluar (haram), ndërsa i dyti të paktën është i urryeshëm (mekruh)...”²³⁴

Ekziston edhe një dimension tjetër i përdorimit të numërorit, se ai është ndihmës i mirë për rregullimin e dhikrit dhe sisteminin e tij mes: tes-pihut (lavdërim), tehilit (shprehjes: La ilahe il-lallah), tekbirit (shprehjes: Allahu ekber), tahmidit (shprehjes: elhamdilil-lah), havkales (shprehjes: La havle ve la kuvete il-la bil-lah, “Gjithçka është në dorë të Zotit të Madhëri-shëm!”), dy shehadetave dhe llojeve tjera të dhikrit që ka në dispozicion. Për të gjitha këto, përdorimi i numërorit e ndihmon dhe lehtëson realizimin e dhikrit për Allahun me të gjitha llojet dhe me numër më të madh të tyre.

Vlera e istigfarit (kërkimit të faljes)

Shumica prej nesh e di vlerën e istigfarit dhe shpërblimin e njerëzve që bëjnë istigfar. Ne të gjithë kemi nevojë për të, sidomos i sëmuri, i cili është në sprovë nga Allahu i Plotfuqishëm për të Cilin ka shumë nevojë, që t’ia largojë dhimbjet dhe vuajtjet. Allahu i Plotfuqishëm thotë:

“Kërkoni falje nga Zoti juaj dhe kthehuni tek Ai, e Ai do t’ju sjellë shi të begatshëm dhe do t’ju shtojë fuqinë mbi fuqinë tuaj...”²³⁵

Pejgamberi, s.a.v.s., ka urdhëruar që istigfarin ta bëjmë në mënyrë permanente, duke thënë:

“O njerëz, kërkoni falje Allahut dhe pendohuni tek Ai, sepse unë i kërkoi falje Allahut dhe pendohem tek Ai 100 herë në ditë!”

Pejgamberi, s.a.v.s., gjithashtu, ka thënë:

*“I lumi ai (tuba), i cili gjen në regjistrin e (veprave të) tij shumë istigfar!”*²³⁶

Për fjalën “tuba” (‘i lumi ai’), ka disa interpretime. Kështu, sipas Ibni Ebi Talha-s nga Ibni Abbasi, kjo fjalë do të thotë: “Gëzim dhe dritë e syrit”. Sipas Ikrimes, do të thotë: “Lum për atë që kanë”. Kurse Dahaku thotë: “Kënaqësi dhe gëzim për ta.” Ndërsa Ibrahim En Nah’ij thotë: “Është mirë për ta”.

Nga ana e tij, Katade thotë: “Ajo është fjalë arabe, kur ia thua dikujt, sikur t’i ke thënë: “Të ka kapluar e mira.” Në një transmetim tjetër thuhet: “Kjo fjalë e ka domethënien ‘mirë për ta’.” Ali bin Ebi Talibi r.a. thoshte:

²³⁴ *Mexhmu’ul fetava (Përmbledhje e fetvave)*, 22/506.

²³⁵ Surja Hud, 52.

²³⁶ Transmeton Ibni Maxhe, hadithi nr. 3818.

“Është çudi me atë që vdes dhe me vete e ka shpëtimin!” I thanë: Çka është ai? Tha: “Istigfari.” Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Tuba” është një pemë në xhenet në largësi prej 100 vjet, nga lulet e saj prodhohen rrobat e banorëve të xhenetit.”

Ne të gjithë e dimë, me siguri, se djajtë asnjëherë nuk ia dëshirojnë të mirën as të sëmurit, as dikujt tjetër. Andaj, djalli e impresionon njeriun, e tundon dhe e poshtëron në mendimin dhe mendjen e tij, pastaj e largon nga të gjitha të mirat dhe nga çdo gjë ku është mirësia e fesë dhe e kësaj bote. Djajtë angazhohen që përmes dinakërisë dhe mashtrimit t’i largojnë njerëzit që të mos kërkojnë shërim me rukje, me lutje, me dhikër dhe me istigfar – në mënyrë që mos të marrin shpërblim as shpërblesë nga Allahu i Plotfuqishëm.

Kjo ishte vetëm një parathënie për të qartësuar sesa shumë ne kemi nevojë për dhikër, tespih dhe istigfar që të fitojmë shpërblim dhe shpërblesë nga Allahu i Plotfuqishëm.

Me të vërtetë, jeta e të sëmurit dhe gjendja e tij psikologjike është nën disa efekte, të cilat mund të kenë ndikim pozitiv, por edhe mund t’i kthehen negativisht. Nëse ai i kthehet Allahut, bën istirxha’, e përmend Allahun vazhdimisht, kërkon prej Tij falje dhe shërim, atëherë ai do të gjejë rahatit dhe qetësi. Andaj ne po shohim – por Allahu e di – se numërori që është bërë i njohur për të gjithë, na përkujton, si neve ashtu edhe të sëmurit, dhikrin, na përkujton shfrytëzimin e tërë kohës për dhikër, për të fituar shpërblime dhe për t’i shlyer mëkatet dhe të këqijat. Aty kemi dhikër të përhershëm për Allahun: **“E, me të vërtetë, kur të përmendet Allahu, zemrat qetësohen!”** Në këtë mënyrë, njeriu është në lidhje me Zotin e tij, beson në urdhrin dhe caktimin e Tij, e qetëson zemrën me dhikër të shumtë dhe të ndryshëm. Dhe kjo ia kujton të sëmurit nevojën e dhikrit në rastin kur ai e ndjen praninë e tij në gisht, kështu që zemra mbetet e lidhur me përmendjen e Allahut. Atëherë, ose do të ketë shërim nga sëmundja, ose shpërblim tek Allahu në Ditën kur do ta takojnë të sëmuret dhe të shëndetshmit.

E këtillë është edhe gjendja e Abdullahut r.h. Ai ishte i durueshëm dhe i kënaqur me caktimin (kadanë dhe kaderin) e Allahut, duke shpresuar nga Allahu faljen dhe xhenetin si shpërblim për durimin e sëmundjes dhe shpërblesë për dhikrin ndaj Zotit tij.

Te mëshira e Allahut, të Mëshirshmit, Mëshirëplotit... te takimi në Shtëpinë e falënderimit, me lejen dhe mëshirën e Allahut.

Përgjigje ndaj djallit bezdisës ('el-vesvas', 'el-hannas')²³⁷

Prej sprovave më të rënda, që i përjeton njeriu, kur ndonjë të dashur të tij e godet sëmundje e rëndë, është se atij i vjen djalli, i cili i pëshpërit mendime, me çka synon t'ia heqë pëlqimin në kada dhe kader dhe durimin ndaj fatkeqësisë, si dhe t'ia humbë shpresën në mirësinë e mëshirën e Allahut të Plotfuqishëm.

Imami El Izz bin Abdusselam e ka prekur qëllimin e fjalëve 'el-Vesvas' dhe 'el-Hannas', në tefsirin e tij të sures 'en-Nas', ku thotë: "El-Vesvas" është cytja (vesvesja) e njeriut që i ndodh në veten e tij, të cilën ia fal Allahu, por djalli ia vërsul në zemër të birit të Ademit, nëse ai është i pakujdesshëm dhe harron. Kur e përmend Allahun e Plotfuqishëm, ai fshihet. Kurse 'El-Hannas' është djalli, sepse fshihet shumë, siç thuhet në Kuran: **"Beto hem në yjet që tërhiqen (ditën, e ndriçojnë natën)."** Pra, yjet për shkak të fshihjes së tyre, kurse djalli me cytje i devijon nga udhëzimi, ose me cytje i nxjerr nga bindja.

Për këtë shkak, Allahu i Plotfuqishëm na ka urdhëruar që të kërkojmë mbrojtjen e Tij nga nxitjet e djajve, madje edhe nga prania e tyre në mënyrë të përgjithshme. Këtë e hasim në këto dy ajete kuranore:

"Dhe thuaj: "O Zoti im, te Ti mbështetem për mbrojtje nga nxitjet e djallit, - dhe te Ti mbështetem, o Zoti im (për mbrojtje), nga prezenca e tyre (djajve) pranë meje".²³⁸

Nganjëherë djalli vjen dhe të nxitë për të thënë (kërkoj falje nga Allahu për këtë fjalë!): "Përse pikërisht ti je goditur me këtë sprovë, e jo dikush tjetër?! Përse pikërisht djali yt, që është loçka e zemrës tënde dhe mbështetja jote në këtë jetë?! A ti dhe djali yt jeni kaq të papërfillshëm për Allahun?!"

Me atë rast, patjetër duhet ta mbyllësh derën para djallit, patjetër duhet të lexosh shumë Kuran, ta ndjekësh shembullin e Pejgamberit, s.a.v.s., të cilit i vdiq djali i vetëm Ibrahim, por ai nuk u tregua i padurueshëm dhe

²³⁷ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 20. 12. 2015.

²³⁸ Surja el-Muminun, 97-98.

nuk e humbi besimin, vetëm qau me sy e u pikëllua me zemër, por nuk tha asgjë, përveçse me çka është i kënaqur Zoti, siç e është e ditur nga hadithi i njohur në kapitullin përkatës.

Vëlla, në fatkeqësi, duhet ta përkujtosht, se si Ibrahim i a.s. është sprovuar me fatkeqësi edhe më të madhe se ti, ndonëse ai ishte i dashuri i Allahut dhe babai i pejgamberëve. Atë Zoti e urdhëroi që ta therte djalin e tij dhe ata të dy menjëherë iu përgjigjen urdhrit, të kënaqur dhe me zemër të qetë. Fëmija është prej begative të Allahut dhe duhet t'i kthehet në çdo kohë. Ai nuk është pasuri e imja, as e jotja, as e askujt tjetër përveç Allahut.

Këto kuptime duhet t'i sjellësh ndër mend dhe me to të mbrohesh nga djalli bezdisës, i cili nuk dëshiron të jesh i qetë, derisa ta sigurojë për ty zjarrin – Allahu na ruajt!

Madje, duhet t'i përgjigjesh, me gjërat e kundërta me dëshirën e tij, aq sa të digjet nga inati se ti ke siguruar, në vend të ulëses nga zjarri, një pallat në xhenet, me lejen e Allahut. Se Allahu të ka shikuar ty dhe të ka gjetur duke bërë durim, duke llogaritur në shpërblimin e Tij, duke bërë shumë dhikër dhe duke shpresuar që Ai të jetë i kënaqur me ty.

O Allah, largona prej nesh djallin bezdisës, forcona zemrat në kënaqësinë Tënde, lehtësona shqiptimin e shehadetit para vdekjes, qoftë edhe vetëm me zemër.

Shkenca mjeko-ligjore dhe ndikimi i saj në parandalimin nga tundimi dhe yshtja te pacienti

Allahu i Madhërishëm thotë në Kuran:

“Kur t’iu vijë atyre ndonjë lajm i rëndësishëm që i përket sigurisë ose frikës, ata e përhapin atë, por në qoftë se ata këtë lajm ia përcjellin Pejgamberit dhe parisë (bashkëpunëtorëve të afërm të tij) do ta kuptonin prej tyre vetëm atë që dëshirojnë ta marrin vesh. Sikur të mos ishte mirësia e Allahut dhe mëshira e Tij, përpos një numri të vogël, ju të gjithë do të ndiqnit djallin.”²³⁹

Allahu i Plotfuqishëm urdhëron që në situatat e trazirave dhe sprovave t’iu kthehemi dijetarëve dhe fetarëve, sepse makinacionet më të mëdha djalli ua bën njerëzve të dhënë pas pasioneve, ekstremizmit dhe kryengritjes. Ai ua zbukuron atyre ndjekjen e pasioneve, veprimin krye në vete dhe keqkuptimet ndaj fesë. Gjithashtu, i largon njerëzit nga kthimi te dijetarët, që të mos i udhëzojnë dhe t’ua tregojnë të vërtetën, por të ngelin në prapësinë dhe humbjen e tyre. Allahu i Madhërishëm thotë:

“...Mos shko pas pasionit tënd, se ai të largon nga rruga e Allahut...”²⁴⁰

Yshtja e djallit ia shton pacientit qëndresën dhe besimin në Allahun e Plotfuqishëm

Besimtari sprovohet me yshtjen e djallit dhe monomaninë (yshtjen e djallit) e mosbesimit, të cilat e shqetësojnë atë, siç kanë thënë sahabët: “O i dërguari i Allahut, (ndo) njëri prej nesh gjen në vete diçka, që rënia e tij prej qiellit në tokë është më e dashur sesa ai të flasë diçka prej saj (yshtjes).” Atëherë ai tha: “Ky është besimi i çiltër!” Ndërsa në një transmetim tjetër: “Krekosej kur flet prej saj.” Tha: “Falënderimi i takon Allahut, i Cili e shndërroi intrigën në yshtje, pra arritja në yshtje, edhe pse ajo është urrejtje e madhe për të dhe largim i tij nga zemra që konsiderohet çiltëri e besimit. Ashtu sikur luftëtari, tek i cili vjen armiku, e sfidon atë derisa e

²³⁹ Surja en-Nisa, 83.

²⁴⁰ Surja SAD, 26.

mposht, që është luftë më e madhe dhe çiltëri e vërtetë. Kështu është bërë i çiltër, meqë ata e urryen atë yshtje djallëzore dhe e larguan, andaj është çiltëruar besimi dhe u bë i çiltër!²⁴¹

Sa më shumë që njeriu të ketë dëshirë për dituri dhe adhurim dhe të jetë më i aftë për këtë sesa tjetri, në mënyrë që të ketë fuqi më të madhe për të, e të ketë vullnet dhe dëshirë më të plotë, këto bëjnë që Allahu ta ruajë nga djalli, sepse ajo me çka e tundon djalli, nëse mundet, është më e madhe.

Pacienti, që e ka gjendje të dobët trupore, mund të pasohet edhe me rënie morale. Ai, si i tillë, ka më shumë gjasa që ta pranojë joshjen apo tundimin e djallit, kështu që djalli e ushqen me iluzione për disa metoda të mjekimit dhe shërimit nga sëmundja, për metoda jologjore, krejtësisht larg mësimeve të fesë islame. Po ashtu, ia zbukuron ankesën, zemërimin dhe mërzitjen me caktimin e Allahut të Plotfuqishëm. Të gjitha këto, në fakt, janë nga djalli, i cili me to dëshiron ta hidhërojë njeriun dhe t'i shkaktojë brengosje e shqetësim, sepse, siç dihet, djalli është armik i njeriut dhe armiqësia e tij është shumë e vjetër. Ai është betuar se do ta fusë në rrugë të gabuar Ademin dhe pasardhësit e tij. Ai bën krejt çka ka mundësi për t'i devijuar ata nga rruga e drejtë, por a ndalet vetëm me kaq? Jo, pasha Allahun. Sepse armiqësia e tij mbështetet në urrejtje dhe xhelozë. Duke rrëfyer për Iblisin, Allahu i Plotfuqishëm thotë: Ai, ka thënë: “Vallë unë t'i bëj sexhde atij, të cilin Ti e ke krijuar nga balta?”²⁴² Pra, armiqësia është e vjetër dhe e rrënjosur. Edhe qëllimi është shumë i qartë. Djajtë kanë plane dhe metoda për joshje dhe devijim.

Disa nga metodat me të cilat djajtë e dobësojnë vullnetin e njeriut janë:

- Lënia e namazit, ose preokupimi me diçka dhe largimi nga përmendja e Allahut të Plotfuqishëm.
- Yshtja (vesvesja) dhe të menduarit e përpiktë (çrregullim i pandreqshëm).
- Pagjumësia, ankthi dhe makthet e bezdisshme.
- Zmbrapsja e pacientit nga marrja e barnave në të cilat e ka shërimin.
- Lodhja shpirtërore dhe trupore.
- Futja shkallë-shkallë në mëkate.
- Humbja e shpresës në mëshirën e Allahut.

²⁴¹ Ibni Tejmije, *Mexhmu'ul Fetava*, 7/282.

²⁴² Surja el-Isra, 61.

- Shkuarja pas magjistarëve dhe fallxhorëve.
- Zbukurimi i të këqijave dhe lehtësimi i rrugëve të mashtrimit të pacientit, derisa të dobësohet lidhja me Allahun e Plotfuqishëm.

Disa pacientëve vazhdojnë t'u vijnë djajtë me këto metoda, derisa iu dobësohet forca psikologjike, fizike dhe ajo e besimit. Kështu, pasi e humbasin mbrojtjen e besimit dhe atë psikologjike, atëherë djajtë përpiqen t'i mposhtin dhe t'u diktojnë atë që duan. Me atë rast, disa iu përgjigjen atyre, kurse disa që do Allahu i mbron. Ai që bie në turbullirat e djallit, i rrëmbehet dëshira, pëson humbje, i vështirësohet shërimi, i keqësohet gjendja, Allahu na ruajt nga e keqja e intrigave të cilat janë të dukshme dhe ato që janë të fshehura.

Myslimani i mirëfilltë karakterizohet me vullnet të fortë, sepse ai e di se vullneti i Allahut është mbi vullnetin e magjistarëve, rebelëve dhe demonëve. Allahu i Madhërishëm thotë:

“Por ju nuk mund të doni, përveç nëse do Allahu – se, Allahu, me të vërtetë, është i Plotëdijshëm dhe i Gjithëdijshëm.”²⁴³

Andaj, myslimani duhet t'i hulumtojë metodat që i ndihmojnë për mosdorëzim dëshirës së djajve dhe nuk duhet të presë derisa të përshtatet me realitetin e xhindosur dhe vazhdimin e fatkeqësisë. I sëmuri mund ta forcojë vullnetin e tij me metodat vijuese, të cilat të afërmit e tij duhet t'i përdorin dhe t'iu kushtojnë rëndësi:

Tespihu (shprehja: Subhanallah), tahlili (shprehja: La ilahe il-lallah) , istigfari (shprehja: Estagfirullah) dhe dhikri (përmendja e Allahut të Plotfuqishëm) dhe me këto të vazhdohet deri në evitimin e yshtjes.

Devotshmëria e Allahut të Plotfuqishëm, shtimi i akteve të adhurimit dhe largimi nga mëkatet. Allahu i Madhërishëm thotë: ***“...E kush i druan Allahut, Ai i bën rrugëdalje atij.”***²⁴⁴ Dhe po ashtu thotë: ***“E, kush i druan Perëndisë, Ai ia lehtëson çështjen atij.”***²⁴⁵

Ibni Kajjimi r.h., në librin *Mjekësia Pejgamberike*, thotë: “Prej mjekimeve më të mëdha të sëmundjes është veprimi i mirë, bamirësia, dhikri, lutja, nënshtrimi (Allahut), përgjërimi ndaj Allahut dhe pendimi. Të gjitha këto gjëra, kanë efekt më të madh për shtyrjen e të këqijave dhe shërimin

²⁴³ Surja el-Insan, 30.

²⁴⁴ Surja et-Talak, 2.

²⁴⁵ Surja et-Talak, 4.

sesa barnat natyrore, por sipas gatishmërinë së shpirtit, sipas pranimit të tyre dhe sipas besimit në to dhe në përfitimin prej tyre.”

Vëllai im i sëmurë, të këshilloj në këtë kontekst, si vijon:

- Shpalle rebelimin dhe mosbindjen ndaj imponimeve të djajve, si kufizimet psikologjike, mendore dhe emocionale.
- Mos e dramatizo çështjen e magjisë e të xhindosjes, dhe angazhoje veten me gjëra që bëjnë ta harrosh sëmundjen, si leximi i Kuranit, prezantimi në ligjërata, në tubime të dhikrit, mbajtja e lidhjeve me farefisin, leximi i librave të dobishëm etj.
- Guximi dhe dalja ballë për ballë me sfidat e djajve dhe kjo mund të arrihet vetëm me durim, me luftë dhe me përballje të ngjarjeve me mençuri.

Një grup i pacientëve beson se shërimi i tyre nuk mund të ndodhë, përveçse me rukje të filan shehut, andaj ti i sheh se zemrat e tyre janë të lidhura për atë njeri të dobët. Ata duhet të pendohen tek Allahu dhe ta përmirësojnë mendimin e tyre për Të, sepse Shëruesi është vetëm Allahu, Ai është i Cili e dërgon sprovën dhe po Ai është që e largon kur të dojë. Ndërsa shehu ‘shërues’ nuk e shëron askënd dhe as që ka fuqi për ta bërë këtë, por ai vetëm lexon pjesë nga Libri i Allahut me bindje dhe besim në fjalët e të Madhërishmit: **“Dhe, Ne, shpallim nga Kurani atë që është ilaç dhe mëshirë për besimtarët...”**²⁴⁶ Neve shpesh na bie të dëgjojmë se filan shehu po dergjet në shtrat për shkak të sëmundjes dhe dobësimit të shëndetit, apo se është dërguar në spital, ndërsa ditë më parë i shëronte të sëmuret! Sikur të kishte aftësi shërimi, pse nuk po e shëron vetveten?! Dhe kjo nuk do të thotë se nuk duhet të kërkojmë të bëhet rukje. Sepse nëna e besimtarëve, Aishja r.a., i kishte bërë rukje Pejgamberit, s.a.v.s., megjithatë, ai nga e njëjta sëmundje vdiq. Por ka raste në të cilat duhet të kërkohet edhe ndihma e njerëzve të mirë dhe me përvojë, pas kërimit të ndihmës nga Allahu i Plotfuqishëm.

Transmetohet nga Muadh bin Xhebeli r.a. se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë: *“Vërtet djalli është një ujk për njeriun sikurse ujku i deleve, ai e rrëmben delen që largohet dhe shmanget. Andaj ruhuni nga ndarja dhe përmbahuni bashkimit, publikut dhe xhamisë.”*²⁴⁷

Së këndejmi, në përmbyllje të kësaj teme, e cila kërkon edhe më shumë shpjegim, konstatojmë se nuk janë të mjaftueshme vetëm këto pak

²⁴⁶ Surja el-Isra, 82.

²⁴⁷ Transmeton Ahmedi, hadithi nr. 22107.

fletë. Por, kush ka njohuri nga shkenca mjeko-ligjore i drejtohet Allahut me gjithçka që Ai është i kënaqur, në mënyrë që ta tejkalojë sëmundjen dhe ta durojë këtë fatkeqësi me zemër të kënaqur në caktimin e Allahut. Mos ta humbas fenë, mos t'i ndjekë rrugët e djallit e të devijojë nga rruga e drejtë. Në fund, do ta fitojë shpërblimin e madh të cilin atij ia ka premtuar Allahu i Plotfuqishëm.

Unë e falënderoj Allahun e Plotfuqishëm, që na dhuroi një djalë, i cili ishte i kënaqur me urdhrin dhe caktimin e Allahut, që për shërimin e sëmundjes i ndoqi të gjitha rrugët e mundshme ligjore, pa indinjatë apo dëshpërim nga mëshira e Allahut, por me besim se jetëgjatësia është në dorën e Allahut. Djalli nuk gjeti rrugë për tek zemra e djalit tim, për ta devijuar nga kënaqësia e Allahut dhe nga shpërblimi i Tij për durimin me falje dhe shpërblim të bukur.

O Allah, pranoje atë tek Ti dhe bëje banor të Firdevsit të Lartë! Jepi për të pirë nga dora e të dashurit dhe të zgjedhurit Tënd, s.a.v.s., nga lumi Kevther, pas të cilit nuk do të ketë etje! Dhe na shpërble, nga kjo fatkeqësi e jona, duke na takuar me të në Shtëpinë e falënderimit.

PAJTIMI ME KADANË DHE KADERIN - Dr. Omer Abdulkafi (4:55)

DOBIA E SHPIRTIT TË QETËSUAR - Shejh Salih El Mugamisi (4:53)

Komunikimi i lindjes së vërtetë... në një mesazh telefonik²⁴⁸

Ky mesazh për mua ka një veçanti, për shkakun se përmban komunikimin e vdekjes, të cilin e konsideroj komunikim të vërtetë për lindje të re, pasi që ajo me mirësinë e Allahut, me mëshirën dhe me premtimin e Tij, përfundon në Shtëpinë e falënderimit.

Historia e tregimit fillon në mëngjesin e hershëm të datës 27 shtator 2014, kur e dha shpirtin e pastër Abdullahu i dashur r.h.

Ne, krejt familja e tij, qëndruam zgjuar tërë natën në çastet e tij të fundit dhe gati na doli shpirti edhe neve nga pikëllimi për të dhe rininë e tij, por falënderimi është për Allahun në çdo rast dhe në çdo çast.

Pasi që e zbatoi Allahu i Plotfuqishëm vendimin e Tij dhe vendimi i Tij është i pakthyeshëm, kërkova prej anëtarëve të familjes fisnike që mos ta njoftojnë askënd për vdekjen e tij, derisa ta hartoj një shkresë për vdekjen e tij siç i ka hije pozitës së tij te ne, që mos të jetë vetëm letër tradicionale e cila e përmban njoftimin e vdekjes, sepse “Abdullahu për neve është ndryshe”.

Ai meriton një njoftim që është i denjë për të dhe për vlerën e tij tek ne. Andaj, u veçova në dhomën e pritjes për disa minuta, që të shkruaj me ndihmën e Allahut, disa shprehje spontane për ndjenjat e mia dhe të gjithë neve atëkohë. Pastaj ia dhashë vëllait të madh, Nasirit, që ta njoftonte të gjithë familjen dhe dashamirët. Nuk kam pritur se për disa orë lajmi do t'i përfshijë horizontet përmes medieve sociale, Allahu e di, por ajo ishte spontane vetëm për familjen, pa paramenduar shtrirje të gjerë me mediet sociale, veçantia e saj konsiston në veçantinë e Abdullahut të dashur.

Në vijim, po paraqes tekstin e mesazhit pas vdekjes, të cilin e konsideroj si mesazh për lindje të vërtetë:

“Falënderimi i takon Allahut, i Cili zgjodhi që Abdullahu t’ua ndërtojë prindërve të tij në xhenet një shtëpi të quajtur Shtëpia e falënderimit, siç na ka premtuar përmes gjuhës së Pejgamberit të Tij s.a.v.s.

²⁴⁸ Ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 6. 12. 2015.

Transmetohet nga Ebu Sinani, i cili thotë: “E varrosa djalin tim Sinanin, kurse Ebu Talha El Havlani ishte ulur pranë varrit. Kur u nisa për të dalë, më kapi për dore dhe më tha: “O Ebu Sinan, a do lajme të mira”. Unë i thashë: “Sigurisht”. Dhe ai tha: “Më ka treguar Dahak bin Abdurrahman nga Ebu Musa el-Esh’ariu, se si Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikujt i vdes një fëmijë, Allahu i pyet melekët: A ia keni marrë shpirtin fëmijës së robit Tim?”

Ata përgjigjen: Po.

Allahu përsëri i pyet: A ia keni marrë frytin e zemrës së tij?

Melekët përgjigjen: Po.

Ai u thotë përsëri: Çka tha rob i Im?

Ata thonë: Ai të falënderoi dhe tha: Inna lil-lahi ve inna ilejhi raxhiun! (Ne jemi të Allahut dhe tek Ai do të kthehemi).

Atëherë Allahu thotë: Ndërtojani robit Tim një shtëpi në xhenet dhe quajeni Shtëpi e falënderimit.”²⁴⁹

Unë jam i sigurt me mendimin e mirë për Zotin tim, se mua dhe nënën e mëshirshme, nënën e Abdullahut, Ai do të na mirëpresë atje me premtimin, me mëshirën dhe me mirësinë e Tij. Pastaj, edhe ne do t’i mirëpresim të gjithë dashamirët tanë dhe dashamirët e Abdullahut, të cilët të pikëlluar u lutën për të dhe na mbuluan me ndjenja të bollshme e të sinqerta. Atyre iu premtojmë se nuk do t’i harrojmë në atë takimin e premtuar në Shtëpinë e respektuar.

E nderoi Allahu i Plotfuqishëm, e me të na nderoi edhe neve pak më parë, sipas kohës suaj në Kuvajt, në orën pesë të mbrëmjes, dita e shtunë, dita e tretë prej dhjetë ditëve të bekuara të muajit dhul hixhe.

Siç e përgëzoi, pa i theksuar detajet, me lehtësim të madh, të cilin e hasi Abdullahu në të gjitha fazat e sëmundjes dhe mjekimit. Çështjet e mjekimit të tij ishin lehtësuar në formë të pakrahasueshme që i ngjanin karakterit të tij të butë dhe të bukur, siç e njihni ju mirë, pa u rekomanduar nga unë, andaj dhe nuk vuajti më shumë nga sa kishte caktuar i Gjithëmëshirshmi, që ishte e mjaftueshme për t’ia shlyer mëkatet dhe për t’ia rritur gradat, me lejen e Allahut, me mirësinë dhe bujarinë e Tij, sepse Ai është Mëshiruesi më i madh.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

²⁴⁹ Transmeton Tirmidhiu, hadithi nr. 1021, Albani e ka cilësuar si *hasen*. (Shih fq. 176, nëntë transmetimet e këtij hadithi).

Falënderimi i takon Allahut, për çdo rast dhe në çdo çast.
Falënderimi i takon Allahut, i Cili nuk falënderohet me dhunë!
Të Allahut jemi dhe vetëm tek Ai do të kthehemi!”

Ose “prindi” i mirë i cili lutet për të²⁵⁰

Lexuesit në fillim mund t’i ngatërrohet çështja dhe të mendojë se në titull ka një gabim gjuhësor të qartë dhe se është ndërruar vendi i fjalës “fëmijë” me fjalën “prind”, por çështja nuk është ashtu, sepse unë kam dashur të jetë pikërisht ashtu siç është në titull. Ja në vijim sqarimi i asaj që më ka shtyrë ta bëj këtë.

Kur vdiq djali im i dashur, Abdullahu r.h., me padurim dëshiroja që t’ia bëja ndonjë mirësi pas vdekjes nga dashuria për të. Sa herë ulesha dhe mendoja për këtë, menjëherë në mendje më vinte hadithi i Pejgamberit s.a.v.s.:

“Nëse vdes biri i Ademit i ndërpritet puna e tij përveç tri gjërave: Lëmosha e vazhdueshme, lënia e diturisë prej së cilës kanë dobi dhe lënia e fëmijës së mirë, i cili bën lutje për prindërit e tij.”²⁵¹

I thashë vetes: Subhanallah! Po si është puna me prindin të cilit i vdes fëmija, a i jep Islami shans për t’i bërë mirësi fëmijës së vet pas vdekjes së tij, që të mos i ndërpritet puna e mirë nga kjo botë, siç është rasti i fëmijës kundrejt prindit pas vdekjes së tij?

Allahu i Plotfuqishëm është Mëshirues, Mëshirëbërës dhe gjithashtu është edhe i Drejtë. Andaj, nuk është e arsyeshme të nënvlerësohet e drejta e prindit i cili e ka humbur fëmijën gjatë jetës, të bëhet i prangosur nga çdo vepër që fëmijës së tij t’ia lehtësojë dhimbjet, që të angazhohet për shtimin e shpërblimit dhe të mos i ndërpritet puna në këtë botë, sikurse është rasti i babait të vdekur, i cili e lë fëmijën e mirë që lutet për të.

Pasi që Allahu i Plotfuqishëm është Drejtësi, atëherë dërgimi i pejgamberëve me shpallje është realizim i drejtësisë, siç konfirmohet nga ajeti kurranor: **“Me të vërtetë, Ne i kemi dërguar pejgamberët Tanë me argumente të qarta dhe me ta ua kemi dhënë librin dhe terezitë, (drejtësinë): që njerëzit të veprojnë drejt...”²⁵²** Dhe nuk është drejtësi të bëhet dallim mes fëmijës së mirë të cilit i vdes prindi dhe prindit të mirë të cilit i vdes fëmija gjatë

²⁵⁰ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 14. 12. 2014.

²⁵¹ Transmeton Muslimi, *Libri i testamentit*, kapitulli: *Cilat shpërblime i shkojnë njeriut pas vdekjes*, nr. 1631.

²⁵² Surja el-Hadid, 25.

jetës tij. Atëherë, është e sigurt se i Drejti ka hapur derë edhe për prindin e mirë, sikurse ka hapur për fëmijën e mirë, sepse i Lartmadhërishtmi nuk bën aspak padrejtësi.

Çështja po intensifikohej me ngulm në mendjen time, ndërkohë (pasi që) kontaktoja me disa miq të birit tim, ata më vizitonin mua dhe unë në veten time ndieja nevojë për t'i nderuar ata në nderim të djalit, andaj dëshiroja të ulesha me ta për ta ndier afërsinë e tij, meqë unë e shihja atë tek ata. Gjithashtu, në mendjen time më sillej fjalia e Pejgamberit s.a.v.s.: *“Vërtet prej mirësive më të mëdha është që njeriu t’i vizitojë të dashurit e babait të tij pas vdekjes së babait.”*²⁵³ Gjithashtu, transmeton sahabiu Malik bin Rebia Es Saidi, i cili thotë: *“Derisa ne ishim ulur te Pejgamberi, s.a.v.s., erdhi një burrë nga fisi Beni Seleme dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, a ka mbetur diçka nga bamirësia e prindërve që mund të bëj për ta pas vdekjes së tyre? Tha: “Po, lutja për ta, kërkimi i faljes për ta, përmbushja e premtimit të tyre pas vdekjes tyre, mbajtja e lidhjeve fafërisnore të cilat i mbanin ata dhe respektimi i miqve të tyre.”*²⁵⁴

Si qëndron puna kur prindi i respekton familjet e miqve të fëmijës së vdekur, si dhe kur i respekton shokët e tij?

Hulumtova për përgjigje të cilat i qetësojnë ata që janë si puna ime, që shpresojnë në mëshirën e Zotit tyre dhe e gjeta atë që isha i bindur te madhështia e Islamit, fesë së mëshirës, kështu që gjeta përgëzime të cilat nuk e lënë prindin të mërëzitur për fëmijën e tij të dëshpëruar e të pikëlluar, por e bëjnë të ngazëllyer e të gëzuar. Ja disa përgëzime të tilla, jo për numërim, por vetëm për sa për ilustrim.

1. Vërtet, lutja e prindit për fëmijën e tij është e pranueshme, pa marrë parasysh a është fëmija i gjallë apo i vdekur, duke iu referuar hadithit të Pejgamberit, s.a.v.s., në të cilin thotë: *“Tri lutje nuk kthehen mbra-pa dhe për këtë nuk ka kurrfarë dyshimi: lutja e atij që i është bërë padrejtësi, lutja e udhëtarit dhe lutja e prindit për fëmijën e tij.”*²⁵⁵ Këtu

²⁵³ Transmeton Muslimi, hadithi nr. 2552. dhe Buhariu, hadithi nr. 3664.

²⁵⁴ Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 5142. dhe Ahmed i në Musnedin e tij, hadithi nr. 3664.

²⁵⁵ Albani hadithin e cilëson *sahih*, në librin *Sahihu ve Daifu Suneni Ibni Maxhe*. Gjithashtu, ka edhe hadithe të tjera *sahih* të kësaj tematike, si p.sh. hadithi: *“Tri lutje janë të pranueshme dhe nuk refuzohen: Lutja e prindit, lutja e agjëruesit dhe lutja e udhëtarit.”* Bejhakui 3/345; Ed-Dijaul Muhtarë, 1/108, Albani e cilëson *sahih*, në Es Sahiha, nr.1797; si dhe hadithi: *“Tri lutje janë të pranueshme: e prindit, e të dëmtuarit dhe e udhëtarit.”* Ebu Davudi, nr. 1536, *Musnedi* 4/154, Albani e cilëson *sahih*, në Es Sahiha, nr.596.

theksohet lutja e prindit për fëmijën e tij, pa kufizuar që fëmija të jetë i gjallë duke jetuar, por më prioritare do të ishte pasi që fëmija të shkojë në takim me Zotin e tij. Atëherë prindi lutet me plot zemër, me sy të përplotur, me zemër të përlulur, me nënshtrim të plotë, duke shpresuar mëkatfaljen e fëmijës dhe që ai të banojë në xhenetet e gjera, të martohet me hyri symëdha, si kompensim për mosmarrtesë me një nuse të kësaj bote, pasi që vdekja e gjeti në mes këtyre dyjave.

2. Vërtet, lutja nga e cila përfiton i vdekuri nuk kufizohet vetëm për fëmijën e mirë, por shtrihet dhe i përfshin të gjithë myslimanët. Argument për këtë është lutja të cilën preferohet ta bëjnë të gjithë myslimanët për vëllezërit e tyre që iu kanë paraprirë me besim deri në Ditën e Kiametit, në ajetin: **“Edhe ata që vijnë pas tyre – thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve; O Zoti ynë, Ti je, me të vërtetë, i mirë dhe mëshirues!”**²⁵⁶

Pastaj, edhe vetë koncepti i fëmijës së mirë zgjerohet dhe përfshin djalin dhe vajzën, madje edhe çdo dashamir të të ndjerit, po qoftë edhe njëri nga prindërit ose të afërmit e tij. Dijetari i shquar Abdulaziz bin Abdullah bin Baz r.h. konsideron se prindi i vdekur përfiton nga lutja e fëmijës së mirë, siç përfiton gjithashtu edhe nga lutja e myslimanëve. Andaj, nëse për të luten vëllezërit e tij, ose japin lëmoshë, ai përfiton nga kjo.²⁵⁷

Kufizimin që të flitet dhe të përmendet ekskluzivisht vetëm fëmija i mirë, pavarësisht pranimit të lutjes së çdo myslimani të mirë për të vdekurin, pa u ndalur në lidhjen familjare apo tjetër, e ka interpretuar Imami Es Subki, i cili ka thënë: “Dobia e kufizimit për fëmijën, pavarësisht pranimit të lutjes edhe nga një tjetër, shërben për nxitjen e fëmijës që të bëjë lutje.” Do të thotë, qëllimi është që, pikërisht, fëmija të nxitet për t’u lutur për prindin e tij, në mënyrë që jeta mos ta shpëtojë nga lutja, sepse ai është më i thirruri nga njerëzit për të bërë lutje për prindin e tij.²⁵⁸

3. Bamirësia e njeriut ndaj vëllait tij njeri, është mirësia të cilën e ka urdhëruar feja, andaj nuk duhet të ndalemi vetëm në pjesën e dukshme të disa teksteve pa u zhytur në qëllimet e tyre dhe pa i

²⁵⁶ Surja el-Hashr, 10.

²⁵⁷ Shih në faqen zyrtare të dijetarit: <http://www.binbaz.org.sa/mat/113832/>

²⁵⁸ *Et Tenvir, sherhul xhami'is sagir*, vol. II, fq. 208.

komentuar të integruara edhe me tekste të tjera. Kështu, p.sh., kur e lexojmë hadithin e Pejgamberit, s.a.v.s., që e transmeton Imam Muslimi: *“Vërtet prej mirësive më të mëdha është që njeriu t’i vizitojë të dashurit e babait tij”*, nga kjo nuk duhet ta kuptojmë se mirësia këtu është e kufizuar vetëm për fëmijën, përndryshe si do të trajtohej p.sh. mirësia e bashkëshortit ndaj familjes së bashkëshortes së tij. Shikoni se si vepronte Pejgamberi, s.a.v.s., me shoqet e bashkëshortes tij, zonjës Hatixhe dhe si i nderonte ato për hir dhe dashuri të saj, siç transmetohet në hadith nga Aishja r.a., e cila ka thënë: *“Nuk e kam xhelozuar asnjërin nga bashkëshortet e Pejgamberit, s.a.v.s., sikur që e kam xhelozuar Hatixhen, edhe pse kurrë nuk e kam parë, por ai shumë shpesh e përmendte. Shpeshherë therte dele, e ndante në copa dhe pastaj ua dërgonte shoqeve të Hatixhes. Unë shpeshherë i thosha: Sikur mos të kishte në botë grua tjetër pos Hatixhes! Kurse ai më thoshte: “Po, ajo ka qenë dhe unë me të kam pasur fëmijë.”²⁵⁹* Nëse kjo ka të bëjë me mirësjelljen e bashkëshortit ndaj bashkëshortes së tij, atëherë vallë, si qëndron puna e mirësjelljes së prindit ndaj fëmijës së tij! Dera është krejtësisht e hapur për prindin që të komunikojë me dashamirët e fëmijës, përkundër dallimit në moshë! Ndoshta ndër të përbashkëtat ndërmjet tyre më së paku është tema e bisedës që përqendrohet në bamirësitë e të ndjerit dhe në kujtimet e tyre tok me të dhe rregullimin e projekteve bamirëse të dhuruara nga të gjithë në favor të tij.

4. Vërtet e drejta e prindit për t’u lutur për fëmijën e tij pas (vdekjes) tij është e mbrojtur. Kujt i vdes fëmija para prindit dhe humbet mundësia e lutjes së fëmijës për të pas tij, nxiton Allahu i Plotfuqishëm duke e përgëzuar, për falënderimin ndaj Allahut, për durimin dhe mosshqetësimin, kështu që e përgëzon me një shtëpi në xhenet që quhet ‘Shtëpia e falënderimit’, siç kemi theksuar edhe më parë.

Falënderimi i goftë Allahut për begatinë e Islamit: Dëshmi për fëmijën, për Shtëpinë e falënderimit dhe për prindërit në xhenet.

²⁵⁹ Transmeton Buhariu, hadithi nr. 3818; Tirmidhiu, hadithi nr. 3875 dhe Ahmed i në *Musned*, hadithi nr. 26379.

Zbulimi i thesarit të pasurisë: unë jam miliarder²⁶⁰

Është bërë zakon që të klasifikohen njerëzit mes të pasurve dhe të varfërve, sipas gjendjes tyre materiale dhe sipas asetëve të tyre në banka, sa që një nga revistat amerikane për çdo vit publikon renditjen e njerëzve më të pasur në botë dhe e pasqyron pasurinë e tyre, me çka tërheq vëmendjen e njerëzve dhe të ëndrrave të tyre.

Pasuria materiale është një nga ëndrrat themelore të njerëzimit. Shumica e tyre ëndërron që sa hap e mbyll sytë ta shohë veten se ka në pronësi një thesar të hollash dhe të floririt. Këtë ëndërr e kanë shfrytëzuar disa kompani, duke organizuar lojëra të fatit, ku mund të fitohen shuma të mëdha parash, të cilat i kanë quajtur “lotari”. Kjo nuk është çudi për birin e Ademit dhe natyrën e tij, sepse siç ka thënë Pejgamberi s.a.v.s.: *“Nëse i biri i Ademit do ta kishte një luginë me flori, do të dëshironte t’i kishte dy. Gojën e tij nuk do ta mbushë tjetër veçse dheu, e Allahu do ta falë atë që i ka kërkuar falje.”*²⁶¹

Shumica e konflikteve dhe përleshjeve të njerëzve ndodhin për shkak të luftës së tyre për pasuri dhe prona të ndryshme materiale. Madje, edhe luftërat e shteteve në të kaluarën, por dhe tash, kanë qenë rezultat i lakmisë për pasuritë e popujve dhe dominim mbi burimet e tyre.

Realiteti i sëmundjes së djalit tim Abdullahut dhe vdekjes së tij r.h., ka zbuluar se unë vërtet e kam fituar “lotarinë”, ndonëse nuk është fjala për paratë kalimtare, por për dashuri gjithëpërfshirëse të njerëzve, numri i të cilëve është me mijëra në nivel të botës islame, falënderimi i qoftë Allahut. Disa prej tyre luteshin për mëshirë dhe shërim të djalit tim, disa këtë e kanë përkthyer në bamirësi me pasuri dhe me kohë, disa e kanë kryer haxhin për të, disa më kanë dërguar mesazhe telefonike ku më inkurajojnë për durim, falënderim dhe mbështetje në Allahun, të tjerët më kanë dërguar mesazhe që përmbajnë ajete dhe hadithe, të cilat i lexohen të sëmurit, të tretët më kanë propozuar leximin e ajeteve të caktuara, që men-

²⁶⁰ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 15. 2. 2015.

²⁶¹ Muttefekun alejhi: Transmeton Buhariu, hadithi nr. 6436; Muslimi, hadithi nr. 1048.

donin se janë shëruese për sëmundjen e kancerit, prej së cilës vdiq djali im më pas.

Prej tyre kishte të tilla që më veçuan mua dhe djalin tim r.h., e madje tërë familjen time me lutje të mira, ndonëse me ta nuk njihesha më parë, por ata këtë e bënin në bazë të asaj që kishin dëgjuar për mua nga bijtë dhe të afërmit e tyre. Ata bënin lutje të sinqertë për hir të Allahut – siç më kanë njoftuar të afërmit e tyre.

Kjo çështje nuk u kufizua vetëm në dërgimin e mesazheve telefonike, por u shtri edhe në mjete të ndryshme të informimit, e po ashtu edhe në mediet sociale, të cilat e transmetuan seriozitetin e sëmundjes së birit tim Abdullahut, duke i inkurajuar njerëzit që të luten për shërim nga sëmundja dhe të kërkojnë mëshirë e falje pas vdekjes tij. Të gjitha këto ata i kanë bërë pa i kërkuar unë, madje, në të shumtën e rasteve, edhe pa dijeninë time atëkohë.

O Allah!

Është lumturi e vërtetë që nuk barazohet me asnjë lumturi tjetër, kur e ndjen dashurinë e gjithë atyre njerëzve që të duan ndershëm dhe pozitivisht, pa pritur prej teje shpërblim as falënderim. Madje, tek ata dominon mendimi se ti nuk do ta kuptosh atë, duke pasur parasysh angazhimin tënd me fatkeqësinë dhe – gjithashtu – angazhimin tënd me përcjelljen e sëmundjes dhe dhimbjet e saj, pastaj me fatkeqësinë e vdekjes, me procedurat e varrimit dhe ngushëllimit, si dhe gjëra të tjera që e preokupojnë zemrën nga njerëzit, pas shkuarjes së të ndjerit r.h.

Krejt ajo që shpresoj nga Allahu i Plotfuqishëm është që të jetë rezultat i sjelljes së mirë dhe të sinqertë me njerëzit dhe të jetë vetëm për hir të Tij, sepse “feja është mirësjellje”. Kjo thënie e famshme është përshkruar në shumë ajete kuranore dhe hadithe të Pejgamberit, s.a.v.s., të cilat inkurajojnë për mirësjellje me njerëzit, siç është edhe ky ajet: **“Allahu, me të vërtetë, urdhëron që të veprohet me drejtësi, mirësi dhe t’iu ndihmohet të afërmeve, e ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon që të pranoni këshillat.”**²⁶² Pastaj ky hadith i Pejgamberit s.a.v.s.: **“Dhe sillu mirë me njerëzit.”**²⁶³, e ka edhe ajete dhe hadithe të tjera të kësaj tematike.

²⁶² Surja en-Nahl, 90.

²⁶³ Pjesë nga hadithi, që e transmeton Ahmedi, hadithi nr. 21354; Tirmidhiu, hadithi nr. 1987. Teksti plotë i këtij hadithi është: *“Frikësoju Allahut kudo që të jesh. Veprenë e keqe pasojë me vepër të mirë që ta fshijë atë (të keqen) dhe sillu mirë me njerëzit.”* (Shënim i përkthyesit)

Unë, gjithashtu, shpresoj nga i Plotfuqishmi, që të më shkruajë tek Ai një dëshmi e cila do të vendoset në peshoren time të veprave të mira dhe të ma mundësojë banimin në xhenetet e Tij.

Transmetohet nga Ebul Esved Ed-Dueli se ka thënë:

“Erdha në Medinë, kur aty kishte ra një sëmundje dhe u ula tek Omer bin El Hattabi, ndërsa njerëzit bartnin një xhenaze. Të pranishmit folën mirë për të vdekurin. Omeri tha: “Ashtu duhet të jetë!” Më vonë kaloi një xhenaze tjetër dhe u fol mirë edhe për të. Omeri prapë tha: “Ashtu duhet të jetë!”. Pastaj kaloi një xhenaze e tretë dhe u fol keq për të. Atëherë Omeri tha: “Ashtu duhet të jetë!” Ebul Esvedi thotë: Atëherë e pyeta: “Çka duhet të jetë ashtu, o prijës i besimtarëve?” Omeri tha: Unë fola ashtu sikurse ka folur Pejgamberi, s.a.v.s., e ai ka thënë: Për cilindo mysliman që dëshmojnë katër vetë se është i mirë, Allahu atë do ta çojë në xhenet. Ne atëherë thamë: E tre? Pejgamberi s.a.v.s. u përgjigj: Edhe tre. Ne pastaj shtuam: E dy? Pejgamberi, s.a.v.s., u përgjigj: Edhe dy. Pastaj më nuk e kemi pyetur vetëm për një dëshmitar.”²⁶⁴

Unë jam shumë mirënjohës për të gjithë ata që më përkrahën në këtë sprovë, sa që më dukej si të jetë një dhuratë nga Allahu i Plotfuqishëm, për të më treguar se çfarë pasurie të paçmuar posedoj, e ajo është dashuria e njerëzve, për të cilën shpresoj të jetë shprehje e dashurisë së Allahut të Plotfuqishëm, i Cili kur e do një rob, dashurinë për të e vë edhe në zemrat e krijesave të Tij.

Është transmetuar në hadith të Pejgamberit s.a.v.s.:

“Kur Allahu i Madhërisëm e do ndonjë nga robërit e Tij e thërret Xhibri-lin a.s. dhe i thotë: Unë e dua këtë njeri, pra duaje edhe ti! Atëherë edhe Xhibrili e do atë njeri. Pastaj Xhibrili thërret në hapësirën qiellore duke thënë: Allahu e do këtë njeri, pra dojeni edhe ju! Atëherë edhe banorët e qiellit e duan atë. Pastaj (ky njeri) pranohet edhe në tokë.”²⁶⁵

Vlera e dashurisë së njerëzve, e cila buron nga zemra është, se ajo mund të jetë shprehje e dashurisë së Zotit të njerëzve, që është dashuri më e lartë dhe pasuri e përjetshme e cila nuk shteron, as nuk krahasohet me asnjë pasuri në botë.

²⁶⁴ Buhariu, hadithi nr. 1368.

²⁶⁵ Muttefekun alejhi: Transmeton Buhariu, hadithi nr. 3209; Muslimi, hadithi nr. 2637.

Për këtë shkak, unë – e falënderoj Allahun – jam miliardë në këtë botë dhe shpresoj që kjo të jetë tregues se unë do të jem prej të pasurve edhe në botën tjetër.

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve.

KUR VDES BIRI I ADEMIT I NDËRPRITEN PUNËT PËRVEÇ TRI PUNËVE - Shejh Muhamed Ratib En Nablusi (14:18)

Prej shenjave të pranimit²⁶⁶

Mëshira është në dorën e Allahut të Plotfuqishëm.

Me të i përgëzon robërit e Tij.

Me të i ka mbuluar të gjitha krijesat e Tij... njerëzit dhe kafshët.

Krejt kjo mëshirë nuk e tejkalon një pjesë nga 100 pjesë të mëshirës së Allahut të Plotfuqishëm.

Pranimi i Tij nga robërit është një pjesë nga kjo mëshirë e gjerë, të cilën Allahu i Plotfuqishëm e ka cilësuar se – *ajo ka përfshirë çdo gjë...* njerëzit, xhinët, kafshët dhe sendet... të gjitha hyjnë nën cilësimin e Tij “*çdo gjë*”.

Ndoshta i Plotfuqishmi i përgëzon robërit e Tij me shenja të pranimit tek Ai dhe ajo është një shenjë e referencës për kënaqësinë dhe lehtësimin e Tij.

Në vijim, disa nga shenjat e pranimit, të cilat, me mirësinë e Allahut të Plotfuqishëm, sikur ia kanë lehtësuar Abdullahut, Allahu e mbuloftë me mëshirën e Tij:

Lutjet e dashamirëve dhe njerëzve për të

Më kanë bërë përshtypje lutjet e shumta të cilat e kanë lehtësuar Abdullahun r.h. gjatë sëmundjes dhe pas vdekjes së tij.

Është e natyrshme që të luten familjarët, dashamirët dhe shokët... por vëmendjen time ma kanë tërhequr lutjet e shumta të atyre që nuk i njohim, të cilët i ka shtyrë mirësia, dashuria për njerëzit, dëshira për të bërë mirë dhe ndjenja për solidaritet në mërzë, edhe përkundër arsytimit të tyre për mosnjohjen e Abdullahut r.h., as të ndonjë familjari të tij..., por ata me këtë pjesëmarrje në ndjenja shpërblehen, pasi që ato burojnë nga brendia e tyre fisnike. Kanë vërshuar letrat e tyre në vendet e takimit me mua, me nënën e tij dhe me ata që i njohin nga familjarët e dashamirët, saqë e kisha të pamundur t’iu përgjigjesha këtyre letrave, nga numri i madh në njërën anë, dhe nga preokupimi im me të dashurin (Abdullah)

²⁶⁶ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 11, 12 dhe 14. 10. 2015.

për mjekimin e pastaj edhe për varrimin nga ana tjetër, duke kërkuar prej tyre justifikim të bukur dhe vlerësim të rrethanave.

Falënderimi i qoftë Allahut, Zotit të botëve... nuk besoj se Zoti im i Plotfuqishëm, Mëshiruesi, Mëshirëbërësi, Dhuruesi i Madh do t'ua çojë mundin kot, nëse një lutje e sinqertë nga ndonjëri apo ndonjëra prej tyre do të pranohet, do të mjaftonte, me vullnetin e Allahut.

Lehtësimi i lëmoshave për të

Falë Allahut dhe ndihmës së Tij, gjatë sëmundjes së Abdullahut r.h. dhe pas vdekjes, pati lehtësim me gjëra që sjellin mëshirë dhe shërim, duke iu referuar hadithit të Pejgamberit s.a.v.s.: “*Shëroni të sëmurët tuaj me lëmoshë*”, të cilin e kemi theksuar në një vend tjetër të kësaj serie të bukur të artikujve, kur folëm për kaptinën “Kontributi i lëmoshës në largimin e fatkeqësisë”.

Ndoshta nuk është e përshtatshme të përmenden të dhënat dhe emrat, për t'ua ruajtur shpërblimin dhe qëllimin e bamirësve, por ajo që gëzon është grumbullimi i lëmoshave për të..., e Allahu është mbisundues i çështjeve.

Nuk ndodh ndryshe, pos sipas caktimit të Allahut, ndërsa ne dhe bamirësit kërkojmë shkakun, flijojmë për hir të Allahut dhe e shfaqim qëllimin e mirë në raste konkrete që të përfitojnë të varfrit dhe nevojtarët.

Shpresojmë që shpërblimi i këtyre lëmoshave të ruhet tek Allahu i Plotfuqishëm, sepse ato i janë kushtuar atij dhe, siç e dimë, nijeti i jepet atij që i kushtohet bamirësia. Këtu e kemi edhe një tjetër adhurim – ajo është lutja, e cila nëse del nga zemra e sinqertë për hir të Allahut, ajo ose pranohet, ose i rrit gradat sa është vetë, ose i largon të këqijat sa është vetë, siç thuhet në burimet e fesë sonë të pastër.

Kryerja e haxhit (tetë herë) për të

Me mëshirën dhe ndihmën e Allahut, ishte zgjedhur që data e vdekjes tij të jetë më 3 dhul hixhxhe, kurse varrimi u bë më 7 dhul hixhxhe, pasi që procedura e dokumentacionit dhe sjellja e kufomës nga SHBA-ja zgjati disa ditë. Haxhilerët për në Qabe tashmë kishin intensifikuar udhëtimet e tyre. Kështu që, falë Allahut të Plotfuqishëm, iu ishte lehtësuar mundësia që të dashurit Abdullah r.h. të mund t'ia japin dhuratën më të çmueshme dhe më të vlefshme, kur tetë persona (burra dhe gra) e kryen haxhin për

të, pa e kërkuar ne këtë prej tyre, madje as që kemi ditur deri pas kthimit të tyre nga haxhi. Ndoshta ka edhe të tjerë që e kanë kryer haxhin për të, por që ne nuk na kanë treguar.

Është e bukur dhe interesante, se shumë haxhilerë ngushëllues më kanë kërkuar falje, për pamundësinë e tyre për pjesëmarrje në varrim ose ngushëllim, për shkak të udhëtimit për në haxh, të cilët i falënderova dhe pa asnjë hezitim iu thashë: Allahu ju begatofte! Cila është më e vlefshme për të dashurin Abdullah r.h., lutja për të në ditën e shtatë të dhul hixhës në varrezat 'Sulejbihat' në Kuvajt, apo në ditën e nëntë në Arafat? Janë të pakrahasueshme: vlera, specifika, koha, vendi dhe rasti. Sa shumë më kanë gëzuar disa haxhilerë të kthyer, me lajmin se i gjithë kontingjenti ishte lutur për të ndjerin r.h., pasi që iu ishte rekomanduar, Allahu ua pranofte dhe i shpërblefte.

Motivim për ta, ndoshta ka qenë - pas dashurisë, origjinalitetit, besnikërisë dhe dashurisë për të bërë mirë, pa e njohur Abdullahun r.h. - ndjenja e tyre pse ai ishte djali i vetëm në mesin e motrave, i sapodiplomuar në universitet, në lulen e rinisë, me sjellje shembullore, i njohur për të gjithë përreth tij, pa ekzagjerim ose paragjykim, falënderimi dhe mirënjohja i takojnë Allahut.

Kënaqësia dhe pajtimi me kadanë dhe kaderin (caktimin) e Allahut

Pranimi i lajmit për sëmundjen nga ana e të dashurit Abdullah r.h. ishte për t'u vlerësuar, ndoshta kjo është nga shenjat e pranimit, me vullnetin e Allahut. Ai nuk u trondit dhe nuk u revoltua kur mësoi se e ka goditur sëmundja e pashërueshme në një vend më të vështirë në trup, pra në thellësinë e trurit. Edhe përkundër stilit të hapur që praktikon, spitali amerikan karshi të gjithë pacientëve, ata me të ishin të hapur rreth detajeve të sëmundjes dhe të pamundësisë së shërimit, pastaj për përfundimit e shpejt të jetës. Ai këtë lajm e mori me zemërgjerësi dhe e pranoi realitetin pa shqetësim, ndoshta edhe kjo është prej shenjave të pranimit. Allahu e di më së miri. Falënderimi i takon Allahut për çdo rast dhe çast!

Lehtësimi gjatë mjekimit të sëmundjes dhe gjatë vdekjes

Ende e kujtoj lehtësimin e madh për mjekimin e të ndjerit r.h., i cili ishte ndarje mes fillimit të zbulimit të sëmundjes dhe paraqitjes te mjeku spe-

cialist në klinikën universitare në San Francisko për një javë. Ky, mesatarisht, është termini më i shpejtë dhe është lehtësimi më i madh, që mjekët e tij specialistë në Kuvajt, na udhëzuan pikërisht te ky spital, në mesin e mijëra spitaleve amerikane, që konsiderohet njëra nga qendrat më të mëdha mjekësore në specialitetin e kirurgjisë së tumorit të trurit.

Këta mjekë, kur ia dhanë udhëzimin për këtë spital, nuk e dinin se ata kishin zgjedhur qytetin në të cilin studionte motra e tij dhe bashkëshorti i saj për marrjen e shkallës bashkëpunëtor në mjekësinë humane. Ata të dy ishin vendosur aty dhe e njihnin qytetin, gjë që na e lehtësoi punën, që ne si të huaj mos të fillojmë nga e para, duke kërkuar banesë dhe mjete transporti prej aty e në spital dhe anasjelltas. Edhe më e rëndësishme se këto të dyja, ishin njohuritë mjekësore që i posedonin, ndaj komunikimi me mjekët u bë jo vetëm i lehtë, por edhe i kuptueshëm deri në imtësitë mjekësore. Betoheëm për jetën time, se ky është lehtësim i madh, përveç ndihmës së stafit mjekësor dhe të gjithë atyre që bashkëpunuan me të dashurin Abdullah r.h., si në spital ashtu dhe jashtë tij.

Ishte prej lehtësimit, gjithashtu, se ai nuk vuajti, as nuk e mundoi askënd prej të dashurve. Koha sa mori mjekim, vetë mjekimi për raste të këtilla të ngjashme, si dhe përsëritjet e sëmundjes shumë herë zgjasin me vite, ndërkaq, sëmundja e tij, mjekimi dhe vdekja nuk zgjatën më shumë se pesë javë, edhe pse ne qemë përgatitur për një periudhë më të gjatë, sipas përvojës së mjekëve.

E këtillë ishte e tërë çështja e tij, madje edhe në gjërat e detajuara jetësore për të dhe për familjarët që e shoqëronin – dhe pa ekzagjerim – kishin një lehtësim në mënyrë të habitshme, sa që medituesin e shtynte të besojë, se prapa këtij lehtësimi, me siguri është Allahu i Plotfuqishëm.

SHENJAT E PRANIMIT TË VEPRËS - Shejh Salih El Megamisi (1:22)

RRUGËT E ARRITJES DHE SHENJAT E PRANIMIT - Shejh Muhamed Ratib En Nablusi (14:01)

Ëndrrat - bukuria përgëzuese për përfundimin e mirë

Prej gjërave që e qetësojnë shpirtin, falë Allahut dhe ndihmës së Tij, ndoshta janë edhe ëndrrat e shumta, të cilat më janë përcjellë nga persona të ndryshëm, që e kishin parë Abdullahun e dashur në ëndërr, me pamje të bukur në forma të ndryshme në secilën ëndërr. Andaj, kjo çështje më shtyri që këto gjëra t'i vendos si shtesë në këtë libër të bukur dhe, me vullnetin e Allahut, të dobishëm në përmbajtjen e tij!

Ëndrrat janë perceptime dhe bindje, të cilat Allahu i Plotfuqishëm i vendos në zemrën e njeriut gjatë gjumit. Kështu, ato të cilat e gëzojnë janë sihariq nga Allahu, ndërsa ato që e dëmtojnë, janë ëndrra të ngatërruara.

Pejgamberi, s.a.v.s., kujdesej që sahabëve të tij t'ua përcillte disa nga ëndrrat e tij dhe t'ua komentonte. Ai u thoshte: *“Pas meje nga pejgamberia nuk do të mbetët, pos ëndrrave të mira.”*²⁶⁷

Gjithashtu, Pejgamberi, s.a.v.s., ka thënë:

*“Kur të afrohet koha (e fundit), atëherë ëndrra e myslimanit thuhet se nuk gënjën, kush prej jush e ka ëndrrën më të vërtetë, ai e ka fjalimin më të vërtetë. Ëndrra e myslimanit është 1/45 pjesë e pejgamberisë. Ëndrrat janë tri llojesh: Ëndrra e mirë është sihariq nga Allahu, ëndrra e pikëlluar është nga djalli dhe ëndrra në të cilën njeriu flet me veten. Nëse dikush prej jush sheh në ëndërr diçka që e urren, atëherë le të ngrihet dhe të falë (namaz) duke mos ia treguar askujt.”*²⁶⁸

Nga kjo kuptojmë se ëndrra e vërtetë në vetvete është mirësi për pronarin e saj, prandaj është karakterizuar ajo nga pejgamberia. Sepse ajo paralajmëron për ndonjë gjë metafizike, gjë që e gëzonin vetëm pejgamberët.

Është e qartë se me ëndërr të mirë nënkuptojmë ëndrrën e cila sjell sihariq, jo ëndrrën e vërtetë, e cila realizohet, qoftë mirë, qoftë keq. Kjo për disa arsye:

²⁶⁷ Transmeton Ebu Davudi, hadithi nr. 5017.

²⁶⁸ Muslimi, hadithi nr. 2263.

1. Cilësimi i saj në hadith se ajo është sihariq, që imponon të jetë përgëzuese për të mirë, ndaj kjo është thënie e shumë komentuesve të ëndrrave, meqë ajo mund të përmbajë përgëzim ose paralajmërim! Kështu, paralajmërimi është e kundërta e përgëzimit. Prandaj, nuk duhet të thuhet se ëndrra e mirë është ajo që hadithi e cilëson si sihariq “parashikuese e së mirës”, sepse ajo përfshin gjithashtu edhe të kundërtën e përgëzimit, që është parashikimi i së keqes.
2. Fjala e Pejgamberit, s.a.v.s., në hadith: *“Nga sihariqet e pejgamberisë nuk ka mbetur tjetër, pos ëndrrës së mirë të cilën e sheh myslimani ose i shfaqet atij.”*²⁶⁹ Shprehja “i shfaqet atij” dëshmon se ka qenë për qëllim ëndrra përgëzuese për të mirë.
3. Vërtetësia e ëndrrës i ndodh edhe jobesimtarit, ashtu siç i ndodh myslimanit. Për këtë ka shembuj nga Kurani dhe nga hadithi. Prej shembujve më të njohur është ëndrra e theksuar në suren Jusuf, të cilën e kishte parë mbreti i Egjiptit, i cili ishte jobesimtar: *“(Dhe tha mbreti): “Kam parë (në ëndërr) se si shtatë lopë të majme i hanin ato shtatë të dobëta dhe kam parë (në ëndërr) shtatë kallinj të gjelbër, shtatë të tjerë të tharë. O paria ime, më shpjegojeni ëndrrën time, nëse dini komentimin e ëndrrave!”*²⁷⁰

Nga pejgamberia kanë mbetur vetëm sihariqet, më kryesorja e tyre është ëndrra e mirë:

Këto ëndrra janë pjesë e pejgamberisë. Në hadith thuhet: *“Nga pejgamberia kanë mbetur vetëm sihariqet.”* I thanë: *“Çka janë sihariqet?”* Tha: *“Ëndrra të cilën e sheh njeriu ose i shfaqet atij”*.

Nuk ka dyshim se besimtari përgëzohet me ëndërr të mirë, por ai nuk guxon që në bazë të saj të bëhet përtac në punë, të mos i hulumtojë shkaqet e mbarësitë dhe suksesit! Përkundrazi, ai duhet të angazhohet në kërkimin e së mirës dhe në largimin e së keqes, duhet t’i bëjë planet e nevojshme për menaxhimin e gjendjes në harmoni me besimin në Allahun. Ëndrra mund të jetë e vërtetë, por ta njollosë komentuesi gjatë interpretimit, duke ia vesh gjërat që nuk i ka. Andaj, ai duhet ta dijë se interpretimi është një mendim dhe përpjekje, që mund të jetë i qëlluar, por mund të mos qëllohet. Kështu ai nuk është i sigurt. Andaj ai nuk duhet të zhgënjehet me të, megjithatë, Allahu e di më së miri. Imam Maliku ka thënë: *“Ëndrra gëzon e nuk dëmton!”*

²⁶⁹ Muslimi, hadithi nr. 479, nga Ibni Abbasi.

²⁷⁰ Surja Jusuf, 43.

Allahu të mëshiroftë, o Abdullah! Na dhanë sihariq ata, duke të parë ty në ëndërr, në ato gjendjet e bukura! Të dashurit, të cilat të kanë parë, na i kanë përcjellë ëndrrat e tyre të bukura për ty.

Në veprën *Sherh Muhtesar Sahih El Buhari*, thuhet në komentimin e hadithit: “Nëse dikush nga ju sheh një ëndërr që e do, atëherë ajo është nga Allahu.” “Le ta falënderojë Allahun...” do të thotë, le ta falënderojë Allahun për të, sepse ajo i jep sihariq për ndonjë begati dhe “andaj le t’ia tregojë atë!” atij që do dhe kujt ka besim.

Ebu Katade transmeton nga Pejgamberi, s.a.v.s., për ëndrrën: “Nëse sheh ëndërr të mirë, atëherë le të gëzohet dhe le t’i tregojë atij që e do.”²⁷¹

Ëndrrat e Pejgamberit, s.a.v.s., në gjumë:

Me hadithe të vërteta konfirmohet se Pejgamberi, s.a.v.s., mund të shihet në ëndërr, veçmas nga njerëzit e mirë, sepse djalli nuk mund ta imitojë atë – s.a.v.s. Ja një hadith i tillë: “Kush më sheh mua në ëndërr, ai vërtet më ka parë mua, sepse djalli nuk mund të më imagjinojë mua.”²⁷²

Lejimi i pamjes së Allahut në ëndërr:

Shejhul Islami Ibni Tejmije thotë: “Njeriu mund ta shohë Zotin e tij në ëndërr dhe të flasë me Të. Kjo në ëndërr është e vërtetë, por nuk lejohet të besohet se Allahu në veten e Tij është ashtu çfarë e ka parë në ëndërr, sepse të gjitha gjërat që shihen në ëndërr nuk duhet të jenë identike, por ato që i ka parë në ëndërr duhet të jenë imazhe të përshtatshme dhe të ngjashme me besimin e tij në Zotin e tij. Nëse besimi dhe bindja e tij është identike, atëherë ai i sheh ato imazhe dhe i dëgjon fjalët që përshtaten me të, përndryshe ndodh e kundërta.”²⁷³

E kanë transmetuar Ahmedi dhe të tjerët hadithin ku thuhet se Pejgamberi, s.a.v.s., e kishte parë Zotin në ëndërr në pamjen më të bukur. Ja teksti:

“Pejgamberi, s.a.v.s., kishte dalë një mëngjes, i disponuar, me fytyrë të ndritshme dhe ne i thamë: ‘O i Dërguari i Allahut, po të shohim të disponuar, me fytyrë të ndritshme.’ Tha: ‘Nuk më është ndaluar që ta shoh Zotin tim, Ai më erdhi sonte në pamjen më të bukur dhe më tha: O Muhamed. I thashë: ‘Urdhëro, o Zoti im!’ Tha: ‘Për çka diskutojnë meleket?’ Thashë: ‘Nuk e di, o Zot.’ Këtë e tha dy herë ose tri herë.

²⁷¹ Buhariu, hadithi nr. 6994.

²⁷² Muslimi, hadithi nr. 2261.

²⁷³ *Bejanu telbisil xhehmije*, 1/73.

*Tha: 'Pastaj e vendosi dorën e tij mes shpatullave të mia, andaj ndjeva freskinë e saj mes gjoksit, saqë m'u qartësua çfarë ka në qiej dhe në tokë. Pastaj ai e lexoi këtë ajet: "Dhe Ne ia treguam Ibrahimit perandorinë e qiejve dhe të Tokës..." (el-En'am, 75) Tha: 'O Muhamed, për çka diskutojnë melekët?' Tha: I thashë: 'Për keffaratet.'*²⁷⁴ *Tha: 'Çka janë keffaratet?' Thashë: 'Shkuarja në këmbë në xhemat, qëndrimi në xhami pas namazeve, marrja e abdesit në situata të pakëndshme.'* *Tha: 'Kush i vepron këto jeton në mirëqenie, vdes në mirëqenie, do të jenë (të zhdukura) mëkatet e tij si ditën kur e ka lindur nëna e tij. Nga nivelet e larta janë: flet bukur, e përhap selamin, jep ushqim dhe fal namaz nate kur njerëzit flen.'*

Tha: "O Muhamed, kur të falësh thuaj: 'O Allahu im, më jep të mira, m'i largo të këqijat, më bëj t'i dua të varfrit dhe më bëj të pendohem! Ndërsa kur Ti do t'i sprovosh njerëzit, atëherë merrma shpirtin duke mos më sprovuar.'"²⁷⁵

Po ndalemi këtu, pasi që lexuesit të ndershëm i ofruam, aq sa patëm mundësi, gjëra të rëndësishme nga bota e ëndrrave, duke lënë hapësirë për të gjithë ata që duan të zgjerohen, që ta shfrytëzojnë trashëgiminë që është në dispozicion në bibliotekat islame.

²⁷⁴ Keffaretun sh. keffarat: rite fetare që shërbejnë për të larë mëkatet, Sulejman Tomçini, *Fjalor Arabisht-Shqip*, fq. 826. (shënim i përkthyesit).

²⁷⁵ Ahmedi, hadithi nr. 16621; Tirmidhiu, hadithi nr. 3223.

Madhështia e Islamit në ligjësimin e dhurimit të shpërblimit të veprave të mira për të vdekurin²⁷⁶

Sa prej nesh kemi mangësi në kryerjen e detyrave tona ndaj njeriut prind, apo ndaj të dyve dhe dëshirojmë ta plotësojmë atë që na ka kaluar duke iu bërë bamirësi pas vdekjes së tyre!

Sa prej nesh na ka vdekur ndonjë i dashur, qoftë fëmijë, qoftë shok, apo dikush tjetër, dhe dëshirojmë të kontribuojmë për t'i ndihmuar në botën tjetër, duke dëshiruar që t'i kompensojmë mangësitë e detyrave tona ndaj tij në këtë botë, apo duke dëshiruar t'i bëjmë mirë në përgjithësi!

Islami, feja jonë madhështore, nuk e ka lënë këtë çështje pa e trajtuar, e si nuk do ta bënte kur ajo është fe e arsyeshme, e mirinformuar dhe e mëshirshme ndaj pjesëtarëve të saj, si të gjallët, ashtu edhe të vdekurit.

Islami ka hapur rrugë për mirësi të njeriut ndaj vëllait tij – ndaj njeriut tjetër gjatë jetës së tij, duke e trajtuar me mirësi, duke u lutur për të në mungesë të tij, duke e vizituar në rast të sëmundjes, duke ia dëshiruar atë që e dëshiron për vete, duke e ndihmuar në drejtësi dhe duke e ndaluar nga padrejtësia, duke i bërë mirë pa reklamacion dhe fyerje, duke e duruar kur ta bën ndonjë shqetësim, duke e falur pas ndonjë dëmi dhe mekanizma të tjerë të mirësisë të cilët pothuajse nuk mund të numërohen apo kufizohen.

Gjithashtu, Islami i madh nuk ia humb shpresat njeriut besnik për vëllanë e tij të vdekur, por i jep mundësi të jashtëzakonshme për t'i bërë mirë, për të kontribuar në mosndërprerjen e veprave të tij të mira në këtë botë, duke inkurajuar lutjet për të, duke lejuar dhurimin e shpërblimit të ndonjë veprë të mirë për vëllanë e tij të vdekur, pa marrë parasysh a është i afërm i tij apo ndonjë tjetër, për sa kohë që vepra është sinqerisht për hir të Allahut dhe është e saktë në aspektin e legjitimitetit.

I këtitillë, për shembull, është ajeti kuranor:

²⁷⁶ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 7. 12. 2014.

“Edhe ata që vijnë pas tyre – thonë: “O Zoti ynë, falna neve dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve; O Zoti ynë, Ti je, me të vërtetë, i mirë dhe mëshirues!”^{277 278}

Ky ajet është dëshmi për solidaritetin e të parëve të umetit me ata të fundit dhe me brezat e tyre, për domosdoshmërinë e dashurisë për të gjithë sahabët, për vlerësimin e vëllazërisë së tyre në fe dhe paraprirjes së tyre në besim, inkurajim për lutje për ta, si dhe për pastrimin e zemrave nga sëmundja e urrejtjes dhe e smirës për cilindo besimtar.

Transmetohet nga Ibni Abbasi r.a. se ka thënë:

“Erdhi një burrë te Pejgamberi, s.a.v.s., dhe tha: ‘O i Dërguari i Allahut, më ka vdekur nëna dhe i ka ngelur një muaj pa agjëruar, a ta agjëroj unë për të?’ Tha: ‘Po, sepse borxhi i Allahut është më meritë që të paguhet.’²⁷⁹

Aishja r.a. tregon se si i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush vdes, ndërsa ka pasur detyrime agjërimi, atëherë këto detyrime duhet t’i plotësojë duke agjëruar kujdestari i të ndjerit.”²⁸⁰

Burejde r.a. tregon: “Derisa isha duke qëndruar tek i Dërguari i Allahut, erdhi një grua dhe i tha: “Unë ia dhurova nënës time një robëreshë dhe ajo vdiq.” Tha: “Ti e fiton shpërblimin, por ktheje përsëri si trashëgim!” (Do të thotë: Ty të takon shpërblimi, ndërsa robëresha të kthehet përsëri si e drejtë në trashëgimi). Tha: O i Dërguari i Allahut, ajo ka pasur edhe detyrime agjërimi, a duhet të agjëroj për të?” Tha: “Po, agjëro për të.” Tha: Ajo as haxhin nuk e ka kryer, a duhet ta kryej haxhin për të?” Tha: “Po, kryeje edhe haxhin për të.”²⁸¹

Imami Ibni Kajjim El Xhevzijj e përmbledh madhështinë e qëndrimit të Islamit për këtë çështje, kur sqaron se shpirtrat e të vdekurve përfitojnë nga kontributi i të gjallëve me dy çështje, për të cilat pajtohen juristët, hadithologët dhe mufesirët. E para, ajo të cilën e shkakton i vdekuri gjatë jetës tij. E dyta, lutja e myslimanëve për të, istigfari i tyre, sadakaja dhe

²⁷⁷ Surja el-Hashr, 10.

²⁷⁸ Dr. Vehbe Mustafa Ez Zuhejli, *Et Tefsirul munir fil akideti vesh sheriati vel menhexhi*, Damask, Darul fikril muasir, botimi II, 1418 h. vol. 28, fq. 85.

²⁷⁹ Buhariu, hadithi nr. 1953 dhe Muslimi, hadithi nr. 1148.

²⁸⁰ Buhariu, hadithi nr. 1952 dhe Muslimi, hadithi nr. 1147.

²⁸¹ Transmeton Buhariu në Librin e agjërimimit, kapitulli: *Kush vdes, ndërsa ka detyrime agjërimi*, hadithi nr. 1816; Muslimi në Librin e Agjërimimit, kapitulli *Kompensimi i agjërimimit për të vdekurin*, hadithi nr. 1935.

haxhi, me diskutimin rreth asaj se çka i arrin atij nga shpërblimi, shpërblimi i shpenzimeve apo shpërblimi i veprës? Xhumhuri mendojnë se i arrin shpërblimi i vetë veprës, ndërsa një pjesë e hanefinjve thonë se i arrin shpërblimi i shpenzimeve. Po ashtu, ata kanë mendime të ndryshme edhe rreth adhurimeve trupore, si: agjërimi, namazi, leximi i Kuranit dhe dhikri.²⁸²

Ndërkaq, Imami El Karafi, veprat e mira (bimirësitë) në bazë pajtimit për arritjen e shpërblimit të tyre tek tjetri pa diskutim, apo i mosarritjes pa diskutim; dhe mospajtimit për arritjen apo mosarritjen e shpërblimit të veprës te tjetri – i ka ndarë në tri grupe.

Grupi i parë, ato për të cilat njerëzit unanimsisht mendojnë se Allahu e ka bllokuar shpërblimin e tyre për robërit e Tij dhe nuk mundësohet transferimi te tjetri, siç është besimi (imani), njëshmëria (tevhidi), lartësimi, madhërimi i Allahut. Po kështu përcillet se edhe për namazin ekziston konsensusi, duke pasur parasysh mospajtimin që ekziston te medhhebi Shafi'i, nga Shejh Ebi Is'haku.

Grupi i dytë, ato për të cilat njerëzit unanimsisht mendojnë se Allahu e ka lejuar transferimin e shpërblimit tek i vdekuri, siç janë lutja, bamirësitë materiale si lëmosha dhe lirimi i skllavit.

Grupi i tretë, ato për të cilat ka mospajtim në mendime se a janë të bllokuara apo jo, siç është agjërimi, haxhi dhe leximi i Kuranit? Thuhet: Nuk arrin shpërblimi i tyre, nëse i dhurohet dikujt. Ky është mendim i njohur te medhhebi Malikij, e po ashtu te medhhebi Shafi'i vetëm për leximin e Kuranit. Po ashtu, thuhet: Arrin shpërblimi, këtë mendim e kanë Ahmed bin Hanbeli dhe Ebu Hanife. Ky mendim konsiderohet më i drejti edhe te medhhebi Shafi'i për çështjen e haxhit për të vdekurin dhe haxhin për tjetrin.²⁸³

Fjala përfundimtare: Ligjshmëria e dhurimit të shpërblimit për disa vepra, siç janë haxhi dhe umra, istigfari, agjërimi, lëmosha, lutja, leximi i Kuranit dhe çlirimi nga skllavëria, ka mendime të ndryshme mes juristëve në disa prej këtyre akteve, siç u përmend më lart.

²⁸² *Err Rruh fil kelami ala ervahil emvati vel ahjai bid delaili minel kitabi ves sunneti*, Darul kutubil ilmijje, Bejrut, fq. 117.

²⁸³ *Envarul buruk fi envail furuk*, Alemul kutub, pa vend dhe datë të botimit, vol. III, fq. 221. Gjithashtu, shih: Ebu Muadh Dhafir bin Hasan Al Xheb'an, *El Bejjinat fi hukmi ihdai thevabil a'mali lilemvat*, Studim i publikuar në: <http://www.saaaid.net/book/open.php?cat&4=book4634=>

Gjatë rrugëtimit tim me Abdullahun për në Shtëpinë e falënderimit, Allahu më dhuroi perceptimin e vlerës së kësaj begatie të madhe, kur e kuptova se vdekja e djalit tim Abdullahut r.h. nuk do të thotë ndërpreje e përfitimit nga veprat e mira, pa marrë parasysh nëse i ka kryer ato ndonjë i afërm i tij apo ndonjë tjetër i dashur i tij në përgjithësi – të cilët, falë Allahut të Plotfuqishëm, janë shumë. Vdekja e tij ndodhi afër ditës së Arafatit, kështu që disa bamirës arritën ta kryejnë haxhin, ata e kryen haxhin për Abdullahun pa e kërkuar prej tyre aspak, por vetëm dashuria e tyre për bamirësi dhe pikëllimi për të i shtyri ata që ta bëjnë këtë. Ata më tepër duan t’iu bëjnë mirë atyre se sa vetes, edhe pse madje vetë janë nevojtarë. Kjo më bëri shumë të lumtur për këtë nder të madh, për mua dhe për Abdullahun, sepse unë i konsideroj – krahas lutjeve për të – si dhuratë më të madhe, më të vlefshme dhe më të çmueshme “zbukurimet e haxhit” dhe “dhuratat e haxhilerëve me rastin e kthimit nga haxhi”, duke ua shtuar këtyre shpërblimin e umres së kryer nga disa persona, shpërblimin e disa hatmeve të Kuranit, të lëmoshave, të projekteve bamirëse, si xhami, puse të ujit normal, puse të ujit artesian, stacione për pastrimin dhe distilimin e ujit, fushatat për ndihmë familjeve të refugjatëve sirianë, kurbanet dhe therjet e kafshëve për ndihmë të varfërve nga familjarët, nga të afërmit, nga shokët dhe nga miqtë.

E lus Allahun e Madhërishtëm që t’ua pranojë atyre haxhin dhe veprat e mira dhe t’i vendosë në peshoren e Abdullahut dhe në peshoret e tyre , t’ua falë mëkatet të gjithë të vdekurve myslimanë, me mirësinë dhe mëshirën e Tij, Ai vërtet është Mëshiruesi më i madh.

SHPËRBLIMI I CILAVE VEPRAT ARRIN TEK I VDEKURI? - Shejh Salih El Megamisi (1:02)

Si mund t'iu dhurojmë kënaqësi banorëve të varreve²⁸⁴

Janë të shumta dëshmitë se banorët e varreve e ndejnë vizitën që iu bëhet, dëshmi e tillë p.sh. është edhe transmetimi në Sahihun e Buhariut²⁸⁵: Hadithi i Nafiut, se Ibni Omeri i ka thënë: “Pejgamberi, s.a.v.s., doli te populli i Kulejbit dhe tha: “*A e keni gjetur premtimin e Zotit tuaj të vërtetë?*” I është thënë: “Po ju bën thirrje të vdekurve?” Ai tha: “*Ju nuk më dëgjoni më mirë se ata, por ata nuk përgjigjen.*”

Gjithashtu, transmetimi i Ibn Abdulbirrit me sened tek Ibni Abbasi, nga Pejgamberi, s.a.v.s., që ka thënë:

*“Kur dikush prej jush kalon pranë varrit të vëllait të tij besimtar që e ka njohur në këtë botë dhe e përshëndet atë, edhe ai e njih dhe ia kthen përshëndetjen.”*²⁸⁶

Gjithashtu, transmetohet nga Pejgamberi, s.a.v.s., se ka thënë:

*“Kur robi lëshohet në varrin e tij dhe njerëzit fillojnë të kthehen, ai e dëgjon zhurmën e hapave (këpucëve) të tyre.”*²⁸⁷

Pejgamberi, s.a.v.s., i mësonte vizitorët e varreve që të thonë:

*“Shpëtimi qoftë mbi ju banorë të varrezave besimtarë dhe myslimanë, edhe ne, në dashtë Allahu, do t’ju bashkëngjitemi.”*²⁸⁸

Imami El Izz bin Abduselam, këtë e ka marrë për argument – në fetvatë e tij – Se i vdekuri i njeh vizitorët e tij e thotë: “Është e dukshme se i vdekuri e njeh vizitorin, sepse ne jemi urdhëruar t’i përshëndesim me selam dhe sheriatin nuk urdhëron t’i flitet atij që nuk dëgjon.” Ndërsa Imami Ibni Kajjimi mendon: “Se selefi (gjeneratat e para) janë kompaktë

²⁸⁴ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën *El Kabes*, më 3. 5. 2015.

²⁸⁵ Buhariu, hadithi nr. 1370.

²⁸⁶ *El Istidhkar*, Ibn Abdulbirr, 1/185, Darul kutubil ilmijje, Bejrut, 1421 h, 2000 m.

²⁸⁷ Buhariu, hadithi nr. 1374 dhe Muslimi, hadithi nr. 2870.

²⁸⁸ Muslimi, hadithi nr. 975.

në këtë mendim, pasi që ka transmetime mutevatir prej tyre se i vdekuri e njeh vizitën që ia bën i gjalli dhe gëzohet me të.”²⁸⁹

Megjithatë, nuk do të thotë, se ekziston konsensusi se të vdekurit dëgjojnë çdo gjë që ndodh rreth tyre, pasi që kjo është çështje metafizike dhe nuk duhet të ekzagjerojmë përtej transmetimeve të besueshme, siç ishin transmetimet e mësipërme, ku vërehet se ato nuk shtojnë më tepër pos që të vdekurit e ndiejnë vizitën që iu bëhet dhe ua kthejnë përshëndetjen, pa e pohuar se të vdekurit dëgjojnë çdo gjë që ua thonë vizitorët.

Ibni Kajjimi, në librin “*Err-Rruh*”, ka cituar tregimin, i cili e shpreh gëzimin e banorëve të varreve për vizitën e të dashurve të tyre, në të cilin nuk kam gjetur asnjë kontradiktë me atë që përmenda më lart. Ai thotë: “Ka treguar Othman bin Sevad Et-Tafavi, se nënën e tij, e cila ishte fetare e përkushtuar, e quanin “*murgeshë*”. Ka thënë: “Kur ajo ishte në prag të vdekjes, e ngriti kokën kah qielli dhe tha: “Oj zahireja ime, oj rezerva ime, oj mbështetja ime gjatë jetës dhe pas vdekjes! Mos më poshtëro kur të vdes dhe mos më lër të vetmuar në varrin tim.” Tha: “Pastaj ajo vdiq. Unë shkoja çdo të premtë, lutesha dhe kërkoja falje për të dhe për banorët e varreve. Një natë e pashë në ëndërr, dhe i thashë: “Oj nëna ime, si je”? Tha: “O biri im, vdekja është një ankth i rëndë, por unë fal Allahut jam në Berzah të lavdëruar, të shtruar me borzilok, jastëkët janë nga mëndafshi dhe kadifeja deri në Ditën e Ringjalljes.” I thashë: “A ke nevojë për diçka?” Ajo tha: “Po, mos e ndërprit vizitën që je duke na bërë, sepse unë gëzohem kur ti vjen të premtën nga familja, atëherë mua më thërrasin: “Oj murgeshë! Ja erdhi djali yt.” Atëherë unë gëzohem, e bashkë me mua gëzohen edhe të vdekurit tjerë përreth meje.”

Të nderuar lexues dhe lexuese, mos i privoni të vdekurit tuaj nga vizita e varrezave, sepse ata kënaqen me të dhe ky nuk është gëzim dhe kënaqësi vetëm për ta, por aty ka mësim dhe kujtim për ju se kjo botë do të zhduket dhe se ne, herët a vonë, do të ndahemi nga të dashurit! Allahu ju dhëntë jetë të gjatë dhe mos ju lëntë pa të dashurit tuaj!

Ndërsa unë, falë Allahut, vetë e kam praktikuar këtë këshillë para se t’ua japë juve. Unë, në zbatim të Sunetit të Pejgamberit, s.a.v.s., pas ceremonisë së përcjelljes së xhenazes, varrimit dhe lutjeve për pronarin, jam ndalur tek Abdullahu i dashur, i kam dhënë selam dhe e kam përgëzuar për ardhjen e një të dashuri apo fqinji në Shtëpinë e falënderimit, pastaj jam lutur për të. Më pas kam shkuar te nëna ime dhe babai, u kam dhënë

²⁸⁹ *Err-Rruh*, Ibni Kajjimi, fq. 5.

selam dhe kam bërë lutje për ta! Ndoshta me këtë ua kthej një pjesë të mirësisë së tyre që kanë bërë për mua që nga vegjësia ime.

O Allah, bashkona me ta në Shtëpinë e falënderimit, se premtimi Yt është i vërtetë dhe Ti je e Vërteta!

LUMTURIA E GRUAS MYSLIMANE NË XHENET - Shejh Mahmud El Misri (22:55)

TË VDEKURIT NË JETËN E BERZAHUT, A I NDIEJNË TË GJALLËT? - Shejh Salih El Megamisi (7:16)

Xheneti nuk është vetëm “hyri symëdha”²⁹⁰

Disa mund të imagjinojnë se kënaqësia e xhenetit reduktohet vetëm me hyritë symëdha, kjo, sepse ata kënaqësinë e kundrojnë vetëm nga ana sensuale, por ky është shikim individualist, sepse nuk e merr parasysh anën psikologjike të besimtareve punëmbara, kurse xhenetin e perceptojnë si vend të lumturisë vetëm për burra!

Në realitet, në xhenet dhe gjithçka ka në të, si Shtëpitë e falënderimit dhe të tjerat, ka kënaqësi shpirtërore të cilat janë më superiore se të gjitha kënaqësitë materiale, të cilat, në mënyrë të barabartë, do të jenë në dispozicion për burra dhe për gra, dhe ato janë kënaqësi, që pakkush i fokuson, duke përfshirë, për shembull:

1. Për banorët e xhenetit nuk do të ketë frikë as pikëllim, do të thotë, ata do ta gëzojnë begatinë e sigurisë dhe lumturisë përgjithmonë, të cilat janë prej begatave më të rëndësishme për të cilat janë të etura krijesat në këtë botë, p.sh. le ta shikojmë fjalën e Allahut: **“Hyni në xhenet! Për ju s’ka frikë as pikëllim!”**²⁹¹
2. Banorët e xhenetit do të kënaqen në shoqëri me familjarët dhe të dashurit: “në mbështetëse ballë për ballë”, pasi që iu është nxjerrë nga gjoksi i tyre urrejtja, armiqësia dhe neveria, e cila gjithashtu është prej begatave më të mëdha. I Lartmadhërishti thotë: **“Ne kemi hequr prej zemrave të tyre çfarëdo urrejtjeje, e ata në mbështetëse qëndrojnë ballë për ballë njëri-tjetrit duke qenë të vëllazëruar.”**²⁹²
3. Banorëve të xhenetit do t’u bashkëngjiten pasardhësit e tyre punëmbarë dhe shumica prej nesh frikësohemi se a do të takohemi me fëmijët tanë pas vdekjes. Allahu i Plotfuqishëm na ka siguruar se ata do të na bashkëngjiten, ose ne do t’iu bashkëngjitemi atyre në xhenet, me lejen e Allahut, vetëm me kushtin e besimit, duke iu referuar fjalës së Allahut: **“E, ata që kanë besuar dhe u shkojnë pas**

²⁹⁰ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën “El Kabes”, më 3. 5. 2015.

²⁹¹ Surja el-A’raf, 49.

²⁹² Surja el-Hixhr, 47.

*pasardhësit e tyre në besim, do t'ua bashkojmë pasardhësit e tyre dhe nuk do t'iu pakësojmë asgjë nga veprat e tyre...*²⁹³

4. Banorët e xhenetit nuk do të ndiejnë ndonjë lodhje apo vështirësi dhe në këtë gjendje do të vazhdojnë pa u nxjerrë nga xheneti as pa u kërcënuar, thotë i Lartmadhërishtmi: *“Ata aty nuk i godet kurrfarë lodhjeje dhe nuk do të nxirren kurrë prej tij.”*²⁹⁴
5. Banorët e xhenetit do të jetojnë me nder dhe dinjitet, fytyrat e tyre nuk do t'i prekë pluhuri as turpi. Kjo është dhuratë e madhe të cilën e dëshiron çdo njeri, që të jetojë me nder dhe dinjitet, të ndihet i sigurt për veten e tij nga poshtërimi dhe jodinjiteti. Le ta shikojmë këtë ajet kuranor: *“Ata që bëjnë mirë, do të kenë shpërblim të mirë, e edhe më tepër! Fytyrat e tyre nuk do t'i mbulojë errësira as poshtërimi. Ata do të jenë banorë të xhenetit, në të cilin do të banojnë përherë.”*²⁹⁵
6. Banorët e xhenetit Allahu i Plotfuqishëm do t'i begatojë me një begati çfarë nuk e ka begatuar kurrë ndonjë krijesë të Tij. Ajo begati i tejkalon të gjitha begatitë e mëparshme, ajo është shikimi në fytyrën e ndershme të Allahut në xhenet. Të gjithë sahabët, ehli suneti dhe dijetarët janë kompakt në këtë mendim, të cilin e mbështesin në ajetin kuranor: *“Atë ditë – disa fytyra do të shkëlqejnë, - në Zotin e tyre do të shikojnë.”*^{296 297}

²⁹³ Surja et-Tur, 21.

²⁹⁴ Surja el-Hixhr, 48.

²⁹⁵ Surja Junus, 26.

²⁹⁶ Surja el-Kijame, 22-23.

²⁹⁷ Shiko: *El Avasim vel kavasim*, Ibnul Vezir, Asociacioni “Risale”, bot. III, viti 1415 h, 1994 m; Tefsiri i Ibni Kethirit, 8/280, Darut Tajjibe, bot. II, 1420.

Sihariq i madh për gruan myslimane në xhenet²⁹⁸

Këtu do të flasim në lidhje me kënaqësinë e xhenetit në Shtëpinë e falënderimit e në të tjerat dhe atë sesi kënaqësia shpirtërore është më superiore mbi të gjitha kënaqësitë e tjera materiale.

Prej begative materiale me të cilat Allahu i Plotfuqishëm do t'i begatojë banorët e xhenetit janë hyritë symëdha, kjo është begati e veçantë për burrat, por aty nuk do të ketë asnjë paragjykim për gratë, sepse Allahu i Plotfuqishëm nuk bën asnjë padrejtësi. Aty, gratë – sikurse burrat – absolutisht nuk do t'i kaplojë pikëllimi në xhenet, sipas premtimit të Allahut, **se banorët e tij nuk do të pikëllohen**, pastaj, ato do të jenë më të bukura dhe më me vlerë se hyritë symëdha, ku secila grua do të jetë me burrin e saj që e do në xhenet, edhe nëse ai ka më shumë gra, ajo do të jetë me atë që e zgjedh vetë dhe që i ka sjelljet më të mira. Kjo argumentohet me hadithin e Umu Selemes, e cila e kishte pyetur Pejgamberin, s.a.v.s., duke i thënë:

“O i Dërguari i Allahut, cilat janë më të mira (në xhenet) gratë e dynjasë apo hyritë symëdha?” Ai tha: ‘Gratë e dynjasë atje janë më të mira se hyritë symëdha, sikurse ana jashtme e rrobave në krahasim me astarin!’ Unë i thashë: ‘O i Dërguari i Allahut, e çka i bën më të mira ato?’ Ai tha: ‘Me namaz, me agjërim dhe me ibadet. Allahu ua ka veshur fytyrat me dritë, trupin me mëndafsh ngjyrë të bardhë, janë të veshura me veshje të gjelbër, me stoli të verdha, mëngët prej margaritari dhe krehrit prej floriri. Ato do të thonë: ‘ne jemi të përjetshme – kurrë nuk do të vdesim, ne jemi të lumtura – kurrë nuk do të jemi fatkeqe, ne do të qëndrojmë këtu përherë – kurrë nuk do të largohemi, ne jemi të kënaqura – kurrë nuk do të zemërohemi, lum ai që na merr neve dhe lum ne kë e marrim!’ I thashë: ‘O i Dërguari i Allahut, një grua prej nesh mund të jetë martuar në këtë botë me dy burra, me tre apo me katër, pastaj vdes dhe hyn në xhenet, por edhe ata hyjnë në xhenet me të, cili do të jetë burri i saj?’ Tha: ‘Oj Umu Seleme, ajo bën zgjedhje dhe do ta zgjedhë atë që ka pasur sjellje më të mira, duke thënë: ‘O Zot, ky ndaj meje ka qenë më i sjellshmi në dynja, më marto me të! Oj

²⁹⁸ Një pjesë nga ky material është botuar në revistën “El Kabes”, më 3. 5. 2015.

Umu Seleme, më i sjellshmi do ta marrë më të mirën e dynjasë dhe të botës tjetër!”²⁹⁹

Urime për banorët e xhenetit, burra dhe gra! Allahu na bëftë prej tyre, na mundësoftë të banojmë në pallatet e tij, nën të cilët rrjedhin lumenjt! Më vendostë mua, Abdullahun dhe nënën e tij – me mirësinë dhe mëshirën e Tij – në Shtëpinë e falënderimit që na e ka premtuar! Unë sikur po e shoh me sytë e mi, me mendimin e mirë që kam për Zotin dhe për fuqinë e Tij! Sepse Shtëpia e falënderimit aspak nuk e pakëson pushtetin e Tij, ngase Ai është i Pasuri, Dhuruesi, Shpërblyesi, Furnizuesi, Bujari, i Gjithëfuqishmi, Madhështori dhe Ai është i Plotfuqishëm për çdo gjë.

Vërtet Ai që i posedon këto cilësi, nëse premtun diçka – e përmbush premtimin, qoftë ajo Shtëpia e falënderimit, apo diçka tjetër?! **“E kush është më i vërtetë se Allahu në fjalë?”**³⁰⁰ dhe ajeti më përpara, po në këtë sure: **“E, kush është në thënie më i drejtë se Allahu?”**³⁰¹

Sa i përket dallimit mes dy shprehjeve **“fjalë”** dhe **“thënie”**, për këto ne do ta kemi një stacion të veçantë në kuadër të rrugëtimit tonë me të dashurin Abdullah për në Shtëpinë e falënderimit.

²⁹⁹ Transmeton Ahmedin në *Musned*, hadithi 27334; Taberaniu në *El Mu'xhemul kebir*, dhe *El Mu'xhemul evsat*, hadithi 3141. Ky tekst është i tij.

³⁰⁰ Surja en-Nisa, 122.

³⁰¹ Surja en-Nisa, 87.

Shpirti i qetësuar: i kënaqur e kënaqës³⁰²

Shumë herë ne shfaqim vajtimin për të vdekurit përmes ajetit 28 të sures El-Fexhr: **“O shpirt i qetësuar! Kthehu te Zoti yt i kënaqur (për vete) e kënaqës (për Zotin)! Hyr mes robërve të Mi! Dhe hyr në Xhenetin Tim!”**³⁰³ Dhe të gjithë shpresojnë që i vdekuri i tyre të jetë pronar i shpirtit të qetësuar, të kënaqur dhe kënaqës.

Subhanallah! Theksimi i këtij shpirtit të qetësuar ka ardhur menjëherë pas theksimit të personit të penduar, i cili do të thotë: “Ah! Sikur të kisha punuar gjëra të mira në jetën time!”, kështu Allahu këtë e përmend kundrejt atij, të cilit i qetësohet shpirti me premtimin e Allahut, që ua ka bërë besimtarëve në këtë botë për nderin që do t’iu bëhet në botën tjetër. Ky është mendimi i Seidit nga Katade.

Siç kanë thënë Katade dhe Hasani: Ai shpirt është i qetësuar dhe beson në atë që ka thënë Allahu i Madhërishtëm.

Muxhahidi ka thënë: Ai është shpirti, i cili është bindur se Zoti i tij është Allahu dhe i është nënshtruar Atij dhe urdhrave të Tij.

Kurse El Hasan El Basriu ka thënë: Ai është (shpirt), i cili nëse do ta marrë Allahu, pajtohet me Allahun e Madhërishtëm, por edhe Allahu qetësohet me të.

Ibni Abasi ka thënë: Ai shpirt është i qetësuar me shpërblimin e Allahut të Plotfuqishëm.

Atë e urdhëron Allahu i Plotfuqishëm që të kthehet në afërsinë e Tij, tek shpërblimet e Tij dhe në ato që ua ka përgatitur robërve të Tij, kështu që i përgëzon me xhenet me rastin e vdekjes dhe në Ditën e tubimit me rastin e ringjalljes, të kënaqur dhe kënaqës, përkatësisht ai është i kënaqur me Allahun për ibadetin që ia ka bërë vetëm Atij dhe për besimin në premtimin e Tij, duke qenë edhe Allahu i kënaqur me të.³⁰⁴

Për këtë arsye, shpirti i qetësuar është shpirti i kënaqur i cili nuk frikësohet gjatë fatkeqësive as nuk bën panik gjatë goditjeve, por as nuk ekza-

³⁰² Një pjesë nga ky material është botuar me dy artikuj në revistën “*El Kabes*”, më 30. 9. 2015.

³⁰³ Surja el-Fexhr, ajetet 28-30.

³⁰⁴ Shih: *Tefsiri i Taberiut* 24/423, Asociacioni “*Risale*”, bot. I, viti 1420 h, 2000 m; *Tefsiri i Ibni Kethirit*, 8/390.

gjeron në gëzime e kënaqësi. Përkundrazi, ai qëndron i qetë, sepse e ka njohur realitetin e kësaj bote dhe përmasat e saj, andaj i është kushtuar botës tjetër.

Elementet më të thjeshta dhe karakteristikat e këtij shpirti të qetësuar janë:

- Përkushtimi ndaj Allahut të Plotfuqishëm, ndjekja e Sunetit të Pejgamberit, s.a.v.s., dashuria e fortë dhe devotshmëria për Allahun e Plotfuqishëm dhe dashuria për të Dërguarin e Allahut, s.a.v.s.
- Devotshmëria ndaj të Plotfuqishmit në çdo situatë dhe reflektimi i saj mbi personalitetin e pronarit me efektivitet dhe bamirësi, me urdhëresë për të mirë dhe ndalesë nga e keqja, me sjellje të mirë, me bamirësi ndaj njerëzve, me ndihmë njerëzve për kryerjen e nevojave të tyre, si dhe me ndershmëri në tri llojet e saj: me Allahun e Plotfuqishëm, me vetveten dhe me njerëzit.

O Allah, furnizona të gjithëve me shpirt të qetësuar, të kënaqur me caktimin e Allahut të Plotfuqishëm!

Dëshmoj o Zot, se Abdullahu i dashur – pa ekzagjerim – ka qenë me shpirt të qetësuar, i kënaqur me sëmundjen dhe vdekjen e tij. Andaj, furnizoje o Zot, me çka e furnizon shpirtin e qetësuar, e po ashtu edhe atë i cili e lexon këtë lutje.

Pas shkrimit të 36 artikujve të përqendruar rreth rrugëtimit tim me Abdullahun r.h. për në Shtëpinë e falënderimit, veçantia e shkakut nuk e ka penguar përfitimin e përgjithshëm. Aty shfaq shumë aspekte që i nevojiten pacientit, familjes së tij dhe të afërmeve të të vdekurit, nga aspekti i njohjes së përgjithshme nga kultura e sëmundjes dhe kultura e vdekjes.

Kështu, vetë Abdullahun nuk i është dhënë mjaft hapësirë për përshkrimin e personalitetit të tij, duke pasur parasysh faktin se personaliteti i tij është subjekt i librit, sidomos kur unë tash jam afruar përfundimit të rrugëtimit tim për në Shtëpinë e falënderimit.

Dhe ndoshta mund të thuhet se në fillim unë po e kujtoja ngjarjen në të cilën isha i plagosur, siç është e qartë edhe afërsia ime familjare, por unë – dhe Allahu e di se ndjenjat i kam të sinqerta – po i paraqes të dhënat në mënyrë objektive dhe për këtë kam shumë dëshmi unanime nga fjalët e të tjerëve, të cilët kanë pasur të bëjnë me të. Për këtë e falënderoj Allahun.

I ndjeri r.h. ishte i mëshirshëm, i butë, i lehtë për bashkëpunim, i respektonte edhe të tjerët, bashkë me prindërit. Jeta e tij ishte e mbushur me tolerancë, dhe në zemrën e tij nuk ushqente ndonjë të keqe ndaj të tjerëve, pa marrë parasysh sesa e ofendonte ndonjëri prej tyre. Krejt ajo çka bënte në lidhje ata që e dëmtonin, ishte shmangia e bashkëpunimit me ta derisa ata vetvetiu t'i ndiejnë gabimet e tyre pa ndonjë provokim apo fërkim.

I mirësjellshëm që pëlqen t'iu ndihmojë të tjerëve, qofshin të afërm, miq apo edhe të njohur. Ai, me secilin prej tyre, kishte raporte të veçanta, ku i trajtonte me vëmendje, i dëgjonte dhe i vlerësonte.

Ai kurrë nuk ka folur për shërbimet e tij që ua ka bërë të tjerëve, edhe pse kjo mund të ishte joshëse dhe interesante për ata që janë në moshën e tij. Ai me edukatën dhe respektin për vetveten, në mënyrë të natyrishtme e ka imponuar respektin dhe dashurinë e të tjerëve për të, duke i lënë kujtimet të bukura çdonjërit me të cilin bashkëpunoi, si të afërmit, të njohurit apo të tjerët – në fakt, ata e kanë humbur mjekimin e mirë ndaj tyre, respektin, shërbimet e këshillat e tij.

³⁰⁵ Ky material është botuar me dy artikuj në revistën “*El Kabes*”, më 31. 1. 2016 dhe 1. 2. 2016.

Ai, Allahu e mëshiroftë, me modestinë e tij, hapi një derë të miqësisë për të tjerët, madje edhe me prindërit dhe motrat e tij në butësi, në biseda, në ndarjen e shqetësimeve dhe në ndjenjën e përgjegjësisë ndaj tyre, veçanërisht kur ata kishin nevojë për të.

Atë e deshën të gjithë, të mëdhenj e të vegjël... ai përpiqej t'iu ndihmonte me sa kishte mundësi, sidomos në sferat ku kishte zotësi për të ndihmuar.

Ishte i mëshirshëm, ndjente dhembshuri për të varfrit dhe nevojtarët, si materialisht edhe moralisht. I refuzonte dëfrimet dhe nuk e shfrytëzoi rastin pse ishte djalë i vetëm në mesin e motrave të tij, për ndonjë përfitim material apo moral mbi to, por – pa asnjë ekzagjerim – e shtrinte krahun e ndihmës për to, saqë e braktisi Kuvajtin dhe udhëtoi me njërën prej tyre, kur këtë e kërkonin kushtet e saj për studime.

Ndërkaq, në mesin e shokëve të tij, ai ishte i njohur – siç u përmend më lart – për kujtime të bukura dhe karakter të butë. Shokët i kishte zgjedhur nga familjet e mira, ishin njerëz me integritet që nuk merreshin me gjëra të parëndësishme me të cilat merreshin të tjerët në këto vite kritike të moshës. Nëse dikush bënte ndonjë padrejtësi ndaj tij, ai largohej prej tij derisa drejtohej, ndërsa nëse dikush i bënte padrejtësi ndonjërit prej shokëve të tij, ai e mbronte fuqishëm dhe i inkurajonte edhe të tjerët të mos i bëjnë padrejtësi.

Shokët e tij kanë treguar se ai me një rast kishte diskutuar lidhur me një çështje fetare, ku mendimet ishin të ndryshme dhe ai pa qëllim kishte ngulur këmbë, ndërsa njëri nga shokët i thotë: “O Abdullah, unë jam më i madh se ti dhe mund të di gjëra që ti nuk i di.” Tregojnë shokët e tij, se atij iu ndryshua pamja e fytyrës dhe menjëherë deklaroi: “Po, ti je më i madh se unë dhe unë kam respekt për ty, pavarësisht që nuk pajtohen mendimet tona.”

E tillë ishte gjendja edhe me respektin dhe vlerësimin e më të mëdhenjve, të cilët e udhëzuan që nga vegjëlia për raportet e tij me mësuesit dhe trajnerët në të gjitha pozicionet e punës me ta, si në gjimnastikë, karate e të ngjashme, si dhe me profesorët e nderuar mbikëqyrës të trajnimeve në kurset dhe programet udhëzuese.

Ishte i kujdesshëm për përsosmëri në çdo gjë, i rregullt në të gjitha çështjet e tij, madje edhe në mënyrën e uljes dhe qëndrimit në sallon, në divan, apo në dhomën e tij personale. Priorja e tij për përsosmëri arriti deri në atë masë, saqë shokëve të tij ua korrigjonte edhe gabimet gramatikore

dhe gjuhësore, pasi që kishte bazë të mirë gjuhësore dhe aftësi të fokusi- mit dhe të kujtesës.

Kur është fjala për fokusimin dhe kujtesën, është interesante të për- mendim, duke cituar nga shokët e tij, se ai ishte pika kryesore e referencës në kërkesën e llojeve të ushqimeve nëpër restorante; pasi që i dinte llojet e ushqimeve dhe emrat e tyre, si dhe kishte dëshirë që t'i zbulonte resto- rantet e reja menjëherë pas hapjes së tyre. Është interesante gjithashtu, se disa prej tyre kur nuk ishte Abdullahu r.h. me ta, i telefononin atij dhe kërkonin që të fliste me kamerierin dhe t'ia shpjegojë kërkesat e tyre të veçanta, ndërsa ai këtë e bënte me zemërgjerësinë më të madhe në shër- bim të të tjerëve – Allahu e mëshiroftë!

Po kështu ishte rasti edhe me studentët e rinj të universitetit, ku bënte gjithçka ishte e mundur për t'iu shërbyer atyre dhe për t'ua përcjellë për- vojën e tij modeste në favor të tyre, kurse si shkëmbim, u shërbente disa të diplomuarve për t'u integruar me idetë e tyre në projektet e diplom- mit, sikur të ishte nga specializimi i tij, edhe pse në të vërtetë ato ishin larg specializimit të tij.

Ai nuk e përgojonte askënd, as nuk donte që dikush të bënte përgojim në praninë e tij. Edhe kur hynte në polemika me ndonjërin nga shokët e tij – për shkak të moshës dhe entuziazmit e shpërthimit rinor – ai shpejt pendohej dhe pajtohej me shokët e tij, pastaj e fajësonte veten duke thë- në: “Si ndodhi kjo!?”

Kur ishte në shoqëri me të tjerët, edhe nëse nuk i pëlqente shija, nuk e hidhte poshtë për hir të tyre. Kur e shijonte një ushqim të përgatitur nga nëna apo motra e tij që nuk e pëlqente, ai nuk e poshtëronte, por vetëm mjaftohej duke thënë: “Ti zakonisht gatuan më mirë se kësaj here!” Kjo ishte si përjashtim, përndryshe, ai zakonisht i inkurajonte me shprehjet më të bukura për ushqim të shijshëm.

Dhe kundrejt këtij personaliteti të dobishëm për studentët e rinj dhe ata të diplomuarit ai nuk lejonte për veten e tij të kërkonin ndihmë për përmirësim të suksesit nga mësimdhënësit e tij, pavarësisht nga rrethanat apo kushtet në të cilat ndodhej, kjo sidomos atëherë kur e lëndoi këmbën dhe u detyrua të ecte me paterica.

Etika e tij, kur u godit nga sëmundja e pashërueshme, ishte kapitull shtesë i sjelljeve të mira, siç përmenda më herët.

Sëmundjen e përballoi me shpirt të qetë, të karakterizuar me kënaqësi dhe bindje në caktimin e Zotit e mosmërzitje, kur u godit nga dhimbja e fortë në kokë nga njëra anë, si dhe kur mjekët ia shprehën hapur llojin e

sëmundjes dhe mundësinë e vdekjes së afërt në bazë të njohurive të tyre mbi realitetin dhe përvojën me këtë lloj të sëmundjes së pashërueshme, nga ana tjetër.

Mendjen e angazhonte në anën tjetër, që mos të jetë burim i pikëllimit dhe dhimbjes për të gjithë rreth tij, veçanërisht për nënën e tij të dashur, e cila shpresonte t'ia përcillte ndonjë ankesë, apo t'ia tregonte ndonjë bisedë sekrete, e cila mund ta mundonte. Sa ishte mbresëlënës momenti kur kërkoi nga nëna e tij që t'i afrohej dhe kur ajo mendoi se do t'i ankohej për dhimbjen që t'ia lehtësonte, ajo u befasua kur ai nga telefoni i tij nisi t'i tregojë asaj gjëra që t'ia zbusin gjendjen e tendosur që po përjetonte për shkak të rrethanave të sëmundjes së tij.

Për shkak të gjitha këtyre, nuk është e çuditshme kur shohim shenjat e pranimit të zërave të turmave duke u lutur për të: si ata që e njihnin, ashtu edhe ata që nuk e njihnin por kishin dëgjuar për të.

Gjithashtu, nuk është çudi që të lërë mbresa të bukura në të gjitha qarqet e jetës së tij sociale: në shtëpi, në familje, në divan dhe në universitet.

Allahu të mëshiroftë, o Abdullah dhe na bashkoftë mua dhe nënën tënde me ty – dhe premtimi i Tij është i vërtetë – në Shtëpinë e falënderimit.

Falënderimi i takon Allahut, në çdo rast dhe në çdo çast.

Përvojë praktike – Mi Abdullah Abdulaziz el Faris

Është mirë që njeriu të përfitojë nga eksperiencia e të tjerëve dhe mos të fillojë nga zeroja. Këtë përvojë praktike e ka shënuar shoqja e saj për ta hartuar një broshurë të dobishme, të vogël për nga vëllimi, por të madhe për nga përfitimi, ngase deri tani janë shtypur mijëra kopje në tri botime. Ajo është zonja e nderuar Mi Abdullah Abdulaziz el Faris, e inkurajuar dhe e nxitur nga bashkëshorti i saj, Dr. Hasan Abdulaziz Es Sind. Ajo përmes kësaj broshure ka përcjellë te të tjerët eksperiencën e saj me sëmundjen dhe kurimin falë Allahut të Plotfuqishëm. Këtë e ka bërë përmes një broshure elegante (në 36 faqe), në të cilën e ka përmbledhur përvojën e saj të pasur. Kjo broshurë është bërë, dhe vazhdon të jetë, referencë e kërkesës së vazhdueshme nga ana e të afërmeve dhe të dashurve të pacientëve me këtë sëmundje. Në vazhdim po citojmë tekstualisht përmbajtjen e plotë të temave të saj, të cilat e shprehin përmbajtjen e përgjithshme të broshurës:

- Përse këtë libër?
- Parathënie
- Definicioni i kancerit të gjirit dhe koncepti i tumorit benignj dhe tumorit malinj
- Cilat gra janë të rrezikuara për t'u prekur nga kanceri i gjirit
- Cilat janë shenjat dhe simptomat e kancerit të gjirit
- Vetekzaminimi i gjinjve
- Çka pas zbulimit të tumorit?
- Si bëhet mjekimi i tumoreve?
- Këshilla të dobishme pas mjekimit kirurgjik
- Mjekimi kirurgjik
- Kimioterapia
- Terapia me rrezatim
- Terapia e hormoneve

- Kimioterapia, komplikimet dhe parandalimi
 1. Dobësimi i përgjithshëm i trupit
 2. Zvogëlimi i imunitetit
 3. Problemi i rënies së flokëve
 4. Ndjenja e dobësimit
 5. Tharja e gojës dhe shfaqja e ulcerave
 6. Kapllëku
 7. Ndryshimi në ngjyrën e thonjve
- Mjekimi me besim: Përgatitja e vërtetë për ballafaqim me sëmundjen
- Para mjekimit shpeshto lutjet
- Rukja legjitime
- Mjekimi alternativ
- Mësova një mësim të ri në jetë

Sa e mrekullueshme është përmbajtja e kësaj broshure të vogël nga vëllimi, por e madhe nga përmbajtja. Unë, në këtë citim të përmbajtjes, po mjaftohem me theksimin e plotë të temës së fundit: “Mësova një mësim të ri në jetë.”

Zonja e nderuar Mi el Faris thotë:

Nga sprova e sëmundjes mësova mësim të vlefshme... dhe thesare të shtrenjta...

1. E falënderova Allahun për begatinë e imanit dhe Islamit: *“O Allah, që je rrotullues i zemrave, përforcona zemrat tona në fenë Tënde. O ndryshues i shikimeve, ndryshoji shikimet tona kah adhurimi ndaj Teje. O Allah, forcona me fjalë të qëndrueshme, në jetën e kësaj bote dhe në botën tjetër”*.

2. Sprova ma hapi derën e istigfarit, të dhikrit dhe të istirxhasë. Kështu që u angazhova me fjalët:

“O Allah, shpërblemë mua në fatkeqësinë time dhe kompensoma me më të mirë.”

“Ne jemi të Allahut dhe tek Ai kthehemi.”

“Më mjafton mua Allahu, s’ka zot tjetër përveç Tij. Unë mbështetem tek Ai, dhe Ai është Zot i gjithësisë madhështore (Arshit të Madh)!”

Kështu e shihja se po më qetësohej shpirti dhe po më kënaqej zemra.

3. Meditova në begatitë e mëdha të cilat po i gëzoj mëngjes e mbrëmje:

*“Dhe ju jep nga të gjitha ato që keni kërkuar nga Ai (sipas nevojave tuaja), e nëse doni t’i numëroni dhuntitë e Allahut, atëherë nuk do të mund t’i numëroni. – Njeriu, me të vërtetë, është zullumqar dhe mosmirënjohës.”*³⁰⁶ dhe ajeti: *“E, pak nga robërit e Mi janë falënderues.”*³⁰⁷ O Allah, më bëj mua prej pakicës falënderuese.
4. Kam jetuar e pasur me pasurinë e kënaqësisë dhe të pajtimit: *“Thuaj: Do të na godasë vetëm ajo që na ka caktuar Allahu, Ai është Zoti ynë dhe vetëm tek Allahu le të mbështeten besimtarët!”*³⁰⁸
5. E mësova kuptimin e shpresës së gjatë dhe sesi mund të ndryshohet nga gjendja shëndosh e mirë e me gjallëri në goditje me sëmundjen më të rëndë: *“Në kohën sa i hap dhe mbyll sytë, Allahu e ndryshon nga një gjendje në tjetrën”.*
6. U binda dhe meditova në kuptimin e fjalëve: *“Me të vërtetë Allahu është i Plotfuqishëm.”* Dhe Ai, i Lartmadhërishtëmi është i Vetmi Shërues i Plotfuqishëm për largimin e dëmit. Ai është Allahu për të Cilin nuk ka asgjë të pamundur as në tokë e as në qiell.
7. U ndjeva e begatuar kur njeriu ka familjarë – sidomos në momentet e krizës – sa jam ndier mirë me praninë e të dashurve të mi rreth meje, të cilët më stëmbushën me dashuri, kujdes dhe lutje. Ju luta Allahut që t’i ruajë dhe t’i begatojë me shëndet të përhershëm.
8. E mësova se njeriu mund ta jetojë jetën e tij dhe të buzëqeshë, parësisht se kalon nëpër sprova të vështira, nëse është i kënaqur me caktimin e Allahut për të.
9. Zbulova se unë kam vend në zemrat e një shumice të madhe, të cilët më deshën dhe u lutën për mua me lutje të bukura e të sinqerta. Dashuria dhe lutja e tyre për mua ishte balsam dhe ajo dashuri pati ndikim të madh për kapërcimin e sëmundjes.
10. Mësova se sprova është një rrugë për ta pranuar bindjen dhe se afri mi tek Allahu nuk përfundon me përfundimin e sprovës, ndaj sprova ishte dhuratë para se të ishte sprovë.
11. E ndjeva kuptimin e vërtetë të vëllazërisë për Zotin. Të gjithë janë përkushtuar që unë ta shtrëngoja rripin, kanë pyetur dhe kanë bërë lutje për mua, janë angazhuar çdo gjë që sjellë kënaqësi dhe qetësi

³⁰⁶ Surja Ibrahim, ajeti 34.

³⁰⁷ Surja Sebe’, ajeti 13.

³⁰⁸ Surja Et-Tevbe, 51.

në shpirtin tim, siç është: sjellja e broshurave me lutje të ndryshme, përgatitja recetave mjekësore popullore, krahas garimit për të më sjellë ujin e bekuar të Zemzemit, i cili nuk më është ndërprerë gjatë gjithë periudhës së kurimit tim. Andaj, e falënderova Allahun për këtë begati të madhe dhe iu luta Allahut që t'i bëjë prijatarë në vepra të mira.

12. Mësova se sprova është një sihariq nga Allahu dhe dëshmi e dashurisë së Tij ndaj robit, ndaj u pajtova me sprovën dhe e falënderova Allahun për të.
13. E ndjeva kuptimin e hadithit “*Shëroni të sëmuret tuaj me lëmoshë!*”³⁰⁹ dhe e përjetova efektin e lëmoshës në kurim dhe shërim.
14. E falënderova Allahun për sëmundjen, ajo ishte një ballafaqim me vetveten për përtëritjen e tevbës dhe pendimit, për shfrytëzimin e kohës dhe shëndetit, dhe për afrim tek Allahu me vepra të mira.
15. E mësova kuptimin e këshillës së Pejgamberit, s.a.v.s., për Ibni Abbasin r.a. kur e këshilloi: “*Ruaje Allahun, nëse do që Allahu të ruajë ty. Ruaje Allahun, Atë do ta kesh pranë teje. Kujtoje Allahun në mirëqenie, e do të kujtojë Ai ty në vështirësi. Dije, se sikur i gjithë njerëzimi të mblidhej bashkë për të ndihmuar, nuk do arrinte të ndihmojë më tepër, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Në të kundërtën, nëse do të mblidhej për të të dëmtuar, nuk do të dëmtojë më tepër, përveç asaj që ta ka caktuar Allahu. Dije, se pas durimit vjen shpëtimi, pas ankthit vjen qetësimi, ndërsa pas vështirësisë vjen lehtësimi.*”³¹⁰
16. E ndjeva fisnikërinë e Allahut të Madhërishëm dhe mëshirën e Tij të madhe; më mbuloi nga bujaria e Tij me bollëk në gjithë jetën time, më dhuroi shërimin, dhe iu ktheva jetës sime normale. Të gjitha falënderimet dhe mirënjohjet i takojnë Allahut.

³⁰⁹ E regjistron Taberaniu në *El Mu'xhemul kebir* (128/10), hadithi nr. 10197, dhe në *El Evsat* (284/2), hadithi nr. 1963.

³¹⁰ E regjistron Taberaniu në *Ed Dua*, hadithi nr. 41.

Ftesë për dokumentimin e eksperiencave të tjera

Kjo ishte përvoja ime modeste dhe përvoja e motrës së nderuar, z. Mi El Faris, nga e cila prore po përfitoj duke e theksuar përmbledhjen e saj. Ajo u shtyp në një broshurë elegante, e cila u botua disa herë dhe u shpërnda në mijëra kopje të saj. Në të ka përfitime të mëdha, pavarësisht se përmbajtja e saj është e fokusuar dhe e përqendruar në një lloj të veçantë. Duke u nisur nga këto dy përvoja, u bëj thirrje të gjithë pronarëve të përvojave të ngjashme, në kontekstin e sëmundjes dhe vdekjes, që t'i dokumentojnë përvojat e tyre në mënyrë që të përhapet dobia e tyre. Edhe pse në tërësinë e tyre ato janë përsëritje, megjithatë, në detajet e tyre – sipas parashikimit tim – do të jenë të ndryshme me shenja të veçanta, të cilat ndryshojnë nga një person në tjetrin, varësisht nga fuqia e tyre e besimit, nga dallimi i ndërveprimit të tyre me mjedisin që i rrethon dhe me ndodhitë e ndryshme, nga ndërveprimet e ndryshme njerëzore, nga modelet e ndryshme të të menduarit dhe nga perspektivat e njohurive.

Transferimi i përvojave të të tjerëve është i dobishëm, në mënyrë që të mos fillohet nga zeroja në zbulimin e karakterit të udhëtimit besimor dhe praktik, i cili mund të përfundojë me shërim – me lejen dhe ndihmën e Allahut – ose në Shtëpinë e falënderimit, të atyre që e falënderojnë Allahun dhe bëjnë istirxha' me rastin e humbjes së birit të dashur apo ndonjë të afërmi të familjes.

Krejt çka nevojitet në kontekstin e dokumentimit të kësaj çështjeje, është një penë e lehtë dhe një guxim letrar për dokumentimin e përvojës. Mendoj se kjo është një punë e lehtë, që nuk kërkon domosdo ndonjë përgatitje të posaçme fetare apo mjekësore, por vetëm aftësi të arsyeshme dokumentare.

Allahu iu ndihmoftë të gjithëve! Unë jam i gatshëm t'i ndihmojë secilit që dëshiron dokumentim të ngjashëm të përvojës së tij.

Allahu ndihmoftë në çdo të mirë! Ai është Udhëzues në rrugë të drejtë!

Përfundimi³¹¹

Në fillim, dhe para çdo përfundimi, duam të theksojmë se ky është vetëm një përfundim i përkohshëm për dokumentimin e këtij udhëtimi me të dashurin Abdullah për në Shtëpinë e falënderimit dhe në monumentet e saj më të shquara. Ndërkaq, ai është fillimi, me vullnetin e Allahut, i premtimit të vërtetë për t'i takuar në Shtëpinë e falënderimit të gjitha ato konsiderata të rëndësishme që janë theksuar në rrjedhat dhe përmbajtjen e këtij libri të bekuar, dashtë Zoti, të mbështetur me tekste fetare nga Kurani dhe Suneti.

Kurani në interpretimin e tij është i qartë, edhe hadithet e cituara nga Suneti janë autentike.

Andaj, e sigurojmë lexuesin e respektuar, për saktësinë e teksteve fetare të cituara nga këto dy burime, të cilat është më mirë t'i dijë pacienti dhe të afërmit e tij, siç është mirë t'i dinë edhe të afërmit e të vdekurit, Allahu i mëshiroftë, sepse mund të mos i dinë shumë prej tyre. Kësaj i kam kush-tuar kujdes gjatë hartimit të temave më të dalluara, për të cilat ata mund të kenë nevojë në rrjedhën e udhëtimit të tyre me të sëmurët, Allahu i shëroftë, ose me të vdekurit e tyre, Allahu i mëshiroftë.

Kjo është përmbledhje e një eksperience modeste, për paraqitjen e së cilës më shtyri ndjenja e përgjegjësisë për transferimin e përvojës së dobishme të tjerët, të cilët mund të kenë nevojë, si nga aspekti fetar, ashtu edhe nga ai dynjasë, të cilën po ua paraqes me plotë modesti dhe pa mburrje para tyre, duke e konsideruar veten më të ulët për nga dija dhe njohuritë, sepse ka shumë që diturinë e përcjellin tek ata që janë më të dijsëm dhe se *'urtësia është një gjë e humbur e besimtarit, kudo që ta gjejë, duhet ta marrë, sepse ai është më meritori për të.'* Ndërkaq, mua si shpërblim më mjafton, shtimi i njohurisë, apo marrja e ndjenjës së këshillës, apo fitimi i eksperiencës, apo përkujtimi i atij që ka zemër, i bindur se unë do të jem – me vullnetin e Allahut – pjesëmarrës në shpërblim, pa iu pakësuar aspak shpërblimi i atyre që përfitojnë prej saj dhe e lus Allahun e Plotfuqishëm, që nga kjo të ketë shpërblim të madh i dashuri ynë, Abdullahu, i cili është strumbullari i librit, shkaktari i shkrimit të tij dhe kjo është e dashur për Allahun e Plotfuqishëm.

³¹¹ Ky material është botuar në revistën “*El Kabes*”, më 14. 2. 2016.

Dhe, gjithsesi, çdokush që angazhohet ka shpërblim. Unë i lutem Allahut që të më japë dy shpërblime; një shpërblim për punën dhe angazhimin dhe shpërblimin tjetër për veprim të drejtë e të suksesshëm.

E lus Allahun e Plotfuqishëm, që lexuesi i nderuar të përfitojë nga ky libër, sidomos lexuesi i interesuar për temat e tij.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

Mallëngjimi i fundit në shpirt

Në fund, libri përfundon, por nuk përfundon rrugëtimi im i mirë me Allahun për në Shtëpinë e falënderimit! Unë ndoshta ia arrita t'i dokumentoj parametrat e udhëtimit, në të cilët i sqarova eksperiencat për të cilat ka nevojë udhëtari në një rrugë të tillë.

Mirëpo, në mallëngjimin e fundit të zemrës sime, e falënderoj shpirtin e Allahut, i cili me vullnetin e Allahut, prehet i qetë dhe i kënaqur në varrin e tij:

Faleminderit, Abdullah ...

*faleminderit, që si i gjallë dhe si i vdekur,
më dhurove kënaqësinë e përkujtimit të Zotit tim,
më bërë që përmes tij të ndihem krenar me fenë time dhe me besimin tim,
më motivove me shpirtin tënd të mirë, që ta nxjerr një libër si ky për të gjithë ata
që kanë nevojë, ku tubova – sipas njohurive të mia modeste – çfarë nuk ishte
tubuar më parë, vendosa brenda kopertinave të një libri, për njerëzit e ngjashëm
me mua të cilët kanë kaluar nëpër përvoja të ngjashme dhe të cilët i ka sprovuar
Allahu i Plotfuqishëm. Dhe si kompensim ua ka premtuar Shtëpinë e
falënderimit.*

*Faleminderit, i dashur, Abdullah ... njafton që ti pas largimit tënd, syve të mi ua
bërë më të lehtë nxjerrjen e lotit, pasi që i pati hutuar jeta me preokupimet dhe
obligimet e saj të shumta. Ato më ndaluan me veten time dhe ndjeva se loti im u
bë një mik i imi më shumë se kurrë më parë, sidomos në momentet e shpërfytyrimit
në namaz apo në momentet e përkujtimit.*

Nuk do të them ty, i dashur: lamtumirë ...

por po të them: mirë u takofshim

në Shtëpinë e falënderimit - me vullnetin e Allahut.

Sa e dashur është kjo për Allahun, i Cili e përmbush premtimin!

A përfunduan stacionet e udhëtimit?³¹²

Me fjalë të tjera, a përfunduan temat e këtij libri?

Përgjigja e qartë buron nga gjeneza e burimit të librit, e që në tërësinë e tij është një përmbledhje e mendimeve prej të cilave mallëngjehet shpirti dhe një mori e fakteve dhe përvojave modeste të cilat desha t'i përcillja te të gjithë ata që kanë pasur një përvojë të ngjashme, e që në shumicën e rasteve janë tri kategori të veçanta:

1. I sëmuri,
2. Të afërmit e të sëmurit dhe
3. Të afërmit e të vdekurit.

Këtyre mund t'ua shtojmë edhe tri kategori të përgjithshme:

1. I mençuri i arsyeshëm, i cili dëshiron të përfitojë nga përvojat e të tjerëve.
2. Predikuesi që ka nevojë për njohuri të reja në përhapjen e thirrjes së tij.
3. Ai, i cili, për shkak të natyrës së punës, bashkëpunon me të sëmurin, familjarët e të vdekurit, specialisti, sociologu dhe psikologu në spitalet dhe shtëpitë e kujdesit.

Është e natyrshme që pas botimit të këtij libri të dalin në pah disa mendime të tjera, të cilat mund të jenë me vlerë në këtë kontekst, por, ndoshta është e papërshtatshme që të vonohet shtypi i librit për shkak të këtyre materialeve shtesë, pasi që materialet themelore dhe kryesore tashmë janë përmendur falë ndihmës së Allahut të Plotfuqishëm.

Prandaj, botimi i këtij libri në formën e tij aktuale, është një angazhim i domosdoshëm në suaza të rrethanave dhe kohës, siç thuhet: e domosdoshme është ajo që është e domosdoshme, andaj është e domosdoshme që eksperiencia të arrijë deri në cakun e saj, se ndoshta në të do të ketë përfitim dhe udhëzim, qoftë edhe një person nëse përfiton nga informacionet dhe eksperiencat e përfshira në këtë libër.

Allahu është mbështetës i suksesit.

Falënderimi i takon Allahut, Zotit të botëve.

³¹² Ky material është botuar në revistën “*El Kabes*”, më 31. 1. 2016.

Po fotografitë ku janë?

Lexuesi i nderuar mund ta parashtojë një pyetje legjitime të pritshme për libra dokumentarë të ngjashëm si ky, e ajo është: “Po ku janë fotografitë e të mëshiruarit, Abdullahut – me lejen e Allahut?”

Është e natyrshme që një libër si ky të mbushet me fotografi të personazhit rreth të cilit sillet libri, ose të vendoset një shtojcë e veçantë me fotografi që përmbledhin jetën Abdullahut r.h., nga fëmijëria deri te sëmundja dhe vdekja. Megjithatë, unë u mjaftova me një fotografi në kopertinë, e cila e shpjegon titullin e librit, duke marrë parasysh si vijon:

- Privatësinë e imazheve sociale dhe personale.
- Përqendrimin e vëmendjes në thelbin e idesë përmes parametrave të udhëtimit për në Shtëpinë e falënderimit.

Veprimi sipas parimit “Arsyeja e veçantë nuk e ndalon të mirën e përgjithshme”, parim i cili librin e bën objekt interesimi për të gjithë ata njerëz që kanë kaluar nëpër rrethana të sëmundjes dhe që të afërmit e tyre i pranojnë rrethanat e vdekjes.

Pastaj, me kalimin nga ngjarja private në dobi të përgjithshme, lexuesi do të ndiejë se po lexon diçka prej të cilës edhe ai vetë ka përfitim dhe jo vetëm fjalim për kujtimet e të tjerëve.

Dhe në fund, nuk mund të përmbahem pa e shtuar edhe një arsye për mosvendosjen e këtyre fotografive në libër – edhe pse i kishim në dispozicion – për shkak se në këtë mënyrë unë e kam respektuar dëshirën kolektive të familjes të çmuar “të nënës dhe motrave të Abdullahut”, sepse libri u intereson atyre.

Me çka veçohet dhe karakterizohet ky libër

Siç thashë në fillim të këtij udhëtimi të mirë me Abdullahun e dashur për në Shtëpinë e falënderimit, me titullin “Referencë për atë me çka veçohet dhe karakterizohet ky libër”, unë nuk e preferova që librin tim ta fillojë me forma të veçimit dhe karakterizimit të cilat m’i përmendi vëllai im bujar, Dr. Ahmed Sejid Ahmed, në margjinat e redakturës gjuhësore të librit.

Dr. Ahmedi me mirësjellje thotë:

Falënderimi qoftë për Allahun, paqja dhe bekimi qoftë për zotërinë tim, të Dërguarin e Allahut, për familjen e tij dhe për të gjithë pasuesit e tij. Pastaj:

Pasi që e lexova librin me kujdes, më dolën në pah disa çështje, të cilat ndoshta janë veçori të këtij libri të bukur dhe vendburim i madhështisë e cilësisë – Allahu i mëshiroftë autorin dhe shkaktarin – dhe mendova t’i shënoj disa syresh me qëllim që të përfitojnë të tjerët. Ato janë si vijon:

Libri i ka integritet të fjalëve, shprehje të lehta, kuptime të qarta, ndaj në të nuk gjen barbarizma, fjalë të pazakonta, banale, as fjalë me kuptim dhe përmbajtje të fshehtë.

Libri përmban diversitet të temave dhe shumëllojshmëri të objektivave, pasi që aty gjejmë qetësim për të dëmtuarin, ngushëllim për humbjen e të dashurit, inkurajim për durim dhe pajtim, rrëfim i vuajtjeve me synim përfitimi, dhënie e këshillave dhe udhëzimeve, ofrim i ndihmës dhe asistencës, përgëzim me dimension shpirtëror i pasqyruar në Shtëpinë e falënderimit, vajtim i lavdisë së humbur të duarve tona, shkëndija të poezisë arabe ... në këtë mënyrë ai është një oazë e pasur, nën hijet e së cilës ka dituri, letërsi, këshilla, udhëzime, aromë të mirë dhe borzilok. Allahu e mëshiroftë shkaktarin e këtij libri, e mëshiroftë gjithashtu edhe atë që e përmirësoi natyrën dhe shkrimin e tij, ia ruajt familjen, të afërmit dhe të dashurit.

Libri është dokumentim i një udhëtimi me vuajtje “mes frikës dhe shpresës” të përjetuar nga e gjithë familja, babai, nëna dhe motrat. Çdo rresht në të rrëfen një kapitull prej kapitujve të përvojës së ashpër me plot

kuptimin e fjalës, përvojë e cila i dridh malet e përforcuara, po mos të ishin mirësia dhe bujaria e Allahut, kështu që ky libër meriton lexim dhe shqyrtim të kujdesshëm.

Mes kopertinave të librit, gjejmë një sintezë të suksesshme mes ankthit të ndarjes me fëmijën e humbur dhe dëshirës e madhe për Shtëpinë e falënderimit, të premtuar nga Zoti Absolut, për atë i cili bën istirxha' dhe falënderon, me rastin e humbjes së djalit, loçkës së shpirtit, mikut të dy-njasë dhe kapitalin e veprave të tij të mira në botën tjetër.

Libri synon një segment të gjatë dhe një sektor të madh të atyre që për një kohë i ka mbuluar harresa, e që janë të sprovuarit, qoftë në vetvete, qoftë në familjet e tyre. Ai është si një balsam për zemrat që i ka rraskapitur dhimbja, si një shkëlqim shprese për zemrat e dëshpëruara për takim pas largimit, të vrara nga tronditja dhe të mbuluara me lotin e të gjorit.

Libri ia bën një pasqyrim preciz dhe monitorim të kujdesshëm gjendjes shpirtërore të pacientit të cilin e kaploi sëmundja në një periudhë të shkurtër kohore, që u pajtua me ndarjen, pa e humbur durimin, pa e lënë kënaqësinë, pa e humbur buzëqeshjen në fytyrën e tij, sikur po i fliste familjes dhe të afërmeve të tij me gjuhën e gjendjes para gjuhës së shprehjes: Myzhde, o të dashurit e mi, se Shtëpia e falënderimit është takimi.

Libri ngërthen në vete kapituj të kompiluar me një stil të ri, ku gërshe-tohet ngjyrimi fetar me përvojën personale, siç është shembulli:

Sprova dhe durimi, ndërsa kundrejt tyre është pajtimi me to; ndalimi i vajtimit më zë dhe të qarët; sikur bën një proklamim se shpirti, edhe përkundër peshës së dhimbjes, ka fuqi për të duruar, se zemra edhe përkundër mizorisë së ndarjes, ka fuqi të pajtohet nëse qetësohet dhe bindet në premtimin e Zotit të Lartë, duke e përcjellë autori përvojën e tij, vuajtjet dhe përfitimin. Kështu që ju mund të lexoni përmbajtjen me titullin **Udhëtimi për në shtëpinë e falënderimit më mësoi** dhe do të gjeni shumë të mira.

Në libër gjejmë pushim në flladin e Shtëpisë së falënderimit, zhytje në kuptimet e tij, shëtitje në përshkrimet e tij dhe të atyre që ka përgatitur Allahu për robërit e Tij durimtarë, falënderues, që bëjnë istirxha' dhe shpresojnë përgjatë një udhëtimi besimor të mbështetur me durim dhe me pajtim.

Libri flet për filozofinë e sëmundjes dhe të vdekjes, për lutjet dhe rukjet në Islam. Kështu, me këto metoda del jashtë kornizës së traditës, duke folur për zemrën dhe mendjen, ofron fakte rreth tyre, por kësaj here duke i shoqëruar ato dyja me sëmundjen, duke e pritur me padurim

shpërblimin e shpresuar. Ato dyja (zemra dhe mendja) janë të vetëdijshme për realitetin e mirësisë hyjnore edhe në kushtet më të errëta, të cilat i përjeton njeriu dhe a ka diçka më të egër sesa sëmundja e pashërueshme dhe vdekja që bën ndarjen e të dashurve.

Libri bën një krahasim të veçantë ndërmjet sistemit mjekësor tek arabët në të kaluarën dhe sistemit evropian të asaj kohe, duke i vënë në pah aspektet mjekësore që i karakterizojnë myslimanët kur filloi vakëfi shëndetësor dhe roli i tij në kujdesin shëndetësor, duke vazhduar me themelimin e *'Pimaristaneve'* te myslimanët dhe shërbimet që ato ofronin atëbotë, në krahasim me sistemin evropian të atëhershëm, të pazhvilluar dhe të prapambetur.

Ai e bën sqarimin e ndërrimit të roleve në kohën bashkëkohore, sesi u tërhoq roli mjekësor islamik në favor të sistemit shëndetësor perëndimor aktual, duke i lënë hapësirë gati të pakrahasueshme në të shumtën e rasteve, sepse stagnoi sistemi ynë mjekësor, duke i munguar transparenca, shërbimet e avancuara, si dhe efikasiteti në shumë aspekte të tij. Në këtë mënyrë, mbeti në bisht të karvanit, pasi që ishte drejtues i tij me meritë dhe kompetencë. Ndërkohë, sistemi mjekësor perëndimor shënoi ngritje me progres shkencor, si nga aspekti human ashtu dhe ai material, e bashkoi thellësinë specialistike me integrimin e disiplinave, pastaj u zhvillua sistemi i sigurimeve, me rolin e tij dhe shumën e shpenzimeve të investuara. Respektimi i aspektit humanitar në mjekimin pacientëve dhe familjarëve të tyre, transparenca e plotë në ofrimin e informacioneve për ta, dhomat e pritjes të përgatitura për shoqërimin e pacientëve me familjarët e tyre, siç është: dhoma për bashkimin familjar të pacientit, dhoma për ibadet dhe lutje, dhoma për pritje të operacionit, dhoma e kujdesit intensiv, dhoma e kujdesit mesatar, dhoma e kujdesit të zakonshëm, e të ngjashme, nga format përparimit dhe kujdesit. Këto janë gjëra të cilat duhet t'i posedojnë edhe qendrat tona mjekësore dhe nuk është për t'u habitur, sepse *'urtësia është një gjë e humbur e besimtarit, kudo që ta gjejë, duhet ta marrë, sepse ai është më meritor për të.'* Të gjitha këto të përmendura dhe shumë të tjera i gjejmë në brendi të këtij libri të mirë.

Nga temat që prodhoi libri dhe me të cilat karakterizohet, është se ai për lexuesin vendosi hapa praktikë, të cilët patjetër duhet t'i ndjekë në rast të sëmundjes fatale. Autori e dokumenton përvojën e tij dhe e përcjellë tek të tjerët në mënyrë që ata të përfitojnë. Ai sprovën e vet nëpërmjet të cilës ka kaluar, e bën edhe sprovë për të tjerët me të cilën atyre ua lehtëson gjendjen dhe ua hap rrugën. Kjo është prej avantazheve dhe bukurive

të këtij libri. Prandaj thuhet se nismëtari edhe nëse nuk ka ndonjë përparësi ndaj pasuesit, atij i mjafton vetëm fakti që ia ka hapur rrugën!

Libri ka dhënë përgjigje të kënaqshme në pyetje të cilat shtrohen shpesh, sidomos nga ata që e kanë humbur fëmijën e tyre, ose me fjalë të tjera, i cili e ka të ruajtur te Zoti i tij dhe është privuar nga shpërblimi i lutjeve të tij “ose fëmija i mirë i cili lutet për të”, a ndodh arritja e shpërblimit, nëse ndërrohen rolet? Këtë e gjejmë të qartësuar në pjesën me titullin: **Prindi i mirë i cili lutet për të.**

Libri e korrigjon konceptin e gabuar, për të cilin një kohë të gjatë janë lidhur shumë prej atyre që e kanë keqkuptuar me dashje ose pa dashje, duke konsideruar se pasuria e vërtetë qëndron në grumbullimin e parave dhe posedimin e pronës, duke sqaruar se pasuria e vërtetë qëndron në dashurinë e krijesave, që janë produkt i dashurisë së Zotit, siç thuhet në hadithin e famshëm. Lidhur me këtë dashuri, libri ofron shembuj për të cilët flet gjer e gjatë. Më saktësisht për këtë flitet në tekstin me titullin **Zbulimi i thesarit të pasurisë, unë jam miliarder.**

Libri ua qetësoi mendjen dhe zemrën shumë grave myslimane, të cilave xhelozia ua kishte kapluar zemrat, si dhe dha përgjigje në shumë pyetje që qarkullonin te një shumicë e tyre, e madje edhe mua personalisht shumë herë më është bërë kjo pyetje: Kush janë hyritë ‘symëdha’? Dhe a duhet të xhelozohen ato? Libri jep përgjigje të kënaqshme, duke sqaruar se në xhenet nuk ka xhelozë dhe se gjendja e besimtares në xhenet është më e mirë se gjendja e hyrive symëdha, se ato janë në një gradë më të lartë dhe janë më të bukura. Këtë formulim mund ta gjejmë te teksti me titullin **Sihariq i madh për gruan myslimane në xhenet.**

Libri nuk e lë pas dore as fjalimin për poezinë dhe poetët në lidhje temën e tij, duke ia kushtuar një kapitull në të cilin autori na jep tablo të gjalla të vdekjes së pejgamberëve në plagët e poetëve dhe këtë përshkrim mund ta gjejmë në libër me të njëjtin titull.

Në libër iu bëhet thirrje e hapur baballarëve dhe nënave që ta zbulojnë botën e fshehtë të fëmijëve të tyre, talentin e tyre të robëruar brenda vetes dhe t’i vendosin linjat e komunikimit midis brezit të fëmijëve dhe brezit të prindërve.

Libri ngre alarmin për paralajmërim, vigjilencë dhe përkujtim për poseduesit e shëndetit që ta falënderojnë Zotin e tyre për begatitë dhe bekimet e Tij, të cilat i gëzojnë ditë e natë.

Libri, në tërësinë e tij, është thirrje për durim dhe pajtim me caktimin e Allahut, për besim në premtimin e Tij përmes pejgamberëve, por thirrja

këtë herë vjen nga një shpirt i cili u zhyt në eksperiment dhe e shqyrtoi atë pjesë-pjesë, duke shënuar risi në këtë kapitull.

Libri në disa kapituj paralajmëron për kujdes nga thirrësit për hyrje në dyert e besëtytnive, të magjisë dhe fallit, duke bërë thirrje për t'u marrë me shkencën fetare, për njohjen e ndikimit të saj në parandalimin e magjepsjes dhe obsesionit, sidomos tek i sëmuri.

Autori në librin e tij e prek edhe pjesën fikhore (juridike), të pasqyruar në ngritjen e disa çështjeve fikhore dhe origjinën e tyre. Këto tema mund të gjenden nën disa tituj, duke përfshirë: I VDEKURI NGA KANCERI ËSHTË SHEHID, LIGJSHMËRIA E HEQJES SË PAJISJEVE TË REANIMIMIT NGA TRURI I TË VDEKURIT, LIGJSHMËRIA E DHURIMIT TË SHPËRBLIMIT TË VEPRAVE TË MIRA PËR TË VDEKURIN.

Autori - Allahu e shpërbleftë - është kujdesur që të sigurojë një sasi sa më të madhe të gjërave të dobishme për lexuesin. Prandaj, ai në trajtimin e tij rreth sëmundjes dhe filozofisë së saj, nuk ka harruar të flasë edhe për disa rregulla në lidhje me sëmundjen dhe pacientët, duke përfshirë: Çfarë duhet për atë që e shoqëron apo e viziton pacientin, shpërblimin e shoqëruesit të pacientit, preferencën e qëndrimit të shkurtër tek i sëmuri...

Në përfundim, unë jam i detyruar që t'i drejtohem me lutje të singerta Zotit të tokës dhe të qiejve, që të ketë mëshirë për Abdullahun tonë të dashur, që Firdevsin e Lartë t'ia bëjë vend pushimi! Që ta lidhë me zemrat e familjarëve, të afërmve dhe dashamirëve të tij dhe t'i bashkojë ata me të në Shtëpinë e falënderimit, të premtuar nga Zoti i Madhërishtëm.

Përfundoi, lavdi Allahut!

Përfundimi i dokumentimit të këtij materiali u bë në përvjetorin e parë të vdekjes së Abdullahun të dashur, (Allahu e mëshiroftë) paraprijësit tonë (me vullnetin e Allahut) për në "Shtëpinë e falënderimit".

Përmbajtja

Falënderim dhe vlerësim për princin njeri!	6
Përse ky libër?.....	8
Përfituesit prej këtij libri	9
Një referencë që e veçon dhe e karakterizon këtë libër	10
Pikënisja e librit	11
Filozofia e radhitjes së përmbajtjes së librit	12
Gjuha e librit.....	14
Një fjalë falënderuese para rrugëtimit.....	16
Treguesit e shtegut të rrugëtimit	19
Njoftim me shtëpinë e falënderimit (pallatet, tendat dhe dhomat)	19
Kuvendet e banorëve të Xhenetit në Shtëpinë e falënderimit.....	22
Çfarë është thënë për shpërblimin e atij që e ka humbur fëmijën (fëmijët) ...	25
Sihariqet për durimtarët me rastin e humbjes së fëmijës.....	26
Mësim dhe ngushëllim nga njoftimet për humbjen e fëmijëve.....	28
Durimi me rastin e sprovës	31
Domethënia e durimit	31
Statusi i kënaqësisë dhe pozita e saj te durimi	31
Frytet e durimit në sprovë	32
Durimtarët janë fitues dhe të shpëtuar	33
Durimtarët shpërblehen pa masë!	33
Allahu i Plotfuqishëm ua kompenson durimtarëve me të mira!	34
Durimi është shkak i shlyerjes së mëkateve dhe shtim i veprave të mira	34
Durimi është shkak për udhëzimin e zemrave	34
Ndërmjet mjerimit dhe fatkeqësisë	35
Ndalimi i ulërimës dhe vajtimit të tepruar	36
Rreth respektit ndaj të vdekurit	40
E kush mund të jetë më i vërtetë se Allahu në thënie.....	42
Shqiptimi i shehadetit para personit që është në prag të vdekjes	44
Filozofia e sëmundjes sipas Islamit	45
Filozofia e vdekjes sipas Islamit	50
Filozofia e lutjeve dhe rukjeve sipas Islamit.....	55
Lutjet dhe rukjet	60
Format e përgjigjes së lutjes	65
Kushtet e pranimit të lutjes	67
Format e përgjigjes së lutjes	68
Përmbledhje e përgjithshme e rukjeve nga dijetarët më të njohur	69

Udhëzime	69
Mesazhi i nënës së Abdullahut, drejtuar dashmirëve të saj dhe dashmirëve të Abdullahut, ku kërkon prej tyre lutje për të	71
Shërimi i të sëmurëve nëpërmjet sadakave (lëmoshave).....	75
Tani më fal mua i dashuri Abdullah, madje edhe deri në një kohë tjetër!	79
Çfarë duhet të bëjë ai që e shoqëron pacientin apo e viziton?	82
Shpërblimi i përcjellësit të pacientit	84
Preferimi i mosqëndrimit gjatë te pacienti	85
Çka më mësoi rrugëtimi për në shtëpinë e falënderimit	87
Zbulojini botët e tjera te fëmijët tuaj	93
Cilat drama po na i tërheqin fëmijët tanë.....	95
Rëndësia e mjekimit dhe moskundërshtimi i tij me tevekulin (mbështetjen te Zoti).....	97
Mjekimi është i obligueshëm dhe nuk është në kundërshtim me tevekulin	99
I vdekuri nga kanceri është shehid.....	101
Ligjshmëria e heqjes së pajisjeve të reanimimit nga pacienti të cilit i ka vdekur truri	108
Shumësia e këshillave mjekësore te pacienti dhe familjarët e tij dhe vlefshmëria e tyre	110
Mirë se vjen fqinji ynë, Halid Abdulatif esh Shajië, në Shtëpinë e Falënderimit	112
Angazhimi civilizues i umetit islamik ndaj të sëmurëve të tij	114
Vakëfi shëndetësor	114
Vakëfi islamik dhe roli i tij në kujdesin shëndetësor dhe psikologjik	114
Pimaristani (spitali) organik në Bagdad.....	116
Vakëfi për shoqërimin e pacientëve dhe të huajve	116
Vakëfi për inspirimin e pacientit për shërim	117
Pimaristani i Madh i Dritës në Damask.....	117
Pimaristani i mirësisë	118
Pimaristani Kalavun – “Spitali el Mensurij”	118
Spitali i Merakeshit.....	120
Gjendja e spitaleve, atëbotë, në Evropë.....	120
Shoku ynë “numërori”, miku fisnik në duart e pacientit dhe të familjarëve të tij	122
Ligjshmëria e tespikut me numëror e të ngjashme	122
Vlera e istigfarit (kërkimit të faljes)	123
Përgjigje ndaj djallit bezdisës (‘el-vesvas’, ‘el-hannas’)	125
Shkenca mjeko-ligjore dhe ndikimi i saj në parandalimin nga tundimi dhe yshtja te pacienti.....	127
Komunikimi i lindjes së vërtetë... në një mesazh telefonik.....	132
Ose “prindi” i mirë i cili lutet për të.....	135
Zbulimi i thesarit të pasurisë: unë jam miliarder	139

Prej shenjave të pranimit	143
Lutjet e dashmirëve dhe njerëzve për të	143
Lehtësimi i lëmoshave për të	144
Kryerja e haxhit (tetë herë) për të	144
Kënaqësia dhe pajtimi me kadanë dhe kaderin (caktimin) e Allahut	145
Lehtësimi gjatë mjekimit të sëmundjes dhe gjatë vdekjes	145
Ëndrrat - bukuria përgëzuese për përfundimin e mirë	147
Madhështia e Islamit në ligjësimin e dhurimit të shpërblimit të veprave të mira për të vdekurin	151
Si mund t'iu dhurojmë kënaqësi banorëve të varreve	155
Xheneti nuk është vetëm “hyri symëdha”	158
Sihariq i madh për gruan myslimane në xhenet	160
Shpirti i qetësuar: i kënaqur e kënaqës.....	162
Abdullahu	164
Përvojë praktike – Mi Abdullah Abdulaziz el Faris.....	168
Ftesë për dokumentimin e eksperiencave të tjera	172
Përfundimi	173
Mallëngjimi i fundit në shpirt	175
A përfunduan stacionet e udhëtimit?	176
Po fotografitë ku janë?.....	177
Me çka veçohet dhe karakterizohet ky libër.....	178

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

28-188.5

El Xharullah El Harafi, Abdulmuhsin Abdullah

Rrugëtimi për në shtëpinë e falënderimit / Abdulmuhsin

Abdullah El Xharullah El Harafi ; e përkthyer nga arabishtja

Miftar Ajdini & Mulaim Shehu. – Prishtinë “Gjurma-botime”,

2017. – 209 f. ; 21 cm.

1.Ajdini, Miftar 2. Shehu, Mulaim

ISBN 978-9951- 427-50- 0



RRUGËTIMI IM ME ABDULLAHUN PËR NË SHTËPINË E FALËNDERIMIT

Libri është dokumentim i një udhëtimi me vuajtje “mes frikës dhe shpresës” të përjetuar nga e gjithë familja, babai, nëna dhe motrat. Çdo rresht në të rrëfen një kapitull prej kapitujve të përvojës së ashpër me plot kuptimin e fjalës, përvojë e cila i dridh malet e përforcuara, po mos të ishin mirësia dhe bujaria e Allahut, kështu që ky libër meriton lexim dhe shqyrtim të kujdesshëm.

Dr. Ahmed Sejid Ahmed

Përmbledhje e një rrëfimi të vërtetë të ngjizur në kuptimin e drejtë të një besimtari për jetën dhe vdekjen në këtë botë si dhe shpresën për shpërblimin në amshim - Shtëpinë e Falënderimit.

Mr. Amir Ahmeti

ISBN 978-9951-427-50-0



9 789951 427500

Rrugëtimi
PËR NË SHTËPINË
E FALËNDERIMIT